

Procesi konsultativ mbi iniciativën për themelimin e KOMRA-s

Pasqyrë e mendimeve, propozimeve dhe rekomandimeve

korrik - dhjetor 2009.



Konsultimet me bashkësinë lokale

Pulë, Kroaci
1 korrik 2009.

Konsultimet i kanë organizuar Qendra për Iniciativat Qytetare, Poreč (Kroaci) dhe Documenta Zagreb (Kroaci). Në tubim kanë qenë 25 pjesëmarrës nga organizatat për të drejtat e njeriut, shoqatat e të pësuarve e të zhdukurve, të organizatave rinore, grupeve të grave, shoqatave profesionale dhe të pushtetit lokal në Istri. Amir Kulagliq nga Srebrenica (BeH), Vesna Tersheliq (Documenta, Kroaci) dhe Eugen Jakovčić (Documenta, Kroaci) kanë qenë ligjërues, ndërsa tubimin e kanë moderuar Bisera Momčinović (Qendra për Iniciativat Qytetare, Pulë, Kroaci) dhe Goran Božićević (MIRAMIDA centar Groznojani, Kroaci). Radio Pula, Tv "Nova" kanë raportuar nga ngjarja. Gazeta "Novi list" dhe "Glas Istre" kanë botuar bisedën me Amir Kulagliqin të autorit Mladen Radiq si dhe tekstin „Ndërpriteni heshtjen dhe mohimin” të autores Tatjana Gromača.

Propozimet, mendimet dhe Rekomandimet e pjesëmarrësve

Iniciativa për KOMRA ka për qëllim ta evitojë heshtjen dhe mohimin e krimit.

Ajo me të cilën ndeshen vazhdimisht viktimat por edhe njerëzit normal në shoqëritë e lindura pas shpërbërjes së RSFJ, është heshtja dhe mohimi (...) Heshtja shfrytëzohet si metodë për ta arsyetuar krejt atë që nuk e keni bërë, mohimi është shans ta arsyetoni edhe atë që diçka keni bërë e që bash nuk është krejt ashtu. Kjo iniciativë ka për qëllim: ta ndërpresim heshtjen dhe mohimin, të fillojmë të krijojmë platformën që të flasim hapur mbi krimet. (Amir Kulagliq nga Srebrenica, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pulë, Kroaci, 1 korrik 2009)

Të gjitha krimet e luftës dhe të gjitha viktimat duhet të regjistrohen.

Në përgatitjen e këtij takimi kam kërkuar me intensitet disa persona që kanë dëshmuar, që kanë mbetur prapa familjeve të veta dhe që i kanë kërkuar familjet e veta, unë nuk i gjeta. E ka bërë koha të veten, apo thjeshtë janë transferuar (...) Do të doja që edhe këto shkelje të drejtave të njeriut, ato zhdukje, ato fate të pazgjidhura, vrasje të regjistruhen në regjistrin shtetëror. (Biserka Momčinović, Qendra për Iniciativat Qytetare Poreč, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pulë, Kroaci, 1 korrik 2009)

Viktimat frikësohen t'i tregojnë rrëfimet e veta, sepse përgjegjësit për krime janë në pushtet. KOMRA duhet të arrijë që frika të nis tu hyjë atyre njerëzve në eshtra.

Jam kthyer në Srebrenicë, jetoj atje. Dhe për keqardhjen time të thellë çdo ditë takoj njerëzit për të cilët dijë se kanë qenë pjesë e krimit si organizatorë, kryes apo nxitës. (...) ata, për pikëllimin tim të madh, të shpeshtën janë të inkuadruar në pushtet (...) dhe ata mund të krijojnë një ambient të jetës shumë të vështirë, plotë frikë e psikozë. (Amir Kulagliq nga Srebrenica, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pulë, Kroaci, 1 korrik 2009)

Dëshmitarët që është dashur sot ta tregojnë tregimin e vet nuk kanë ardhur. Përse s' kanë ardhur? Sepse kanë frikë. Sepse në rrethinën e tyre lokale ekziston njëfarë sherifi lokal nga i cili kanë frikë (...) Ky komision duhet të arrijë atë që ngadalë të ndryshohet ajo paradigmë. Ky komision duhet të arrijë atë që atyre njerëzve ngadalë të nis t'u hyjë frika në eshtra. (Tatjana Gromača, gazeta "Novi list", Kroacia, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pulë, Kroaci, 1 korrik 2009)

Shtrohet pyetja nëse në hapësirën e RSFJ-së së dikurshme ka gatishmëri pikëllimi për viktimat e huaja dhe të dënimit të kriminelëve në radhët tona.

Euripidi gjithashtu ka thënë se madhështia e një populli pasqyrohet në aftësinë e tij t'u pikëllohet edhe viktimave të popullit tjetër dhe në gatishmërinë e tij që t'i gjykojë kriminelët në radhët e veta. Unë pyes. a jemi ne tërësisht të përgatitur për këtë maksimum në këto hapësira? (Antun Perushko, Partia Social Demokrate, Kroacia, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pulë, Kroaci, 1 korrik 2009)

Mediat mund të luajnë rol të rëndësishëm në nxitje për bashkëndjenja ndaj viktimave tjera.

Është shumë i qenësishëm ai rol që mund të luajnë mediat. Thelbësore është që mediat t'i transmetojnë më tutje ato rrëfime (...) Thelbësore është se ato janë transmetuar me anë të televizionit, sepse aty njerëzve do tu sqarohej: 'E sheh, ka pas të pësuar në të gjitha anët e luftës.' (Vesna Tersheliq, Documenta, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pulë, Kroaci, 1 korrik 2009)

KOMRA duhet ta hulumtojë rolin e mediave në përgatitjen e luftës - disa i kanë dëgjuar mediat, kanë shkuar në front dhe kanë kryer krime.

E dini se disa nga këto krime i kanë krijuar mediat? Ju kujtohet para luftës, ju kujtohet çka shkruhej mbi Kosovën? I gjithë ai orkestrim ka ndodhur me anë të mediave. Pra, ato kanë qenë politike, shumë kriminel janë manipuluar. (Xhevdet Haxhiselimoviq, Shoqata Protogora, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pulë, Kroaci, 1 korrik 2009)

Kur KOMRA ta kryej mandatin e vet, Koalicionit për KOMRA i mbetet detyra rreth përgatitjes së Rekomandimeve mbi reparacionin dhe kthimin e refugjatëve e të zhvendosurve..

Dhe, kur komisioni e ofron atë regjistër zyrtar atëherë është e mundshme të punohet edhe në sqarimin plotësues, sepse çështja e kompensimit të drejtë në Kroaci ende është e hapur, sikurse që akoma është e hapur çështja e kthimit. (Vesna Tersheliç, Dokumenta, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pulë, Kroaci, 1 korrik 2009)

Në emër të Partisë Social Demokrate pajtohem se ekziston nevoja për formimin e KOMRA -s.

As krejt politika e as gjithë njerëzit nuk jemi të barabartë dhe unë personalisht mund të them, e mund të them edhe në emër të partisë për të cilën jam këtu (PSD) (...) absolutisht e mbështes një qasje të këtillë dhe nevojën e formimit të KOMRA-s (...) Unë besoj dhe PSD e mbështet. Besoj se partia do ta nënshkruaj këtë fletë anëtarësim dhe do t'ua kthejmë juve. (Antun Perushko, Partia Social Demokrate, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pulë, Kroaci, 1 korrik 2009)

Shoqëria civile në Kroaci nuk guxon të pajtohet që rrënimet, vrasjet, përndjekjet, shkatërrimet të imponohen si vlera të Luftës Atdhetare.

Tek ne në Kroaci lufta e arsyeshme mbrojtëse në një moment u shndërrua në fllorskullë mbi dinjitetin e Luftës Atdhetare. Lufta për nga natyra e vet është vepër kriminale. Ajo është shkatërruese. Ajo është gjakderdhje (...) Dinjitet kanë njerëzit (...) Ai shkatërrim, ajo gjakderdhje tek ne po orvatët të imponohet si vlerë e Luftës Atdhetare. A do të pajtohemi ne me vlerën e rrënimit, vrasjes, përndjekjes, shkatërrimit? (...) Nuk mund të pajtohemi me këtë. (Mladen Momčinoviq, Qendra për iniciativat qytetare Poreç, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pulë, Kroaci, 1 korrik 2009)

Për përfitimin e opinionit duhet të dëgjohet zëri i viktimave.

Duhet shkuar më me agresivitet në shoqëri. Domethënë, para se gjithash me anë të mediave. Pra, të zhurmohet. Të jemi prezent (...) Jepni pak jumbo-pllakata me kufomat (...) Le të kujtohet se ajo kufomë është nëna, babai, djali apo vëllai i dikujt dhe se është vrarë aty pardje. (Tatjana Gromaça, gazeta "Novi list", Kroacia, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pulë, Kroaci, 1 korrik 2009)

Duhet të dëgjohet (...) zëri i atyre viktimave, duhet diç ngjashëm shkuar me agresivitet, sepse njerëzit (...) nuk duan të kthehen, sidomos ne që nuk kemi përjetuar asgjë nga lufta këtu në Istri (...) Luftën e kemi parë vetëm në televizion (Denis Sgagliardi, Shoqata rinore Zum Pulë, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pulë, Kroaci, 1 korrik 2009)

Më duket se kini disa shprehje tejet të ashpra (...) Fushata po, jo agresive. Ne nuk guxojmë të jemi agresiv. (...) Ikni asaj që vetvetiu mund serish të prodhojë telashe. Domethënë, me kujdes, me mendim të mirë. (Xhevdet Haxhiselimoviq, Shoqata Protogora, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pulë, Kroaci, 1 korrik 2009)

Anëtarët e KOMRA-s duhet të jenë persona prej integriteti, profesionist në fushat e tyre, të pranueshëm në mbarë rajonin dhe të aftë për t'iu kundërvyer trysnive. Anëtarët e KOMRA-s duhet të jenë edhe përfaqësuesit e viktimave.

Njerëzit, (...) në atë komision i cili do ta vërtetojë se çfarë ka ndodhur gjatë atyre viteve, që ata njerëzit të punojnë ashtu si duhet profesionalisht punën e vet, që kjo të mos punohet nën ndonjë trysni politike sikurse që punohet në parim në komisione të ndryshme, tubime pune e kështu me radhë. (Denis Sgagliardi, Shoqata e të rinjve Zum, Pulë, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pulë, Kroaci, 1 korrik 2009)

Një gjë rreth së cilës duhet të pajtohemi është që anëtarët e KOMRA-s duhet të jenë njerëz me kredibilitet të veçantë moral të cilët gëzojnë (...) besim në mbarë rajonin (...) Aty nuk duhet të ketë vend për politikanët (...) Më duket se në këtë komision duhet të jenë shkencëtarët, sociologët, psikologët, avokatët por edhe përfaqësuesit e shoqatave të caktuara, sepse më duket se në shumë gjëra më pak dëgjohet fjala e viktimave (...) Kryesisht nga ata kërkohet të jenë dhënësit të informacioneve, por shumë pak flitet për nevojat e tyre. (Amir Kulagliq nga Srebrenica, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pulë, Kroaci, 1 korrik 2009)

Të rinjtë anojnë kah harresa dhe relativizmi.

Çështjen e së kaluarës duhet zgjidhur tash deri-sa kjo është e freskët.

Njerëzit e rinj e kanë përqaftuar këtë teori të harresës, çdo gjë nën tepih, kokën në zall, s'ka ndodhur asgjë. Nëse ne e harrojmë këtë thua se s'ka ndodhur gjë (...) shumica janë në gjurmën e njëfarë relativizmit të krimet. (Tanja Cariq, Gjumnazi i Pulës, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pulë, Kroaci, 1 korrik 2009)

Ajo që nuk dëshiroj, nuk dëshiroj që unë dhe gjen-nerata ime me gjashtëdhjetë vjet, nëse i përjetojmë ato gjashtëdhjetë vjet, të kapemi për temat e Luftës Atdhetare. Domethënë, këtë duhet zgjidhur derisa kjo është e freskët dhe kjo është gjë e shkëlqyeshme. (Denis Sgagliardi, Shoqata e të Rinjve Zum, Pulë, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pulë, Kroaci, 1 korrik 2009)

Është kryesore që faktet të hyjnë në dokumen-te, programe mësimore, tekste shkollore dhe në edukimin e fëmijëve. Vetëm ashtu mund të evi-tohen interpretime të ndryshme.

Unë e kam marrë për vete tekstin e historisë nga Republika Serpska në BeH, nga Federata e BeH, librin tonë nga Kroacia, nga Serbia dhe bash më inte-resoje interpretimi i këtyre ngjarjeve, të shpërbërjes së Jugosllavisë. Natyrisht, secili e interpreton sipas mënyrës së vet. Dhe ky është problem, ky është ai problemi i cili e ngarkon vërtetimin e të vërtetës dhe prandaj vetëm kjo qasje rajonale mund të jetë rrugë e vetme e drejtë. (Lidija Leshiq, profesoreshë e filo-zofisë dhe historisë nga Poreçi, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pulë, Kroaci, 1 korrik 2009)

Unë jam i interesuar veçanërisht që diçka nga kjo që po bëni ju të hy në dokumente, programe mësimor, në tekstet shkollore dhe në edukim (...) Fëmijët të na jenë primar (...) Kjo është kryesore. (Xhevdet Haxhi-selimoviq, Shoqata Protogora, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pulë, Kroaci, 1 korrik 2009)

Ministria jonë dhe arsimimi ynë në dokumentet e veta nuk e ka këtë për të cilën tash po flasim ne, që është jashtëzakonisht e rëndësishme. (Tanja Cariq, Gjumnazi i Pulës, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pulë, Kroaci, 1 korrik 2009)

Pushteti po i keqpërdorë shoqatat e viktimave të cilat shpesh flasin si dorë e shtrirë e pushte-tit, e jo si përfaqësues të viktimave.

Edhe viktimat shpesh herë i qasen apo e zbatojnë atë metodë të heshtjes dhe të mohimit apo të minimizi-mit të viktimave të huaja. Po për shkak që thjeshtë janë politikisht të keqpërdorur, ashtu që shpesh herë flasin si dorë e shtrirë e pushtetit, e jo si përfaqësues të viktimave. Kjo të shpreshtën ka të bëjë me do farë shoqata apo bashkësi. (Amir Kulagliq nga Srebreni-ca, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pulë, Kroaci, 1 korrik 2009)

Qëllimi i Iniciativës dhe i KOMRA-s është krijimi i atmosferës ku do të jetë e pashembullt të mohohet krimi.

Mendoj se do të jetë sukses i madh i kësaj iniciati-ve kur të arrijmë në atë fazë kur vërtetë do të jetë e pashembullt, e pa dëshirueshme, kur do të jetë e palejueshme që të flitet për krimet sipas kujtdo qoftë. (Eugen Jakoviçiq, Documenta, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pulë, Kroaci, 1 korrik 2009)

Qëllimi i KOMRA-s mund të jetë pajtimi, por ky është proces i cili kërkon dialog, çeljen e hapësirës për rishikime dhe pikëpamje të ndryshme.

Dhe pikërisht, kur them pajtim atëherë ky nuk është pajtim ku të gjithë do të përqafohemi, puthemi, të mbajmë figën në xhep (tallje me dikë), fjala nuk është me rëndësi çfarë ka qenë, veç pajtim i cili kërkon biseda të këtitlla, që kërkon pyetje, që kërkon një varg të tërë procesesh të ballafaqimit me të kalu-arën. Pajtimi si proces por edhe si qëllim, pajtimi që nënkupton se konfliktet e dhunshme më nuk do të ndodhin. (Goran Bozhiceviciq, MIRamiDA, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pulë, Kroaci, 1 korrik 2009)

Proces ky i cili do të dal nga iniciativa e këtitllë për mua është shumë më i rëndësishëm në këtë kuptim se sa në atë teknik, kush do të hyjë, çfarë përbërje do të kemi, e duam këtë mandat kështu apo të struk-turuar ashtu (...) Të shkohet në më shumë vende (...) dhe përfundimisht, të krijohet hapësira ku për këtë çështje seriozisht, lirisht dhe nga aspekte të ndryshme (...) do të flitet. Sepse, ky është parakushti themelor që pastaj të fillojë të zgjidhet. (Mladen Momçinoviq, Qendra për iniciativat qytetare Poreç, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pulë, Kroaci, 1 korrik 2009)

Iniciativa për KOMRA mund t'u shërbejë shoq-ërive tjera me probleme të ngjashme që të bar-tën me të keqën.

Por më duket se po ndërtojmë, jo më duket, veç jam i bindur se po ndërtojmë infrastrukturën për qërim hesapsh me të keqën në ndonjërin nga luftërat e ardhshme. Ne nuk kemi në këtë planet mekanizma të cilat do të barten me të keqën. (Goran Bozhiçević, MIRamiDA, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pulë, Kroaci, 1 korrik 2009)

KOMRA mund t'i shtyjë gjykimet në shpejtësi dhe cilësi të procedimit.

Nga KOMRA pres edhe trysni shtojce, edukim, ngritjen e vetëdijes në shoqërinë tonë e veçmas në gjyqësi. Sepse mendoj se vetë fakti se do të evidentohen sërish faktet, se ndoshta do të bëhen ca lëvizje përpara edhe në gjyqësinë tonë, në shpejtësinë dhe cilësinë e gjykimet. (Biserka Momčinović, Qendra për Iniciativat Qytetare Poreç, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pulë, Kroaci, 1 korrik 2009)

Nevojitet që në proces të përfshihen partitë politike dhe bashkësitë fetare

Elitat fetare dhe njerëzit jashtëzakonisht me renome fetare kanë qenë kundërshtar të vërtetimit të fakteve. Kjo është ajo që dhemb (...) Sepse unë nga ata pres që të na mësojnë dashurinë, tolerancën, mirëkuptimin e jo ksenofobinë. (Amir Kulaglig nga Srebrenica, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pulë, Kroaci, 1 korrik 2009)

U bë fjalë se do të bisedohet për bashkësitë fetare që është shumë mirë, sepse shpesh konfesionit dhe nacionalitetit në njëfarë mënyre lidhen, dhe aty ka qenë një nga arsyet e mobilizimit, (...) në këto hapësirat tona. Dhe e dyta, që mendoj se është shumë me rëndësi, është që të bisedohet me politikanët. (Mladen Momčinović, Qendra për Iniciativat Qytetare Poreç, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pulë, Kroaci, 1 korrik 2009)

Në Kroaci, veçmas në Istri, duhet organizuar konsultime me organizatat e pakicave të cilat do të shohin interesin e vet për tu inkuadruar.

Po këtë njësoj mund ta bëjmë ne këtu me siguri edhe me organizatat e pakicave kombëtare të cilat këtu janë të organizuara mirë dhe të cilat me siguri do ta shohin interesin e vet që të inkuadrohen në këtë, e kështu me radhë. (Mladen Momčinović, Qendra për Iniciativat Qytetare Poreç, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pulë, Kroaci, 1 korrik 2009)

Konsultimet mbi Iniciativën për KOMRA të

organizohen si tubime publike, të hapura për qytetarët e interesuar.

Nuk do të ishte keq kur ato konsultime në qytete, bie fjala, të jenë tubime publike, të hapura për të gjithë qytetarët e interesuar. Që ata të informohen me afishhe në kutitë postare në të cilat do të sqarohet se çka në realitet është KOMRA. (Tatjana Gromača, gazeta "Novi list", Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pulë, Kroaci, 1 korrik 2009)

Konsultimet me bashkësinë lokale

Zvornik, BeH

18 korrik 2009.

Konsultimet i kanë organizuar Shoqata "Anima 2005" (BeH) dhe Shoqata e familjeve të personave të rrëmbyer e të zhdukur të Komunës së Zvornikut (BeH). Në tubim kanë qenë 22 pjesëmarrës, përfaqësues të shoqatave të viktimave, familjarët e dëshmorëve të rënë, të organizatave joqeveritare, bashkësive vendore, institucioneve fetare dhe të mediave. Në konsultime kanë marrë pjesë të dërguarit e Zyrës së përfaqësuesit të lartë në BeH, të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), dhe të Qendrës ndërkombëtare për të drejtën në tranzicion. Fjalët e hyrjes i kanë mbajtur Mevludin Lupiq (Shoqatat e familjeve të personave të rrëmbyer e të zhdukur të Komunës së Zvornikut, BeH), Branko Todorović (Këshilli i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në RS, BeH) dhe Natasha Kandiq (Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi), ndërsa tubimin e ka moderuar Vehid Shehiq (Forum i Qytetarëve të Tuzllës, BeH).

Propozimet, mendimet dhe Rekomandimet e pjesëmarrësve:

Anëtarët e KOMRA-s duhet të jenë persona profesional dhe moral të lartë njerëzor e që opinioni i gjerë publik ka besim në ta. Shoqëria civile lypset të ketë rolin vendimtar në përkufizimin e rolit për zgjedhjen e anëtarëve të KOMRA-s si dhe në zgjedhjen e anëtarëve të tij.

Personat që do të zgjedhen në komision duhet ta kenë mbështetjen e pandarë të shoqërisë, prestigj në shoqëri dhe të jenë të pranueshëm nga opinioni i gjerë (Branko Todorović, Këshilli i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën Serpska, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale në Zvornik, BeH, 18 korrik 2009.)

Komisioni lypset të përbëhet nga njerëz me moral të lartë njerëzor, profesionist, të cilët do të mundën drejtë t'i interpretojnë faktet e vërtetuara e të verifikuara. Përse? Sepse ne jetojmë në shoqërinë tërësisht të politizuar ku elitat politike e fetare kryesisht po manipulojnë me mendimin tonë dhe emocionet tona. (Amir Kulagliq nga Srebrenica, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale në Zvornik, BeH, 18 korrik 2009.)

Është kryesore që aty të punojnë ekspertët, njerëzit e rinj dhe njerëzit me moral të lartë (Zekerijah Haxhiq, Asociacioni i Studentëve të Srebrenicës, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale në Zvornik, BeH, 18 korrik 2009.)

Komisioni duhet të jetë i pavarur nga ata që e formojnë. Edhe shoqëria civile në rajon lypset të ketë ndikim të konsiderueshëm në përkufizimin e vlerësimeve por edhe në zgjedhjen e atyre njerëzve. Nëse këtë ua lëmë qeverive që gjoja të përzgjedhin dikë, ata do t'i zgjedhin të dëgjueshmit e vet dhe druaj se nuk do ta arrijmë atë që e duam. (Amir Kulagliq nga Srebrenica, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale në Zvornik, BeH, 18 korrik 2009.)

Është shumë me rëndësi tu mundësohet kryesve të flasin publikisht mbi krimet që i kanë bërë në mënyrë që opinionin të fitojë rastin t'i mësojë faktet për krimet e kryera.

Tash njësoj mund ta shtrojmë edhe pyetjen si do të pritej në Bosnjë e Hercegovinë që dikush nga kryesit e krimit, bie fjala, të flet botërisht në atë komision dhe atë ta transmetojnë mediat, dhe atë ta shikojnë viktimat e kështu me radhë (...) Shumë do të thoshin, se pikërisht ky është (...) rast i mirë që dikush nga ata kryesit të flas botërisht mbi atë që ka bërë dhe në çka ka marrë pjesë. (Branko Todoroviq, Këshilli i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën Serpska BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale në Zvornik, BeH, 18 korrik 2009.)

Dëgjimi publik i viktimës dhe dëshmitarit na janë të nevojshme, sepse mund të kontribuojnë në ndërtimin e solidaritetit me viktimat, që sot nuk ekziston.

Ndonjëherë kjo e folur publike (e viktimave dhe e dëshmitarëve) gjithësesi mundet, para se gjithash, ta zgjojë solidaritetin në shoqëri, që sot ne në Bosnjë e Hercegovinë, fatkeqësisht se kemi. (Branko Todoroviq, Këshilli i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën Serpska BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale në Zvornik, BeH, 18 korrik 2009.)

Nevojitet puna më aktive e organizatave të shoqërisë civile që të arrihet formimi i komisionit. Kur të ndodh formimi i tij, organizatat e shoqërisë civile duhet ta bëjnë mbikëqyrjen e punës së komisionit.

Unë mendoj se tubimet e këtilla, veprimi i organizatave të tilla joqeveritare dhe të organizatave të ndryshme, do të mund të ndihmojnë dhe ta lehtësojnë procesin e formimit të këtij komisioni. (Zekerijah Haxhiq, Asociacioni i Studentëve të Srebrenicës, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale në Zvornik, BeH, 18 korrik 2009.)

Të gjitha shtetet duhet ta nxisin dhe të qëndrojnë prapa atij komisioni (...) Sektori joqeveritar nga të gjitha ato shtete, në njëfarë mënyre, do të jetë kontrollues i punës së atij institucioni të formuar nga ana e shtetit. (Zorana Petković, Radio Osvit, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale në Zvornik, BeH, 18 korrik 2009.)

Ekziston dilema nëse kryesit për shkak të bashkëpunimit me komisionin duhet të amnistohen, apo vetëm t'u zbutet dënimi.

Jam për atë që kushdo çfarë informacioni që jep, nuk është për t'u liruar nga dënimi (...) Qëllimi i dënimit është reflektim parandalues që diç ngjashëm në të ardhmen të mos ndodhë.. (Zekerijah Haxhiq, Asociacioni i Studentëve të Srebrenicës, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale në Zvornik, BeH, 18 korrik 2009.)

Mendoj se është shembull i mirë (...) të flasin edhe viktimat, por gjithashtu duhet të flasin edhe kryesit. Për vetë masën se sa kryes eventualisht do të amnistohen kjo është çështje, të themi, e vlerësimit të profesionit (...) nuk do të thotë që edhe vet pranimet e fajësisë japin amnisti të plotë. (Mustafa Muharemoviq, Mexhlisi i Bashkësisë Islame në Zvornik, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale në Zvornik, BeH, 18 korrik 2009.)

Duke qenë se akoma nuk e kam gjetur pjesën më të madhe të varrëve të mi, unë megjithatë jam i privë që përpara këtij komisioni rajonal të paraqiten ekzekutuesit me kusht se mund të japin informata të caktuara mbi varrezat masive, për individët e kështu me radhë. (...) Unë kam 50 vjet. Nuk kam edhe shumë kohë ndoshta të pres. Ndoshta në Srebrenicë shumë nëna që i kanë humbur fëmijët dhe burrat nuk kanë kohë të presin. Prandaj edhe jam për atë që tu jepet shansi. Do të jenë apo jo të amnistuar, a do të jenë

të zbutur në përgjegjësi, kjo është çështje e vlerësimit të komisionit. (Amir Kulagliq nga Srebrenica, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale në Zvornik, BeH, 18 korrik 2009.)

Mandati i komisionit duhet ta përfshijë rolin e mediave në përgatitjen e konfliktit të armatosur.

Mendoj se duhet pasqyruar edhe rolin e mediave në përgatitjen e makinerisë propaganduese luftënxitëse, në periudhën e përgatitjes së luftës (...) me siguri edhe atë segment ky komision, sipas mendimit tim personal, duhet ta përfshijë në gjenërimin e nacionalizmit tek të gjitha palët.. (Samir Paliq, Bashkësia lokale Kula Grad në Zvornik, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale në Zvornik, BeH, 18 korrik 2009.)

Nevojitet që komisioni të merret me shkaqet e luftës, sidomos me rolin e Armatës Popullore të Jugosllavisë (APJ) dhe të bashkësisë ndërkombëtare.

Jam i mendimit se duhet pasqyruar edhe përgjegjësinë dhe rolin e udhëheqjes ushtarake, respektivisht të Shtatmadhorisë së ish-RSFJ-së (...) Me armët e APJ janë bërë ato krime. Më tutje, gjithashtu duhet pasqyruar edhe roli i bashkësisë ndërkombëtare në atë periudhë, pra çfarë ka qenë, (...) sidomos në ndodhitë në hapësirën e Bosnjës e Hercegovinës kur një populli duar thatë iu imponua embargoja e armatosjes, kurse të gjitha palët tjera e kanë pasur këtë mundësi. (Samir Paliq, Bashkësia Lokale Kula Grad në Zvornik, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale në Zvornik, BeH, 18 korrik 2009.)

Komisioni duhet të merret me zgjidhjen e çështjes së të zhdukurve. Që të zgjidhet çështja e të zhdukurve, nevojitet të sigurohet bashkëpunimi i të gjitha niveleve të pushtetit, sidomos të komunave, ushtrisë e policisë.

E përshëndes çdo iniciativë e cila do t'i avanconte këto problemet tona, pikë së pari procesin e kërkimit të të zhdukurve. (Radomirka Duvnjak, Këshilli për kërkimin e të zhdukurve, Organizata komunale e dëshmorëve të rënë në Vllasenicë, BeH, Konsultimet lokale me shoqatat e viktimave, familjet e dëshmorëve të rënë e të veteranëve dhe organizatat tjera të shoqërisë civile, Zvornik, BeH, 18. korrik 2009.)

Akoma jemi në kërkim të 500 personave nga territori i Komunës së Zvornikut, domethënë lokalitetet e varrezave masive. Kjo është arsyeja më e madhe për

shkak të së cilës ne jemi këtu -Shoqata e familjeve të personave të zënë rob e të zhdukur të Komunës Zvornik- e ka në nënshkruar këtë deklaratë për t'iu bashkuar Koalicionit për KOMRA. (Mevludin Lupiq, Shoqata e familjeve të personave të zënë rob e të zhdukur të Komunës Zvornik, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale në Zvornik, BeH, 18 korrik 2009.)

Është pikëlluese që plot 14 vjet pas përfundimit të luftës kemi numër aq të madh të personave të zhdukur (...) Mendoj se secila viktimë meriton ta ketë identitetin e vetë dhe t'i ketë shenjat e veta, respektivisht që me dinjitet të varroset (...) Është e sigurt se bashkësitë lokale, në hapësirat e< të cilave janë bërë ekzekutimet e viktimave, duhet të dinë se edhe ku janë varrosur ato viktima. Ashtu që ky komision, sipas mendimit tim të thellë, duhet të ushtrojë tryzni mbi bashkësitë lokale në procesin e kërkimit< ,të personave të zhdukur si të ish udhëheqjes ushtarake ashtu edhe të asaj civile.< (Samir Paliq, Bashkësia Lokale Kula Grad në Zvornik, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale në Zvornik, BeH, 18 korrik 2009.)

Komisioni duhet të bëjë regjistrimin edhe të viktimave edhe të kryesve.

Pajtohem se (...) ky komision duhet ti emërtojë kryesit e krimeve të luftës, sepse megjithatë, ... Nëse i emërtojmë viktimat, kundruall kësaj le të kenë edhe ata që i kanë kryer ato krime të luftës pavarësisht nga cili popull vijnë. (Samir Paliq, Bashkësia Lokale Kula Grad në Zvornik, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale në Zvornik, BeH, 18 korrik 2009.)

Duhet bërë partneriteti me mediat për tu siguruar që opinioni të marrë informacionin mbi krimet e luftës. Mediat duhet dhënë më shumë hapësirë për shembujt pozitiv.

Mendoj se këtu lypset vërtetë një reformë dhe promovim serioz, e kjo është që mediat t'u japin më shumë hapësirë jo vetëm viktimave, por gjithashtu më shumë hapësirë gjërave fisnike që po ndodhin dhe që kanë ndodhur në të kaluarën tonë të afërt e të largët (...) Ne dëgjuam pak më parë mbi rolin e mediave në përgatitjen e luftës. Kjo padyshim është një çështje që duhet hulumtuar, por gjithashtu lypset ngarkuar rolin e mediave për shërimin e shoqërisë së përgjithshme. (Mustafa Muharemoviq, Mexhlisi i Bashkësisë Islame në Zvornik, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale në Zvornik, BeH, 18 korrik 2009.)

Këtu sot dëgjuam disa herë radhazi (referimin në)

medie dhe unë pajtohem me këtë, se mediat janë ato që mund të ndihmojnë në vërtetimin e gjendjes faktike. (Hiba Ramiq, Fondacioni Mezarje, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale në Zvornik, BeH, 18 korrik 2009.)

KOMRA duhet të ketë mandat të hulumtojë rolin e individëve dhe të institucioneve.

Me çka do të merret ky komision, me individët apo me institucionet? Mendoj se pikë së pari është me rëndësi të merret me institucionet që do të sjell edhe tek individët të cilët kanë bërë gjëra të tilla. (Zekeri-jah Haxhiq, Asociacioni i Studentëve të Srebrenicës, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale në Zvornik, BeH, 18 korrik 2009.)

Dhe kur më pyesni me çka duhet të merret ky komision rajonal, a me sjelljen e individëve apo të institucioneve (...) Po, kjo është e pandashme. Ne duhet kuptuar se krimi është proces bukur i sofistikuar ku keni ideale, projektues, ideolog, nxitës, kryes (Amir Kulagliq nga Srebrenica, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale në Zvornik, BeH, 18 korrik 2009.)

KOMRA duhet të merret me sjelljet e individëve, por edhe me veprimet e institucioneve, (...) nga ato ushtarake, siguria civile, MPB, komuna (...) Të gjithë ata njerëz që janë vrarë, pavarësisht nga cila anë janë, Siguria Civile ka qenë ajo e cila i ka transportuar mbeturinat mortore. Domethënë, këtu do t'i fitojmë njëherësh edhe ata njerëz, respektivisht edhe individët që janë përgjegjës dhe të cilët të paktën mund të na ndihmojnë në zbulimin e varrezave masive. (Hiba Ramiq, Fondacioni Mezarje, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale në Zvornik, BeH, 18 korrik 2009.)

KOMRA duhet të ketë bashkëpunimin direkt me organet e gjyqësisë.

Për shumicën e këtyre krimeve që janë bërë në territorin e Komunës Zvornik ... po zhvillohen disa procese gjyqësore. Ato janë në zhvillim e sipër, por për shumicën e atyre krimeve ende askush nuk është përgjigjur (...) Domethënë, komisioni duhet të ketë bashkëpunim më të ngushtë me prokuroritë për shkak të, ashtu të them, dërgimit sa më të shpejtë të fakteve dhe të dhënave mbi krimet e luftës.. (Mevludin Lupiq, Shoqata e Familjeve të personave rob e të pagjetur të Komunës Zvornik, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale në Zvornik, BeH, 18 korrik 2009.)

Parlamentet në rajon duhet të miratojnë ven-

dime ligjore mbi shfrytëzimin e fakteve që do t'i vërtetojë KOMRA, si dëshmi në procedimet gjyqësore.

Në këto konsultime ne duhet të shfaqim kujdes (...) nëse ajo që e vërteton ky komision si fakt, mund të shfrytëzohet si provë para gjykatave kompetente? (...) Kjo ndoshta do të imponojë që në marrjen e vendimeve nga ana e parlamenteve të këtyre shteteve, të merret edhe vendimi, sepse me këtë ndoshta do të plotësohet LPP (Ligji mbi Procedurën Penale), që atë të cilën e konfirmon komisioni mund të shfrytëzohet si provë. (Vehid Shehiq, Forumi i Qytetarëve të Tuzllës, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale në Zvornik, BeH, 18 korrik 2009.)

KOMRA duhet të ketë tri qëllime: vërtetimin e fakteve, verifikimin e fakteve, interpretimin e fakteve.

Përse ky komision yni duhet të quhet komision rajonal për vërtetimin e fakteve? Shpesh herë dikush thotë, përse ky nuk është komision rajonal për konfirmimin e të vërtetës. E vërteta është relative dhe secili nga ne e ka perceptimin personal të së vërtetës. Kur është fjala për Bosnjën e Hercegovinën, këtu të paktën ka tri të vërteta (...) boshnjake, serbe dhe kroate, (...) Unë jam i prirë që ky të jetë komision rajonal për konfirmimin e fakteve. Së dyti, ky komision nuk duhet të mbetet (...) vetëm në nivelin e konfirmimeve të fakteve, sepse shumë fakte veç janë vërtetuar (...) ashtu që ky komision duhet të punojë edhe në verifikimin e fakteve veç të vërtetuara, sidomos nëse është fjala mbi faktet juridike, faktet të cilat i kanë vërtetuar institucionet relevante gjyqësore në një proces të paanshëm gjyqësor. Çështja e tretë me çka duhet të merret komisioni është interpretimi i drejtë i fakteve të vërtetuara. (Amir Kulagliq nga Srebrenica, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale në Zvornik, BeH, 18 korrik 2009.)

KOMRA duhet t'i nis hetimet e veta nga viti 1990.

Pra unë propozoj që ta marrim periudhën prej vitit '90. (Hiba Ramiq, Fondacioni Mezarje, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale në Zvornik, BeH, 18 korrik 2009.)

Viktimat presin që në kompetencën e KOMRA-s të iniciohet programi i reparacioneve.

Kur është fjala për programin e KOMRA-s duhet prekur edhe çështjen e reparacionit për viktimat. (Mustafa Muharemoviq, Mexhlisi i Bashkësisë Isla-

me në Zvornik, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale në Zvornik, BeH, 18 korrik 2009.)

Duhet të japim kontributin tonë që këtë ta përshpejtojmë, që pikërisht ato viktimat ta kenë një satisfakcion. Satisfakcioni nënkupton të marrësh informacionin, t'i varrosësh më të dashurit tu, të ketë vend ku do të mund të shkosh që në një mënyrë të sjellshme e të ndershme të ballafaqohesh ndoshta edhe me vetveten, apo të ballafaqohesh me ankthet tua dhe ëndrrat tua të rënda. (Amir Kulaghiq nga Srebrenica, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Zvornik, BeH, 18 korrik 2009.)

Me njohjen e fakteve mbi krimet nga e kaluara do të evitohet përsëritja e tyre.

Por, ju lutem, kur është fjala për të kaluarën ne duhet të vërtetojmë qartë se çfarë ka ndodhur. Po, pse? Që të mos na përsëritet, zotërinj. Nëse nga e kaluara e bëjmë flamurin e bardhë nëpër të cilin mund të shkruaj kush çka do dhe ta valëvisë kush do, druhem se biri im dhe fëmijët tuaj, mos dhashtë Zoti, do të jenë viktimat të reja. (Amir Kulaghiq nga Srebrenica, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Zvornik, BeH, 18 korrik 2009.)

Ne dëshirojmë që njerëzit e ri në njëfarë mënyre, me anë të njohurive dhe vërtetimit të fakteve të mirëfillta mbi atë çfarë ka ndodhur, t'iu ofrojmë mundësinë që ta marrin përgjegjësinë për të ardhmen tyre. (Alma Mashiq. Iniciativa e të Rinjve mbi të Drejtat e Njeriut, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Zvornik, BeH, 18 korrik 2009.)

Konsultimet me bashkësinë lokale

**Knin, Kroaci
4 gusht 2009.**

Konsultimet me bashkësinë lokale në Knin i kanë organizuar Shoqata e Grave -Drnish (Kroaci), Dua në shtëpi- Knin (Kroaci) dhe Documenta Zagreb (Kroaci). Në tubim kanë qenë 30 pjesëmarrës dhe vëzhgues, përfaqësuesit e shoqatave të viktimave, të kthyerve dhe të pësuarve të tjerë, të dy bashkësitë e Kninit si dhe anëtarët e Koalicionit për KOMRA në Kroaci.

Dëshmimi publik i viktimave ka qenë pjesa qendrore e konsultimeve të Kninit. Kanë dëshmuar Jovan Beriq (Varivode), Milena Perçin (Drnish) dhe Rado-

slav Bobanoviq (Knin). Në tubim kanë folur edhe deputetët i kuvendit të SDSS Ratko Gajica.

Ligjëruesit kanë qenë Bogdan Ivanisheviq (Qendra ndërkombëtare për drejtësinë në tranzicion), Vesna Tersheq (Documenta, Kroaci) dhe Eugen Jakovçiq (Documenta, Kroaci). Tubimin e kanë moderuar Vesna Tersheq (Documenta, Kroaci) dhe Eugen Jakovçiq (Documenta, Kroaci).

Mbi konsultimet e Kninit kanë raportuar mediat lokale (Radio Kroate e Kninit) si dhe TV Nova në emisionet e veta kryesore informative, ndërsa në reportazhin mbi konkluzionet e tubimit ka njoftuar gazeta "Novi list" (Rijekë).

Propozimet, mendimet dhe Rekomandimet

Përpos informimit, qëllimi i konsultimeve është që të ndryshohen gjërat në terren.

Ky proces konsultativ (...) këtu në Knin ka për qëllim, para se gjithash, nga njëra anë ta prezantojë iniciativën për KOMRA (...) por gjithashtu kemi dëshirë (...) para se të arrijmë realizimin e qëllimit kryesor, që me vetë procesin e konsultimeve (...) t'i ndryshojmë gjërat në terren. (Eugen Jakovçiq, Documenta, Kroaci), Konsultimet me bashkësinë lokale, Knin, Kroaci, 4 gusht 2009)

Lypset të lihet gjurmë e pastër për gjeneratat e ardhshme, të emërtohen edhe viktimat edhe kryesit, në mënyrë që të mos përsëriten gabimet e njëjta.

Duhet të jemi me vetëdije kritike dhe të vetëdijshëm nëpër çka kemi kaluar dhe çfarë është kjo sot e çka do të jetë nesër (...) ne pjesëmarrësit e atyre ngjarjeve, të asaj kohe (...) duhet të lëmë gjurmë të vlefshme dhe të pastra prapa vetës për ata që po vijnë, që nesër të dinë të jetojnë më mirë në këto hapësira. Sepse pa të vërtetën nuk do të mund të jetojmë, sado që ajo të jetë e rëndë. (Radoslav Bobanoviq, viktimat e kampit serb "Spitali i vjetër" në Knin, Kroacia, Kroacia, Konsultimet me bashkësinë lokale, Knin, Kroaci, 4 gusht 2009)

Kush na ka munduar? Ne këtë e dimë. E dimë edhe kush jo. Nuk mund të përgjigjen të gjithë serbët për çdo gjë, ashtu si as të gjithë kroatët. Krimet nuk vjetërsohen, mirëpo si viktimat ashtu edhe kryesit kanë emrin e vet, duhet t'i zbulojmë! (Radoslav Bobanoviq, gjatë kohës së luftës i zënë rob dhe i munduar në burgun

e Kninit „Spitali i vjetër”, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Knin, Kroaci, 4 gusht 2009)

Viktimat serbe e kroate dëshirojnë të ndihmojnë në zbulimin e pësimit të viktimave nga bashkësitë tjera, dhe nuk duan të bartin barrën e krimit që kanë krye tjerët.

Do të doja që ata të cilët ndodhën diku, që nuk kanë bërë aq shumë gabime, të vinë e të na ndihmojnë, sikur që dëshiroj unë të ndihmojë po ashtu për t'u zbuluar disa marrëzi, krime (...) dhe kush i ka bërë ato. Nuk mund ta barti mbi supet e mia barrën e dikujt që e ka bërë këtë nga budallaqet, nga marrëzitë. Jo nga kroatizmi, jo nga serbizmi, nga çka unë nuk e di. (Radoslav Bobanoviç, gjatë kohës së luftës i zënë rob dhe i munduar në burgun e Kninit “Spitali i vjetër” në Knin, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Knin, Kroaci, 4 gusht 2009)

KOMRA mund ti zbulojë kryesit e krimit sepse për bashkëjetesë është me rëndësi të thuhet se individit është fajtorë e jo komplet një komb.

„Po çka ke të bisedosh me ta, ata t'i kanë vrarë prindërit, e ti me ta rrinë” (...) unë ashtu nuk mendoj (...) nuk konsideroj se këtë e ka bërë secili kroat, veç këtë e kanë bërë individët të cilëve fatkeqësisht ende nuk u dihet emri dhe që në gjithë këtë më gëzon kjo iniciativë e cila ndoshta do të mund t'i zbulojë ata kryes dhe të mbërrijmë tek e vërteta e cila me siguroi do të na shpie në ndonjë drejtim më të mirë. (Jovan Beriq, serb nga Zara, viktimë, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Knin, Kroaci, 4 gusht 2009)

Do të angazhohem deri në fundin e jetës sime që të ballafaqohemi me të vërtetën. Dhe, nuk janë të gjithë njerëzit fajtor, as nga njëra as nga ana tjetër. Sikur të mos kishte gabime e lëshime, e ka pasur, dhe për këtë jemi dëshmitar (...) veçmas ne që jemi gjetur në anët e kundërta, por jeta vazhdon më tutje dhe derisa njerëzit nuk thonë se fajtor është individit e jo komplet një komb (...) deri atëherë nuk kemi bashkëjetesë. (Milena Perçin, kroate nga Drnishi, viktimë, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Knin, Kroaci, 4 gusht 2009)

Të gjithë, përfshirë viktimat, duhet të ballafaqohen me të kaluarën dhe ngjarjet që i kanë përjetuar, sepse pa këtë sërish do të sundojë ekstremizmi dhe do të ndodhë e keqja.

Thënë sinqerisht (...) nuk kam dëshirë të gjurmojë nëpër të kaluarën. Mirëpo, jam e vetëdijshme për faktin se derisa nuk ballafaqohemi edhe ne perso-

nalisht si individ me të kaluarën dhe me ngjarjet që i kemi përjetuar, dhe po ashtu nuk themi haptas të gjithëve në bashkësinë tonë se nuk do të ketë paqe të mëtejshme dhe se (...) ekstremizmi do të mbisundojë sërish, (...) do të ndodhë e keqja të cilën kurrë nuk do ta dëshiroja që ndodhë. (Milena Perçin, kroate nga Drnishi, viktimë, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Knin, Kroaci, 4 gusht 2009)

Njerëzit e zakonshëm kanë mirëkuptim dhe kapacitete për pajtim.

Midis njerëzve të zakonshëm jam i bindur se ekziston kapaciteti për mirëkuptimin, e kësaj ideje për të cilën po flisni ju dhe thënë krejt thjeshtë, midis njerëzve të zakonshëm ekziston kapaciteti i madh për pajtim. Atë thjeshtë duhet zbuluar të sillet në skenën kryesore. (Ratko Gajica, deputetët në Kuvendin e kroat, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Knin, Kroaci, 4 gusht 2009)

Qëllimi i KOMRA-s duhet të jetë edhe pajtimi. Dëshmitet publike të viktimave mund të ndihmojnë në këtë.

Mua më intereson vetëm hulumtimi, ballafaqimi me të vërtetën, hulumtimi i krimeve pa vazhdim (...) Unë mendohem si ta inkorporojmë atë dimension të pajtimit. Kjo është shumë e rëndësishme (...) Mendoj se ky është një dimension që është i nevojshëm. Shumë njerëz nuk do ta dinë këtë që e kemi dëgjuar sot, këto dëshmitë e viktimave. Me anë të këtyre dëshmitëve mendoj se mund të gjenden palët që kanë qenë në njërin apo në anën tjetër.. (Ljubo Manojloviç, Forumi Dokumentar Serb, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Knin, Kroaci, 4 gusht 2009)

Me autoritetet duhet realizuar bashkëpunimin, por politikanëve s'duhet lejuar të përzihen në punën e KOMRA-s.

Si ta ruajmë atë komision, si ta ruajmë virgjërinë e tij nga politikanët? Mendoj se është rrezik nëse implikohen shumë politikanët në këtë. Njëkohësisht nëse nuk janë të përfshirë, (...) si të arrihen të dhënat (...) secili pushtet do të ketë ndonjë interes të imët. (Ljubo Manojloviç, Forumi Demokratik Serb, Kroacia, Konsultimet me bashkësinë lokale, Knin, Kroaci, 4 gusht 2009)

Iniciativa për KOMRA ka kuptim, por gjykata mund të bëjë më shumë për viktimat.

Mendoj se kjo iniciativë ka një kuptim të caktuar,

por kujtoj se megjithatë nuk do ta bëjë atë që ndoshta për momentin mund ta premtojë apo të pritët nga gjykata. (Jovan Beriq, serb nga Zara, viktimë, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Knin, Kroaci, 4 gusht 2009)

Koalicioni për KOMRA dhe shoqëria civile por edhe organizatat ndërkombëtare do të kenë obligimin të përcjellin si organizatat qeveritare i zbatojnë ato Rekomandime.

Çdo raport ka Rekomandime që kanë të bëjnë edhe me faktet e vërtetuara, por edhe propozimet për programet e komentimit për viktimat. Dhe është shumë esenciale që koalicioni pastaj të përcjellë si po ec zbatimimi i atyre Rekomandimeve (...) detyra e koalicionit është, në njëfarë mënyre, të shikojë se çka po ndodhë me të. (...) Institucionet e ndryshme ndërkombëtare dhe tjera të viktimave, dhe organizatat për të drejtat e njeriut (...) Janë të përgjegjshme për të marrë pjesë në procesin e zbatimit të Rekomandimeve. (Vesna Tershelij, Dokumenta, Kroacia, Konsultimet me bashkësinë lokale, Knin, Kroaci, 4 gusht 2009)

Procesi i konsultimeve dhe mbledhja e një milion nënshkrimeve i siguron legjitimitet iniciativës dhe nuk mundëson që pushteti ta injorojë.

Për shkak të arritjes së legjitimitetit të gjerë të komisionit, janë të rëndësishme edhe këto procese konsultative dhe nënshkrime që do të mblidhen më vonë (...) por është me rëndësi fakti se njerëzit përpara (...) koalicionit do të rrinë diku në rrugë, do të bisedojnë me njerëzit anembanë rajonit për atë se çfarë ide kemi (...) se në atë mënyrë në realitet në komunikim të barabartë me njerëzit do të marrim mbështetjen për formimin e komisionit, e ku pastaj do ta kenë vështirë edhe politikanët (...) që ta injorojnë gjithë këtë iniciativë. (Mario Mazhiq, Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Knin, Kroaci, 4 gusht 2009)

Të rinjtë në Kroaci dëshirojnë të mësojnë faktet mbi të kaluarën, sepse nga kjo varet si do të duket e ardhmja.

Për mua është shumë me rëndësi të theksoj se ne si të rinj dëshirojmë t'i mësojmë disa fakte, dëshirojmë të jemi pjesë e një gjëje që është proces i ballafaqimit me të kaluarën. Kjo është shumë me rëndësi për ne, sepse është qenësore se si do ta ndërtojmë më tutje të ardhmen (...) Komisioni (...) për ne është (...) i qenësishëm në shkallën e ballafaqimit dhe të mësim, për ne ai është i qenësishëm në shkallën e transme-

timit të një gjëje më tutje, në disa gjenerata të reja. (Emina Buzhinkiq, Rrjeti i të rinjve të Kroacisë, Konsultimet me bashkësinë lokale, Knin, Kroaci, 4 gusht 2009)

Mua jashtëzakonisht më pëlqen që në ato organizata të ndryshme të konsultimeve, janë përfshirë këto konsultime lokale, sepse në të gjitha këto shtetet pas jugosllave, ekzistojnë hapësirat që absolutisht kanë qenë të goditura nga lufta e madje edhe pse njerëzit që kanë jetuar në ato territore, s' kanë qenë, si të them, viktima në ndonjë kuptim të rreptë të fjalës. (...) Kjo formë e konsultimeve lokale mendoj s'është e domosdoshme (...) por më vjen mirë se i tërë aksi- oni i Koalicionit për KOMRA-n e ka pa rëndësinë e atij procesi (...) për ato bashkësi lokalet, bashkësitë e vogla nga të cilat njerëzit e ndryshe nuk do të mund të vinin deri tek fjala. (Slaven Rashkoviq, Dokumenta, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Knin, Kroaci, 4 gusht 2009)

Konsultimet lokale me shoqatat e viktimave

**Mitrovicë, Kosovë
5 shtator 2009.**

Konsultimet lokale me shoqatat e viktimave i ka organizuar Shoqata e familjeve të të pagjeturve, më 22 maj (Kosovë). Në tubim kanë marrë pjesë 41 pjesëmarrës, para se gjithash nga familjet e të pagjeturve. Ligjëruesit kanë qenë Ylber Maxhuni (Youth Step, Kosovë), Valdete Idrizi (CBM, Kosovë) dhe Natasha Kandi (Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi). Konsultimet i kanë moderuar Valdete Idrizi (CBM, Kosovo) dh Avni Melenica (22 maj, Kosovë).

Propozimet, mendimet, Rekomandimet e pjesëmarrësve

Shoqatat e familjeve të shqiptarëve të pagjetur duhet të kenë qëndrim unik ndaj Iniciativës KOMRA, e jo që disa shoqata të paraqiten autonome.

Ne jemi aleancë e 19 shoqatave dhe kemi qëndrim unik. Dhe zoti Avni lypset të bisedojë me këshillin, duhet ta mbledh këshillin edhe në të gjitha shoqatat tjera, duhet biseduar me këshillat, që të jemi unik lidhur me një çështje të këtillë (Iniciativa për KOMRA). (Xhafer Veliju, Pengu i Lirisë, Kosovë, Konsultimet lokale me shoqatat e viktimave Mitrovicë, Kosovë, 5 shtator 2009.)

Shqiptarët dhe serbët duhet të bashkëpunojnë dhe ta informojnë njëri tjetrin, sepse kjo është mënyrë e vetme për ta zgjidhur çështjen e të pagjeturve.

Unë e kam kuptuar ç' është në të vërtetë. Duhet të bashkëpunojmë me njëri tjetrin (...) Nëse ne nuk bashkëpunojmë mes veti, shqiptarët dhe serbët, nëse se informojmë njëri tjetrin lidhur me këtë çështje, ne atëherë nuk do të mundemi ta zgjidhim as të vetmen çështje. (Xhafer Veliju, Pengu i Lirisë, Kosovë, Konsultimet lokale me shoqatat e viktimave, Mitrovicë, Kosovë, 5 shtator 2009.)

Mediat kosovare nuk po e përcjellin aktivitetin e shoqatave të familjeve të pagjeturve. As pas 10 vitesh nga krimi në Vushtrri, asnjë televizion nuk ka ardhur në përvjetor.

Nga 22 maji, prej kur ne po i mbajmë tubimet, askush nga mediat nuk ka ardhur kurrë deri më tash, asnjë kamerë. TV Prishtina (...) TV 21 (...) kanë pasur obligim të vijnë (...) Pastaj KTV, e kështu me radhë. Ja, me radhë dhjetë vjet, çdo 22 në Vushtrri mbahet tubimi, por askush nuk na vjen. Turp është. (Mahmut Sylja, anëtar i familjes së viktimave, Kosovë, Konsultimet lokale me shoqatat e viktimave Mitrovicë, Kosovë, 5 shtator 2009.)

Kryesit e krimit në Vushtrri gjenden në Kosovë, shëtitin lirshëm.

Unë vërtetë jam i zemëruar në qeverinë (...) E di fare mirë kush e ka bërë gjithë këtë më 22 maj, me emër e mbiemër, a e kanë arrestuar një? Jo. Janë në Mitrovicë, atypari sillen, në Prilluzhë, Gajbullë, e kështu me radhë (...) Turp është (Mahmut Sylja, anëtar i familjes së viktimave, Kosovë, Konsultimet lokale me shoqatat e viktimave Mitrovicë, Kosovë, 5 shtator 2009.)

Ne të gjithë i kemi emra e mbiemra e të ashtuquajturit "shtabi i krizës". Me emër e mbiemër të gjithë ata janë në listën që e kemi gjetur në Kuvendin e Komunës. Për këtë i kemi njoftuar edhe përfaqësuesit ndërkombëtar edhe kryetarin e Komunës, por kurrfarë masash nuk janë marrë, edhe pse dihet se ata kanë qenë organizator që e kanë bërë këtë masakër. (Musli Melenica, anëtar i familjes së viktimave, Kosovë, Konsultimet lokale me shoqatat e viktimave Mitrovicë, Kosovë, 5 shtator 2009.)

Për familjet më me rëndësi është t'i marrin mbetjet mortore të pagjeturve të tyre dhe t'i

varrosin. Iniciativa KOMRA është shpeshë për familjet.

Do të donim t'u mbështesim në këtë iniciativë në emër të anëtarëve të familjeve të pagjeturve dhe dashtë Zoti që me bashkëpunimin tonë dhe tuaj të përbashkët, si dhe të qeverisë tonë, t'i gjejmë të pagjeturit tanë (...) Dëshira më e madhe dhe pasuria më e madhe do të ishte ta gjejë babën tim, ta dijë ku e ka varrin. Nuk kam ardhur për shkak të drekës e as do ta bëja një hap për shkak të drekës apo për ndonjë cent, veç para se gjithash kam ardhur për shkak të babës dhe t'u mbështes gjithë juve, anëtarët e familjeve dhe të gjithë ata që sot nuk janë këtu, sepse nuk kanë mundur të vijnë. (Naser Kadriu, anëtar i familjes së viktimave, Kosovë, Konsultimet lokale me shoqatat e viktimave Mitrovicë, Kosovë, 5 shtator 2009.)

Unë jam Musli Melenica, anëtar i familjes së të pagjeturve. Kam pesë anëtarë të pagjetur. E mbështes këtë iniciativë dhe dëshiroj të vazhdoni përpara. Iniciativa vërtetë është e përshtatshme dhe jam i sigurt se të gjithë anëtarët këtu e mbështesin. (Musli Melenica, anëtar i familjes së viktimave, Kosovë, Konsultimet lokale me shoqatat e viktimave Mitrovicë, Kosovë, 5 shtator 2009.)

Ju përsënderes, ju uroj për një iniciativë të këtillë, keni bërë punë të mirë që e keni nisur. Jam anëtar i familjes së të pagjeturve. Sa i përket takimit me anëtarët e familjeve të pagjeturve mund të them se çdo ditë mblidhemi, takohemi (...) Ne që jemi këtu në Kosovë, (...) Por shumica janë në botën e jashtme, ata nuk mund të dinë se sa shpesh ne këtu takohemi (Fatime Melenica, anëtare e familjes së viktimave, Kosovë, Konsultimet lokale me shoqatat e të pagjeturve Mitrovicë, Kosovë, 5 shtator 2009.)

Unë jam Isa Latifi, kryetar i Shoqatës së të Burgosurve Politik. Unë gjithashtu, si edhe të gjithë, e mbështes këtë ide. Është shumë e mirë (...) Shihet se njerëzit kanë interesat e veta, vrapojnë pas tyre (...) Prandaj po e përsëris edhe njëherë, faleminderit të gjithë atyre që janë iniciator të kësaj çështje (Isa Latifi, Shoqata e të Burgosurve Politik, Kosovë, Konsultimet lokale me shoqatat e të pagjeturve Mitrovicë, Kosovë, 5 shtator 2009.)

Familjet e viktimave vuajnë për fatin e të pagjeturve të vet dhe për shkak të varfërisë dhe moskujdesit.

Duhet ta dimë një gjë, sa herë do të bëjmë diçka për

këta njerëz, çdo herë serish ua kthejmë vuajtjen atë ditë (Vehbi Halili, jurist, Kosovë, Konsultimet lokale me shoqatat e të pagjeturve Mitrovicë, Kosovë, 5 shtator 2009.)

Çdo herë kur dikush merr këso iniciativash e të ngjashme, duhet të jetë shumë i vëmendshëm. Rreth çështjes së këtyre njerëzve nuk është bërë asgjë nga ana e qeverisë tonë (...) e të mos flasim për disa shoqata (...) Anëtarët e familjeve që kanë të pagjetur ka në një dhimbje, por kanë edhe një dhimbje tjetër, e kjo është se kanë telashe ekonomike. (Vehbi Halili, jurist, Kosovë, Konsultimet lokale me shoqatat e të pagjeturve Mitrovicë, Kosovë, 5 shtator 2009.)

Ne nuk duam fjalime, duam rezultate. Qartë e troç, çka po bëjnë shtetet jashtë krejt kjo është thash e them. Ne do të flasim për këtë që të mos na përfshijë mungesa e parave, skamja na ka përfshirë gjithë neve, na kanë mbetur jetimë. Duam rezultate jo fjalime (Mahmut Sylja, anëtar i familjes së viktimave, Konsultimet lokale me shoqatat e të pagjeturve Mitrovicë, Kosovë, 5 shtator 2009.)

Ligjet e Kosovës që e rregullojnë të drejtën sipas personit të pagjetur nuk janë adekuat.

Për ta marrë një certifikatë në komunë, duhet ta marrë me vete vërtetimin se nuk paguaj taksa. Nëse shkoj tek mjeku ma kërkon librezën e shëndetësisë, e ti them se kam tre djem të vrarë, menjëherë do të më thotë se po rrej. Kur e kthen në anën tjetër marrë 130 euro për një djalë. E dy tjerët nuk janë të mitë? Nuk marrë asgjë. (Arif Zeka, anëtar i familjes së viktimave, Konsultimet lokale me shoqatat e të pagjeturve Mitrovicë, Kosovë, 5 shtator 2009.)

Lypset organizuar konsultime me familjet e viktimave në mënyrë që të marrin informacione mbi nevojat e tyre.

Është shumë me rëndësi të organizohen konsultime me familjet e viktimave që të dimë cilat janë nevojat e tyre, cilat janë mendimet e tyre, të dimë si të orientohejmë (Nazim Bahtiri, Youth Step, Kosovë, Konsultimet lokale me shoqatat e të pagjeturve Mitrovicë, Kosovë, 5 shtator 2009.)

Nevojitet të formohet Fondi rajonal për kompensimin e viktimave dhe të familjeve të tyre.

Nuk mund të zhvillohet asnjë shtet që pas luftës, në njërën anë të ketë shumë të pasur, e të ketë tepër

shumë familje të viktimave të cilat nuk kanë për jetë të përditshme. Kjo nuk është mirë as për të rinjtë si ndonjë leksion që ndodh kur bëhen krimet, se mbetet numër i madh i njerëzve, familjeve të cilat nuk mund të jetojnë. Dhe kjo është shumë e rëndësishme që për këtë të ushtrohet rrymë mbi pushtetin, të bëhen përpjekje që e gjithë kjo të bëhet njëfarë prioriteti në politikën sociale, e që ndërkohë të mendohet se kush krejt mund ta ndihmojë këtë, të themelohen Fondi rajonal i cili pastaj mund t'i përcaktojë nivelet, kategoritë e viktimave dhe disi ta bëjë ndarjen e drejtë e atyre kompensimeve. (Natasha Kandiq, Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi, Konsultimet lokale me shoqatat e të pagjeturve Mitrovicë, Kosovë, 5 shtator 2009.)

Për familjet nuk është me rëndësi nëse Serbia e ka njohur Kosovën - dihet se në kohën e humbjes Kosova ka qenë nën kontrollin e Serbisë – më e rëndësishme është të zgjidhet çështja e të pagjeturve.

Nuk është fare e rëndësishme do të na njoh Serbia apo jo Kosovën. Kjo për ne anëtarët e familjeve të viktimave nuk është me rëndësi. Hajde të punojmë bashkë, hajde ta zgjidhim çështjen e anëtarëve të familjeve të pagjeturve. (...) Dihet edhe tash e është ditur edhe më herët ku është fajtori. Çdo gjë në Kosovë ka qenë nën kontrollin e Serbisë. (Xhafer Veliu, Pengu i Lirisë, Kosovë, Konsultimet lokale me shoqatat e të pagjeturve Mitrovicë, Kosovë, 5 shtator 2009.)

Nevojitet të hartohet pasqyra e krimeve të luftës nëpër komuna që të mund të shënohet e vërteta për gjeneratat e ardhshme.

Kisha një propozim që më shumë është për anëtarët e familjeve, por edhe për të gjithë qytetarët e Vushtrrisë (...) Në fakt mungon historia e luftës së fundit që ka ndodhur në Vushtri. Propozimi im është (...) ta iniciosh edhe në vendet tjera, gjithnjë derisa nuk has në vendin adekuat që të publikohet libri mbi luftën e fundit që ka ndodhur në përgjithësi në Vushtri, sepse me kalimin e kohës po zhduken dëshmitarët, po i merr koha, dikush po vdes, po shkojnë. Fëmijët e mi e kanë shijuar luftën, po nuk e dinë çfarë ka ndodhur. Sot janë në klasën e shatë, tetë, nëntë dhe nuk dinë çka është lufta, nuk dinë çfarë kanë përjetuar familjet e tyre. Nëse nuk u tregoj unë çka kam përjetuar ata nuk do të mësojnë kurrë (Isa Latifi, Shoqata e të Burgosurve Politik., Kosovë, Konsultimet lokale me shoqatat e të pagjeturve Mitrovicë, Kosovë, 5 shtator 2009.)

Ka ndodhur masakra në Studimle, ka ndodhur burgu pranë varrezave, ka ndodhur Galica dhe shumë çka nga kjo ka mbetur e pa shkruar, mbetet vetëm ajo për të cilën flitet nëpër tubime e kafehane. Le të ekzistojë libri ku do të shënohet krejt, pra edhe kjo për çka po flasim sot. Le të mbetet dëshmia e jo të mbetet të përflitet vetëm nëpër takime e tubime. (Isa Latifi, Shoqata e të Burgosurve Politik, Kosovë, Konsultimet lokale me shoqatat e të pagjeturve Mitrovicë, Kosovë, 5 shtator 2009.)

Nëse nuk lajmërohen krimet, bie fjala krimi i përdhunimit, nuk mund të vërtetohen as faktet e me këtë nuk mund të arrihet drejtësia.

Keqtrajtimet seksuale –kjo është dobësi e gjithë shoqërisë e cila nuk është vetëdijshme në këtë aspekt se duhet dhënë dëshmi edhe për këtë. Këtu tek ne, nuk di nëse dikush individualisht apo kolektivisht e ka lajmëruar të paktën një viktimë të dhunës seksuale. Ndoshta është çështje e mentalitetit, por nëse ne vuajmë nga mentaliteti nuk do të ketë gjetje të fakteve, atëherë nuk mund të kërkojmë drejtësinë kur nuk ka prova të ofruara. (Lale Grabanica, Shoqata Elena Gjika, Kosovë, Konsultimet lokale me shoqatat e të pagjeturve Mitrovicë, Kosovë, 5 shtator 2009.)

Në të ardhmen është e nevojshme të organizohen ekskursione gjatë të cilave nxënësit e shkollave fillore e të mesme do t'i vizitojnë vendet e krimeve- ky do të jetë mekanizëm i suksesshëm që krimi më të mos përsëritet.

Një ditë do të doja të vjen ai çast kur nxënësit e shkollave të mesme ose të fakulteteve do të shkojnë në ekskursione ashtu që do të nisen gjurmëve të atyre krimeve të kryera, dhe të nisen sdi, nga Sllovenia, e të shkohet dhe të vizitohen të gjitha ato vende ku kanë ndodhur atë krime të tmerrshme (...) Atëherë me siguri do të ndodhë që në këto hapësira kurrë më nuk do të ndodhë, nëse të gjitha shoqëritë pranojnë se për gjeneratat e reja më e rëndësishme është që ta kalojnë atë rrugë të krimit që ka ndodhur. (Natasha Kandiç, Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi, Konsultimet lokale me shoqatat e të pagjeturve Mitrovicë, Kosovë, 5 shtator 2009.)

Komisioni duhet të merret me hulumtimin e fakteve mbi ngjarjet politike në Kosovë apo të jap rekomandimin që të formohet një trup i veçantë i cili do të merrej me atë që ka ndodhur.

Më duket se do të duhej, që ai komision apo ndonjë

trup i veçantë të cilin do ta formojë komisioni që duhet të merret (...) me izolimet, që gjithashtu të merret edhe me ata të burgosurit politik që ka pas edhe para vitit 1988 (...) Askund nuk mund ta gjeni të ekzistojë për këtë ndonjë lëndë në arkiva. Kjo nuk ekziston (...) Për këtë po flasim njerëzit që ende janë gjallë, që e kanë kaluar këtë, besoj se gjeneratat e reja për këtë nuk dinë asgjë. (Natasha Kandiç, Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi, Konsultimet lokale me shoqatat e të pagjeturve Mitrovicë, Kosovë, 5 shtator 2009.)

Nevojitet të hulumtohet rasti i helmimit të nxënësve të shkollave të mesme në Vushtrri.

Helmimi i nxënësve në shkollat e mesme në Vushtrri, këtë rast nuk e ka përmendur askush. Njerëzit kanë pasur pasoja, disa kanë akoma sot e kësaj dite, e askush nuk merret me këtë rast, as me grumbullimin e këtyre shënimeve. (Blerim Ibrahim, anëtar i familjes së viktimave, Kosovë, Konsultimet lokale me shoqatat e të pagjeturve Mitrovicë, Kosovë, 5 shtator 2009.)

KOMRA mund të jap rekomandimin që të formohet një trup i veçantë i cili do të merrej me hulumtimin e mashtrimit të familjeve të cilat kanë paguar për informatat mbi më të dashurit e vet.

Mund të jepet rekomandimi (KOMRA) për formimin e një komisioni tjetër i cili do të merrej, për shembull, me mashtrimet që u kanë ndodhur këtyre familjeve, duke u marrë para me detyrim për informatën mbi më të dashurit e tyre (Bekim Blakaj, Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi, Konsultimet lokale me shoqatat e të pagjeturve Mitrovicë, Kosovë, 5 shtator 2009.)

Konsultimet me bashkësinë lokale

**Krushevc, Serbi
7 shtator 2009.**

Konsultimet me bashkësinë lokale në Krushevc i ka organizuar Shoqata e Grave "Peshçanik" nga Krushevc (Serbi). Kanë marrë pjesë 47 presona (meshkuj e femra), përfaqësues të administratës komunale, të institucioneve gjyqësore, institucioneve shkencore e shkollore, organizatave të luftëtarëve, partive politike dhe të organizatave joqeveritare. Midis pjesëmarrësve 2009. qenë edhe krye-shefi i Qar-

kut të Rasinës. Ligjërues kanë qenë Maja Stojanović (Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut, Serbi) dhe Dragan Popović (Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi), ndërse tubimin e ka moderuar Sandra Far-kash (Shoqata e grave “Peshçanik”, Serbi). Televizioni rajonal i Krushevcit dhe javoret “Pobeda” e “Grad”, kanë raportuar nga konsultimet.

Propozimet, mendimet, Rekomandimet e pjesëmarrësve

Pyetja themelore është si të përfitohen qeveritë në rajon kur ato nuk pajtohen.

A keni ju ndonjë ide se me cilën shpejtësi, në përgjithësi, dhe në çfarë mënyre mund t’ua mbushni mendjen të gjithë këtyre qeverive të cilat as vet, me vetveten nuk mund të pajtohen e lërë më ndërmjet veti (...) sepse kjo është çështje shumë serioze (...) Më intereson, a keni ndonjë vizion si mundet dhe me çfarë shpejtësie kjo vërtetë mund të gjallërohet (Mishko Radonjiq, “Eurokontakt”, Serbia, Konsultimet me bashkësinë lokale, Krushevc, Serbi, 7 shtator 2009.)

Nëse iniciativa do të mbështet qartë e zëshëm nga qytetarët në të gjitha shoqëritë pas-jugosllave, atëherë edhe pushtetet do ta pranojnë.

Në qoftë se tek shumica e njerëzve në të gjitha vendet ekziston mbështetja reale për t’u themeluar diçka e tillë, ne e dimë se qeveritë tona nuk do të bëjnë gjë nëse i humbin votat për atë që do ta bënin, nëse ajo mbështetje do të jetë shumë e qartë dhe e zëshme, mendoj se ekziston shansi i madh që diçka e tillë të realizohet. (Maja Stojanović, Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Krushevc, Serbi, 7 shtator 2009.)

Shtetet në rajon lypset të pajtohen rreth formimit të KOMRA-s: apo këtë ta bëjnë parlamentet, qeveritë ose kryetarët.

Secili vend (...) nga territori i ish Jugosllavisë, ka rregullat e veta juridike si formohen disa organizata, respektivisht komisionet (...) Nuk do të ishte mirë që Parlamenti në Serbi të miratojë ligjin për tu themeluar komisioni, që në Kroaci qeveria të miratojë dekretin mbi formimin e komisionit, e në Kosovë (...) kryetari i shtetit të miratojë ndonjë dekret, urdhëresë apo diçka të ngjashme. (Jelena Milutinović, “Peshçanik”, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Krushevc, Serbi, 7 shtator 2009.)

Mendoj se KOMRA s’ka kuptim në qoftë se në të gjithë

ha shtetet tani nuk miratohet, të them, në shkallë të njëjtë, domethënë në shkallë të parlamenteve. Mendoj se pastaj është e kotë. (Mishko Radonjiq, Evrokontakt, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Krushevc, Serbi, 7 shtator 2009.)

KOMRA mund të nis të punojë nëse e merr mandatin nga të gjitha shtetet në rajon..

Mendoj se do të ishte shumë mirë që ky trup rajonal të nis të punojë në një moment kur të gjitha kushtet janë përmbushur. Kjo do të thotë, nëse ai e ka marrë mandatin nga Serbia apo Bosnja e Hercegovina, e nuk e ka marrë nga Kroacia, shtrohet pyetja nëse ai trup duhet të nis të punojë. (Sasha Radovanović, Instituti për kulturën serbe, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Krushevc, Serbi, 7 shtator 2009.)

Viktimave që dëshmojnë publikisht duhet siguruar mbështetje adekuate psikologjike.

Personi që është viktimë e përdhunimit para 15 vjetësh dhe ato plagët e veta mezi i ka varrosur, duhet serish dhe atë publikisht, dëgjova se insistoni në publikun (...) Mendoj, kjo është e dëshiruar për shoqërinë si tërësi, por kjo pastaj nënkupton punën e ekipit të ekspertëve i cili do t’i ndihmonte asaj gruajë të përballët me të kaluarën e vet, e kjo nënkupton punë tejet serioze të njerëzve në atë komision (Vesna Vesković, kryetare e Kuvendit të Qytetit të Krushevcit, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Krushevc, Serbi, 7 shtator 2009.)

Kryesit të cekur për të cilët në procesin gjyqësor tregohet se janë të pafajshëm, duhet të gëzojnë të drejtën e kompensimit material.

Çfarë ndodh me personat që do të njihen apo cekur nga ndonjë viktimë si kryes të tmerrit të tij në të kaluarën, e pastaj në ndonjë procedim eventual gjyqësor të ndodh që personi të lirohet apo fare të mos procedohet, ose gabimisht të jetë në atë regjistër? Kush do ta kompensojë atë kryes të cekur dhe ku janë këtu të drejtat e tija njerëzore. (Vesna Vesković, kryetare e Komunës së Qytetit të Krushevcit, Konsultimet me bashkësinë lokale, Krushevc, Serbi, 7 shtator 2009.)

KOMRA duhet të ketë zyra kombëtare apo të jetë afër viktimës.

Sa i përket punës së komisionit, mendoj se duhet të punojë si shumë i decentralizuar (...) Do ta kemi në çdo rajon nga një zyre, por mendoj se duhet të punojë në shkallë lokale, që ashtu më mirë të mblidhen të dhënat mbi viktimat dhe që viktimat ndoshta do të

funksiononin në ndonjë mjedis të njohur (...) për shkak të konfirmimit më të lehtë të nevojave të rajoneve të caktuara. (Jovana Pavloviq, Peshçanik, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Krushevc, Serbi, 7 shtator 2009.)

Historianët konsiderojnë se për konfirmimin e të vërtetës objektive mbi luftën gjatë viteve të nëntëdhjeta është herët, por mund të ndodh të bisedohet mbi idetë e njerëzve mbi atë ngjarje.

Sa i përket (...) konfirmimit të asaj të vërtete objektive mbi ngjarjet, mendoj se akoma është herët të flitet për këtë dhe kujtoj se thjeshtë e vërteta mbi ngjarjet që kanë ndodhur gjatë viteve të 90-ta, nuk mund të konfirmohen sipas disa, të them, metodave shkencore. Duhet të kalojë edhe ndonjë periudhë. Mirëpo, mundet thjeshtë të bisedohet për idetë e njerëzve nga rajoni mbi ato ngjarje. (...) historiografia bashkëkohore synon atë që t'i studiojë idetë e njerëzve mbi ngjarjet. (Jovana Pavloviq, Peshçanik, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Krushevc, Serbi, 7 shtator 2009.)

KOMRA duhet të merret me faktet, e jo të marrë gjyqe historike e politike.

Një nga problemet është raporti i fakteve dhe shkaqeve (...) Fakti shoqëror është shumë më i komplikuar nga fakti natyror-shkencor. Fakti natyror-shkencor i nënshtrohet (...) sqarimit shkaksor (kauzal) për dallim nga fakti shoqëror (...) Këtu nuk mundemi që ngjarjen ta reduktojmë në një shkak, (...) në një dukuri e kështu me radhë (...) Do të ishte bukur problematike që ky institucion (...) të marrë gjyqe historike e politike. (Sasha Radovanović, Instituti për Kulturën Serbe, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Krushevc, Serbi, 7 shtator 2009.)

Mendoj se KOMRA nevojitet të merret ekskluzivisht me faktet, madje as me (...) reflektimin e gjenezës e tjerave, sepse kjo menjëherë prek në politik, e nëse prek në politik, atëherë krijon probleme shtojcë. (Mishko Radonjić, Evrokontakt, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Krushevc, Serbi, 7 shtator 2009.)

KOMRA nevojitet të merret me rolin e politikanëve e të mediave në përgatitjen e luftës.

Mendoj se me vetë formimin e këtij komisioni në Serbi përfundimisht do të arrimë në ballafaqimin me të kaluarën (...) Krahas politikanëve, gjykimi i madh nga ana ime është i mediave të cilat kanë qenë bashkëpjesëmarrëse kryesore, nxitëse, mund të

them madje një nga shkaktarët e krimeve të mëdha që kanë ndodhur. (Dejana Jovanović, Partia Liberal Demokratike, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Krushevc, Serbi, 7 shtator 2009.)

Pjesëmarrësit janë të ndarë rreth amnistisë: disa janë kundër amnistisë së kryesve të krimeve të luftës, kurse disa konsiderojnë se KOMRA mund t'u jap Rekomandime organeve gjyqësore për amnisti, por jo edhe vet amnistinë.

Sa i përket amnistisë (...) unë këtu jam rigoroz kundër (...) që ai komision të jap Rekomandime, por të marrë vendime (...) këtu tash shtrohet çështja e kompetencës së trupit dhe unë mendoj se këtu veç hymë në kompetencën e organeve juridike dhe kjo tash më (...) është një çështje serioze juridike (...) kujtoj bile se është edhe çështje etike (...) Kjo amnisti, në realitet mund të jetë rekomandim. (Sasha Radovanović, Instituti për Kulturën Serbe, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Krushevc, Serbi, 7 shtator 2009.)

Sa i përket amnistisë pajtohem ky se duhet të jetë rekomandim, por në rast se kryesit janë të gatshëm për bashkëpunim (...) dhe ndihmojnë zbulimin e të vërtetës, domethënë vetëm në atë rast në qoftë se duan të bashkëpunojnë.. (Dejana Jovanović, Partia Liberal Demokratike, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Krushevc, Serbi, 7 shtator 2009.)

Sa i përket amnistisë (...) unë gjithsesi jam kundër kësaj, sepse konsideroj (...) se secili duhet të bartë përgjegjësinë e veprimeve të veta pavarësisht nëse ai bashkëpunon me mua apo jo në gjetjen (...) e varrezave masive ose në zbulimin e ngjarjes (...) por përvoja historike thotë se në rastet e tilla gjithmonë është bërë amnistia. (Jovana Pavloviq, Peshçanik, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Krushevc, Serbi, 7 shtator 2009.)

Sa i përket amnistisë mendoj se për atë as që duhet diskutuar fare, as si rekomandim, as si çfarëdo tjetër. (Mishko Radonjić, Evrokontakt, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Krushevc, Serbi, 7 shtator 2009.)

Për formimin e KOMRA-s është e domosdoshme mbështetja e bashkësisë ndërkombëtare.

Sa i përket (...) formimit të këtij trupi unë mendoj se kjo nuk mund të bëhet pa mbështetjen e OSBE (...), kjo nuk mund të bëhet pa ndihmën e faktorit ndërkombëtar. (Sasha Radovanović, Instituti për

Kulturën Serbe, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Krushevc, Serbi, 7 shtator 2009.)

Për formimin e KOMRA-s nevojitet fushata e fuqishme dhe konsensusi i partive politike.

E për sa i përket parlamentit, kjo gjithashtu duhet të jetë një fushatë e organizuar me kryetaren e Kuvendit, kryetaren e Parlamentit, shefat e grupeve të deputetëve dhe të gjitha trupave që janë të ndërlidhur me problemin mbi të cilin po flasim (...) këtu megjithatë duhet të arrihet një konsensus i caktuar. (Dejana Jovanović, Partia Liberal Demokratike, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Krushevc, Serbi, 7 shtator 2009.)

KOMRA nevojitet të jetë trup shumetnik. Organizatat e shoqërisë civile duhet të jenë të përfaqësuar në KOMRA, që të sigurohet objektiviteti i komisionit.

Do të dëshiroja që ai komision të jetë shumetnik (...) për konfirmimin e të vërtetës objektive, sepse sado që ne do të përpiqemi (...) të vërtetohen faktet, secili nga ne është pjesëtar i ndonjë grupi etnik, dhe mendojmë se ne jemi më të mirë nga tjerët dhe se kemi kryer më pak vepra penale nga tjerët. (Jelena Milutinović, Peshçanik, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Krushevc, Serbi, 7 shtator 2009.)

Organizatat e shoqërisë civile duhet gjithsesi të jenë pjesë e komisionit dhe të përfaqësuar në të gjitha nivelet, sepse në atë mënyrë sigurohet, nëse jo që puna e komisionit të jetë krejtësisht objektive, (...) atëherë në njëfarë mënyre sigurohet mundësia më e madhe që komisioni të punojë objektivisht. (Slavica Stanojlović, Peshçanik, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Krushevc, Serbi, 7 shtator 2009.)

Është me rëndësi që me rastin e zgjedhjes së anëtarëve të KOMRA-s të respektohet barazia gjinore.

Gjithashtu, për mua si aktiviste për të drejtat e grave dhe të njeriut, është me rëndësi dimensionin gjinor, e jo vetëm kur është fjala mbi krimet dhe mbi përdhunimet që i përmendem, veç thjeshtë dimensionin gjinor në punën e komisionit në të gjitha nivelet. (Slavica Stanojlović, Peshçanik, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Krushevc, Serbi, 7 shtator 2009.)

KOMRA duhet ta përkufizojë nocionin e viktimës dhe të kryesit.

Mendoj se është me rëndësi (...) të bëhet harmonizimi në disa elemente sikurse janë definicionet, bie fjala, të kemi njëjtë të harmonizuar definicionin se kush është viktima e kush kryesi, (...) çka konsiderohet krim. (Slavica Stanojlović, Peshçanik, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Krushevc, Serbi, 7 shtator 2009.)

Rezultati më i rëndësishëm i KOMRA-s është krijimi i dokumentacionit mbi të kaluarën.

Suksesi më i madh, nëse fare formohet ky trup rajonal, do të ishte në realitet që të ekzistojë një dokumentacion qendror (...) E tërë kjo iniciativë në realitet do të ishte një pikë reference (...) dhe që gjyqet tona morale e me vlera në realitet t'i ndërtojmë në bazë të dokumentacionit të KOMRA-s. (Sasha Radovanović, Instituti për Kulturën Serbe, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Krushevc, Serbi, 7 shtator 2009.)

Ndoshta KOMRA (...) do të duhej të (...) niset në këtë drejtim, të shtrojë një objektiv afatgjatë i cili do të sillte diçka të atillë që të kemi (...) njerëz tolerant, njerëz me mendim kritik, njerëz që dinë ta thonë „e çka do të bëja, sikur të isha i lindur si shqiptar i vogël, apo kroat i vogël, si do të mendoja unë atëherë“. (Branimir Shoshkić, profesor në Gjimnazin e Krushevcit, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Krushevc, Serbi, 7 shtator 2009.)

Nevojitet mbështetja e bashkësive fetare, sepse ato për shkak të ndikimit të vet mund të kontribuojnë në pajtimin midis bashkësive etnike.

Do të ishte shumë me rëndësi që kishat, respektivisht (...) bashkësitë fetare ti japin mbështetje këtij projekti, e në esencë, akoma nuk kemi kurrfarë përgjigje, të paktën sa di unë nuk ka, jo vetëm me rastin e kësaj çështje, por në përgjithësi lidhur me çështjen e ndonjë përparimi drejtë pajtimit (...) dhe të bashkimit në një bashkësi në kuptimin njerëzor. (Mishko Radonjić, Evrokontakt, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Krushevc, Serbi, 7 shtator 2009.)

KOMRA duhet ti hartojë Rekomandimet mbi arsimimin e të punësuarve në administratën publike.

Në komunat tona dhe në administratat e qyteteve, pikërisht punojnë njerëzit që nuk janë të stërvitur për atë punë. Ne jemi të vetëdijshëm se gjatë disa viteve të fundit jemi shtet partiak dhe se aty kryesisht punësohen personat sipas përkatësisë partiake, dhe mendoj se është i domosdoshëm edukimi i admin-

istratës shtetërore, të qytetit e të komunës, dhe krejt kjo me qëllim të shërbimit më të mirë për qytetarët e qytetarët, (...) mendoj se rekomandimi i KOMRA-s mund të kontribuojë që ky qëllim të arrihet sa më shpejtë.. (Dejana Jovanović, Partia Liberal Demokratike, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Krushevc, Serbi, 7 shtator 2009.)

Konsultimet kombëtare me të rinjtë

Sarajevë, BeH
19 shtator 2009.

Konsultimet kombëtare me të rinjtë i ka organizuar Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në BeH. Në tubim kanë qenë prezent 40 pjesëmarrës dhe vëzhgues, kryesisht aktivist të organizatave joqeveritare për të drejtat e njeriut, kurse në konsultime si vëzhgues ka marrë pjesë edhe anëtarja e Partisë Politike "Nasha Stranka". Ligjërues kanë qenë Mario Mazhiq (Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Kroaci) dhe Marijana Toma (Impunity Watch, Serbi), kurse moderator ka qenë Aleksandra Letiq (Këshilli i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën Serpska, BeH).

Propozimet, mendimet, Rekomandimet e pjesëmarrësve

Të rinjtë nuk janë përgjegjës për krimet e bëra, por kanë nevojë ta kuptojnë të kaluarën (të ballafaqohen) dhe ta marrin përgjegjësinë për të ardhmen.

Të rinjtë (...) nuk mund të jenë përgjegjës për atë që kanë bërë prindërit e tyre (...) gjatë kohës së luftës. Mirëpo, (...) gjenerata e re është ajo e cila i ndjen jashtëzakonisht pasojat e atyre ndodhjeve luftarake dhe vërtetë kemi për qëllim që të rinjtë (...) me anë të proceseve konsultative, e po ashtu edhe me punë në procesin e ballafaqimit me të kaluarën (...) ta kuptojnë të kaluarën (...) dhe në atë mënyrë ta marrin përgjegjësinë në të ardhmen, (...) që të bëjnë çmos, të evitojnë gjithçka që ato krime të tmerrshme më të mos përsëriten kurrë. (Alma Mashiq, Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në BeH, Konsultimet kombëtare me të rinjtë, Sarajevë, BeH, 17 shtator 2009.)

KOMRA duhet të rekomandojë programe të reparacionit për viktimat dhe shoqërinë në

tërësi, të cilët do ta ndihmojnë ballafaqimin më të lehtë me atë që është bërë.

Ky trup (...) pasi që të publikojë raportin, hartojë (...) Rekomandimet të cilat pastaj shteti (...) duhet t'i zbatojë (...) Ato rekomandime janë njëfarë programi i reparacionit për viktimat. Por unë do të thosha se këto mund të jenë (...) programe të reparacionit për shoqërinë në tërësi. Pra, ajo propozon se si kjo shoqëri sa më mirë të kalojë nëpër atë tranzicion, që sa më mirë të ballafaqohet me atë çka është bërë (...) që të jetë sa më e shëndoshë në të ardhmen. (Mario Mazhiq, Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Kroaci, Konsultimet kombëtare me të rinjtë, Sarajevë, BeH, 17 shtator 2009.)

KOMRA duhet të jetë i pavarur nga ndikimet politike dhe të ketë fuqi të jap urdhëresa role të detyrueshme për dëshmitarët pavarësisht nga cili shtet në rajon janë..

Edhe ne këtu tash mund të formojmë komisionin, dhe t'i ftojme dëshmitarët të dëshmojnë e ai thotë "s'dua" (...) Vërtetë lypset të jetë i pavarur (...) nga të gjitha ndikimet e mundshme politike, e nga ana tjetër nevojitet të ketë instrumente të detyrimit. Kur ai komision ta gjejë të nevojshme se duhet të dëshmoji ai dhe ai person, domethënë që edhe automatikisht mund të jap urdhëresën për shoqërimin e atij personi që të vijë, do me thënë që ai të dëshmojë e që atë urdhëresë nuk mund ta bllokojë ndonjë institucion tjetër në kuadër të shtetit. (Gjorgje Radanović, Qendra për Afirmimin e të Rinjve Shekoviqi, BeH, Konsultimet kombëtare me të rinjtë, Sarajevë, BeH, 17 shtator 2009.)

Vështirë është të ndërlihet konflikti i Kosovës me konfliktet e vitit 1991-1995 dhe të pritët që KOMRA të miratojë konkluzione unike.

Nuk mund të flasim se e gjithë kjo është plotësisht e ndërlihur, e nga një komision duhet të kemi konkluzione unike. Si do të nxjerrim konkluzione unike nëse nga tri grupe të konflikteve të cilat pavarësisht realisht janë krijuar, pavarësisht nga ndërlihdja e ndonjërit?(...) paraqet problem ta formojmë komisionin rajonal plotësisht unike nëse e lidhim konfliktin Kosovës bashkë me këto që kanë ndodhur më '91-'95. (Haris-Qamil Beshlagiq, Iniciativa për të Drejtat e Njeriut në BeH, Konsultimet kombëtare me të rinjtë, Sarajevë, BeH, 17 shtator 2009.)

Në bashkësitë lokale ka frikë dhe moskuptim të cilat mund të eliminohen me punë të përhër-

shme, me informim dhe me inkuadrimin e të rinjve në Koalicionin KOMRA.

Popullata e njerëzve të rinj duhet të marrë pjesë aktive në një Koalicion të këtillë. Aktivisht mund të kyçet me informimin direkt të njerëzve të rinj. Një nga mënyrat e këtij informimi është që këtë informatë që ne e morëm sot këtu, mund ta ndajmë në mjediset tona lokale dhe ajo natyrisht, do të shtrihet më me cilësi midis njerëzve të rinj. (Drazhen Boshković, Forumi i të Rinjve Trebinje, BeH, Konsultimet kombëtare me të rinjtë, Sarajevë, BeH, 17 shtator 2009.)

Këtu me siguri do të ekzistojnë shumë vështirësi (...) veçanërisht në mjediset e vogla. Trebinje është një nga ato mjedise. Është organizuar ai konsultimi lokal. Mirëpo, disa njerëz të cilët kanë ardhur aty nga mos informimi (...) thanë se kurrë më nuk do të vijë në këtë konsultim, sepse mua pastaj aty dikush do të më vras apo diç ashtu. Mendoj se shumica e mjediseve të vogla në Bosnjë e Hercegovinë ashtu do të silltet, dhe se shumica e njerëzve të rinj për afërsisht ashtu mendon. Dhe se pikërisht duhet punuar në atë që të ndryshohet mendimi. Kjo duhet të bëhet me informimin e vazhdueshëm të njerëzve të rinj, çka është KOMRA. (Drazhen Boshković, Forumi i të Rinjve Trebinje, BeH, Konsultimet kombëtare me të rinjtë, Sarajevë, BeH, 17 shtator 2009.)

KOMRA duhet të jetë prezent dhe i mbështetur në bashkësitë lokale.

Në qoftë se KOMRA në Bosnjë e Hercegovinë do të jetë pjesë rajonale, ai para se gjithash duhet të jetë i fuqishëm në territorin e vet dhe ata anëtarë që do të jenë anëtar të KOMRA-s nevojitet të jenë persona me besim të plotë dhe persona të cilët dinë çka punojnë, të dinë se kë e përfaqësojnë (...) dhe në interesin e kujt janë ato vendime. Pra, unë angazhohem për atë që të punohet më shumë në iniciativën e KOMRA-s lokal (Drazhen Boshković, Forumi i të Rinjve Trebinje, BeH, Konsultimet kombëtare me të rinjtë, Sarajevë, BeH, 17 shtator 2009.)

Në debatin mbi KOMRA-n lypset folur me gjuhë të zakonshme që i përshtatet moshës dhe njerëzve që marrin pjesë.

Dhe e kuptoj plotësisht reagimin e njerëzve të rinj kur përmenden reparacionet, drejtësia në tranzicion. Po i frikësoni njerëzit (...) Unë konsideroj se duhet (...) thënë me gjuhë të zakonshme, jo të sqarohet. Ata nuk duan t'u sqarohet. Nuk dua as unë. Me gjuhën më të zakonshme, më të thjeshtë çka është ajo drejtë-

sia në tranzicion (...) që fare ta kuptojnë kontekstin e konsultimeve dhe të asaj që kërkohet nga ne (...) Domethënë, do të ishte mirë që (...) gjuhën e konsultimeve (...) t'ia përshtatim moshës dhe njerëzve me të cilët konsultohemi (Jasminka-Drino Kriliq, Qendra Rinore Gornji Vakuf/Uskoplje, BeH, Konsultimet kombëtare me të rinjtë, Sarajevë, BeH, 17 shtator 2009.)

Megjithatë ato janë viktime edhe të torturës, edhe të luftës dhe gjithë tjerave, dhe nuk do ta kuptojnë këtë gjuhë me të cilën ndodhsha do t'u flitet, ashtu që atë duhet përshtatur. Veçmas që në ato disa mjedise ka shumë njerëz që nuk janë të arsimuar. (Nina Zupan, Lëvizja Rinore "Revolt" Tuzëll, BeH, Konsultimet kombëtare me të rinjtë, Sarajevë, BeH, 17 shtator 2009.)

Nuk është sa duhet e qartë cila është strategjia e Koalicionit për KOMRA dhe cilat janë detyrat e pjesëmarrësve në konsultime.

Çka kërkohet nga unë si person i ri në tërë këtë proces të konsultimeve? (...) Kah po shkon Koalicioni? Çfarë është strategjia e Koalicionit? (...) Kah po shkojnë konsultimet? Kur e merreni (...) materialin për konsultime, çka do të bëni me atë? Ku shkon ai dhe çfarë është strategjia? (...) A po sheh Koalicioni, a ka vizion? Për mua kjo është shumë qenësore. (Jasminka-Drino Kriliq, Qendra Rinore Gornji Vakuf/Uskoplje, BeH, Konsultimet kombëtare me të rinjtë, Sarajevë, BeH, 17 shtator 2009.)

Është qenësore që debati të zhvillohet në bashkësitë lokale.

Është shumë me rëndësi që edhe në mjediset më të vogla të nisni konsultimet e këtilla, sepse kjo është mënyra e mirëfilltë që ne të gjithë ta paraqesim, të rinj e të moshuar, mendimet tona për gjithë këtë. Svetlana Vuković, Shoqata e Grave -Luna, Konsultimet kombëtare me të rinjtë, Sarajevë, BeH, 17 shtator 2009.)

Iniciativa KOMRA do të ketë mbështetjen e të rinjve nëse paraqitet si sfidë.

Ju sugjeroj si organizatorëve (...) S' është se njerëzit e rinj nuk janë të interesuar. Njerëzit e rinj kërkojnë sfida. Në qoftë se nuk u jepet sfida e mirëfilltë atëherë do të bëjnë sfidë të gabueshme (...) në Bosnjën Lindore (...) vetëdija e tyre është formësuar (...) në rrethin familjar një nacional. (...) Unë kam punuar me fëmijët të cilët shkojnë në shkollën e njëjtë, klasat e

njëjta, por paralelja tjetër. Myslimani e serbi nuk njihen. Fare nuk përhëndetën (...) Do të mbledhim ne mbi një milion nënshkrime dhe mbështetje në qoftë se njerëzve si duhet ua shpjegojmë çka është kjo, për çka po bëhet kjo. (Salih Rasavac, Corridor, BeH, Konsultimet kombëtare me të rinjtë, Sarajevë, BeH, 17 shtator 2009.)

Përmendoret e viktimave dhe kryesve çfarë janë ngritur në BeH, po e thellojnë hendekun midis popujve.

Unë e di se kur shkojmë (...) në Bosnjën Lindore (...) këtu (...) kanë bërë atë e këtë, dhe regjistri. Duhet shënuar përmendoren. Përmendorja si përmendore është përmendore dhe dihet për çka dhe çfarë qëndrimi duhet pasur ndaj saj. Mirëpo, kështu si po punohet, ne (...) po e thellojmë hendekun që është prezent. (Salih Rasavac, Corridor, BeH, Konsultimet kombëtare me të rinjtë, Sarajevë, BeH, 17 shtator 2009.)

KOMRA ka dimensionin humanitar në raport me viktimën se sa gjykimet penale.

Unë kam qenë në Hagë një muaj në edukim. E kam përcjellë punën e Gjykatës, veçmas të fokusuar në viktimën dëshmitarit në proces (...) Ky është proces pa aspak dinjitet. (...) Kjo është diçka tjetër. E ka një dimension human (...) I realizon të drejtat, e në anën tjetër është edhe parandalues, në rastin e fundit, për disa ngjarje të ardhshme.. (Salih Rasavac, Corridor, BeH, Konsultimet kombëtare me të rinjtë, Sarajevë, BeH, 17 shtator 2009.)

KOMRA nuk duhet t'i mbulojë ngjarjet që kanë ndodhur në të kaluarën e largët.

Të shkohet me këtë në të kaluarën e largët, në vitin 1800 apo ndonjë vit tjetër. Kjo është zbutje e përgjegjësisë për atë (...) që ka ndodhur para disa vitesh në këto hapësirat tona. Për mua kjo fare nuk është e afërt, prandaj do të sugjeroja (...) që të mos shkojmë larg, se do t'i hulumtojmë Ilirët (...) e nuk do ta (...) kërkojmë përgjegjësinë e atyre atje të cilët kanë bërë vepra të këqija sikurse janë bërë në vendin tonë. (Salih Rasavac, Corridor, BeH, Konsultimet kombëtare me të rinjtë, Sarajevë, BeH, 17 shtator 2009.)

Njëri nga problemet për marrjen e vendimit mbi formimin e KOMRA-s mund të jetë praktika e Parlamentit në BeH, ku miratimi i ligjeve dhe i vendimeve zgjatë me vite.

Ne një ligj e miratojmë një 10 vjet. Në fund e refuzojmë për shkak se nuk na pëlqen një fjali (...) Nga ana tjetër nëse nuk e përfundojmë diçka në mandatin prej katër vjetësh, sa janë në pushtet disa politikan, atëherë kemi fituar asgjë, sepse prapë duhet të vijë një tjetër ta marrë punën.. (Ivana Grabovac, Byroja e Qytetarëve Tuzëll, BeH, Konsultimet kombëtare me të rinjtë, Sarajevë, BeH, 17 shtator 2009.)

Një nga problemet për formimin e KOMRA-s mund të jetë edhe fakti që disa shtete në rajon nuk e njohin Kosovën e disa, siç është Sllovenia, janë anëtare të Bashkimit Evropian.

KOMRA si (...) komision rajonal i cili duhet të formohet me marrëveshje ndërkombëtare, si mund t'i tejkalojë problemet e quajtura anëtarësim të Sllovenisë, e së shpejti edhe të Kroacisë, në Bashkimin Evropian dhe mosnjohja ndërkombëtare e Kosovës vetëm si vend ku duhet të hulumtohen shkeljet e të drejtave të njeriut? (Damir Salkiq, Iniciativa Rinore për të Drejtat e Njeriut të Bosnjës e Hercegovinës, zyra në Sarajevë, BeH, Konsultimet kombëtare me të rinjtë, Sarajevë, BeH, 17 shtator 2009.)

Viktimat në BeH nuk janë të hapura për bisedime dhe nuk kanë besim ndaj personave nga bashkësitë tjera etnike.

Unë veç një vit e gjysmë po punojë në viktimat e torturës dhe kam shkuar edhe nëpër vendbanimet e refugjatëve dhe nëpër vendet ku njerëzit janë kthyer në vatrat e veta (...) Njerëzit janë mjaftë skeptik rreth këtyre gjërave (...) Është shumë vështirë t'u flitet atyre njerëzve. Ata njerëz nuk duan të flasin për atë që u ka ndodhur atyre (...) Unë e cila quhem Nina, kur vij në ndonjë vend ku ekskluzivisht janë myslimanët, ata automatikisht ngrenë mur përpara meje, për shkak se unë quhem Nina apo që mbie-mrin e kam Zupan dhe mua më duhet që gjysmë orën e parë të sqaroj kush jam dhe çka jam dhe për çka jam aty, që ata fare të më lejojnë t'i pyes si janë e gjëra të ngjashme. (Nina Zupan, Lëvizja Rinore "Revolt", Tuzëll, BeH, Konsultimet kombëtare me të rinjtë, Sarajevë, BeH, 17 shtator 2009.)

Viktimave në bashkësisë e përziera (kthyes) u nevojitet mbështetja dhe ndihma e veçantë psikologjike.

Ata thonë (...) gjykata edhe më tutje po e bënë këtë, komisionet po e bëjnë këtë, por ata njerëz akoma mbeten me ato trauma. (...) Përfundimisht me ata (viktimat) duhet punuar sidomos, bie fjala, që të

gjithë ata njerëz kanë fëmijë të cilët kanë probleme në shkollë (...). Këto tash janë katunde dhe vendbanime të përziera dhe ata fëmijë shkojnë në shkolla të ndarë apo shkojnë bashkë në shkollë ku çdo ditë ndeshën me ato probleme të caktuara. (Nina Zupan, Lëvizja Rinore "Revolt", Tuzëll, BeH, Konsultimet kombëtare me të rinjtë, Sarajevë, BeH, 17 shtator 2009.)

Nevojitet të fillojmë lobingun dhe kërkimin e mbështetjes nga pushteti dhe partitë politike.

A ekziston lobingu aktiv, domethënë, momental i atyre parlamenteve? Mendoj se ky është proces i cili është shumë i rëndësishëm (...) për miratimin e mëvonshëm të të gjitha atyre strategjive dhe në fund të KOMRA-s. (Drazhen Boshković, Forumi i të Rinjve të Trebinjes, BeH, Konsultimet kombëtare me të rinjtë, Sarajevë, BeH, 17 shtator 2009.)

Mendoj se duhet kërkuar atë mbështetje maksimale nga strukturat qeveritare në pushtet për shkak se pa to nuk mund të bëhet asgjë. (Nina Zupan, Lëvizja Rinore "Revolt", Tuzëll, BeH, Konsultimet kombëtare me të rinjtë, Sarajevë, BeH, 17 shtator 2009.)

Rrjetet e të rinjve mund të ndihmojnë në grumbullimin e 1.000.000 nënshkrimeve.

Njëfarë propozimi imi është (...) nëse ndoshta nuk keni filluar, veç është dashur të nisni ta ndërtoni një rrjet të organizatave rinore (...) Ato organizata rinore, të paktën e jona një herë në javë ka takime me anëtarët e vet dhe mundët veç me ta të fillojë të bisedojë, dhe me këtë do të mundeni në të ardhmen e afërt të merrni nga ata informatën kthyesë, cili është ai numër i anëtarëve që mund të punojë, emrat e mbiemrat menjëherë t'i keni konkretisht dhe të futeni të gatshtëm në atë proces të grumbullimit të petitionit. (Drazhen Boshković, Forumi i të Rinjve të Trebinjes, BeH, Konsultimet kombëtare me të rinjtë, Sarajevë, BeH, 17 shtator 2009.)

Konsultimet janë të mira por sa më shpejtë lypset organizuar fushatën mediatike, që të fitohet mbështetja e gjerë.

Sado që për mua ishin cool këto konferencat kur ne të gjithë pak shihemi, bisedojmë, njohim shumë njerëz nga viset e ndryshme të shtetit. Mendoj personalisht se ky KOMRA do të duhej, (...) shumë shpejtë, domethënë, të nis me njëfarë (...) fushate mediatike për një masë më të gjerë popullore, sepse (...) KOMRA nuk mundet as të ketë sukses pa (...) mbështetjen e masës së gjerë popullore. (Damir Dejanović, Lëvizja Rinore "Revolt", BeH, Konsul-

timet kombëtare me të rinjtë, Sarajevë, BeH, 17 shtator 2009.)

Nevojitet të shfaqet kujdes që deklaratat e dëshmitarëve të janë të verifikuara.

Mua më intereson konkretisht kush do të punojë në teren në bashkësitë lokale midis atyre viktimave. Kush do t'i mbledh ato rrëfime? Pra, kush do të punojë në sistematizimin e kësaj? A do të jenë këto organizatat prej partneri, individët, përfaqësuesit e KOMRA-s apo ... Dhe në kontekst të kësaj dëshiroj të propozoj që të shfaqet kujdes, sepse ne jemi të privë që ato rrëfime t'i trillojmë (...) Duhet të shfaqet kujdes mbi vërtetësinë e atyre rrëfimeve dhe të fakteve në terren. (Almir Salihović, Asociacioni i Studentëve Srebrenicë, BeH, Konsultimet kombëtare me të rinjtë, Sarajevë, BeH, 17 shtator 2009.)

Iniciativa për KOMRA dhe vetë KOMRA janë parandalim që konfliktet të mos përsëriten në të ardhmen.

Kur erdha këtu as që mund të paramendoja se kjo është ajo për të cilën po bisedojmë. Por tash kur po shoh, po vërej se kjo ndoshta është një çështje e re në Ballkan e cila është parandalim. Domethënë, gjëja më e rëndësishme e gjithë kësaj është parandalimi që kurrë më të mos ndodhë ajo që ka ndodhur. (Gjorgje Radanović, Qendra për afirmimin e të rinjve Sheković, BeH, Konsultimet kombëtare me të rinjtë, Sarajevë, BeH, 17 shtator 2009.)

KOMRA nevojitet të ketë zyrat në bashkësitë lokale, para se gjithash në ato ku gjenden bashkësitë etnike të cilat jetojnë ndaras njëra nga tjetra, si dhe në bashkësitë që janë të ngarkuara me konflikte. Mësimi i fakteve në bashkësitë e ndara do t'u jep shembull shteteve si t'i zgjidhin problemet.

Unë vij nga bashkësia e ndarë kombëtare dhe shkojë në shkollë e cila është e etiketuar si dy shkolla nën një kulm. Dhe pikërisht angazhohem për këtë lokale e primare. Domethënë, KOMRA-n lokale. Kjo është ide ekstra, sepse (...) nëse ne e zgjidhim këtë në bashkësinë lokale, shumë lehtë kjo do të mund të shtrihet në shkallë shteti (Avdo Zec, Qendra rinore Gornji Vakuf/Uskoplje, BeH, Konsultimet kombëtare me të rinjtë, Sarajevë, BeH, 17 shtator 2009.)

Viti 2010 është viti zgjedhor në BeH dhe fushata paraelektorale potencialisht mund të ketë ndikim negativ në iniciativën dhe formimin e KOMRA-s.

Folëm mbi problemet që mund të lindin, respektivisht të cilat me siguri do të krijohen me rastin e formimit (...) Nuk di nëse keni llogaritur njërën nga gjërat (...) Viti 2010 gjithsesi është një vit i turbulencave në BeH për shkak të fushatës elektorale (...) Në atë kohë turbulente po hyjmë ne me fushatën tonë, domethënë, formimin e komisionit. (Nihad Ganija, Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në BeH, Konsultimet kombëtare me të rinjtë, Sarajevë, BeH, 17 shtator 2009.)

Konsultimet me bashkësinë lokale

Pakrac, Kroaci
22 korrik 2009

Konsultimet në Pakrac i kanë organizuar Qendra për mbështetje e zhvillim të shoqërisë civile Delfin (Kroaci) dhe Documenta (Kroaci). Në tubim kanë qenë të pranishëm 63 pjesëmarrës/se, kryesisht përfaqësues/se të organizatave për të drejtat e njeriut, të bashkësive e të shoqatave të familjeve të viktimave, të bashkësive minoritare, bashkësive të shoqatave të veteranëve, si dhe përfaqësues/se të vetëqeverisjes lokale, e individ nga qytetet Pakrac e Lipik. Ligjërues kanë qenë Suzana Kunac (B.a.b.e, Kroacia), Dragan Popoviq (Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi) dhe Goran Božićević (Miramida Centar, Kroacia). Tubimin e kanë moderuar Mirjana Bilopavloviq (Delfin, Kroaci), Vesna Tersheļiq (Documenta, Kroaci) dhe Goran Božićević (Miramida Centar, Kroaci). Gazeta e Pakracit dhe Radio Daruvar kanë njoftuar nga tubimi ndërsa Mirjana Bilopavloviq (Delfin, Kroaci), Vesna Tersheļiq (Documenta, Kroaci) dhe Dragan Popoviq (Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi) kanë dhënë deklarata për HRT (Radiotelevizioni i Kroacisë), korrespondenca në Daruvar. Letra të mbështetjes tubimit i kanë dërguar në emër të zyrës së presidentit të Republikës së Kroacisë, këshilltari i presidentit për çështjet e sistemit politik, prof dr sc Sinisha Tataloviq në emër të Qeverisë së RK dr. Slobodan Uzelac, nënkryetari i Qeverisë së RK.

Propozimet, mendimet dhe Rekomandimet

Iniciativa KOMRA është mbështetje e mirëseardhur për procesin e vërtetimit të së vërtetës mbi kryesit dhe viktimat, që do të reflektojë pozitivisht në marrëdhëniet midis popujve dhe shteteve në rajon.

Puna e deritashme e shoqatave pjesëmarrëse të këtyre konsultimeve dhe të shoqatave tjera joqeveritare në Kroaci dhe në shtetet fqinje të përfshira nga lufta gjatë viteve të nëntëdhjeta, në masë të ndjeshme ka ndihmuar përsheptimin e procesit të vërtetimit të fakteve lidhur me kryerjen e krimeve të luftës dhe shkeljen e të drejtave të njeriut. Kjo iniciativë është mbështetje e mirëseardhur për intensifikimin e mëtejme dhe zbatimin e plotë të këtij procesi, në mënyrë që e vërteta mbi kryesit dhe krimet të vërtetohet si duhet dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse, që padyshim do të reflektonte pozitivisht në ndërtimin e marrëdhënieve gjithëpërfshirëse midis popujve e shteteve që kanë qenë të përfshira me luftë. (prof. dr. sc. Sinisha Tataloviq, Zyra e presidentit të RK, Kroaci, letra e mbështetjes, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pakrac, 22 korrik 2009)

Hartimi i regjistrit zyrtar e objektiv mbi të kaluarën dhe njohja e viktimave është detyrë e madhe.

Hartimi i regjistrit të saktë, zyrtar e objektiv mbi krimet e luftës dhe shkeljet tjera të rënda të drejtave të njeriut të kryera në periudhën prej fillimit të luftës më 1991 deri në fund të vitit 2001, njohja e viktimave dhe e vuajtjeve të tyre, si dhe evitimi i përsëritjes së krimeve, sikurse keni cekur në përshkrimin e objektivave të KOMRA-s, vërtetë është detyrë e madhe. (Slobodan Uzelac, nënkryetar i Qeverisë së RK, Kroaci, letra e mbështetjes, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pakrac, 22 korrik 2009)

Iniciativa KOMRA e hap dialogun midis grupeve të ndryshme në shoqëri të cilat deri më tash nuk kanë biseduar.

Për mua është shumë me rëndësi që ne në Kroaci ta hapim dialogun ndërmjet njerëzve të cilët deri më tash bash nuk kanë biseduar (...) se kemi nevojë të bisedojmë dhe kjo mund të funksionojë (Goran Božićević, Miramida Centar, Kroacia, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pakrac, 22 korrik 2009)

Duhet nisur nga fakti se kush dhe kur e ka nisur luftën pavarësisht nga mendimet e ndryshme mbi shkaqet e luftës.

Mua personalisht më mungon fjalia se kush dhe kur e nisi luftën. Mendoj se pa këtë, derisa të mos ketë guxim që ai tanku i APJ që ka hyrë në Pakrac dhe ai fqinji (...) e rroki pushkën më 1. 3. dhe e sulmoy postëkomandën e policisë (...)n ë Pakracin kroat të mund të thotë „po, ne e nisem jemi të gatshëm të

shkojmë përpara" ... Unë jam katolik, jam i gatshëm të fali kur të më shtrihet dora. (...) dhe nuk më pëlqen ai opsioni se fillimi është Beogradi. Mirë shumë, por nëse prapa kësaj qëndron fakti se jeni të vetëdijshëm për atë çfarë ka ndodhur. (Dubravka Shpançiq, Qyteti Pakrac, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pakrac, 22 korrik 2009)

Mendoj se shkaqet duhet të jenë për çdo rast, sepse ne sot po flasim ekskluzivisht mbi pasojat, e ato pasoja kanë lindur për arsye të ndonjë shkaku (...) Ne me siguri kemi mendime të ndryshme mbi shkaqet e kësaj lufte (Branko Kovaçiq, Këshilli i pakicës kombëtare serbe i qytetit Daruvar, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pakrac, 22 korrik 2009)

Si të sigurohet që parlamentet t'i zgjedhin anëtarët e ndershëm, me përvojë dhe të arsimuar të KOMRA-s pa ndikimin e politikës.

Më habit fakti që parlamenti do t'i formojë komisionet. Akoma demokracia në shtetet tona nuk është aq sa që t'i ikim politikës dhe anëtarët e komisioneve të pa ndërlidhur për politikën. (...) Si mendoni ti ikni politikës? Si mendoni ta impononi që parlamentet të zgjedhin anëtarë mjaftë të ndershëm, me përvojë dhe të arsimuar (...) këtë nuk e kam të thënë deri në fund (Dubravka Shpançiq, Qyteti Pakrac, Kroacia, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pakrac, 22 korrik 2009)

KOMRA hap hapësirë që fajtorët të amnistohen.

E keni hapur poligonin që fajtorët mund të flasin, e për këtë mund të amnistohen. Me këtë nuk pajtohem. ((Dubravka Shpançiq, Qyteti Pakrac, Kroacia, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pakrac, 22 korrik 2009)

Pjesëmarrësit/set nga Kroacia dëshirojnë të mësojnë se në çfarë mënyre në Serbi, BeH dhe në Mal të Zi trajtohen veteranët që janë pjesëmarrës të luftës në Kroaci: a trajtohen ata si heronj?

Ne e kemi të zgjidhur legjislacionin, ligjet mbi mbrojtësit e atdheut ...Unë personalisht nuk i njoh ligjet në Serbi. A i konsideron Serbia veteranët dhe mbrojtësit njerëz që kanë shtënë ndaj nesh? A e ka këtë Mali i Zi apo Bosnja? Kush janë mbrojtësit, cilët janë heronjtë e vendeve me të cilët ne do të bashkëpunojmë në KOMRA? ((Dubravka Shpançiq, Qyteti Pakrac, Kroacia, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pakrac, 22 korrik 2009)

KOMRA do ti hulumtojë krimet të cilat nuk janë proceduar deri më tash.

Kemi njerëz tanë, pakracasit të cilët nga Kostajnica janë dërguar në Manjaçë, Bjelinë, vukovaras të zënë rob në Mitrovicën e Sremit, kurrë s' kam dëgjuar se (...) dikush është proceduar nga ato teritore. (...) Unë e di se komisioni do të jap përgjigje pikërisht në këto pyetje. (Dubravka Shpançiq, Qyteti Pakrac, Kroacia, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pakrac, 22 korrik 2009)

Nevojitet të definohet nocioni i viktimës. Këta janë edhe fëmijët të cilëve u është shkurtuar fëmijëria e rehatshme.

Të definohet viktimat. I përmendet gratë, i përmendet përdhunimet, atë që nuk e njeh as legjislacioni kroat, kurse ne e ndjejmë shumë mirë, viktimat janë madje edhe fëmijët e mi të cilët jetojnë në qytetin e tillë, të cilëve u është shkurtuar ajo që e kam gëzuar unë para 30 vjetësh. Viktimat janë edhe gratë të cilat me fëmijët janë endur nëpër shtëpia të huaja derisa burrat e tyre kanë qenë në fushëbetejë (...) Ne jemi të gjithë njerëz me trauma. (Dubravka Shpançiq, Qyteti Pakrac, Kroacia, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pakrac, 22 korrik 2009)

Viktimat nuk guxon të barazohen me agresorin.

Ndoshta jam e lidhur emotivisht, por (...) edhe kur kam hyrë në këshillin ndërkombëtar për pajtim dhe këtu në famulli, kurrë s'kam thënë se viktimat duhet të barazohet me agresorin.. Kjo është e para dhe themeloria që duhet të kuptohet. (Jaroslav Vozab, Këshilli i pakicës kombëtare çeke, Famullia e Pozhegës-Sllavonisë, Qyteti Lipik, Kroacia, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pakrac, 22 korrik 2009)

Duhet emërtuar kryesit dhe urdhërdhënësit e jo të fajësohet i tërë populli.

Kur flitet për ndonjë krim, atëherë gjithmonë jam për atë që të flitet me emrin e mbiemrin e kriminelit dhe të atij i cili e ka shty. Domethënë, aty do të duhet edhe ai që e ka bërë atë të thotë kush e ka shty. (Jaroslav Vozab, Këshilli i pakicës kombëtare çeke, Famullia e Pozhegës-Sllavonisë, Qyteti Lipik, Kroacia, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pakrac, 22 korrik 2009)

Kam qenë robër në kampin Buçe, por para këtij kampi në Buçe ka qenë një kamp në Grgjevicë (...) Unë kam qenë si serb për shkak se nuk kam pranuar

të shkoj në ushtri (...) Mua tmerrshëm më ofendon si njeri. Kudo që vi thonë „Ju serbët e keni bërë këtë”. E unë them: „Po, se kam bërë.” Unë tash në katundin tim kam njëqind shtëpi. Asnjëri nuk është fajtor, unë garantoj me jetën time (...)por duhet thënë me emër e mbiemër. (Veljko Mandiq, Shoqata e luftëtarëve antifashist dhe e antifashistëve, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pakrac, 22 korrik 2009)

Të gjitha shtetet duhet të pranojnë dorëzimin e kriminelëve dhe ti dënojnë kriminelët.

Të gjitha vendet duhet para se gjithash ta pranojnë një ligj themelor, dorëzimin e kriminelëve dhe respektimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë dhe ti fusin të gjitha klauzolat në shtetet e veta se ata kriminel duhet të dënohen. (Jaroslav Vozab, Këshilli i pakicës kombëtare çeke, Famullia e Pozhegës-Sllavonisë, Qyteti Lipik, Kroacia, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pakrac, 22 korrik 2009)

Është me rëndësi të regjistrohen të gjitha kampet dhe ata të shënohen.

Kam qenë robër në kampin Buçe, por para këtij kampi Buçe ka qenë një kamp në Grgjevic për të cilin ndoshta askush nuk ka ditur nga këto pushtete, vetëm kanë ditur disa njerëz, ata kriminelët që na kanë mbyllur atje (...) Sekret, për të cilët nuk ka ditur askush përpos partisë, të këtyre “serbomëdhenjve”, si do ti quaja unë ata, apo jo serbët (...) dhe atje duhet vendosur një tabelë (Veljko Mandiq, Shoqata e luftëtarëve të antifashizmit dhe antifashistëve, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pakrac, 22 korrik 2009)

Të gjitha krimet dhe viktimat duhet të regjistrohen e ndriçohen. Akoma ka krime për të cilat nuk flitet.

Tek ne gjithashtu është një katund, Gornji Grahovljani. Atje janë zhdukur dymbëdhjetë njerëz. Askush për ta deri më sot nuk ka pyetur as nga serbët as nga kroatët, edhe kjo të radhitet e të spastrohet edhe kjo situatë. (Veljko Mandiq, Shoqata e luftëtarëve të antifashizmit dhe antifashistëve, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pakrac, 22 korrik 2009)

Askush nuk mund të thotë se nuk di nga pushteti për 14 njerëz nga Gornji Grahovljani. Nuk janë 12 por 14. Ja Vesna Tersheci, ua bashkangjes regjistrimin. Nuk i kam krejt të dhënat. Kush nuk mund të më thotë se nuk e di askush për njerëzit që kanë mbetur pas meje në Fushën e Pakracit, e nuk janë. (Gjor-

gie Gunjeviq, kampist i kampit Buçe dhe Fusha e Pakracit, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pakrac, 22 korrik 2009)

Në territorin e Daruvarit dhe Pakracit ka serb të zhdukur, fatin e të cilëve duhet ta ndriçojë KOMRA.

Kemi (...) në territorin edhe të Daruvarit edhe të Pakracit dhe të komunave fqinje, gjithashtu civil të zhdukur të nacionalitetit serb të cilët janë zhdukur gjatë operacioneve luftarake e bile edhe më pas. Dhe me siguri ekzistojnë njerëz këtu të cilët e dinë ku janë ata njerëz dhe kush i ka marrë, dhe ku janë zhdukur, por besojmë se edhe ky komision dhe kjo iniciativë do të ndihmojnë. (Branko Kovačić, Këshilli i pakicës kombëtare serbe të qytetit Daruvara, Kroacia, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pakrac, 22 korrik 2009)

KOMRA duhet t'i regjistrojë viktimat e bombardimeve të NATO-s.

Më intereson a do të jetë objekt i KOMRA-s (...) a do të përfshihen edhe viktimat që janë zhdukur si pasojë e krimit që e ka bërë edhe Pakti NATO gjatë intervenimit, pasi që fjala është për territorin e gjithë ish Jugosllavisë. (Branko Kovačić, Këshilli i pakicës kombëtare serbe të qytetit Daruvar, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pakrac, 22 korrik 2009)

Viktimat, sidomos fëmijët prindërit e të cilëve janë vrarë apo zhdukur, do të marrin kompensim.

A ekziston mundësia që ato viktimat (...) të marrin ndonjë kompensim nga sistemi (...) mu pikërisht për shkak të faktit që kemi shembullin e fëmijëve, domethënë që kanë mbetur pa prindër, kurse prindërit u janë marrë dhe u janë vra. (Marija Zhi-liq, Qendra për furnizim social të Qytetit Pakrac, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pakrac, 22 korrik 2009)

Njerëzit vështirë ballafaqohen me të vërtetën se pjesëtari i grupit të tij etnik ka bërë krim. Shtetet në rajon nuk kanë vullnet ta zgjidhin këtë çështje.

Shteti ka të gjitha instrumentet dhe mundësitë që nëse dëshiron cilido nga shtetet e përmendura këtu, ato çështje mund ti zgjidh. Evident se nuk ka vullnet, vështirë njerëzit ballafaqohen me të vërtetën se edhe pjesëtari i grupit të tij etnik ka bërë krim. (Gjor-

gje Gunjeviq, kampist i kampit Buçje dhe Fusha e Pakracit, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pakrac, 22 korrik 2009)

Iniciativa KOMRA e inkurajon grumbullimin e serbëve dhe kroatëve në Pakrac që të bisedojnë hapur mbi temat e ndryshme, që kontribuon në normalizimin e marrëdhënieve të tyre.

Mendoj se ky takim (...) ka tubuar (...) njerëz të orientimeve të ndryshme, (...) të cilët kanë qenë, (...) në anët e kundërta (...) Kjo sjellë njëfarë perspektive dhe të ardhme për këtë qytet (...) për t'i inkurajuar që ata vetë të inkurajohen që me një normalizim të marrëdhënieve këtu, që edhe ata të nisin të flasin dhe t'i tregojnë të vërtetat (Obrad Ivanović, Forumi Demokratik Serb Pakrac, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pakrac, 22 korrik 2009)

Pjesëmarrësit/set e mbështesin që të vërtetohen faktet kush janë viktimat, kryesit dhe urdhërdhënësit.

Njëmend duhet vërtetuar faktet për t'u parë kush janë viktimat, kush janë ata kryesit dhe urdhërdhënësit (...) kjo nuk duhet tash të ndahet, sepse tash praktikisht 50 për qind nga ne që kemi qenë në Buçje, janë të vdekur (...) Aty kanë qenë njerëzit prej 20, 18 e deri 83 vjeç (...) Dhe prandaj e përshëndes këtë iniciativë në drejtim të asaj për t'u vërtetuar faktet. (Vladimir Solar, kampist në kampin Buçje dhe Stara Gradishka, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pakrac, 22 korrik 2009)

Institucionet dhe shtetet i kanë të gjitha të dhënat mbi krimet. Ato duhet të merren me këto çështje. Iniciativa KOMRA nuk do të sjellë fryt.

Policia ka njohuri për shumë gjëra edhe në njërën edhe në palën tjetër. Këtë duhet thënë botërisht. Ne duhet t'u japim mbështetje shteteve dhe institucioneve që të merren me këtë, por as ky tubim mendoj se shumë nuk do të sjellë fryte. Ne mund të themi çka duam. (Milutin Cicvara, ish anëtarë i Bashkisë së qytetit në Pakrac, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pakrac, 22 korrik 2009)

Ekzistojnë incizimet arkivore të krimeve. KOMRA duhet të ketë qasje në ato incizime.

Ekzistojnë plotë incizime arkivore edhe nga kjo edhe nga ajo palë. Ky komision do të duhej pikërisht të angazhohet për atë që edhe ato incizime të kontrollohen. Është fakt se viktimat, si në Kukunjevc, janë

incizuar pohojnë disa njerëz nga ajo palë, (...) Ekzistojnë incizimi i rrënimt të kishës në Çaglig, ekzistojnë incizimi i rrënimt të (...) kishës në Lipik. (Jaroslav Vozab, Këshilli i pakicës kombëtare çeke, Famullia e Pozhegës-Sllavonisë, Qyteti Lipik, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pakrac, 22 korrik 2009)

Secili e ka të vërtetën e vet, por duhet ta shikojë të huajën. Këtë e mëson iniciativa KOMRA.

Në këto hapësira jemi të vetëdijshëm se ka shumë të vërteta. Unë pikërisht jam ihtar i kësaj iniciative KOMRA, sepse secili ai që e ka të vërtetën e vet duhet ta shikoj të huajën (...) Secili pyet për djalalin e vet (...) Çdo lëvdatë ushtarëve kroat që i kanë ruajtur civilët, por nuk e përmendi se nuk janë ruajtur civilët në Klis (...) E vërteta duhet të mësohet, por (...) secili le ta shikojë të vetën dhe të huajën. Në bazë të atyre të vërtetave do të shkruhet historia. (Miladin Jakovljeviq, qytetar i Pakracit, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pakrac, 22 korrik 2009)

Shumë fakte kurrë nuk do të mësohen, por KOMRA mund ta ngushtojë hapësirën për rrena e manipulime.

Një fjali më ra ndër mend kur e dëgjova një mik nga Irlanda Veriore (...) „Qëllimi ynë është (...) ta ngushtojmë hapësirën për rrena e manipulime.” Kurse tek shumë të vërteta (...) kurrë nuk do të arrihet, por ne sa më shumë ta mbylлим atë farë hapësire ku dikush nesër mund të flas se ka ndodhur kjo e ajo me aq njerëz, njëmijë njerëz, gjithnjë e më tepër e ngushtojmë atë hapësirë. (Goran Božićević, Miramida, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pakrac, 22 korrik 2009)

Dëgjimet publike të njerëzve janë shumë të qenësishme.

Dëgjova këtu tregime të tmerrshme. Unë, fatkeqësisht i dëgjoj në zyrën time ndonjëherë nga njerëzit, dhe prandaj konsideroj se njerëzit duhet të dëshmojnë (...) Më rikujtoj një grua (...) Mendoj grua ka përjetuar goditje në kokë (...) Thotë (...) “E dini, mua në këtë luftë më janë zhdukur burri dhe djali.” (...) Konsideroj se dëshmitë si të zonjave që këtu dëshmuar mbi tmerret e veta, janë shumë të qenësishme. (Mirica Miljanij, Forumi Demokratik Serb Pakrac, Kroacia, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pakrac, 22 korrik 2009)

Komisionet shtetërore për të zënë rob dhe të

zhdukurit duhet ta japin mbështetjen për formimin e KOMRA-s.

Ekzistojnë edhe trupat shtetëror të Republikës së Kroacisë, a po, komisioni për të zënë rob dhe të zhdukur e ashtu edhe në shtetet tjera. Pra, ato komisioneve me siguri do tu japin mbështetje të mirë që të formohet një dokument i mirëfilltë dhe juridik. (Mirica Miljaniq, Forumi Demokratik Serb Pakrac, Kroacia, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pakrac, 22 korrik 2009)

Në bashkësitë lokale duhet biseduar për atë kush e ka nisur këtu luftën.

Unë mendoj se iniciativa juaj është e mirë por duhet këtu ne, si qytetar të Pakracit, të kemi një komision të tillë (...) që të përfundojë se kush këtu e nisi luftën. (Antun Bruneta, Këshilli i pakicës kombëtare italiane Pakrac, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Pakrac, 22 korrik 2009)

Konsultimet kombëtare me intelektualët

**Novi Sad, Serbi
25 shtator 2009.**

Konsultimet kombëtare me intelektualët i ka organizuar Shoqata e Pavarur e Gazetarëve të Vojvodinës (NDNV, Serbi). Kanë marrë pjesë 35 individ, profesorë universiteti, bashkëpunëtorë shkencor, nga institutet dhe muzetë, avokatë, përfaqësues të OJQ dhe të mediave. Ligjërues kanë qenë Bogdan Ivanisheviq nga Qendra Ndërkombëtare për të Drejtën në Tranzicion dhe Dragan Popoviq nga Fondi për të Drejtën Humanitare (Serbi). Dinko Gruhonjiq (NDNV), e ka moderuar tubimin. Radio Novi Sad, TV Pink, NDNV, TV Vojvodina dhe TV Apolo kanë raportuar nga tubimi.

Propozimet, mendimet, Rekomandimet e pjesëmarrësve

Organet shtetërore të Serbisë kanë bërë pak në zbulimin e kryesve të krimeve të luftës nga radhët e policisë dhe ushtrisë dhe në konfirmimin e rolit të kishës, shkollave, institucioneve akademike e shkencore.

Ne kemi organet shtetërore që kanë qenë të shtrë-

guar, falë aksioneve të Fondit (për të Drejtën Humanitare) para se gjithash dhe falë mediave të bëjnë diçka, por shumë pak ato organe shtetërore kanë bërë që të zbulohen krimet që rrjedhin nga policia, nga ushtria, që të zbulohen kriminelët të cilët rrjedhin nga kisha, që të zbulohet çfarë ka qenë roli i shkollës (...) çfarë ka qenë roli i institucioneve më të larta akademike e shkencore. (Slobodan Beljanski, avokat nga Novi Sadi, Serbi, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Novi Sad, Serbi, 25 shtator 2009.)

Kisha ortodokse serbe (SPC) nuk do të mundësojë qasje në dokumentet e veta as që do ta mbështes formimin e KOMRA-s.

Dikush nga kisha do të duhej të ishte në KOMRA ose në trupat e tij, saktë nga kishat (...) në botë kjo ka fituar autoritet (...) Kjo tek ne do të shkojë shumë vështirë (...) gati nuk do të ec, (...) A do të mundësojë dhe si kisha, apo saktësisht kishat, qasjen dokumenteve? (...) kjo nuk do të shkojë lehtë. (...) dhe vërejtja e tretë, (...) Filaret, vlladika i tashëm i Milishevës, me armë në dorë në tank, dokumentet janë aty, kurse kisha nuk e ka proceduar atë rast edhe pse, sipas të drejtës kanunore, ka qenë e obligueshme ta procedoj (...) ta zhbëjë (Mirko Gjorgjeviq, publicistë, Serbi, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Novi Sad, Serbi, 25 shtator 2009.)

Çfarë kishe, ata nuk do të duan të bisedojnë për këtë (...) s'kemi shans që Kroacia, Serbia, nuk di Mali i Zi, ta pranojnë me entuziazëm formimin e KOMRA-s. Çfarë kishe, ata nuk do të duan ta lexojnë këtë, nuk di çfarë kundër-memorandume. (Mirko Gjorgjeviq, publicistë, Serbi, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Novi Sad, Serbi, 25 shtator 2009.)

Rrethanë e vështirësuar është se Serbia nuk ka marrëdhënie të mira me fqinjët. Pa mbështetje të fuqishme ndërkombëtare do të jetë vështirë të formohet KOMRA.

Bashkëpunimi i Serbisë me fqinjët e ri (...) nuk është i mirë (...) aty nuk ka dialog dhe aty në realitet nuk ka përparim rajonal (...) Kjo është një nga gjërat të cilën duhet llogaritur si rrethanë rënduese të supozuar (...) Në një situatë të tillë (...) një iniciativë e këtillë (...) vështirë do të kalojë pa mbështetje të fuqishme ndërkombëtare. (Milan Simurdiq, ish diplomat nga Novi Sadi, Serbi, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Novi Sad, Serbi, 25 shtator 2009.)

KOMRA lypset ta fitojë statusin e palës në pro-

cedimet e krimeve të luftës dhe të ketë autorizime ta iniciojë procedurën.

Ne tani kemi procese që neve na ofrohen (...) kundër disa krimeve të luftës, relativisht të imtë (...) por përse ai komision me njohuritë e veta (...) e nuk është përjashtim se ai do të kishte qasje më të madhe se sa vet organet e shtetit (...) të mos inkuadrohet në punën e një procedimi të tillë publik? Përse ai nuk do të ishte palë e interesuar? (...) Përse ai nuk do të ishte aktivisht i legjitimuar për të iniciuar procesin, përse të mos e marrë statusin e palës? (Dragana Qoriq, Fakulteti Juridik në Novi Sad, Serbi, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Novi Sad, Serbi, 25 shtator 2009.)

Nevojitet të hulumtohet roli i mediave, sepse të akuzuarit për krime të luftës mbrohen ashtu që thonë se kanë shkuar në luftë të nxitur me raportet e mediave mbi pësimin e serbëve.

„Por unë këtë e kam dëgjuar, parë në gazeta, pastaj” (...) „e rroka armën dhe u nisa në atë qytet” (...) Për momentin ka disa raste të tilla ku të akuzuarit gjatë procesit (...) thjeshtë e kanë paraqitur këtë element si konkret. Ata kanë theksuar se diçka që kanë parë e dëgjuar në momentin e dhënë, ka qenë shkak për veprimet e tyre konkrete (...) Thënë më konkretisht (...) në Vukovar, atë që e ka publikuar i pari Rojters, e pastaj RTS, më pas “Gazeta e Vukovarit (...) ajo është informatë mbi atë se (...) 43 bebe serbe janë vrarë nga ana e kroatëve (Branislava Kostiq, Fakulteti i Shkencave Teknike në Novi Sad, Serbi, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Novi Sad, Serbi, 25 shtator 2009.)

KOMRA duhet të përcaktojë grupet e objektivit të cilave u drejtohet dhe në harmoni me këtë ta adaptojë të folurit: duhet të jetë në harmoni me vlerat e atyre grupeve, të jetë i njohur (si për njerëzit të cilëve u adresohet që mesazhet e dërguara të mos i kuptojnë si diç që u imponohet nga jashtë).

Kush është grupi i objektivit? Të them, ja vetëm dy grupe objektivi (...) Njëra janë viktimat e këtij konflikti (...) në atë rast mund të flasim për një funksion psikoterapi, domethënë që viktimave t'u jepet mundësia që vetë të tregojnë vuajtjet e veta apo tua prezantojnë tjerëve (...) Nëse grupi objektiv cilit i adresohet komisioni është ai mjedis shoqëror nga i cili rrjedhin kryesisht, atëherë është (...) shumë e rëndësishme për efikasitetin e ardhshëm të rezultateve të punës së këtij komisioni që (...) leksiku (...) i tek-

steve që i sqarojnë qëllimet dhe leksiku i teksteve të përfunduara, duhet të mbështetet mbi vlera që janë konstitutive për vetëdijen e atij grupi objektiv. (Pavle Rak, publicistë, Slloveni, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Novi Sad, Serbi, 25 shtator 2009.)

Anëtarë të KOMRA-s duhet të bëhen edhe përfaqësuesit e institucioneve që kanë përgjegjësi për konflikte, sikurse janë kishat, akademitë e shkencave e tjera. Ato institucione nuk kanë në qëndrimet e veta të vlerave asgjë që radikale është kundërthënëse me objektivat e KOMRA-s (jeta e qetë me tjerët, pendimi, falja), dhe se detyra e tyre do të ishte ta vërtetojnë përse i kanë shkelur vlerat e veta.

Unë jam shumë i interesuar që diç e tillë të bëhet; që në punën e komisionit duhet inkuadruar përfaqësuesit e të gjitha kishave apo të disa institucioneve tjera që janë mjaftë përgjegjëse për këto konflikte, bie fjala, Akademia e Shkencave (...) mendoj se duhet insistuar në këtë që të gjinden njerëzit në gjendje që, duke u angazhuar për vlerat e grupit të vet, megjithatë në një komision të tillë të kontribuojnë që në fund rezultati të jetë i pranueshëm edhe nga aspekti i vlerave universale. (Pavle Rak, publicist, Slloveni, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Novi Sad, Serbi, 25 shtator 2009.)

KOMRA duhet të merret me grumbullimin e të dhënave dhe të dokumentacionit e jo me interpretimin e fakteve.

Unë s'kam kurrfarë dileme kur është fjala për atë nëse është e nevojshme të formohet një komision i tillë apo jo, por mendoj se komisioni lypset të grumbullojë të dhënat, e me (...) interpretimin të merret dikush tjetër. (Pavel Domonji, Këshilli i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Serbi, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Novi Sad, Serbi, 25 shtator 2009.)

Propozoj që ne të fokusohemi në ngjarjet dhe në atë dokumentacion, dhe të mos i shtrojmë vetvetes (...) qëllime shumë të mëdha, sepse thjeshtë do të biem në ndonjë kurth që ne ato qëllime të mos mund t'i përmbushim. (Hajrija Mujoviq Zorniq, Instituti i Shkencave Shoqërore, Serbi, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Novi Sad, Serbi, 25 shtator 2009.)

Një komision (...) nuk mund të ekipohet ashtu mirë të punojë dhe hulumtojë e të bëjë edhe interpretimin (...) atë kontekst të interpretimit, fakti i të gjeturve thjeshtë nuk po më përputhet në konceptin e tij disi (...) trup hulumtues, si perceptojmë se duam të jetë ai

komision, (...) nuk duhet të merret me kurrfarë interpretimi. (Dragana Qorij, Fakulteti Juridik në Novi Sad, Serbi, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Novi Sad, Serbi, 25 shtator 2009.)

Vërtetimi dhe interpretimi i fakteve janë të pandashme.

Vërtetimi dhe interpretimi i fakteve (...) sado që parimisht jemi (...) të prirë t'i dallojmë ato dy procedime, duhet të kemi ndërmend edhe faktin se ato janë të pandashme. (...) Dhe atë (...) çka do të propozojmë ne të jenë kompetenca (...) të atij komisioni nuk mund të eliminohet interpretimi dhe për ato gjyqe të vlerave duhet të jemi të vetëdijshëm (...) Duhet të jemi të vetëdijshëm se nuk ka vetëm gjyqe faktike që ekskluzivisht kanë faktikisht të dëshmuar dhe në atë kuptim përpigemi të bëhen në këtë komision dëshmuar pa kurrfarë elemente vlerash (Jasminka Hasanbegović, Fakulteti Juridik në Beograd, Serbi, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Novi Sad, Serbi, 25 shtator 2009.)

Midis serbëve bisedat mbi viktimat serbe më nuk shkakton pasione, prandaj edhe nxitja e bashkë ndjenjës ndaj viktimave nga bashkësitë tjera etnike do të jetë e rëndë..

Ideologjitë me kalimin e kohës eshtërohen, sidomos atëherë kur bëhen shtetërore, ideologji parashtetërore. Atëherë kur ideologjitë eshtërohen ndodh edhe një fenomen kulturor (...) opinioni pak a shumë bëhet i pa interesuar për përmbajtjet e asaj ideologjie (...) Kur tash e inicioni bisedën midis serbëve mbi viktimat, kjo më nuk nxit kurrfarë pasioni, njëherë bile më është thënë „po kjo është e bezdisshme” (...) Edhe më vështirë në këtë kuptim do të jetë rikujtimi i faktit se pjesëtarët e bashkësisë tonë etnike kanë bërë krime mbi pjesëtarët e bashkësive tjera etnike. (Gjokica Jovanović, Fakulteti Filozofik në Beograd, Serbi, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Novi Sad, Serbi, 25 shtator 2009.)

Derisa në kriminelët dhe viktimat tona shikohen ndryshe nga ato tjerat, KOMRA nuk do të ketë rezultate.

Në kriminelët shikohet me dy kute, kriminelët në radhët tona dhe (...) në viktimat në radhët tona dhe këtu pikë për pikë njësojë sillen në të gjitha mjediset dhe derisa kjo është kështu e ka vështirë që një komision i tillë të arrijë rezultate të caktuara. (Vladislav Radaković, politolog, Serbi, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Novi Sad, Serbi, 25 shtator 2009.)

Asnjë kërkim- falje zyrtare nuk ka qenë e sinqertë.

Nuk ka pasur kërkim falje të sinqerta, edhe pse presidenti ynë ka kërkuar falje për ato krime, pro askush nuk i ka përjetuar ato kërkim falje si të sinqerta (...) Presidentët tjerë këtë as që e kanë menduar. (Vladislav Radaković, politolog, Serbi, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Novi Sad, Serbi, 25 shtator 2009.)

Në shumicën e vendeve rezultatet e ballafaqimit me të kaluarën janë të vogla. Në Serbi nuk është e mundshme sikur që nuk ka qenë e mundshme në Spanjë dhe Austri. Gjermania bënë përjashtim.

Rezultatet e ballafaqimit me të kaluarën në tërësi janë të vogla në shumicën e vendeve (...) në shkallë shoqërore (...) Gjermania bënë përjashtim dhe nuk është shembull karakteristik (...) në Spanjë, pas rënies së Frankos (...) faktikisht është arritur një konsensus shoqëror, ka rënë Franko, është kthyer demokracia, por nuk hyhet në atë çfarë ka ndodhur gjatë kohës së Frankos (...) Ndryshe, gjithë kohën derisa pezeta ka qenë valutë zyrtare në Spanjë, domethënë deri në fund të shekullit 20, kanë ekzistuar pezetat me figurën e Frankos (...) E të mos flasim për shembullin e Austrisë (...) shembull më eklatant është se Kurt Valdhajm ka mundur të bëhet Sekretar i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara si dikush që ka marrë pjesë në krimin e luftës (...) të bëhet kryetar i Austrisë. (Slobodan Marković, Fakulteti i Shkencave Politike në Beograd, Serbi, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Novi Sad, Serbi, 25 shtator 2009.)

Në planin akademik unë jam optimist, besoj (...) se po hapet (...) diskutimi akademik mbi këtë temë (ballafaqimi me të kaluarën). Mirëpo (...) pa pjesëmarrjen e shumicës së vlefshme (...) në Serbi që të bëjmë çfarë do qoftë, kjo absolutisht nuk është e mundshme dhe pikërisht për shkakun se kjo nuk ka qenë e mundshme as në Spanjë, as në Austri. (Slobodan Marković, Fakulteti i Shkencave Politike në Beograd, Serbi, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Novi Sad, Serbi, 25 shtator 2009.)

Të gjitha shtetet janë të interesuara që të mos zbulohet përgjegjësia e tyre. Nuk do t'i japin dokumentet e pa këtë KOMRA mund të jap vetëm vlerësimin e përgjithshëm.

Ne mund t'i formojmë pesëdhjetë komisione, nëse nuk na jepen dokumentet ne mund të japim vetëm

ndonjë vlerësim të përgjithshëm (...) Në kohën e fundit jam edhe anëtar i këtij komisioni (...) për vërtetimin e rrethanave të pushkatimit të gjeneralit Mihajloviq (...) Madje edhe sikur të ekzistojë gatishmëria e shtetit, e këtu ekziston pasi që është formuar komisioni që diç e tillë të gjendet, edhe më tutje nuk jam i bindur 100 për qind se komisioni i ka marrë të gjitha dokumentet për kontrollim (...) Ne këtu po flasim për diçka që ka ndodhur para (...) 65 vitesh, ku (...) askush relevant politikisht për momentin nuk është gjallë (...) Këtu (Iniciativa për KOMRA) po flasim për diçka që ka ndodhur para 10 vitesh, para 15 vitesh, ku gati të gjithë aktorët janë të gjallë dhe ku gati të gjithë janë të interesuar (...) që kjo në njëfarë mënyre të mos zbulohet. (Slobodan Marković, Fakulteti i Shkencave Politike në Beograd, Serbi, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Novi Sad, Serbi, 25 shtator 2009.)

KOMRA mund të kontribuojë në ripërtëritjen e mirëbesimit midis bashkësive të cilat kanë qenë të kyçura në luftë.

Ekziston një kontekst ku duhet vendosur këtë ide mbi formimin e komisionit për vërtetimin e fakteve mbi krimet që janë kryer (...) Në qoftë se ai vërtetë formohet, mund të kontribuojë në krijimin e marrëdhënieve të reja në mbarë rajonin, e kjo do të thotë edhe përtëritjen e mirëbesimit të ndërsjellë midis të gjitha bashkësive etnike ndërmjet të cilave kanë ekzistuar konfliktet. (Vladimir Paviqeviq, doktorant i Fakultetit të Shkencave Politike në Beograd, Serbi, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Novi Sad, Serbi, 25 shtator 2009.)

Nevojitet që sa më shpejtë të fillohet me tryninë mbi elitat politike në të gjitha shtetet në rajon. Bashkësitë akademike mund të ndihmojnë.

Ndoshta nuk duhet të pritët 1 dhjetori apo 10 dhjetori i vitit 2010, që të nis të ushtrohet tryzna e butë në arenën politike (...) Edhe mendimi im është që krahas sektorit joqeveritar, bashkësitë akademike paralel duhet të zhvillojnë konsultime edhe me aktorët relevant politik në të gjitha këto shtete në mënyrë që, (...) për atë 10 dhjetor të sigurohet mbështetja e numrit të caktuar të formacioneve politike. (Vladimir Paviqeviq, doktorant i Fakultetit të Shkencave Politike në Beograd, Serbi, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Novi Sad, Serbi, 25 shtator 2009.)

Mendoj se në këtë fazë ia keni dalë relativisht mirë t'i loboni përfaqësuesit relevant që do të ishin të interesuar që komisioni të paraqitet si një lloji i zërit të

tyre. E ndoshta tash do të duhej, nëse deri më tash nuk keni pasur kontakte të tilla me shtetin, parlamentin, qeverinë (...) të vazhdoni një lloj të lobingut të mëtutjeshëm në këtë kuptim. (Dragana Qoriq, Fakulteti Juridik në Novi Sad, Serbi, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Novi Sad, Serbi, 25 shtator 2009.)

KOMRA duhet ta ketë parasysh se në vetëdijen e njerëzve, rrënimi i ish RSFJ dhe krimet e kryera paraqesin vazhdimin e Luftës së II Botërore.

Këto krime janë të pandashme nga ato që janë bërë gjatë Luftës së II Botërore ose pas Luftës së II Botërore (...) Urrejtja, dëshira për hakmarrje, madje edhe bindja se (...) krimi i luftës mund të mos dënohet, e gjithë kjo është pasojë e asaj periudhe dhe e atyre krimeve. (Balint Ishtvan, publicist, Serbi, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Novi Sad, Serbi, 25 shtator 2009.)

Nuk do të thotë se ky komision duhet të hetojë (...) krimet e luftës në Luftën e II Botërore, kjo nuk është puna e tij, por unë personalisht, si sociolog, kam argumente shumë të vlefshme të pohoj se (...) konflikti në territorin e ish RSFJ, shkatërrimi i saj është vazhdim (...) i Luftës së II Botërore. Nëse hiq tjetër, të paktën në mentalitetin dhe në vetëdijen e njerëzve. (Lazar Zholt, Fakulteti Filozofik në Novi Sad, Serbi, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Novi Sad, Serbi, 25 shtator 2009.)

Qëllimi i KOMRA-s duhet të jetë evitimi i krimeve në të ardhmen.

Është i qartë fakti se (...) kurrë nuk do të arrijmë që secili (...) krim të dënohet, (...) Por kjo as që është e qenësishme, veç duhet disa të arrijmë që këto krime të mos përsëriten, as brenda 45, as brenda 200 vitesh (...) dhe ky do të ishte sukses. (...) Dhe mendoj se Koalicioni bash në këtë kuptim duhet ta ketë konceptin e vet. (Balint Ishtvan, publicist, Serbi, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Novi Sad, Serbi, 25 shtator 2009.)

Pritjet duhet harmonizuar me gjendjen reale, kushtet shoqërore dhe rrethanat ndërkombëtare.

Nëse dikush është i vetëdijshëm për kufizimet e ndonjë aksioni shoqëror, kjo nuk do të thotë se nga ai aksion duhet hequr dorë, përkundrazi, kjo vetëm nënkupton se thjeshtë ia përshtat pritjet asaj që është gjendje reale, asaj që janë kushte shoqërore, asaj që janë rrethana ndërkombëtare. (Slobodan Marković,

Fakulteti i Shkencave Politike në Beograd, Serbi, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Novi Sad, Serbi, 25 shtator 2009.)

Në qoftë se Koalicioni për KOMRA nuk mund ta përvetësojë asnjë peshkop dhe teolog, kjo qenësisht e kufizon veprimin e tij.

Nëse ju tash, ato elemente liberale që ekzistojnë kudo në shoqëri, (...) nuk mund t'i tërhiqni në këtë koalicion, nëse nuk mund të gjejnë asnjë peshkop (vlladik) apo ndonjë teolog të shquar që të përfshihet këtu, atëherë kjo qenësisht e kufizon mundësinë e veprimit shoqëror. (...) Ju i lexoni hulumtimet e agjencisë "Strategic marketing" dhe shihni se pesë për qind të qytetarëve (...) e mbështet fuqimisht aksionin e sektorit joqeveritar. (Slobodan Marković, Fakulteti i Shkencave Politike në Beograd, Serbi, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Novi Sad, Serbi, 25 shtator 2009.)

Nuk është vështirë të mblidhen një milion nënshkrime, por për t'u ndryshuar opinionin publik kjo nuk mjafton. Sa më shpejtë duhet nisur fushatën.

Sado që na duket se një milion nënshkrime është një shifër e rëndësishme, unë mendoj se një milion nënshkrime për një ide të këtillë edhe nuk do të jetë aq vështirë (...) Mirëpo, sa është kjo e rëndësishme? Shikoni, këto janë një milion nënshkrime në mbarë rajonin, sa do të jetë kjo e rëndësishme për ndryshimin e qëndrimit brenda opinionit publik. (...) Me këtë punë duhet nisur më herët (...) domethënë pak më me guxim në opinion pavarësisht faktit që pjesa më e madhe në opinionin e përgjithshëm publik me siguri për momentin bash nuk anon nga kjo ide. (Jasminka Hasanbegović, Fakulteti Juridik në Beograd, Serbi, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Novi Sad, Serbi, 25 shtator 2009.)

Nevojitet të sinkronizohen sjelljet e të gjithë aktorëve në përgatitjet për formimin e komisionit dhe të respektohen specifikat e shteteve.

Rajonalizmi që është menduar, kërkon një sinkronizimin jashtëzakonisht të mirë në sjelljet e atyre të cilët punojnë në përgatitjet për formimin e komisionit. Domethënë, sinkronizimi i mirë dhe harmonizimi i konkluzioneve me ndoshta respektimin e specifikave në territoret e shteteve që duhet të përfshihen me këtë komision. (Zhivojin Tasiq, Muzeu Popullor në Leskovc, Serbi, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Novi Sad, Serbi, 25 shtator 2009.)

E vërteta të cilën e paraqesin viktimat mund tu shërbejë gjykatave dhe hulumtimeve shkencore, për viktimat ka funksionin psikoterapi, e duhet të shërbejë edhe spastrimit të së keqes në popull.

E vërteta e viktimës mund t'i shërbejë edhe gjykatës, mund t'u shërbejë edhe hulumtimeve shkencore, por më duket se më së shumti duhet t'i shërbejë vet viktimës (...) që ajo duhet të ketë funksionin psikoterapi. (...) Ajo e vërtetë (...) e viktimës do të duhej (...) t'i shërbejë (...) spastrimit të asaj të keqeje që gjendet në ne, që i ka lindur të gjitha këto të këqijat tjera që i kanë goditur më së shumti ata që janë bërë viktime.. (Zhivojin Tasiq, Muzeu Popullor në Leskovc, Serbi, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Novi Sad, Serbi, 25 shtator 2009.)

KOMRA do të ndihmojë në inicimin e hetimeve mbi krimet që kanë mbetur të panjohura.

KOMRA nuk do të mund të procedojë, por gjithsesi do të mund të krijojë atmosferën dhe të (...) mbledh argumente me të cilat do të kërkojë shtrirjen ndoshta të së drejtës penale, apo të drejtës tjetër luftarake në kuptimin e procedimit të mundshëm edhe të disa gjërave të cilat ndoshta deri më tash kanë mbetur jashtë sistemit juridik. (Llazar Zholt, Fakulteti Filozofik në Novi Sad, Serbi, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Novi Sad, Serbi, 25 shtator 2009.)

KOMRA duhet të merret me vërtetimin e fakteve mbi ngjarjet në kohën e konflikteve në Slloveni dhe në Maqedoni.

Me qenë se fjala është mbi luftërat që kanë nisur në Slloveni (...) por edhe Maqedonia në fund përjetoi një luftë, mendoj se duhet t'i përfshijmë të dy këto vende. Për çdo rast, problemet janë më të vogla dhe do të jetë më lehtë të bëhen hulumtimet në ato dy vendet. Dhe prandaj, atëherë do ta linim diçka të pa thënë, nëse qenësisht është e lidhur me këtë që ka ndodhur në këto zona qendrore. (Pavle Rak, publicist, Slloveni, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Novi Sad, Serbi, 25 shtator 2009.)

Nevojitet të sqarohet roli i bashkësisë ndërkombëtare në konflikt.

Bashkësia ndërkombëtare shumë konkretisht ka marrë pjesë në atë luftë dhe aty kanë qenë disa viktime, dhe kjo mund të sjellë gjakun e keq dhe të sqarohen edhe ato gjëra, mendoj se nuk është e padobishme. Nga asgjë nuk duhet të ikim. (Pavle

Rak, publicist, Slloveni, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Novi Sad, Serbi, 25 shtator 2009.)

Konsultimet rajonale me gazetarët

Novi Sad, Serbi
26 shtator 2009.

Konsultimet rajonale me gazetarët i ka organizuar Shoqata e Pavarur Gazetarëve të Vojvodinës (Serbi). Në tubim kanë qenë prezent gjithsej 47 pjesëmarrës, themelues, drejtor, kryeredaktor, redaktor dhe gazetar të mediave nga rajoni. Ligjërues kanë qenë Bogdan Ivanisheviq nga Qendra Ndërkombëtare për Drejtësinë në Tranzicion, Natasha Kandiç (Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi) dhe Vesna Ter-sheliq (Documenta, Kroaci). Moderator kanë qenë Dinko Gruhonjiq (Shoqata e Pavarur e Gazetarëve të Vojvodinës, Serbi), Eugen Jakovçiq (Documenta, Kroaci) dhe Aleksandar Trifunoviq (Buka, BeH). Nga takimi kanë raportuar agjencia e lajmeve SRNA (BeH), TV B92 dhe Radio Pançeva.

Propozimet, mendimet, Rekomandimet e pjesëmarrësve

Iniciativa KOMRA ka çelur hapësirë për debat mbi të kaluarën në mbarë rajonin dhe ka krijuar koalicionin i cili ka fuqinë që nga qeveritë të kërkojë formimin e KOMRA-s.

Ekziston mundësia që shtetet, për shembull njëri të thotë "jo, nuk e duam këtë". Por ajo që do të jetë rezultat i këtij debati rajonal është hapësira e pushtuar për diskutim mbi të kaluarën. Kurrë më askush nuk do të mund të përjashtojë, ta mbyll, të thotë "nuk ka asi debati". Koalicioni për KOMRA i krijuar njëherë është fuqi e atillë sa kurrë më nuk do ta lë rehat asnjë qeveri në raport me atë që ai koalicion ka kërkuar, e ky është formimi i Komisionit zyrtar rajonal i cili do të merrej me vërtetimin e fakteve mbi krimet e luftës. (Natasha Kandiç, Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi, Konsultimet rajonale me gazetarët, Novi Sad, Serbi, 26 shtator 2009.)

Milion nënshkrime për KOMRA-n nuk janë garanci se qeveritë e vendeve në rajon do ta përqafojnë Iniciativën për formimin e KOMRA-s.

Sa i përket kësaj ideje unë fare nuk dyshoj se do të mbliidhen një milion nënshkrime, por më duket se

më vonë, kur këto të mbliidhen, nëse qeveritë e vendeve në rajon (...) nuk e përqafojnë këtë iniciativë (për formimin e KOMRA-s) (...) atëherë duhem se kjo do të kalojë dobët. (Lluka Brailo, "Novi list", Kroaci, Konsultimet rajonale me gazetarët, Novi Sad, Serbi, 26 shtator 2009.)

Krahas vullnetit politik nevojitet mbështetja e pronarëve dhe redaktorëve të mediave të cilat mund të ndihmojnë që iniciativa të prezantohet në mënyrë të mirëfilltë.

Më duket se pas kësaj duhet ulur me redaktorë, por edhe me pronarët e mediave në rajon, sepse në qoftë se ata nuk e japin mbështetjen bashkë me atë vullnetin e famshëm politik, duhem se kjo për të cilën ne po flasim dhe ato ide të mira (...) dhe qëllimet e ndershme të KOMRA-s, nuk do të prezantohen në mënyrë të mirëfilltë në bazë të së cilave do të shtohen efektet e mëvonshme. (Lluka Brailo, "Novi list", Kroaci, Konsultimet rajonale me gazetarët, Novi Sad, Serbi, 26 shtator 2009.)

Grupi medial i cili do t'u (...) paraprinte raporteve të (Koalicioni për)KOMRA ndaj opinionit dhe ndaj mediave duhet të thirr takimin me grupet e caktuara mediale, drejtorët e radiove, të gazetave, të agjencive, që veç e veç, varësisht nga profili medial, ta fokusojnë pyetjen dhe në fund të fundit mënyrën se si krejt do të raportohet, të ndërtohet apo kurdiset ngjarja e caktuar, lajmet dhe ta njoftojë opinionin. (Zoran Iliq, FENA, BeH, Konsultimet rajonale me gazetarët, Novi Sad, Serbi, 26 shtator 2009.)

Për marrëveshje mbi përcjelljen e iniciativës KOMRA nevojitet që sa më shpejtë të organizohet takimi me drejtorët e serviseve publike dhe me pronarët e të gjitha mediave. Është me rëndësi që mediat ti caktojnë gazetarët të cilët do të raportojnë.

Kam (...) një lloj sugjerimi për iniciatorët dhe anëtarët e Koalicionit për KOMRA. Që në konsultimet e ardhshme, e lidhur për problemet e përcjelljes së kësaj teme në media e kështu me radhë, duhet përfundimisht të jenë drejtorët e serviseve publike dhe pronarët e të gjitha mediave. (...) Konsultimet lypset organizuar me njerëzit të cilët në njëfarë mënyre vendosin dhe i krijojnë konceptet redaktuese të mediave. (Aleksandar Reljiq, TV Pink, Serbi, Konsultimet rajonale me gazetarët, Novi Sad, Serbi, 26 shtator 2009.)

Kur bëjmë konsultime, që ju si njerëz në media, drej-

tor, redaktor, të na sugjeroni ose redaktorët tuaj me të cilët duhet të punojmë ose njerëzit të cilët gjithsesi do të duhet të thirren në tubimet tona. Ne i paguajmë ato shpenzime të ardhjes, të rrugës që shpesh është pengesë e madhe që ndonjë gazetarë të vijë dhe marrë pjesë në ndonjë ngjarje. (Aleksandar Trifunović, Buka, BeH, Konsultimet rajonale me gazetarët, Novi Sad, Serbi, 26 shtator 2009.)

Nevojitet të hulumtohet roli i mediat para dhe gjatë konflikteve.

Kolegu (...) shtroi një tezë të rëndësishme (...) duke hapur bisedën për hulumtimin e rolit të mediave gjatë viteve të nëntëdhjeta (...) Hulumtimi i rolit të mediave gjatë viteve të nëntëdhjeta është i rëndësishëm, por është me rëndësi të konstatohet roli i mediave edhe për atë periudhë para viteve të 90-ta kur në realitet nisi orkestrimi i ngjarjeve. (Zheljko Hodonj, HINA, Kroaci, Konsultimet rajonale me gazetarët, Novi Sad, Serbi, 26 shtator 2009.)

Duhet të shënohet se si krejt dhe në çfarë mënyre mediat kanë kontribuar, jo vetëm për t'u përgatitur konflikti ose opinioni për shpërthimin e konflikteve, por që edhe atë konflikt shpesh e kanë shtytur: urretja ka qenë më madhe, frika, likuidimet, vrasjet dhe shkelja e të drejtave të njeriut më të mëdha dhe më të tmerrshme. (Branislava Obranović, Shoqata e Pavarur e Gazetarëve të Vojvodinës, Serbi, Konsultimet rajonale me gazetarët, Novi Sad, Serbi, 26 shtator 2009.)

Pengesat më të mëdha në BeH janë qëndrimi jo i qartë i pushtetit ndaj krimeve të luftës dhe pritjet jo reale e iniciatorit të KOMRA-s që partner të jenë autoritetet të cilat i mohojnë krimet.

Nën këtë projekt, që ai të nis të realizohet, ekziston një fushë e tërë e minuar me pengesa shumë serioze (...) Pengesa e parë (...) për mua është qëndrimi ende i panjohur i pushtetit (...) ndaj krimeve të luftës (...) Këtu në veçanti po flas për Bosnjën e Hercegovinën ...Tani jemi dëshmitar se kemi një fazë të tretë (...) Po flas këtu (...) mbi mohimin e krimit (...) Pra, ne gjendemi në fazën në të cilën presim që (...) njerëzit të cilëve u takon pjesa më e madhe e pushtetit, (...) që ata të jenë partner të iniciatorit të kësaj ideje (...) Komisionit rajonal. Unë mendoj se ky, pak ose shumë, por praktikisht është mision i pamundshëm. (Senad Peqanin, "Dani", BeH, Konsultimet rajonale me gazetarët, Novi Sad, Serbi, 26 shtator 2009.)

Pasqyra e fakteve mbi krimet e luftës nuk është

e mjaftueshme pa analizën shkaqeve dhe të kontekstit, por në rastin e ish RSFJ kjo do të nënkuptonte kthim në të kaluarën e largët (shekullin e XIV).

Mina tjetër shkelëse (...) është dilema a do të merret ky komision rajonal vetëm me faktet apo edhe me shkaqet. Nëse është fjala për faktet (...) mendoj se (...) aty nuk ka shumë të panjohura, pavarësisht nëse rastin për paraqitjen e të vërtetës dhe të përvojës së vetë e kanë vetëm viktimat apo edhe kryesit e krimit (...) Natyrisht se pasqyra e atyre fakteve tek të cilët mund të vihet nuk do të ishte (...) e mundshme as për së afërmi në shkallën në të cilën është e dëshirueshme dhe e nevojshme pa analizën e shkaqeve të atyre ngjarjeve (...) E në qoftë se nisemi me kontekst, atëherë (...) nisemi me historinë (...) Unë jam absolutisht i sigurt se sikur do të niseshim me analizën e shkaqeve apo pasqyrimin e kontekstit (...) do të shkolinim deri në shekullin e XIV. Unë thjeshtë nuk shoh në territoret e shtetit tonë, as ambient akademik, as një ambient në shoqëri ku është e dëshirueshme lidhja faktike e historisë. (Senad Peqanin, "Dani", BeH, Konsultimet rajonale me gazetarët, Novi Sad, Serbi, 26 shtator 2009.)

Natyrisht se çdo rrëfim e ka kontekstin e vet, por njëfarë rekomandim imi është që megjithatë në fillim të ndaleni në diçka që janë fakte lakuriqe. (Sanda Saviq, B92, Serbia, Konsultimet rajonale me gazetarët, Novi Sad, Serbi, 26 shtator 2009.)

Për mediat është vështirë ta përcjellin procesin sikur që e përcjellin ngjarjen. Vështirësues është edhe fakti se sot ka më pak donator për mediat të cilat raportojnë mbi krimet e luftës.

Për mediat është vështirë (...) ta përcjellin procesin (...) në të njëjtën mënyrë sikurse përcillet ngjarja (...) Këtu që po ashtu është (...) e qenësishme të theksohet janë resurset që i disponojnë mediat për përcjelljen e një gjëje që është proces (...) Kontributi i madh i një grupi të mediave në hapësirën e ish Jugosllavisë në zbulimin e krimeve të luftës, ka qenë (...) në kohën kur shumica e atyre mediave kanë marrë pak a shumë donacion dorëilirë (...) nga organizatat ndërkombëtare (...) Është fakt se sot një ndihmë e tillë më nuk ekziston dhe është fakt se, bie fjala, një medium i cili ka dhënë, mendoj pa precedent (...) kontribut (...) një gazetari të guximshme të ndershme (...) sikurse është "Feral tribun", ka qenë i detyruar të shuhet, (...) nga arsyeja që nuk ka mundur të gjejë midis qindra donatorëve (...) asnjë i cili e ka pa arsyen dhe ndoshta idenë se më mirë është të mundësohet ekzistenca e Feral Tribun-it se sa

të mbahen dy konferenca. (Senad Peqanin, "Dani", BeH, Konsultimet rajonale me gazetarët, Novi Sad, Serbi, 26 shtator 2009.)

Në media gjenden edhe gazetarët të cilët e kanë përgatitur luftën. A mundet dhe a duhet me mediat e tilla të realizohet bashkëpunimi?

A mund të presim që po ato medime të njëjta të cilat e kanë përgatitur hapësirën për luftë, të cilat gjatë luftës kanë punuar ashtu e ashtu, e (...) midis anëtarëve të atyre redaksive ka njerëz të njëjtë që kanë punuar më herët (...) si do ta botojnë ato media tash rrëfimin të cilin ne tani duhet ta prezantojmë në bazë të fakteve që i kemi grumbulluar? (Branislava Obranova, Shoqata e Pavarur e Gazetarëve të Vojvodinës, Serbi, Konsultimet rajonale me gazetarët, Novi Sad, Serbi, 26 shtator 2009.)

Ideja (formimi i KOMRA-s) është e mirë, por në ambientin aktual medial, kulturor e politik nuk është e mundur të realizohet kjo ide.

Unë gjithsesi mendoj se kjo është një ide e mirë, por nuk e shoh në ambientin e të gjitha shteteve tona si në atë medial ashtu edhe politik, kulturor, nuk shoh mënyrën se është e mundur të realizohet ky projekt. (Senad Peqanin, "Dani", BeH, Konsultimet rajonale me gazetarët, Novi Sad, Serbi, 26 shtator 2009.)

Vlera kryesore e KOMRA-s duhet të jetë e vërteta, rehatia e familjeve të viktimave dhe pajtimi midis bashkësive. Në realizimin e këtyre qëllimeve KOMRA duhet të llogaris amnistinë dhe mbrojtjen e dëshmitarëve.

Do të thosha se vlera kryesore e KOMRA-s duhet të jetë e vërteta. Për KOMRA-n duhet të jetë shumë më e rëndësishme sa familje të viktimave do të mësojnë të vërtetën, sa kriminel do të jenë në burgje. Pra, imuniteti në këmbim për të vërtetën (...) Për hir të rehatisë së familjeve të cilat nuk dinë se çfarë ka ndodhur me më të dashurit e tyre, për hir të vërtetës dhe varrimit eventual të mbeturinave mortore të viktimave, KOMRA duhet t'i kushtojë një kujdes të veçantë e të madh një gjëje që quhet dëshmitari i mbrojtur (...) Vlera kryesore e KOMRA-s duhet të jetë e vërteta për hir të rehatisë së familjeve të viktimave dhe pajtimin midis bashkësive (Zheljko Tvrdishiq, Shoqata e Gazetarëve të Kosovës, Kosovë, Konsultimet rajonale me gazetarët, Novi Sad, Serbi, 26 shtator 2009.)

Shtetet në rajon që nuk i njohin faktet të cilat i ka vërtetuar Gjykata e Hagës vështirë do ta pranojnë iniciativën për formimin e KOMRA-s.

Pra, janë të pakontestueshme faktet se Gjykata e Hagës i ka konstatuar faktet në të gjitha palët, por ato në realitet nuk i pranojnë politikat dhe për këtë shkak mendoj se do të jetë shumë vështirë të binden qeveritë e vendeve të cilave vështirë do të mund tu qaseni me këtë projekt. (Damir Shimi, TV BH1, BeH, Konsultimet rajonale me gazetarët, Novi Sad, Serbi, 26 shtator 2009.)

Duhet nisur nga faktet që i kanë konfirmuar Gjykata e Hagës dhe gjyket vendore – këtë askush nuk do ta kundërshtojë.

Mendoj se për fillim do të ishte më së miri të (...) bazohemi ekskluzivisht në faktet. Sepse ne kemi aktgjykimet e Gjykatës së Hagës e të gjykatave vendore, dhe mendoj se për fillim më mirë të shfrytëzohen faktet, aktgjykimet e plotfuqishme që i kanë miratuar gjyqtarët e pavarur, të cilat njerëzit nuk mund t'i kundërshtojnë. E pastaj kjo të shtrihet më tutje (Xhenana Karup-Drushko, "Dani", BeH, Konsultimet rajonale me gazetarët, Novi Sad, Serbi, 26 shtator 2009.)

Në BeH akoma manipulohet me të dhënat prej 200.000 boshnjakëve të pësuar, edhe pse Qendra Hulumtuese-Dokumentuese ka vërtetuar se janë vra, pësuar e zhdukur gjithsej rreth 97.000 njerëz.

Ne, një ditë në Bosnjë e Hercegovinë kemi pasur promovimin e liderit të ri politik, magnatit medial (...) i cili gjithashtu, ka manipuluar (...) me faktin mbi numrin e përgjithshëm të pësuarve në Bosnjë e Hercegovinë. Domethënë ai prapë në atë tezën e "viktimës boshnjake" ka përmendur numrin prej 200.000 boshnjak të vrarë (...) Qendra Hulumtuese Dokumentare në Bosnjë e Hercegovinë ka arritur njëfarë shifre (...) dhe mendoj se ajo është më pak se 100.000. Pra në të gjitha palët në Bosnjë e Hercegovinë gjithsej ka 97.000 të pësuar. (Damir Shimi, TV BH1, BeH, Konsultimet rajonale me gazetarët, Novi Sad, Serbi, 26 shtator 2009.)

Mediat kroate që po e përcjellin gjykimin e gjeneralëve kroat për krime të luftës –po raportojnë në mbrojtje të tyre.

Ky po ashtu është pozicion shumë i vështirë i juve që kërkon mbështetjen e mediave në këto shtete. Shpesh

i përcjelli mediat kroate (...) dhe në realitet mund të vërehet, (...) se qasja raportimit (...) nga gjykimi për krime të luftës kryesisht është pro aktiv në mbrojtje të gjeneralëve kroat të cilët gjykohen. (Damir Shimić, TV BH1, BeH, Konsultimet rajonale me gazetarët, Novi Sad, Serbi, 26 shtator 2009.)

Pavarësisht nëse KOMRA do t'i vërtetojë faktet dhe do t'u ndihmojë gjeneratave të ardhshme ta kuptojnë çfarë ka ndodhur, kjo nuk do ta pengojë manipulimin me të dhëna.

Nëse ky projekt do të ketë sukses, nëse e realizon qëllimin e vetë të së vërtetës që ai në afat të gjatë, domethënë gjeneratave të ardhshme mund t'u lë diçka për çka ata do ta njohin më mirë atë që ka ndodhur këtu (...), kjo prapë nuk do të ndihmojë që të mos manipulohet me të dhënat pavarësisht sa të vërteta dhe fakte i konfirmoni dhe publikoni në çfarëdo dokumente. (Damir Shimić, TV BH1, BeH, Konsultimet rajonale me gazetarët, Novi Sad, Serbi, 26 shtator 2009.)

Në Kosovë ekziston problemi i identifikimit të mbeturinave mortore. Pikërisht për këtë duhet nisur më parë nga shkalla kombëtare / shtetërore e pastaj të bëhet lidhja në shkallë rajonale.

Në Kosovë kemi problem, i kemi varrosur 2.000 njerëz pa analiza ADN, kurse në morgun në Prishtinë (...) gjenden (...) edhe 400 mbeturina mortore ADN e të cilëve nuk po përputhet me analizat që i kanë dhënë anëtarët e familjeve. Pra, ne kemi problem brenda vet vendit (...) Konsideroj se do të ishte shumë më mirë sikur të nisemi nga vendet, e pas kësaj të takohemi në planin rajonal. (Ardijana Thaçi, Koha Vision, Kosovë, Konsultimet rajonale me gazetarët, Novi Sad, Serbi, 26 shtator 2009.)

Faktet nuk janë të mjaftueshme. Nevojitet që krimet e luftës të tregohen në kontekst, e kjo nuk u përgjigjet autoriteteve në rajon.

Unë këtu jam tepër pesimist, sepse e di kur u krijua fuqia, e dimë kur u krijua paraja, dhe atyre struktura (politikanëve) e vërteta nuk u konvenon (...) Në Mal të Zi para tri, katër vitesh (...) është filmuar një film dokumentar (...) ki cili merret me agresionin në Dubrovnik. Në atë film gjithçka sillet me fakte (...) Mirëpo dimensionin politik i gjithë asaj ekspedite në Dubrovnik (...) absolutisht nuk ekziston. Ashtu që me një qasje faktike u arrit ajo që dukej se njerëzit me mjekra e të dehur, u futën në thesarin botëror të

prirë nga njëfarë energjie antike e ngjashëm. Me qelmin po karikaturizoj (...) dua të them se ai kontekst duhet të paraqitet me anë të asaj si do të renditen faktet, e kjo atyre nuk u përgjigjet. (Brano Mandić, "Vijesti", Mali i Zi, Konsultimet rajonale me gazetarët, Novi Sad, Serbi, 26 shtator 2009.)

Fushata mediale duhet të jetë serioze dhe atë duhet ta udhëheqin të përkushtuarit idesë.

Fushata juaj mediave duhet të jetë tejet serioze (...) Unë do t'u këshilloja që prerë të formoni një ekip për këtë (...) Në këtë mund të punojnë njerëzit e përkushtuar (...) Domethënë dikush që ka forcë të mjaftueshme (...) duhet shkuar ngulshëm, partizançe, me disa individ të fuqishëm (...) Mendoj se ka mjaftë njerëz që janë të përkushtuar kësaj. Për këto probleme nevojitet dikush i cili do t'i bartë në shtëpi. (Brano Mandić, "Vijesti", Mali i Zi, Konsultimet rajonale me gazetarët, Novi Sad, Serbi, 26 shtator 2009.)

KOMRA duhet ta ngrit vetëdijen e njerëzve se të gjithë duhet të ballafaqohen me të kaluarën.

Ajo që po dua të them është se KOMRA-s lypset t'i jepet mbështetja që t'u krijojë ndonjë qasje alternative njerëzve, pasi që kjo është më e qenësishme, domethënë ajo vetëdije, ngritja e vetëdijes, se të gjithë duhet të ballafaqohen me të kaluarën. (Idriz Seferi, "Koha Ditore", Kosovë, Konsultimet rajonale me gazetarët, Novi Sad, Serbi, 26 shtator 2009.)

KOMRA është qenësor që në Serbi të flitet mbi viktimat shqiptare, e në Kosovë mbi ato serbe.

KOMRA (është) qenësor për të ardhmen e gjithë neve, domethënë duhet të punojmë në këtë rrafsh dhe ta mbështesim (...) Shumë njerëz këtu nuk e dinë se në Kosovë janë vlarë rreth 10.000 njerëz, kanë frikë se vetëm viktimat serbe do të përmenden e kështu me radhë, kurse këtu po flitet vetëm mbi viktimat serbe. (Idriz Seferi, "Koha Ditore", Kosovë, Konsultimet rajonale me gazetarët, Novi Sad, Serbi, 26 shtator 2009.)

Në mbarë rajonin mediat po i përcjellin vetëm faktet në favor të viktimave të "veta".

Në Bosnjë e Hercegovinë nga fillimi i luftës, e ja edhe në Kosovë prej vitit 1999 ... Kemi sistemin ku flitet vetëm për një pjesë të çështjes, çështjes e cila i konvenon një mjedisi të caktuar (...) duhet bërë ndarja nga praktika që të përcillen vetëm faktet (...) ekskluzivisht vetëm të viktimave "tona" (...) Për shembull,

gykimet e boshnjakëve i përcjellin ashtu vetëm nëse gjykohej ndonjë serb, (...) se përcillet vetëm që qëndron në aktakuzë, kurrë mbrojtja; nëse gjykohej boshnjakët përcillet vetëm mbrojtja, e fare jo çka qëndron në aktakuzë (...) e kemi mjaftë të ndërtuar atë sistem të dimë vetëm një pjesë të çështjes. (Sanja Shkuletqi, "Avaz", BeH, Konsultimet rajonale me gazetarët, Novi Sad, Serbi, 26 shtator 2009.)

Mediat do të nisin ta përcjellin aktivitetin e Koalicionit për KOMRA në qoftë se konsultimet bëhen ngjarje politike.

Ne do t'ju përcjellim (Koalicionin për KOMRA) në qoftë se ju vërtetë e bëni ngjarje të mirë politike (...) Ju vërtetë duhet të përpigjeni që, ja, si edhe këta njerëz të cilët në këtë me apo pa qëllim ia kanë dal nga diçka që është dashur të jetë vetëm gjë paradë, të bëhet ngjarje kryesore politike në vend.. (Sanda Saviq, B92, Serbi, Konsultimet rajonale me gazetarët, Novi Sad, Serbi, 26 shtator 2009.)

Sapo të formohet komisioni do të bëhet objekt i kundër-fushatës.

Atë moment kur të shpallet vetëm ekzistimi i atij komisioni, që të nis të punojë, ne të gjithë veç mund të shohim mijëra shkrime në gazeta përse serish edhe një komision për të vërtetën, kush e ka porositur, kujt i konvenon, si do të jetë dhe të gjithë veç mund të supozojmë se çka kemi krejt me pa. (Vesna Sladojeviq, Radiotelevizioni i Serbisë, Konsultimet rajonale me gazetarët, Novi Sad, Serbi, 26 shtator 2009.)

Vlera më e madhe e KOMRA-s është se do t'u mundësojë të rinjve dhe gjeneratave të ardhshme të mësojnë mbi gjithçka që ka ndodhur me anë të rrëfimeve të njerëzve nga hapësira e ish Jugosllavisë.

Mendoj se është i rëndësishëm (KOMRA) mu për shkak të së ardhmes. Dëshiroj që fëmija im një ditë (...) kur të hyjë në internet dhe kur të dëshirojë të mësojë detaje për atë çfarë ka ndodhur në hapësirat ku kanë jetuar prindërit e tij, të mësojë diçka që është më afër të vërtetës, e do të mësojë diç që është më afër të vërtetës ashtu (...) që të vërtetën e vet do ta tregojnë të gjithë njerëzit që kanë marrë pjesë në këtë, respektivisht njerëzit nga këto hapësira (...) dhe mendoj se kjo është vlera më e madhe e këtij projekti. (Vesna Sladojeviq, Radiotelevizioni i Serbisë, Konsultimet rajonale me gazetarët, Novi Sad, Serbi, 26 shtator 2009.)

KOMRA do të ketë problem ti marrë të dhënat dhe dokumentet në posedimin e organeve të shtetit.

Në qoftë se kërkojmë dokumente nga ato (institucionet) dhe të dhënat që më lehtë të sigurojmë faktet, për këtë jemi dëshmitarë se vështirë se do ta përjetojmë, ato do t'i japin kur ata të duan. Fatkeqësisht për këtë jemi çdo ditë dëshmitarë në çdo gjykim për krime të luftë. (Vesna Sladojeviq, Radiotelevizioni i Serbisë, Konsultimet rajonale me gazetarët, Novi Sad, Serbi, 26 shtator 2009.)

Programi informativ i Radiotelevizionit të Serbisë do të raportojë nga konsultimet, por cilësia raporteve do të varet nga interesimi i gazetarit i cili raporton. Dëshmitë e viktimave duhet emetuar në emisione të veçanta, sepse krijojnë përshtypje më të fuqishme. Emisionet speciale mbi viktimat ndihmojnë që rrëfimet mi viktimat të fitojnë më shumë shikues.

Çështja e raportimit nga kjo konferencë (konsultime), bie fjala, apo nga ndonjë e ardhshme (...) Këtë vazhdimisht do ta bëjmë në Programin informativ të Radiotelevizionit të Serbisë (...) Ne do t'i kemi përfaqësuesit tanë (...) por me sa sinqeritet do të merren me vet të ardhmen e kësaj ideje, kjo varet personalisht nga autori, respektivisht nga kolegu i cili do të merret me këtë, sa do të futet në atë tregim. (Vesna Sladojeviq, Radiotelevizioni i Serbisë, Konsultimet rajonale me gazetarët, Novi Sad, Serbi, 26 shtator 2009.)

Mendoj se duhet kultivuar autorësitë individuale (...) në terminet e posaçme, sepse kjo nuk mund të shkojë në programin informativ ditë ku ju mbysin ngjarjet e ditës. Nëse një pjesë e punës së atij komisioni do të jetë dëshmimi i viktimave, siç po shohim se është planifikuar, (...) mendoj se kjo gjithmonë është më mirë të bëhet në terminet e veçanta, në emisionet e posaçme dhe veprat e posaçme autoriale të cilat lënë përshtypje shumë më të fuqishme. (Vesna Sladojeviq, Radiotelevizioni i Serbisë, Konsultimet rajonale me gazetarët, Novi Sad, Serbi, 26 shtator 2009.)

A keni menduar eventualisht për bashkimin apo mbështetjet e rrjetëzuar të mediave ndaj (Koalicionit për) KOMRA? (...) A ekziston ndonjë variant që mediat e caktuara (...) të nënshkruajnë kontratë me ju dhe me këtë, të them, të zotohen të emetojnë emisione speciale apo diç ngjashëm nga kjo? (...) flas mbi efektin (...) si do të mund t'u ndihmojmë ne juve në çështjen që viktimat të fitojnë më shumë shikues, ashtu të themi (Rajko Sherbet, TV Mali Zi, Mali i Zi, Kon-

sultimet rajonale me gazetarët, Novi Sad, Serbi, 26 shtator 2009.)

KOMRA duhet saktësisht ta definojë nocionin e viktimës dhe ai lypset të zbatohet në të gjitha shtetet, në të kundërtën ideja do të komprometohet.

KOMRA duhet qartë dhe saktë ta definojë nocionin e viktimës dhe me konsekuencë ta aplikojë në të gjitha mjediset ku do të jetë kompetent (...) Në të kundërtën, rrezikojmë të hyjmë në çështjen edhe si shoqëri, por edhe si (Koalicioni për) KOMRA vetë mbi „viktimat tonat e tuajat”, mbi „viktimat e rendit të parë e të dytë” dhe kjo tërë çështjen do ta komprometonte pakthyeshmëri (...) para se elitat e ndryshme politike fare do të gjendeshin në situatë të vendosin mbi KOMRA-n. (Zoran Sekulic, FONET, Serbi, Konsultimet rajonale me gazetarët, Novi Sad, Serbi, 26 shtator 2009.)

Viktimat janë viktima, nuk ekzistojnë “tonat” dhe “të tyre”. Viktimat duhet të kenë trajtim të barabartë – ajo qasje do të sigurojë iniciativës besueshmëri, autenticitet dhe mirëbesim.

Nuk janë të gjitha viktimat të njëjta (...) por viktimat janë viktima. Dhe nuk ekzistojnë tonat e tuajat, ekzistojnë viktimat edhe pse ideja e këtij komisioni është që të dëgjohet zëri i viktimës, atëherë ato viktima vërtetë duhet të kenë trajtim të barabartë (...) Opinioni do ta përfitojmë edhe ju si (Koalicioni për) KOMRA edhe ne si mediume, në qoftë se kjo çështje nga fillimi do të ketë besueshmëri, do të jetë autentike dhe e besueshme dhe e punuar pa kurrfarë paragjykimesh. (Zoran Sekulic, FONET, Serbi, Konsultimet rajonale me gazetarët, Novi Sad, Serbi, 26 shtator 2009.)

Iniciativa KOMRA e ka kundër vetes opinionin i cili thërret se të gjithë kriminelët duhet të përgjigjen, por se kriminel janë gjithmonë tjetër.

Sipas hulumtimit 80 për qind të njerëzve (...) po flas për mjedisin nga vi unë (Banja Luka) (...) kanë thënë se në esencë të gjithë kriminelët e luftës duhet të përgjigjen (...) Në anketën njëjtë, përqindja e njëjtë e njerëzve thotë se “ne (serbët) nuk kemi bërë krime të luftës.” Ky në realitet është opinionin ynë të cilin ne tash e provokojmë. (Aleksandar Trifunovic, Buka, BeH, Konsultimet rajonale me gazetarët, Novi Sad, Serbi, 26 shtator 2009.)

Pjesëmarrja në luftë është edhe mos bërja. Tek kur për këtë ta hapim debatin, kemi të drejtë të

pyesim çka do të thonë fëmijët tanë.

Ne duhet të arrijmë deri tek ajo shpërlarje e trurit të njerëzve se ka pasur luftë, se ka pasur viktima, se kemi marrë pjesë në këtë. Se ajo që nuk e “kemi bërë” ka nënkuptuar se marrim pjesë në atë. Mendoj se tek atëherë fare do të kemi të drejtë të flasim se çka do të ndjejnë nga ajo fëmijët tanë apo jo, a do tu interesoje apo jo. (Aleksandar Trifunovic, Buka, BeH, Konsultimet rajonale me gazetarët, Novi Sad, Serbi, 26 shtator 2009.)

Në BeH iniciativa nuk mund ta marrë mbështetjen politike pa trysni të bashkësisë ndërkombëtare.

Bisedova me kolegët nga BeH dhe të gjithë flasin heshtazi (...) se iniciativa kurrë nuk do të mund të marrë mbështetjen politike dhe se atje, me qenë se shteti është nën protektorat legal, ndoshta do të dëgjohej bashkësia ndërkombëtare. (Sasha Kosanovic, Radiotelevizioni i Kroacisë, Konsultimet rajonale me gazetarët, Novi Sad, Serbi, 26 shtator 2009.)

Kusht i pranimi në Bashkimin Evropian duhet të jetë që midis shteteve kandidate të mos ketë konflikte.

Nëse ato elitat (në rajonin e ish Jugosllavisë) dëshirojnë të hyjnë në Bashkimin Evropian, duhet punuar në atë drejtim që kushti i pranimi në Bashkimin Evropian – që këto konflikte tona fisnore të përfundojnë më përpara se njëri nga vendet të bëhet kandidate serioze. Apo para hyrjes në Bashkimin Evropian që të gjitha ato pllaka të vendosen dhe të përfundojë ajo çështje. (Sasha Kosanovic, Radiotelevizioni i Kroacisë, Konsultimet rajonale me gazetarët, Novi Sad, Serbi, 26 shtator 2009.)

Kroacia e ka miratuar Deklaratën mbi luftën atdhetare me të cilën mohohet pjesëmarrja në luftë në BeH. Nga ky kënd në BeH nuk ka ndodhur asgjë që ka lidhje me Kroacinë.

Si mendoni ju ta zgjidhni, bie fjala, problemin e vogël se Kroacisë absolutisht nuk i intereson asgjë që nuk ka ndodhur në Kroaci, kurrfarë një milion nënshkrimesh: do të shikohet sa ka aty kroat, sa ka serb, sa kinez janë nënshkruar. Në Kuvendin e Kroacisë është miratuar Deklarata mbi Luftën Atdhetare ku gjëja kryesore ka qenë që të distancohemi nga pjesëmarrja e Kroacisë në luftë në Bosnjë e Hercegovinë. Pra, qytetarëve kroat, politikës kroate nuk i intereson asgjë në Bosnjë, asgjë nuk ka ndodhur atje lidhur

me ne, e të mos flas për ndonjë Serbi, Kosovë, Mal të Zi. (Sasha Kosanović, Radiotelevizioni i Kroacisë, Konsultimet rajonale me gazetarët, Novi Sad, Serbi, 26 shtator 2009.)

KOMRA duhet ta hartojë listën e kampeve dhe vendeve të mbajtjes rob dhe të rekomandojë që të gjitha vendet e pësimi të shënohen.

Njëra nga listat e cila shpresoj do të jetë pjesë e raportit të ardhshëm të KOMRA-s, do të jetë lista e të zënëve rob dhe e kampeve dhe me të mund të shkojë edhe rekomandimi që të shënohen të gjitha vendet e pësimi (Vesna Tersheć, Documenta, Kroaci, Konsultimet rajonale me gazetarët, Novi Sad, Serbi, 26 shtator 2009.)

Koalicioni për KOMRA duhet të formojë ekipin medial i cili do të punonte në ndërlidhjen e serviseve publike në rajon, që në të gjitha shtetet të dëgjohen dëshmitë publike të viktimave dhe vendimet e gjykatave për krime të luftës.

Mendoj se ky Koalicion për formimin e KOMRA-s eventualisht mund të ketë një (...) ekip të mediave kurse detyra e atij ekipi do të ishte (...) të insistojë tek televizionet kombëtare që të bashkëpunojnë, sepse (...) ato janë servise publike, domethënë përfaqësojnë interesin publik (...) Njëra nga idetë apo Rekomandimet do të ishte të emetojnë dëgjimet publike të viktimave (...) Kemi, për shembull, gjykim për krime të luftës në Serbi dhe në Bosnjë e Hercegovinë dhe (...) në Kroaci (...) ajo që do ta propozoja dhe që ai ekip duhet ta bëjë është që ato televizione të ndërlidhen, që ne në Mal të Zi të dëgjojmë çka është ajo që ka vendosur gjykata për krime të luftës në Beograd apo në Sarajevë sepse ne absolutisht jemi të izoluar. (Sonja Radoshević, gazetarë e lirë, Mali i Zi, Konsultimet rajonale me gazetarët, Novi Sad, Serbi, 26 shtator 2009.)

Për promovimin e Iniciativës për KOMRA nevojitet të angazhohen personalitetet publike që janë të njohura në rajon.

Njëra nga (...) dinakëritë e mediave (...) është edhe shfrytëzimi i personaliteteve publike që janë perceptuar si persona pozitiv, të suksesshëm në punët e veta, zakonisht në disa punë që kanë jehonë në opinion (...) Tash do të ishte shumë interesant të shkohet më tutje (...) që disi të ndërlidhet në nivel rajonal, që pikërisht personat nga Kroacia, personaliteti publik të flas për diçka që është lidhur për krimet në Kroaci dhe në Beograd për ato në Serbi e kështu (...) tash edhe me theksim të qartë se prapa gjithë kësaj qën-

dron Iniciativa për KOMRA. (Brano Mandić, "Vijesti", Mali i Zi, Konsultimet rajonale me gazetarët, Novi Sad, Serbi, 26 shtator 2009.)

Mediat alternative gjithashtu janë të rëndësishme – e kanë publikun e vet specifik.

Injorimi i atyre mediave alternative fare nuk është produktive, sepse ato media e kanë publikun e vet specifik dhe forcën e vet specifike dhe mendoj se thjeshtë në shkallë rajonale duhet bërë përpjekje për rrjetëzim. (Jelena Svirčić, H-alter, Kroaci, Konsultimet rajonale me gazetarët, Novi Sad, Serbi, 26 shtator 2009.)

Për të gjitha mediat të rëndësishme janë fatet e jetës dhe mbi to të gjitha do të shkruajnë e raportojnë.

Mund të them me siguri se temat që i kemi pasur këtu sot (...) vetvetiu janë interesante dhe ato me siguri do të jenë në faqet e gazetave tona, kjo është 100 për qind (...) Ajo që është interesante për të gjitha mediat e shkruara e elektronike janë fatet e jetës. Ne këtu me siguri, kemi mjaftë material të shkruajmë dhe me siguri do ta shkruajmë. (Mladen Milutinović, "Dani", Mali i Zi, Konsultimet rajonale me gazetarët, Novi Sad, Serbi, 26 shtator 2009.)

Mediat janë të gatshme që KOMRA-s t'ia vënë në dispozicion arkivin e vet.

Ne (FENA) e kemi arkivin luftarak të ngjarjeve të ndryshme dhe interpretimeve të ndryshme të atyre ngjarjeve dhe krimeve (...) Atë arkiv ne mundemi bashkë edhe me kolegët nga HINA apo nga SRNA ta ofrojmë kur duhet diçka, ndonjë e dhënë nga viti 1993, 1994 mbi ndonjë ngjarje. (Zoran Ilić, "FENA", BeH, Konsultimet rajonale me gazetarët, Novi Sad, Serbi, 26 shtator 2009.)

Në emër të agjencisë së lajmeve BETA ofrojmë arkivin i cili gjithashtu është i begatshëm. (Dinko Gruhonjić, Shoqata e Pavarur e Gazetarëve të Vojvodinës, Konsultimet rajonale me gazetarët, Novi Sad, Serbi, 26 shtator 2009.)

Nuk ka fushatë mediave pa mjaft para.

Të jemi real, mendoj se këtu do të duhen mjaftë para. Nëse Dodik mund t'i ndajë pesë milion për mediat në Republikën Serpska, mendoj se ju përafërsisht atë shumë do ta ndani për atë entitet të njëjtë. Thjeshtë, dyshoj se pa para mund të bëhet diçka kështu diçka,

përkundër faktit që të gjithë ne këtu po e përsërisim se e gjithë kjo është super, e shkëlqyeshme, mrekulli, mendoj se kjo do të duhet të përgatitet edhe me para. (Sanja Shkuletiq, "Avaz", BeH, Konsultimet rajonale me gazetarët, Novi Sad, Serbi, 26 shtator 2009.)

Gazetarëve duhet siguruar trajnim dhe t'u ofrohet mbështetja e plotë nëse shkruajnë mbi krimet e luftës.

Nevojitet të jemi (Koalicioni për KOMRA) të hapur ndaj (...) gazetarëve në atë kuptim të mbështetjes së punës së tyre (...) të bëhen trajnime me ta, tu jepet mbështetje nëse shkruajnë mbi krimet e luftës, kanë probleme në punën e vet, kërcënime, trysni e ngjashëm. (Aleksandar Trifunović, "Buka", BeH, Konsultimet rajonale me gazetarët, Novi Sad, Serbi, 26 shtator 2009.)

Servisi rajonal ERNO anëtar të së cilit janë serviset publike nga Sllovenia, BeH, Serbia, Mali i Zi, Maqedonia, Bullgaria dhe Rumania mund të ndihmojë në promovimin e idesë së KOMRA-s.

Serviset publike në rajon ende janë duke bashkëpunuar (me anë të servisit rajonal ERNO). Ne kemi këmbimin e përditshëm të lajmeve ditore respektivisht pamjet me filmime ditore nga i mbarë rajoni, e di se është bërë dhe dikur kanë qenë projekte (...) Ato (serviset publike) dikur kanë punuar projekte të caktuara lidhur me disa çështje të caktuara të cilat në momentin e caktuar kanë qenë problem në rajon. Si tregtia me njerëz (...) Ashtu që në atë mënyrë mund të provohet me anë të ERNO-mit të organizohet të punohet ndonjë tregim, domethënë që çdo qendër të punojë segmentin e caktuar dhe pastaj kjo të mbërthehet dhe të punohet tregimi mbi gjithë idenë dhe çka dëshirohet të arrihet me këtë (...) anëtarët janë sllovenët i, HRT, BHT, Televizioni Federal, RTS, Radio Televizioni i Podgoricës, Maqedonia, madje edhe Bullgaria edhe Rumania (...) në kuadrin e atij servisi rajonal. (Zheljko Tica, FTV, BeH, Konsultimet rajonale me gazetarët, Novi Sad, Serbi, 26 shtator 2009.)

Duhet përgatitur një emision Televiziv mbi KOMRA-n – Po ose JO, të cilin do ta shfaqnin të gjitha televizionet në rajon.

Ndoshta do të ishte mirë të përgatitet një emision i cili ndoshta do të zgjaste një orë ku do të shfrytëzoheshin të gjitha ato materialët që i posedojnë edhe FONET edhe Sarajeva dhe të gjitha stacionet televizive (...) në rajon (...) Ndoshta gjysmë ore para kësaj tregimi mbi KOMRA-n PO ose JO, bashkëbiseduesit që janë pro e kundër dhe pas kësaj të shkohet me atë

emision. (Budimir Raičević, Radio Mali i Zi, Konsultimet rajonale me gazetarët, Novi Sad, Serbi, 26 shtator 2009.)

Konsultimet kombëtare me të rinjtë

**Prishtinë, Kosovë
30 shtator 2009**

Konsultimet nacionale me aktivistët e rinj të organizatave për të drejtat e njeriut i ka organizuar OJQ Integra (Kosovë). Në tubim kanë qenë të pranishëm 40 pjesëmarrës, aktivist të OJQ dhe studentë të fakulteteve nga Kosova. Ligjërues kanë qenë Xhevad Bektasheviq (Shoqata e familjeve të viktimave civile të luftës Vlasenica '92 - '95, Bosnja e Hercegovina), Nora Ahmetaj (aktiviste për të drejtat e njeriut, Kosovë) dhe Bekim Blakaj (Fondi për të Drejtën Humanitare, Kosovë). Moderator të tubimit kanë qenë Kushtrim Koliqi (Integra, Kosovë) dhe Bekim Blakaj (Fondi për të Drejtën Humanitare, Kosovë).

Propozimet, mendimet dhe Rekomandimet e pjesëmarrësve

Komisionin rajonal duhet formuar sepse akoma nuk janë identifikuar të gjithë kryesit e krimeve të luftës, as që kanë siguruar kompensimet për familjet e viktimave.

Pse ne dëshirojmë ta bëjmë një komision për verifikimin e fakteve, të dimë çka ka ndodhur në luftën e ish-Jugosllavisë është mu kjo arsye: që ne është dashur të lirohemi prej barrës së madhe që ende nuk po dihet kush i ka kryer ato, me emër e me mbiemër dhe ende askush s'u dënua dhe askush s'ka dëmshpërbyer, që është faktor shumë i rëndësishëm për viktimat dhe familjarët e viktimave. (Kushtrim Koliqi, Integra, Kosovë, Konsultime nacionale me aktivistët të rinj të OJQ, Prishtinë, 30. shtator 2009.)

Lufta në Kosovë nuk ka përfunduar kohë të largët, janë dhjetë vite dhe nëse jo 100%, 90% të përgjegjësve janë ende gjallë dhe lëvizin lirshëm. Andaj, unë fuqimisht e përkrah nismën e KOMRA-s dhe mbaj shpresë në të. (Mehmet Ajeti, INPO, Kosovë, Konsultime nacionale me aktivistët të rinj të OJQ, Prishtinë, 30. shtator 2009.)

Është e nevojshme që Komisioni Evropian dhe ICO të ndikojnë që më shpejtë të zgjidhen lëndët e krimeve të luftës përpara gjykatave, sidomos në BeH dhe në Kosovë.

Është shumë e rëndësishme të bëhet presion në gjykatat që të ketë më shumë gjykime, që mos të mbeten vetëm në dy-tri raste (...). Të dëmtuar janë Bosnja dhe Kosova, sepse kanë pasur numër të madh të viktimave, të vrarëve, të zhdukurve, kështu që më së miri kishte me qenë të ndikojë drejtpërdrejt Komisioni Evropian ose Organizata ICO që të zgjidhen këto raste sa më shpejtë. (Veton Kryeziu, Zana, Kosovo, Nacionalne konsultacije s mladima, Priština/Prishtinë, 30. shtator 2009.)

Viktimat janë harruar, qeveritë nuk po e zgjidhin fatin e 16.000 personave tjerë të zhdukur në rajon, prandaj është e nevojshme kjo iniciativë civile.

Mendoj se viktimat, tashmë dhjetë vjet që nuk janë shumë, janë harruar nga opinioni dhe përmenden vetëm gjatë ceremonive të ndryshme. (..) Në krejt rajonin, janë diku rreth 16.000 persona të zhdukur, fati i të cilëve ende nuk dihet. Ne si qytetarë e kemi për obligim që të bëjmë më shumë, meqë qeveria e cila drejtpërdrejtë është e obliguar nuk po bën asgjë për zbardhjen e tyre. Ne jemi të obliguar me i shty gjërat përpara dhe me dhënë kontributin tonë dhe mbështetjen tonë dhe t'i a tërheqim vëmendjen qeverisë dhe opinionit për nevojën e ballafaqimit me të kaluarën. (Vjosa Rexhepi, Nisma e të rinjve për të drejtat e njeriut, Kosovë, Konsultime nacionale me aktivistë të rinj të OJQ, Prishtinë, 30. shtator 2009.)

Ne jemi shtet, të them ashtu. Është e keqe se përnjëmend nuk kujdesen për viktimat. Ndoshta kujdesen për neve, si qytetarë, si vendas, kujdesen në atë kohë kur kanë përfitime për vete. Por për kohë të gjatë as nuk u intereson çka jemi, qysh jemi. (Kimete Ukaj, NPU, Kosovë, Konsultime nacionale me aktivistë të rinj të OJQ, Prishtinë, 30. shtator 2009.)

Pa qasje rajonale nuk do të ketë zgjidhje të fatit të personave të zhdukur në Kosovë.

Nëse nuk i qasemi në mënyrë rajonale, atëherë nuk mund të mbërrijmë në zbardhjen e fatit të këtyre personave që tash janë të zhdukur. (Vjosa Rexhepi, Nisma e të rinjve për të drejtat e njeriut, Kosovë, Konsultime nacionale me aktivistë të rinj të OJQ, Prishtinë, 30. shtator 2009.)

Forca e KOMRA-s është në faktet, me cilat vetëm mund t'i kundërshtojmë me rrena dhe me zmadhimin e krimit të tjerëve.

Krijimi i një komisioni (KOMRA), për mua kishte

me qenë shumë kompetente për gjetjen dhe paraqitjen publike të fakteve, do të thotë për zbardhjen e një historie që ka ndodhë vërtet dhe jo një historie që është e ndërthurur në gënjeshtër dhe në interes politik, të cilën e bëjnë shtetet sepse kemi parë se çdo shtet i fshehë të këqijat e veta, ato krime që i ka bërë vet, kurse ia zmadhon tjetrit. (Vjosa Rexhepi, Nisma e të rinjve për të drejtat e njeriut, Kosovë, Konsultime nacionale me aktivistë të rinj të OJQ, Prishtinë, 30. shtator 2009.)

Historia nuk do të përsëritet në qoftë se zbulohet numri dhe identiteti i viktimave dhe nëse viktimave u mundësohet të flasin publikisht.

Kur do të kishim zbuluar se çka ka ndodhur në të kaluarën, kur do të kishim zbuluar numrin e viktimave dhe kur do të kishim parë viktimat duke folur ose përmes dëgjimit publik të viktimave, atëherë do të kishim mundur të ecim përpara dhe të mos vije deri te një përsëritje e historisë. (Vjosa Rexhepi, Nisma e të rinjve për të drejtat e njeriut, Kosovë, Konsultime nacionale me aktivistë të rinj të OJQ, Prishtinë, 30. shtator 2009.)

Është e nevojshme të organizohen konsultimet me familjarë të viktimave, në të gjitha bashkësitë ku kanë ndodhur krimet.

Duhet hapa konkretë, do të thotë edhe të dalim në terren, të kemi përfaqësues nga familjet e të zhdukurve, që të kemi përfaqësues në këto tryeza, sepse ata janë të cilët i dinë më së mirë gjërat sepse janë të prekur direkt nga dhuna (...) Duhet të organizohen tryeza nëpër qytete anekënd Kosovës (...) Duhet të kemi përfaqësues edhe nga qytetet tjera, jo vetëm nga Vushtrria, sepse e kemi Gjakovën që ka pasur masakra të tmerrshme, poashtu kemi edhe Drenicën. (Mentor Hasani, Youth Step, Kosovë, Konsultime nacionale me aktivistë të rinj të OJQ, Prishtinë, 30. shtator 2009.)

Shoqëria kosovare është e mbyllur, viktimat e përdhunimit janë të izoluar por edhe viktimat tjera nuk po flasin publikisht dhe nuk janë të hapura ndaj organizatave joqeveritare. Ky proces konsultativ mund të ndihmojë në tejkalimin e paragjykimëve dhe barrierave.

Ky komision deri diku do të kishte plotësuar nevojat e viktimave, sepse shoqëria kosovare është e izoluar dhe është e mbyllur. Këtu mund të bazohemi në atë se viktimat nuk flasin dhe nuk merren parasysh për arsye se ekziston një mbyllje ndaj aktivistëve të

shoqërisë civile, konkretisht të organizatave rinore dhe organizatave të shoqërisë civile që merren me të drejtat e njeriut, të cilat mund të luajnë një rol të rëndësishëm në thyerjen e këtij paragjykimi. Sidomos viktimat e dhunës seksuale janë të izoluar (...) Pra, të thyhen këto paragjykime, të shkruhet historia drejt, të shihet çka është bërë dhe të mos hezitohet të konsultohen organizatat e femrave dhe të inkurajohen që të dëshmojnë. (Ylber Maxhuni, Youth Step, Kosovë, Konsultime nacionale me aktivistë të rinj të OJQ, Prishtinë, 30. shtator 2009.)

Që viktimat të kenë mundësi të flasin mbi përvojat e veta, nevojitet t'u ofrohet ndihma psikologjike.

Viktimat për të thënë të vërtetën, së pari duhet të bëhet trajtimi psikologjik i tyre (...) Ata janë viktima të prekur dhe ata nëse nuk trajtohen psikologjikisht ata nuk do të mund të tregojnë as të vërtetën e as atë që kanë përjetuar. Trajtimi i parë është trajtimi psikologjik, ofrimi i mundësive për një jetë shumë më të mirë, për tu kyçur në jetën e përditshme dhe në jetën e cila u përket. (Venera Ramaj, Integra, Kosovë, Konsultime nacionale me aktivistë të rinj të OJQ, Prishtinë, 30. shtator 2009.)

"Vetëm në qoftë se zbulohet e kaluara e vendit tënd, mund të dish kush je."

Ai njeri që e harron të kaluarën e vendit të vet ai e harron edhe veten. Në atë moment që të harrohet e kaluara, atëherë nuk e di ti kush je. Zbulojë të kaluarën nëse do me dit kush je dhe çka do me bë. (Kimete Ukaj, NPU, Kosovë, Konsultime nacionale me aktivistë të rinj të OJQ, Prishtinë, 30. shtator 2009.)

Në qoftë se mbliiden një milion nënshkrime, Koalicioni për KOMRA do të ketë mundësi të ushtrojë ndikim në bashkësinë ndërkombëtare.

Te nisma e [Koalicionit për] KOMRA-s vjen ai konteksti se bashkimi bën fuqi. Dhe nëse bashkohemi, të bëhemi pra mbi 1 milionë, atëherë KOMRA kishte me pas atë mundësinë e ndikimit në instanca shumë më të larta, në Kombe të Bashkuara, në Bashkimin Evropian e tjera. (Mehmet Ajeti, INPO, Kosovë, Konsultime nacionale me aktivistë të rinj të OJQ, Prishtinë, 30. shtator 2009.)

Është me rëndësi që të rinjtë të përfshihen në procesin e ballafaqimit me të kaluarën, në mënyrë që gjeneratave të ardhshme t'ua përcjellin faktet mbi luftërat dhe me këtë të

ndikojnë që lufta të mos ndodh më.

Pse është me rëndësi ballafaqimi me të kaluarën dhe pse është me rëndësi ju si të rinj që jeni e ardhmja e këtij vendi, të dini të kaluarën (...) argumenti kryesor është që kurrë më të mos ndodhë lufta (...) ju duhet ti edukoni brezat e rinj dhe ti thoni: këto janë faktet e luftërave që kanë ndodhur në vitet e 90-ta, prej 1991 deri në 2001 dhe këto kurrë më nuk do të përsëriten. (Nora Ahmetaj, aktiviste e të drejtave të njeriut, Kosovë, Konsultime nacionale me aktivistë të rinj të OJQ, Prishtinë, 30. shtator 2009.)

Pjesëmarrësit dyshojnë se në afatin prej tre vjetësh, sikurse propozohet të zgjas funksionimi i KOMRA-s, do të mund të ndriçohen fatet e të gjithë të pagjeturve.

Në Kosovë, konflikti ka përfunduar në vitin 1999. Janë bërë gati dhjet vjet e gjysmë dhe dihet se për fatin e të pagjeturve është bërë shumë pak. Jam skeptik, sepse si do të kishte mundur KOMRA për 3 vjet të zbulojë fatin e të pagjeturve, kur dihet se janë 16. 252 të pagjetur. Pse të mos vendoset një kriter: që KOMRA ta përfundojë mandatin e tij deri sa të zbulohet fati i të gjithëve. (Mehmet Ajeti, INPO, Kosovë, Konsultime nacionale me aktivistë të rinj të OJQ, Prishtinë, 30. shtator 2009.)

Ekziston dyshimi se Kosova dhe Serbia nuk do të vendosin bashkëpunimin në drejtim të vërtetimit të fakteve, pavarësisht kush do të jetë anëtar i KOMRA-s.

Unë jam skeptike në bashkëpunimin [e Serbisë dhe Kosovës], për arsye se e dimë që bashkëpunimi për gjetjen e fakteve në Kosovë, shkon faktikisht drejtpërdrejt me Serbinë, për shkak se shumica e fakteve për të cilat ne jemi të interesuar, gjenden atje. Unë jam skeptike në atë se sa mund të bashkëpunojmë me ta, sa munden të na ofrojnë ndihmë, në zbulimin e fakteve të cilat neve na interesojnë. Për këtë, unë e kam një dyshim të madh, një pikëpyetje shumë të madhe se sa mund të jetë efikas kjo dhe sa ju faktikisht besoni se ajo mund të jetë frytdhënëse, pa marrë parasysh çfarë persona zgjedhën për atë koalicion. (Venera Ramaj, Integra, Kosovë, Konsultime nacionale me aktivistë të rinj të OJQ, Prishtinë, 30. shtator 2009.)

Një milion nënshkrime të qytetarëve dhe bashkësia ndërkombëtare mund të ushtrojë tryzni të fortë mbi qeveritë në rajon për ta formuar KOMRA-n, e pastaj këto qeveri do të kenë obligime t'i hapin arkivat dhe t'i dorëzojnë provat.

Kuptohet se jemi skeptikë sepse Qeveria e Serbisë nuk është duke bashkëpunuar, por pak po shpresojmë edhe në presionin ndërkombëtar. Prej momentit që pajtohet çdo qeveri që të themelohet një komision i pavarur, atëherë ato të njëjtat kanë obligime ndaj këtyre komisioneve. Kanë obligime me i çel arkivat, kanë obligime me dhënë dëshmitë që i kanë ata, plane e tjera. Për këtë ne edhe do t'i mbledhim 1 milionë nënshkrime e ndoshta edhe më shumë (...) Dihet me qeveritë Kosovë – Serbi ndoshta kurrë nuk do të bëhet të ulen ata bashkë, kush e di edhe sa vjet, por përdorimet presioneve të ndryshme po shpresojmë se do të themelohet një komision i pavarur. (Kushtrim Koliqi, Integra, Kosovë, Konsultime nacionale me aktivistë të rinj të OJQ, Prishtinë, 30. shtator 2009.)

Mandati i komisionit duhet të jetë edhe regjistrimi i viktimave të pësuar nga fushat e mbetura me mina.

Më duket se po lëmë anash shumë periudhën e pas luftës. Me këtë rast po e marr Kosovën ku një numër i konsiderueshëm i viktimave rezulton nga zonat e minuara në hapësira të territorit të Kosovës. Mendoj se duhet të jetë temë diskutimi dhe temë shqyrtimi i këtij komisioni edhe për viktimat nga zonat e minuara. (Zana Ahmetxhekaj, Nisma e të rinjve për të drejtat e njeriut, Kosovë, Konsultime nacionale me aktivistë të rinj të OJQ, Prishtinë, 30. shtator 2009.)

KOMRA duhet të merret edhe me viktimat dhe kryesisht që të arrihet deri te vërteta e plotë.

Pasi që po dëshirojmë ta zbulojmë një të vërtetë dhe të vijmë deri te një kompromis mbi një të vërtetë, atëherë duhet të merren për bazë të dy anët. Duhet me u marrë me viktimat të cilat janë të atij konflikti apo të një rasti, por gjithashtu, faktikisht kur merremi me viktimat duhet të merremi edhe me fajtorët të cilët do të jenë përgjegjës për atë krim që e kanë bërë. (...) nëse merremi vetëm me viktimat atëherë faktikisht ne vetëm po mbledhim argumente dhe vetëm po dëgjojmë storie por prapë asgjë nuk po zgjidhim. (Venera Ramaj, Integra, Prishtinë, Kosovë, 30. shtator 2009.)

Selia e zyrës qendrore e KOMRA-s duhet të jetë rrotulluese.

Në rast se KOMRA duhet me qenë e organizuar në atë mënyrë që me pas zyrën qendrore, ku do të duhej të ishte selia e KOMRA-s dhe ku do të vendoseshin zyrat përfaqësuese (...) propozimi im është që selia e KOMRA-s të vendoset me rotacion. (Furtuna She-

remeti, Nisma e të rinjve për të drejtat e njeriut, Kosovë, Konsultime nacionale me aktivistë të rinj të OJQ, Prishtinë, 30. shtator 2009.)

A rritet nacionalizmi dhe urrejtja ndaj popullit i cili ka bërë krim, në qoftë i dëgjon pësimet e viktimave nga bashkësia e vet.

Nëse te dëgjimi publik, mësohemi të dëgjojmë vazhdimisht ngjarje të rënda dhe dëgjojmë për një person të nacionalitetit tonë nëpër çka ka kaluar ai dhe familja e tij, a ka menduar ky koalicion, nëse pas këtyre dëgjimeve të njerëzve në përgjithësi të cilët do t'i dëgjojnë ata ka me rrit nivelin e nacionalizmit dhe e kundërta do ta rritë nivelin e urrejtjes ndaj popullit tjetër. (Korab Krasniqi, Integra, Kosovë, Konsultime nacionale me aktivistë të rinj të OJQ, Prishtinë, 30. shtator 2009.)

Në përmendoret e viktimave në Kosovë shihet dhuna. Të gjitha viktimat janë me armë. Më mirë do të ishte të tregojnë çfarë ka ndodhur në të kaluarën e jo ti nxisin të rinjtë kundër një populli.

Në Kosovë (...) në ato lapidare qartë shihet dhuna. Ato janë të ndërtuara me armë dhe ato janë të vendosura nëpër qendra të vendeve (...) ku fëmijët kanë qasje vizuale tërë kohën dhe ajo gjatë rritjes së tyre mund tua pjek një ide, një ide kundër një kombi tjetër i cili gjithmonë ka me qenë i keq deri në vdekjen tone. A ka ndonjë plan konkret për këto memoriale, që të jenë në nivel nacional por që nuk i irriton personin drejtpërdrejt në aspektin të asaj që ka ndodhur më herët. (Korab Krasniqi, Integra, Kosovë, Konsultime nacionale me aktivistë të rinj të OJQ, Prishtinë, 30. shtator 2009.)

Nevojitet të shënohen vendet e pësimit dhe në ato vende të ngriten përmendore.

Ndërtimi (...) i monumenteve përkujtimore do të kishte treguar se në atë vend përnjëmend ka ndodhur diçka dhe të tregohet një e vërtetë në mënyrën reale si ka ndodh (...) Në Suharekë, ekziston një vend ku janë djegë disa apo shumë njerëz dhe tash ai vend është harrua dhe ndoshta është si një lloj depoje. Prandaj, po them kishte me qenë shumë e arsyeshme me u marrë një iniciativë dhe ai vend me u bërë ndoshta një lloj vendi ku kishin mund ta dinë për të (...) Në monument ku do të ishin shënuar të gjitha viktimat që kanë rënë në atë vend dhe njerëzit tjerë ose të rinjtë të shohin se çfarë ka ndodhur në atë vend. (Venera Ramaj, Integra, Kosovë, Konsultime

nacionale me aktivistë të rinj të OJQ, Prishtinë, 30. shtator 2009.)

Ne po ngrisim përmendore por s'po ngrisim aty ku duhet. Çështja e Dubravës (..) Përmendorja është ngritur kilometra larg vendit të ngjarjes. Atëherë, pse po ngritet ajo. Për këtë arsye desha të them se ne nuk po përkujdesemi për viktimat. (Liridon Jetishi, student, Kosovë, Konsultime nacionale me aktivistë të rinj të OJQ, Prishtinë, 30. shtator 2009.)

Çka do të bëhet me ato viktimat që e kanë humbur anëtarin e familjes dhe pas kësaj kanë bërë krim?

Çka do të bëhet në ato raste kur një viktimë, është detyruar të kryej një krim të caktuar për shkak se atij ia kanë vrarë dikë nga familja e vet. (Liridon Jetishi, student, Kosovë, Konsultime nacionale me aktivistë të rinj të OJQ, Prishtinë, 30. shtator 2009.)

Konsultimet me bashkësinë lokale

Vukovar, Kroaci
30 shtator 2009

Konsultimet me bashkësinë lokale në Vukovar i kanë organizuar Qendra për paqe, jo dhunë e të drejta të njeriut dhe Qendra e dialogut Nansen, nga Osijeku (Kroaci), Luç nga Berka (Kroaci) dhe Documenta nga Zagrebi (Kroaci). Kanë marrë pjesë 69 përfaqësues/se të shoqatave të viktimave, të organizatave joqeveritare për të drejtat e njeriut, organizata e mbrojtësve, përfaqësues të vetëqeverisjes lokale dhe të mediave. Ligjërues kanë qenë Vesna Tersheliq (Documenta, Kroaci), Ivan Novosel (Legalis, Kroaci), Amir Kulagliq (Srebrenicë, BeH) dhe Natasha Kandiç (Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi). Moderatore ka qenë Vesna Tersheliq. Nga konsultimet kanë raportuar.

Propozimet, mendimet dhe Rekomandimet e pjesëmarrësve

Secili e ka të vërtetën e vet, por të vërtetat mund të afrohen vetëm në bazë të fakteve. Faktet çelin hapësirë për dialog, dialogu na shpie në mirëkuptim i cili e mundëson tolerancën, e ajo na çon në lirimin nga barra që e bartim.

Sepse është e natyrshme që secili prej nesh ta ketë të vërtetën e vet, sepse të gjithë në mënyrë të ndryshme

e kemi përjetuar (...) jo vetëm këtë luftë, veç të kaluarën e tërësishme. Edhe jeta jonë e tërësishme ndikon në atë çka do të jetë e vërteta për ne. Prandaj, është e natyrshme të ekzistojnë të vërteta të ndryshme dhe ato mund të afrohen vetëm në bazë të fakteve. Faktet janë ato për të cilat duhet biseduar, faktet janë ato që krijojnë hapësirën për dialog, kurse biseda duhet të sjellë mirëkuptimin. Mirëkuptimi do të sjellë tolerancën, e toleranca do të na mundësojë të lirohemi nga barra të cilin e bartim të gjithë në vete. Prandaj, mendoj se këtë iniciativë gjithsesi duhet mbështetur. (Ljiljana Gehrecke, Shtëpia Evropiane Vukovar, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Vukovar, Kroaci, 30 shtator 2009.)

Nevojitet të vërtetohen faktet dhe gjeneratave të ardhshme tu lihet në trashëgimi shënime mbi të kaluarën.

Për të gjithë ne (është) me interes t'i mësojmë të gjitha faktet, t'i eliminojmë motivet, interpretimet e paragjykimet dhe krejt (stereotipet) ngjeshjet tjera nga mendimet tona dhe të punojmë në atë drejtim që këto kolona kurrë më të mos përsëriten dhe që fëmijët dhe nipërit tanë të jetojnë në këto hapësira përfundimisht në paqe. (Ljiljana Gehrecke, Shtëpia evropiane Vukovar, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Vukovar, Kroaci, 30 shtator 2009.)

Ne duhet bërë çmos që gjeneratave të reja t'ua lëmë një shënim historik dhe autentik mbi të kaluarën tonë, të cilin disa gjenerata të reja do ta lexojnë në një mënyrë më humane e njerëzore. (Amir Kulagliq nga Srebrenica, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Vukovar, Kroaci, 30 shtator 2009.)

Serbët presin nga KOMRA që të merret me zhvarrosjen dhe identifikimin e serbëve të zhdukur si dhe me krimet tjera mbi serbët.

Këtë proces të themelimit të KOMRA-s e përcjellë që nga fillimi dhe në realitet janë kapur shumë për këtë ide, e do t'u them në të vërtetë nga një arsye kryesore që, sipas njohurive të mia (...) në Kroaci në fakt nuk ka institucion, organizatë, e më duket as individë të cilët merren (...) me çështjen e serbëve të zhdukur, krimet e kryera midis tjerash mbi serbët dhe krejt atë që ka ndodhur në kontekstin e luftës prej vitit '91 deri më '95. (Ruzhica Spasiq, Shoqata e familjeve të personave të zhdukur dhe të dërguar me dhunë, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Vukovar, Kroaci, 30 shtator 2009.)

Atë që e tha zonja N.K., se nuk e dimë territorin apo

nuk i dimë lokalitetet e të gjitha varrezave masive. Po, nuk i dimë në Bosnjë ndoshta, nuk i dimë ndoshta në Serbi, por në Kroaci kemi të njohura 22 varreza masive dhe 28 individuale që presin zhvarrosjen. Mbi 300 të zhvarrosur nga ofensiva 'Bljesak' e 'Oluja' (serb) po presin identifikimin. (Ruzhica Spasiq, Shoqata e familjeve të personave të zhdukur dhe të dërguar me dhunë, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Vukovar, Kroaci, 30 shtator 2009.)

KOMRA është shpresë se secila viktimë, pavarësisht nga nacionaliteti, do ta ketë emrin e mbiemrin dhe varrin e vet.

Unë në këtë, Iniciativën për KOMRA, në realitet e shoh një fije kashtë shpëtimi e cila do të ndihmojë që çdo viktimë, pavarësisht nga nacionaliteti, do të merr emrin e mbiemrin e vet, të marrin dy metër katror tokë të vetën nën këtë nën-qiell dhe që me të dashurit e tyre të kenë vend ku do të shkojnë të ndezin qirin, të dërgojnë lule. (Ruzhica Spasiq, Shoqata e familjeve të personave të zhdukur dhe të dërguar me dhunë, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Vukovar, Kroaci, 30 shtator 2009.)

Nevojitet të mësohet kush janë kryesit, sepse ata janë udhërrëfyes drejtë urrejtjes dhe nevojës që ajo të eliminohet.

Jam për atë që kur hulumtohen viktimat atëherë të hulumtohen edhe kryesit dhe atë për shkak se është e rëndësishme ta dimë pse po e bëjmë këtë (...) mjafton nëse pyesim kriminelët apo si do t'i quanim, përse e ke bërë këtë, ai do të thotë: ose këtë e kam dëgjuar nga prindërit, ose në rrethinë, ose në shkollë, ose nga shoqëria. Dhe kjo për ne është një udhërrëfyes të dimë se ku krijohet urrejtja (...) Prandaj, luftojmë që të mos shtrihet urrejtja. (Biserka Tompak, mjeke, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Vukovar, Kroaci, 30 shtator 2009.)

Në Vukovar shkollat ende janë të ndara.

Për mua personalisht çrregullimi (ekscesi) i parë dhe i madh janë shkollat e ndara pas aq shumë kohe, në shekullin 21, në Vukovar. Këtu fëmijët akoma janë të ndarë. Unë mendoj se nuk ka çrregullim më të madh dhe çrregullimi më i madh nuk mund të ndodhë. (Ruzhica Mandiq nga Vukovari, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Vukovar, Kroaci, 30 shtator 2009.)

Nuk është mirë të hartohet lista e kryesve, sepse me emra manipulohet dhe do të bëhet dëmi shtojcë.

Emrat e kryesve, mendoj se edhe kjo është shumë pyetëse, sepse kam përjetuar edhe në përvojën personale edhe tjetër kah, që me emrat të manipulohet tepër shumë dhe derisa diç nuk dëshmoni ai nuk është fajtor (...) ju e dini vet se një e pa vërtetë e folur njëqind herë, bëhet e vërtetë. Shtrohet pyetja çka, si dhe sa dëme shtojcë do të sjellin përpos kësaj që veç e kemi deri më tash. (Ruzhica Mandiq nga Vukovari, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Vukovar, Kroaci, 30 shtator 2009.)

Të rinjtë duhet të inkuadrohen që të evitohet përsëritja e historisë.

Mendoj se të rinjtë janë shpresa e kësaj shoqërie, sepse nëse neve pas 18 vjetësh na ndodh që t'i shohim fëmijët të cilët pas ndeshjes së futbollit, e cila nuk ka lidhje me Serbinë dhe me Kroacinë, bërtasin "Serbe na vrbe" (serbët në shëlgje) prej pesë vjeç, aq vite pas luftës, mendoj se të rinjtë vërtetë duhet inkuadruar, dhe shtrojmë pyetjen a do të ndodhë që kjo e njëjta të pritët pas 50 vjetësh. (Ruzhica Mandiq nga Vukovari, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Vukovar, Kroaci, 30 shtator 2009.)

Nevojitet të inkuadrohen Sllovenia dhe Maqedonia, pavarësisht që atje lufta ka zgjatur shkurt.

Çka është me Slloveninë dhe Maqedoninë, përse ato shtete nuk përmenden? Fakti që diku lufta ka zgjatur 12 ditë apo 13 ose 14, sa ka zgjatur në Slloveni, (...) nuk do të thotë se unë nuk konsideroj se shteti nuk duhet të inkuadrohet në këtë proces. (Dragana Stojiq nga Vukovari, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Vukovar, Kroaci, 30 shtator 2009.)

Në mbarë rajonin njerëzit nuk janë të gatshëm që të bëjnë vet diçka kundër ndarjeve etnike dhe paragjytimeve.

Këtu të gjithë po flasim për atë se si nuk dëshirojmë (...) të ndodhë gjenocidi, krimi, lufta dhe krejt e keqja që është prapa nesh, po unë vetëm dua tu pyes juve, sa jeni ju vetë të përgatitur të bëni diçka për këtë? A do ta lëshoni fëmijën tuaj të shoqërohet me fëmijën e nacionalitetit tjetër? A e bëni këtë vetë? Dhe kam biseduar shumë me njerëzit jo vetëm nga Kroacia, por nga Bosnja, Serbia dhe përgjigja tyre është (...) 'më mirë të mos përzihemi me ta' (...) 'ashtu është më thjeshtë'. Pra pyetja ime është- a jemi sa duhet të fuqishëm që vetvetes t'ia pranojmë se ne këtë e kemi tejkaluar? (Iva Nikoliq, Tabu, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Vukovar, Kroaci, 30 shtator 2009.)

KOMRA duhet ti rishikojë aktgjykimet nga vitet e 90-ta, veçmas të gjykatave ushtarake, të cilat nuk kanë qenë të drejta, e po ashtu edhe rastet e lirim të akuzuarve për çka familjarët e viktimave duhet të paguajnë shpenzimet gjyqësore.

Pyetja ime tani ka të bëjë me qëndrimin e iniciativës për komisionin se a do të merret edhe me rastet që janë proceduar para gjykatave? Në fakt, në Kroaci mbi pesëmbëdhjetë vjet janë zhvilluar procese gjyqësore të panumërta (...) në vitet e vona të nëntëdhjeta, ose para atyre gjykatave të famshme ushtarake të cilat kanë qenë çdo gjë tjetër, veç jo gjykime të drejta. (...) A do të merret ndoshta komisioni edhe me ato viktimat, viktimat e gjyqësisë? Gjithashtu a do të merret edhe me rastet kur kryesit janë liruar apo amnistuar dhe pastaj familjarët kanë marrë me aktgjykimin që t'i paguajnë edhe shpenzimet gjyqësore? (Branka Shesto, Forumi Demokratik Serb, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Vukovar, Kroaci, 30 shtator 2009.)

Problemi më i madh është të gjenden kryesit sepse janë nën mbrojtjen e qeverive ose në shtetet të cilët i mbrojnë.

Ne dimë për të zhdukurit tanë, vuajmë, qajmë, nuk i kanë gjetur, i kanë gjetur, por problemi më i madh është të gjenden kryesit. Mendoj se KOMRA do të ketë situata tepër të vështira, sepse shumë përgjigje fshehën prapë në qeveri, fshehën në atë politikë të turpshme që ishte gjatë atyre viteve të nëntëdhjeta në të gjitha anët. Secili e mbron dikë, ose Gjokën, ose Anten ose Fridrihun (...) kriminelët kanë bërë të këqija këtu, gjenden në Bosnjë. Kriminelët boshnjak kanë bërë krime atje e gjenden në Kroaci. (Mirko Kovačić, Shoqata e Nënave të Vukovarit, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Vukovar, Kroaci, 30 shtator 2009.)

KOMRA duhet t'u rekomandojë ministrive të arsimit në rajon që programet e historisë t'i ndryshojnë në bazë të fakteve të vërtetuara.

Mendoj se bashkësia është e ndarë, kujtoj se në Vukovar njerëzit e rinj janë të ndarë. Mendoj se fakti që shkojnë në shkollën e njëjtë, tash në ndërrimet e njëjta, nuk ka aq domethënie nëse historinë nuk e dëgjojnë bashkë, por dëgjojnë ndryshe (...) Së këndejmi mendoj se kjo gjithësi është një nga atutet dhe argumentet e rëndësishme për këtë komisioni i cili me atë që do ti konfirmojnë faktet do ta obligojë, midis tjerash, edhe Ministrinë e Arsimit në mbarë rajonin e cila do të jetë e detyruar që programet e

veta mbi historinë e re t'i hartojë në bazë të fakteve që i ka vërtetuar komisioni. Këtë me siguri do ta radhis në njërin nga Rekomandimet të komisionit ose të paktën do të duhej. (Mario Mazhiq, Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Vukovar, Kroaci, 30 shtator 2009.)

Dëgjimet publike të viktimave do t'i formojnë qëndrimet tona mbi atë se çka ka ndodhur në realitet.

Mendoj se komisioni patjetër mund t'i formojë qëndrimet. Dhe atë në disa mënyra. Një është që ai do ta mundësojë platformën publike për zërin e viktimës. Se viktimat nga të gjitha anët mund të flasin për dhimbjen e tyre hapur dhe se ne tjerët do të kemi rastin të dëgjojmë mbi këtë. Dhe në bazë të fakteve të tyre që i paraqesin, por gjithashtu edhe të bashkë ndjenjave të tyre shumë relevante ndaj asaj që ka ndodhur, mund të ndërtohet qëndrimi për atë që ka ndodhur. (Mario Mazhiq, Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Vukovar, Kroaci, 30 shtator 2009.)

Që të sigurohet besueshmëria, ndoshta kryetari i tij duhet të jetë nga shteti i cili nuk merr pjesë në formimin e KOMRA-s.

Për shkak të legjitimitetit që duhet ta ketë komisioni, a mendoni ndoshta se për shkak të objektivitetit të atij komisioni, duke marrë parasysh se legjitimiteti i tij veç po arrihet me faktin që e kanë formuar të gjitha shtetet të cilat do ta themelojnë KOMRA, më intereson a thua ndoshta anëtarët e komisionit respektivisht, të paktën ndonjë anëtar kryesor kryetari i komisionit, mund të jetë dikush që nuk është nga ai vend, në kuptimin e objektivitetit dhe në kuptimin e mundësisë së pakësuar të ndikimit të politikës në vend në atë person? (Slaven Rashković, Documenta, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Vukovar, Kroaci, 30 shtator 2009.)

Koalicioni për KOMRA e nxit dialogun dhe ballafaqimin me viktimat, ndërsa KOMRA mund ta kthejë besimin dhe në të ardhmen të sjellë pajtimin.

Cilësia e punës së përbashkët (Koalicioni për KOMRA) qëndron në faktin që bashkë ndiejmë njëri me tjetrin, por edhe ndihmojmë që një ide jashtëzakonisht e mirë (KOMRA) të përjetojë realizimin e vet final në faktin që në këtë hapësirë jo vetëm që do të vendoset dialogu, veçse do të vendoset mirëbesimi,

e do të isha fatlum që gjatë jetës time të arrihet pajtimi. (Amir Kulagliq nga Srebrenica, BiH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Vukovar, Kroaci, 30 shtator 2009.)

Varrezat masive hapen para zgjedhjeve.

Bash në këtë gjurmë se janë viktimat se kryesisht shërbejnë për larje hesapësh, sepse si të shpjegohet ndryshe që para çdo zgjedhje të hapet ndonjë varrezë masive? Kur kalojnë zgjedhjet ajo varrezë masive harrohet. (Dragica Aleksić, Luç, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Vukovar, Kroaci, 30 shtator 2009.)

Mbrojtësit dhe familjet e tyre janë të interesuar për formimin e KOMRA dhe duhet të inkuadrohen në procesin e konsultimeve.

Në Kroaci ka 500.000 (...) mbrojtjes të atdheut. Nëse marrim se rreth tij është bashkëshortja dhe të paktën një fëmijë, kjo është 35 për qind e popullatës së Kroacisë (...) Mendoj se ajo popullatë e si pra është interesuar çka komisioni i tillë, nëse formohet (...) nëse ai aktivizohet dhe e merr ligjshmërinë dhe legjitimitetin e vetë... Është shumë qenësore që edhe ajo pjesë e popullatës duhet të inkuadrohet dhe të ketë çka të thotë. (Veljko Vičević, Shoqata e vullnetarëve dhe veteranëve të Luftës Atdhetare të qytetit të Zagrebit, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Vukovar, Kroaci, 30 shtator 2009.)

Dëshmimi publik ka reflektim terapeutik në viktimat, por duhet të verifikohet se krejt është e saktë çka thotë dëshmitari.

Komisioni i ardhshëm rajonal do të mundësojë e veç po u mundëson edhe tash viktimave që botërisht të flasin për atë se çka kanë përjetuar. Kjo është mirë. Kjo ka rezultat të jashtëzakonshëm terapeutik në vet viktimat (...) Por të gjitha organizatat që janë kryesore në Koalicionin për KOMRA, e shfrytëzojnë rastin dhe i paralajmërojnë, se konsideroj se të gjitha viktimave duhet mundësuar të thonë, para se gjithash, unë me fjalë (...) dëshirojë të them se kam qenë dëshmitar (...) nga tetë viktimat të dëgjua njëra e ka shfrytëzuar pozicionin, ka mbajtur fjalim politik me një sasi të pavërtetë, masat e fakteve të cilat jemi të gatshëm t'i rrëzojmë momentin e njëjtë (...) dëshiroj të tërheq vërejtjen se kur u mundësohet viktimave të flasin e si pra jemi të sigurt se ai njeri e ka përjetuar atë, se është dëshmitar i vërtetë, e jo të qëndrojnë këtu (...) „e dini unë kam ardhur atje, komshiu më ka thënë, po komshiu më ka thënë, po” (Veljko Vičević, Shoqata

e Vullnetarëve dhe Veteranëve të Luftës Atdhetare të qytetit të Zagrebit, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Vukovar, Kroaci, 30 shtator 2009.)

Duhet regjistruar të gjithë të pësuarit dhe të vrarët dhe atë regjistër ta përqafojnë të gjitha shtetet në rajon. Kjo është mënyra e vetme që të ndërpriten manipulimet.

Pra, nuk është tash kryesore që ne vetëm t'i numërojmë viktimat, por të bëjmë një regjistrim të njëmendët mbi ngjarjet në territoret e shteteve të sapo formuara, që të mos mund të manipulohet me faktet brenda pesëmbëdhjetë, njëzetë, pesëdhjetë vitesh (...) unë shoh perspektivë dhe rezultat të mirë të komisionit që vërtetë t'i regjistrojë edhe të pësuarit edhe viktimat dhe që ai regjistrim i ngjarjeve të jetë regjistër të cilin do ta pranoni të gjithë, të gjitha shtetet e sapo formuara në këto hapësira. (Veljko Vičević, Shoqata e Vullnetarëve dhe Veteranëve të Luftës Atdhetare të qytetit të Zagrebit, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Vukovar, Kroaci, 30 shtator 2009.)

Nevojitet të shqyrtohet roli i bashkësisë ndërkombëtare në luftërat e armatosura në ish Jugosllavi.

Nuk duhet larguar mundësinë (...) e revidimit të rolit të bashkësisë ndërkombëtare në hapësirën e ish Jugosllavisë dhe përgjegjësitë e saj (...) Ky është rast unik i zhvillimit të luftës së armatosur për formimin e shteteve të pavarura e demokratike me rrënimin e ish Jugosllavisë, ku nga fillimet e para në terren pjesëmarrës direkt i të gjitha ngjarjeve ka qenë edhe bashkësia ndërkombëtare (...) fakt se ata këtu kanë qenë para krisjes së pushkës së parë. (Veljko Vičević, Shoqata e Vullnetarëve dhe Veteranëve të Luftës Atdhetare të qytetit të Zagrebit, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Vukovar, Kroaci, 30 shtator 2009.)

Për veteranët çështje kyçe është ku do të gjendet arkivi i Gjykatës së Hagës.

Ne këtu e konsiderojmë përgjegjëse Serbinë për fillimin dhe për shumicën e të këqijave që kanë ndodhur në këto hapësira. Dhe për këtë shkak, në kuadrin e të drejtës, për të ditur ekziston një gjë qenësore, e kjo është e drejta që ta di personi cilit i ka ndodhur diçka dhe e drejta ta di bashkësia cilës i ka ndodhur kjo. Për këtë çështje kyçe për veteranët është çështja e arkivave. Ku do të gjenden arkivat? Arkivat e Gjykatës së Hagës dhe arkivat d kujtimeve praktike dhe të dëshmimeve të bashkësisë e cila ia jep kujtimet

e veta dikujt në dispozicion nga të cilat më pas do të bëhen hulumtime. (Ljiljana Canjuga, Shoqata e Vullnetarëve të Luftës Atdhetare të qytetit të Zagrebit, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Vukovar, Kroaci, 30 shtator 2009.)

Faktet e përcaktojnë kush është viktimë. Ai paraprakisht ka mundur të jetë kryes dhe prapë të jetë kryes.

Tash në realitet shtrihet pyetja kush është viktimë? Të jesh viktimë është vetëm një prerje në kohë. Ai person ka jetuar para kësaj, ai person nëse ka pasur fat e ka përjetuar edhe vet atë aktin e agresionit që e ka përjetuar në vete, por ka jetuar edhe pas asaj. Ai më përpara ka mundur të jetë kryes dhe pas kësaj prapë të jetë kryes. Ashtu që kur debatojmë mbi viktimitë propozoj të diskutojmë parimisht dhe pastaj kur t'i marrim faktet dhe të dhënat atëherë të bëhet kontekstualiteti (lidhja) i vetë ngjarjeve dhe të nxirren interpretime të caktuara. (Ljiljana Canjuga, Shoqata e Vullnetarëve të Luftës Atdhetare të qytetit të Zagrebit, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Vukovar, Kroaci, 30 shtator 2009.)

Për fillimin e debatit mbi Luftën Atdhetare nevojitet të nisemi nga Deklarata mbi Luftën Atdhetare të cilën e ka miratuar Kuvendi i Kroacisë.

Për mua si veterane, si mbrojtëse, është me rëndësi se fillimi i gjithë debatit mbi Luftën Atdhetare nisët nga Deklarata mbi Luftën Atdhetare, sepse kjo është diçka që e ka miratuar Kuvendi dhe evident i besojmë Kuvendit kur dëshirojmë që prapë ta formojmë komisionin. (Ljiljana Canjuga, Shoqata e Vullnetarëve të Luftës Atdhetare të qytetit të Zagrebit, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Vukovar, Kroaci, 30 shtator 2009.)

Konsultimet me bashkësinë lokale

**Doboj, Bosnja e Hercegovina
3 tetor 2009.**

Konsultimet me bashkësinë lokale i ka organizuar Forumi i Qytetarëve Tuzëll (BeH). Në tubim kanë qenë prezent gjithsej 22 pjesëmarrës. Ligjërues kanë qenë Aleksandra Letiq (Këshilli i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republika Serpska BeH) dhe Dragan Popović (Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi). Moderator ka qenë Vehid Shehiq (Forum i

Qytetarëve Tuzëll, BeH). FTV, BHT1, RF BeH dhe Avaz kanë raportuar mbi tubimin.

Propozimet, mendimet, Rekomandimet

Qëllimi i konsultimeve dhe i KOMRA-s është që të pranohen faktet mbi të gjithë krimet e luftës.

Atëherë gjithmonë dikush ju akuzon se ju po përpiqeni ta amnistoni dikë, të akuzosh dikë sepse secili i ka parë vetëm viktimitë e veta dhe dhimbjen e vet.. Këtu është qëllimi i edhe i këtyre konsultimeve por edhe qëllimi i komisionit (KOMRA), që megjithatë duhet t'i pranojmë faktet se ka ndodhur krimi në Sërbenicë, se ka ndodhur krimi i tmerrshëm edhe në Vozuqi. (Vehid Shehiq, Forumi i Qytetarëve Tuzëll, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Doboj, BeH, 3 tetor 2009.)

Dëshmimi publik i viktimitëve na ndihmon ta ndiejmë dhimbjen e tjerëve dhe të ndërtojmë solidaritet midis viktimitëve.

Me këto konsultime do të mundemi me siguri t'i inkurajojmë njerëzit që të flasin. Do t'i inkurajojmë sipas mënyrës që me anë të dëgjimit të viktimitëve eventualisht, të kuptojnë se edhe tjerët e kanë atë dhimbje për diçka që i ka goditur në luftë dhe aty ta afirmojmë atë farë parimi të një solidariteti midis nesh. (Vehid Shehiq, Forumi i Qytetarëve Tuzëll, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Doboj, BeH, 3 tetor 2009.)

Askush që ka bërë kryer krimin e luftës nuk mund të amnistohet.

Nuk ka amnisti për askënd që ka bërë atë krim. (Marko Grabovac, Organizata republikane për kërkimin e të zënëve rob dhe të luftëtarëve e civilëve të zhdukur të Republikës Serpska –Organizata komunale për kërkimin e personave të zhdukur në komunën Brod, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Doboj, BeH, 3 tetor 2009.)

Unë që në start do të kam qëndrim negativ ndaj amnistisë eventuale, sepse amnistia e krimit të luftës ndonjëherë do të thotë edhe si bashkëpjesëmarrje në vetë krimin. E duke marrë parasysh masivitetin e krimeve të luftës në Bosnjë e Hercegovinë, unë se shoh askënd të cilin duhet amnistuar, por duhet thënë qartë opinionin se ai është fajtor. (Vehid Shehiq, Forumi i Qytetarëve Tuzëll, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Doboj, BeH, 3 tetor 2009.)

Unë nuk jam për ndonjë amnisti. Ai që ka qenë i gatshëm të bëjë vepra të këqija le të përgjigjet për atë, kujtdo që i takon. (Llazar Blagojeviq, Organizata e Luftëtarëve të Republikës Serpska, Këshilli në Shamac, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Doboj, BeH, 3 tetor 2009.)

Nevojitet të definohet saktësisht nocioni i viktimës, humbjeve të njerëzve, i kampeve dhe burgjeve.

Më duhet ta përmendi edhe këtë se ne do të shohim të shtypim një doracak për të gjithë, që duke respektuar të drejtën ndërkombëtare të dimë çka janë viktimat, çka janë humbjet, çka është kampi, çka është burgu, çka është paraburgimi (...) sot, për fat të keq, po manipulohet me këto nocione dhe të gjitha janë kampet, e nuk kanë qenë të gjitha kampe. Çka janë humbjet në luftë. (Vehid Shehiq, Forumi i Qytetarëve Tuzëll, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Doboj, BeH, 3 tetor 2009.)

Ajo që është thënë e rëndësishme, (...) që unë si gazetar nga aspekti profesional duhet ta them dhe ta theksoj se e mbështes propozimin zotit Vehid mbi katalogun e fakteve (...) Kjo është diçka që do tu ndihmojë shumë mediave, gazetarëve sepse nuk është njëjtë nëse dikush ka raportuar mbi viktimat civile, mbi viktimën e luftës mbi, siç thatë, kampin, vend pranimin, mbi burgun. Këto janë fakte të qendrësishme. Kjo e ndryshon të vërtetën. Kjo e ndryshon njohurinë e atij që e pranon informatën. Raportimi i njëanshëm apo pa njohuri mbi gjërat juridike është shumë e rrezikshme. (Ljiljana Zurovac, Këshilli për shtyp i BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Doboj, BeH, 3 tetor 2009.)

Kur këtu flitet për kualifikimin e vendit të burgosjeve, kjo është pjesë shumë e rëndësishme dhe mendoj se KOMRA do të mund të jap përgjigje në të gjitha këto pyetje që deri tash kanë qenë të diskutueshme dhe ku nuk jemi pajtuar me disa mendime. (Shaban Ibrahimović, Shoqata e kampistëve e Kantonit Zenicë-Doboj, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Doboj, BeH, 3 tetor 2009.)

Kërkimi i të zhdukurve duhet të jetë e ndarë nga politika.

Por do t'ua them diçka pasi që ndoshta jam më i suksesshmi midis të suksesshëmve në gjetjen e të gjithëve, për shkak se e kam larguar nga vetvetja politikën, politikanët, partitë dhe kam përqindje të madhe të serbëve, kroatëve e boshnjakëve të gjetur në hapësirën e Komunës Brod e më gjërë. E këtë e bëjë

edhe sot (Marko Grabovac, Organizata republikane për kërkimin e të zënëve rob dhe të luftëtarëve e civilëve të zhdukur të Republikës Serpska –Organizata komunale për kërkimin e personave të zhdukur në komunën Brod, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Doboj, BeH, 3 tetor 2009.)

Nuk dihet numri i saktë i të zhdukurve, sepse ka të zhdukur të cilët nuk ka kush ti lajmërojë.

Nuk është e vërtetë se kemi pasqyrë të themeltë për personat e zhdukur. Ka akoma, si në Bosnjë e Hercegovinë ashtë edhe në Serbi edhe në Kroaci dhe në të gjitha republikat, që kanë qenë të përfshira nga lufta (...) Për shkak se ende të gjitha nuk janë të lajmëruara. Nga arsyet se familjet janë zhdukur, vrrarë e kështu me radhë. Dhe nuk ka kush t'i kërkojë. Apo përfundimisht thuaja se nuk ka pasur kush t'i paraqes. E kemi edhe persona të zhvendosur nëpër të gjitha qytetet, shtetet e sot edhe këtu kemi probleme. (Marko Grabovac, Organizata republikane për kërkimin e të zënëve rob dhe të luftëtarëve e civilëve të zhdukur të Republikës Serpska –Organizata komunale për kërkimin e personave të zhdukur në komunën Brod, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Doboj, BeH, 3 tetor 2009.)

Mirëbesimi tek njëri tjetri fitohet vetëm nëse shoqatat kombëtare të viktimave i përfaqësojnë të gjitha viktimat.

Nëse duam të fitojmë besim në njëri tjetrin, atëherë duhet të themi se ne këtu jemi në emër të gjithë viktimave, e jo që atje dikush të dal se si e përfaqësoni shoqatën e vetë dhe të flas për babën, nënën, vëllain e vet dy orë apo edhe 15 minuta e të mos i përmend viktimat e luftës. (Marko Grabovac, Organizata republikane për kërkimin e të zënëve rob dhe të luftëtarëve e civilëve të zhdukur të Republikës Serpska –Organizata komunale për kërkimin e personave të zhdukur në komunën Brod, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Doboj, BeH, 3 tetor 2009.)

Organizata republikane për kërkimin e luftëtarëve dhe civilëve të zënë rob dhe të zhdukur e Republikës Serpska është vëzhgues e procesit konsultativ sepse donë të jetë e sigurt se Koalicioni paraqitet në emër të gjithë viktimave.

Ne ende do të jemi vëzhgues të gjithë këtyre tubimeve. Këtë urdhër unë e kam marrë nga ana e organizatës tonë e cila është më e madhja në Republikën Serpska (...) Dhe e cila e përcjellë punën e KOMRA-s kudo që shohim dhe e ndajmë se pjesërisht po nda-

hemi në disa gjëra, e të mos i japim vetës të drejtë të flasim mbi të gjitha viktimat, kurrë nuk do të lejojmë që në KOMRA të jemi çfarëdo anëtar. (Marko Grabovac, Organizata republikane për kërkimin e të zënëve rob dhe të luftëtarëve e civilëve të zhdukur të Republikës Serpska –Organizata komunale për kërkimin e personave të zhdukur në komunën Brod, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Doboj, BeH, 3 tetor 2009.)

KOMRA duhet të përcaktohet qartë kush janë urdhërdhënësit e kush ekzekutorët. Disa krye kanë qenë të detyruar ta kryejnë urdhrin, sepse u janë kërcënuar me vdekje.

Edhe këtu duhet të spastrojmë me anë të KOMRA -s tonë veçmas urdhërdhënësit, e veçmas kryesit. Shumë as që kanë pas qëllim ta kryejnë atë por kanë qenë të detyruar ta bëjnë atë, sepse kanë qenë në gjendje shumë të rëndë, por edhe në rrezik për jetën.. (Zahid Kremitq, Shoqata e të kthyerve të Komunës Doboj, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Doboj, BeH, 3 tetor 2009.)

Viktimave lypset garantuar siguria, për të thënë çka ju ka ndodhur.

Që viktimat të cilat e kanë përjetuar gjithë këtë ta thonë të vërtetën pa kurrfarë ngurrimi me kusht që neve viktimave të cilët deri më tash nuk kemi pasur rast të themi, të na garantohet siguria. (Zahid Kremitq, Shoqata e të kthyerve të Komunës Doboj, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Doboj, BeH, 3 tetor 2009.)

Kërkim-falja e atyre që i kanë shkelur të drejtat e njeriut është gjest që për viktimat ka domethënie të madhe.

Kam përjetuar edhe kërkim falje (...) Policët që na kanë dëbuar nga banesat, nga shtëpitë dhe nga gjithçka, më pas kanë kërkuar falje, sepse kanë dëgjuar çdo gjë të mirë për mua dhe për familjen time (...) Them, një gjest i vogël për njeriun ka domethënie të madhe. (Faketa Avdiq, Merhamet, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Doboj, BeH, 3 tetor 2009.)

Pjesëtarët e dikurshëm e Sigurimit të Shtetit në Doboj, urdhërdhënësit e krimit, tash janë në funksione.

Tek ne në Komunën e Dobojit ka të atillë që kanë qenë urdhërdhënës në Sigurimin e Shtetit (...) i di personalisht, sepse tërë kohën kam qenë aty. Domethënë,

ata që kanë qenë urdhërdhënës të krimit tash janë në funksione. Këtë duhet ta zgjidhim dhe për këtë duhet të orvatem t'i paraqesim të dhënat (Faketa Avdiq, Merhamet, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Doboj, BeH, 3 tetor 2009.)

KOMRA duhet t'i regjistrojë të gjithë të pësuarit, me emër e mbiemër dhe të dihet si kanë pësuar.

Mendoj se përfundimisht ka ardhur koha që pas 14 vjetësh, si në këto hapësira të Bosnjës e Hercegovinës ka pushuar lufta ... Të vijmë deri tek e vërteta, respektivisht që të gjitha viktimat të regjistrohen saktësisht me emër e mbiemër. Dhe mendoj se ky është rol i KOMRA -s. Nëse nuk mund të vijmë tek të dhënat e sakta mbi kryesit, të paktën mund të sigurojmë të dhënat kush dhe si ka pësuar (Llazar Blagojeviq, Organizata e Luftëtarëve të Republikës Serpska, Këshilli në Shamac, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Doboj, BeH, 3 tetor 2009.)

Ne si (...) njerëz serioz bartim përgjegjësi historike për t'i regjistruar viktimat dhe të dimë saktësisht kush është ai dhe në kohën e sotme njerëzit të cilët e drejtojnë këtë vend, jo vetëm të pretendojnë ta drejtojnë, veç vërtetë ta drejtojnë dhe të paraqesin rrugëdalje pa vërtetimin e fakteve flasin mbi viktimat dhe për këta e ata numra, varësisht si u konvenon kjo. (Llazar Blagojeviq, Organizata e Luftëtarëve të Republikës Serpska, Këshilli në Shamac, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Doboj, BeH, 3 tetor 2009.)

Që të vendoset mirëbesimi dhe pajtimi nevojitet që secili t'i dënojë veprat e këqija që i kanë kryer pjesëtarë e bashkësisë së tij.

Doktor Ruzmir Jusufiq dhe bashkëshortja e tij (...) kanë mbetur tërë kohën në Shamac, ku ka qenë pushteti serb dhe e di se kanë përjetuar momente të vështira, si dhe doktor Hasan Izetbegović. Ai tek pas përfundimit të luftës ka shkuar në Sarajevë. Jam i gatshëm të flas për padrejtësitë që u janë bërë atyre. Por derisa nuk vijmë në situatë që secili ta gjykojë kryesit e vepër së keqe (...) nga rrethi i vet, nga populli i vet, nuk do të arrihet besimi midis nesh. Derisa ne ata që kanë krye vepra të tilla të këqija i konsiderojmë nga ana jonë se janë trima heronj, e kështu me radhë, e në realitet kanë pasur sjellje jonjerëzore, këtu nuk ka as mirëbesim as pajtim. (Llazar Blagojeviq, Organizata e Luftëtarëve të Republikës Serpska, Këshilli në Shamac, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Doboj, BeH, 3 tetor 2009.)

Personat që do të punojnë në komision duhet të fitojnë besimin e viktimave, që viktimat të jetë të hapura.

Kush do të punojë në komision ...Nuk di nga kush varet krejt. Por ata njerëz që do të punojnë duhet të kenë besim edhe tek ato viktimat që ajo vërtetë të hapet dhe të thotë. (...) Kanë ardhur shumë misionar të ndryshëm, ashtu të them, edhe gazetarë dhe gjithçka dhe kanë dhënë deklaratat e veta por nuk kanë përjetuar ndonjë kënaqje dhe ngadalë po mbyllet, po e humbin shpresën, po e humbin durimin se do të arrihet drejtësia. (Llazar Blagojeviq, Organizata e Luftëtarëve të Republikës Serpska, Këshilli në Shamac, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Doboj, BeH, 3 tetor 2009.)

Viktimave u pengon qasja përzgjedhëse dhe KOMRA -n e shohin si “dritë në fund të tunelit.”

Dua të them se mua si viktimë më pengon qasja përzgjedhëse. Dhe këtë KOMRA e shoh si ndonjë dritë ... Hajt të themi në fund të tunelit, si orvatje që at ndryshojmë atë raport (...) Por, kjo për mua si viktimë është e vetmja shpresë. Unë evident po shoh se këto gjykata këtu nuk duan ta bëjnë këtë për arsye politike apo diç tjetër. (Vllado Dragojloviq, Shoqata e kampistëve dhe robërve të luftës, Modriçë, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Doboj, BeH, 3 tetor 2009.)

Viktimave nuk u duhet pasqyra mbi luftën në BeH, veç drejtësia dhe kënaqja

Viktimave nuk u duhet pasqyra mbi luftën në Bosnjë e Hercegovinë. Atyre u nevojitet drejtësia dhe kënaqja. (Vllado Dragojloviq, Shoqata e kampistëve dhe robërve të luftës, Modriçë, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Doboj, BeH, 3 tetor 2009.)

Mediat në BeH po e shfrytëzojnë gjuhën e urrejtjes.

Fatkeqësisht, gjatë një viti të fundit kemi rënie drastike të etikës së raportimeve edhe në shtyp edhe në mediat elektronike, sidomos në shtyp dhe kundër kthimit të kësaj gjuhës së urrejtjes duhet luftuar. (Ljiljana Zurovac, Këshilli për shtyp i BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Doboj, BeH, tetor 2009.)

Mediat duhet “bombarduar” me informacione që të raportojnë mbi konsultimet.

Nga organizatat tuaja duhet të bombardohen mediat me informacione. Domethënë, ose me thirrje për

tubim të këtyllë ose me dërgimin e kumtesave nga tubimet tuaja apo pas përfundimit të aktiviteteve në medie. Edhe sot pas këtij tubimi, të dërgohen disa fjali çka është thënë, ku është thënë, agjencive të lajmeve dhe mediave. Kjo është shumë e rëndësishme. Nuk mund të presim vazhdimisht që mediat të vijnë tek ne për të mësuar. (Ljiljana Zurovac, Këshilli për shtyp i BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Doboj, BeH, tetor 2009.)

Ekipet hulumtuese duhet të punojnë në teren, duhet të shkojnë në çdo katund, në çdo shtëpi dhe duhet hulumtuar kush kë e ka humbur.

Tek formimi i këtij komisioni mendoj se duhet imtësuar në mënyrë që të shkohet në secilin katund, në çdo shtëpi që të hulumtohet dhe të thuhet se kush kë e ka humbur dhe ti prezantohet një komisioni qendror e cila do t'i paraqiste, veç nëse duhet komisionit rajonal i cili do të formohet (Reuf Mustajbashiq, Shoqata e pensionistëve të kthyer në Doboj, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Doboj, BeH, tetor 2009.)

Se duhet të kemi disa zyra është e saktë, dhe rekomandimi im do të ishte që asnjë nga ato zyra të mos jetë as në Banja Llukë as në Sarajevë (...) mendoj se është shumë e dobishme dhe më lehtë të punohet nëse jemi në teren dhe në vendet në të vogla, madje qoftë se zyra qendrore do të jetë në ndonjë vend të vogël (Snezhana Sheshlija, Shoqata ToPeeR, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Doboj, BeH, tetor 2009.)

Zyrat e KOMRA-s në BeH nuk duhet të jenë në Banja Llukë dhe në Sarajevë, veç se duhet përzier nga vendi në vend.

Nuk do të ishte mirë të formojmë dy zyra në Sarajevë dhe në Banja Llukë, sepse në momentin e njëjtë do të ndahemi (...) mendoj se nëse ekziston mundësia, këtë iniciativë lypset duhet transferuar edhe nëpër qytete veç e veç. (Snezhana Sheshlija, Shoqata ToPeeR, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Doboj, BeH, tetor 2009.)

Mbledhja e nënshkrimeve duhet të shoqërohet me sqarimin e iniciativës KOMRA, ndryshe nuk do të ketë ndikim në pushtetin.

Nuk është çështje e grumbullimit të një milion nënshkrimeve. Kjo mund të bëhet lehtë (...) Mendoj se mbledhja e nënshkrimeve pa iniciativë të mirëfilltë dhe pa kuptimin real çka është ajo që duhet, nuk do të jetë e dobishme, nuk do të mund të ndikojmë direkt

në organet e pushtetit. (Snezhana Sheshlija, Shoqata ToPeeR, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Doboj, BeH, tetor 2009.)

Viktimat kanë interes që të vërtetohet e vërteta, e që përgjegjësit të dënohen dhe të marrin kënaqje me anë të reparacionit.

Interesi i vetëm i viktimës është që të atë arrijë tek e vërteta, ta përjetojë kënaqje me anë të reparacionit, me anë të dëmit material, me anë të përgjegjësisë së atyre që i kanë burgosur dhe në fund të arrihet e vërteta se çfarë ka ndodhur në realitet në këto hapësira. (Shaban Ibrahimović, Shoqata e kampistëve tël Kantonit Zenicë-Doboj, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Doboj, BeH, tetor 2009.)

Konsultimet kombëtare me organizatat e grave, politikanet, artistet, gazetaret mbi formimin e KOMRA-s

**Beograd, Serbi
9 tetor 2009.**

Konsultimet kombëtare me organizatat e grave, politikanet, artistet dhe gazetaret në Serbi i kanë organizuar Gratë në të Zeza. Në tubim kanë qenë 69 pjesëmarrëse, në mesin e të cilave edhe veprimtarët e organizatave për ndihmë viktimave nga Serbia, anëtare të familjeve të viktimave, si dhe anëtarët e rrjetit ndërkombëtar Gratë në të Zeza nga rajoni (BeH, Kroacia, Mali i Zi) nga Lindja e Afërt (Izraeli, Palestina), Guatemala dhe Suedia.

Fjalën e hyrjes e kanë mbajtur Natasha Kandiq (Fondi për të Drejtën Humanitare, Beograd, Serbi) dhe Marijana Toma, Impunity Watch (zyra në Beograd), kurse tubimin e ka moderuar Stasha Zajević, Gratë në të Zeza. Mbi tubimin ka raportuar “e – novine”.

Mendimet, propozimet dhe Rekomandimet e pjesëmarrëseve.

Nuk ka konfirmim të vërtetës dhe të përgjegjësisë as pajtim derisa nuk shikohen shkaqet dhe pasojat.

Por nëse arrijmë deri tek e vërteta dhe nëse formohet Komisioni Rajonal mbi të vërtetën, e vërteta nuk është baras me faktin. Domethënë, faktet e renditura pa ndonjë kontekst nuk do të thonë asgjë, por konteksti është ai i cili e sqaron si ka ardhur deri

tek ngjarja e caktuar dhe si është viktimja e gjenocidit në Srebrenicë viktimë, dhe si është viktimja e bombardimeve të NATO-s viktimë. Ja këtu qëndron çështja, pra nuk ka konfirmim të së vërtetës dhe të përgjegjësisë as pajtim në rajon derisa nuk shikohen shkaqet dhe pasojat. (Biljana Kovačević Vučo, YUCOM, Beograd, Serbi, Konsultimet kombëtare sa organizatat e grave, politikanet, artistet, gazetaret, Beograd, Serbi, 9 tetor 2009.)

Kryesore është të vërtetohen faktet e ato i pasqyrojnë kontekstin dhe shkaqet.

... qëndrimi im personal është se duhet të nisemi nga faktet, pasi që vërtetimi i shkaqeve, (kjo nuk mund të ndahet), kur i vërtetojmë shkaqet, paraqitet konteksti i caktuar dhe shkojmë në drejtim të vërtetimit të shkakut. Por disi mendoj se është më qenësore të nisemi mu nga ajo çfarë ka ndodhur, ku ka ndodhur, kush ka qenë aty... domethënë disa nga këto gjërat. Kur i shikojmë përvojat e të gjithëve në këto hapësira, është fakt se askund nuk janë vërtetuar faktet, dhe pikërisht kjo ka krijuar hapësirë për mitologjizim dhe lecitim me viktimat. Nisur nga kjo, ndonëse kjo vepron si minimale por fare nuk është këtu, disi e krijojmë hapësirën për tu pasqyruar edhe konteksti dhe të arrijmë tek ajo përse ka ndodhur diçka në këto hapësira. (Marijana Stojčić, Gratë në të Zeza, Beograd, Serbi, Konsultimet kombëtare sa organizatat e grave, politikanet, artistet, gazetaret, Beograd, Serbi, 9 tetor 2009.)

Memoriet individuale dhe dëshmimet publike mund të kenë rëndësi vendimtare në krijimin e politikave të reja të identitetit të shoqërive ballkanike.

Në këtë kuptim mua më duket se insistimi në faktin e saktë dhe memorien individuale, në rastin individual që për ne është dhimbshme ta dëgjojmë, është shumë me rëndësi. Kur foli nëna Mejra, kjo është shumë me rëndësi të dëgjohet, kjo është më rëndë të dëgjohet dhe është shumë më e ndjeshme të dëgjosh historinë personale se sa arsyetimin teorik të shkakut, pasojave, një mijë, një milion, atëherë ato shifra pushojnë të kenë çfarëdo rëndësie. Ashtu që më duket se regjistrimi i memorieve individuale, dëshmimet publike pa ndërprerje, mund të kenë rëndësi vendimtare në krijimin e një baze të re për zhvillimin e identitetit të gjithë shoqërive ballkanike. (Milena Dragiqević Sheshiq, Fakulteti i Arteve Dramatike, Beograd, Serbi, Konsultimet kombëtare sa organizatat e grave, politikanet, artistet, gazetaret, Beograd, Serbi, 9 tetor 2009.)

KOMRA duhet ti shfrytëzojë kualifikimet juridike të krimit.

Në konfliktet tona, në luftëra, ato shkelje drastike kanë qenë gjenocid, spastrim etnik dhe krim kundër njerëzimit. Mendoj se është shumë me rëndësi që KOMRA të mbetet në atë kualifikimin juridik. Kjo na jep legjitimitet dhe peshë të veçantë, sepse këto janë krime të cilat jo vetëm që janë të përfshirë me të drejtën humanitare ndërkombëtare, por këto vërtetë janë krime të veçanta dhe kujtoj se është shumë e rëndësishme që ajo platformë juridike në KOMRA të mbetet në ato korniza. (Dragana Duliq, Fakulteti i Sigurisë, Beograd, Serbi, Konsultimet kombëtare sa organizatat e grave, politikanet, artistet, gazetaret, Beograd, Serbi, 9 tetor 2009.)

Pavarësisht kush do të jenë anëtarë të Komisionit, kjo nuk do të pengojë që të mblidhen fakte të fuqishme të cilat do tu ofrojnë mundësi historianëve të ardhshëm koje që ta përshkruajnë çfarë ka ndodhur në hapësirën e ish RSFJ.

Ajo për të cilën folët rreth asaj se kush i zgjedh anëtarët e Komisionit, kush do ti propozojë, kush do të jenë ata njerëz, çfarë do të jetë integriteti tyre etikë, më duket se nuk do të mund ta pengojë që megjithatë korpusi i fuqishëm i fakteve të mblidhet dhe historianëve e teoricienëve të ardhshëm tu ofrohet mundësia që realisht ta përpunojnë, të gjenden fjalë të mirëfillta, që të përshkruhet ajo që ka ndodhur në këto territore dhe të gjenden terma adekuate se që janë këta juridik me të cilët po shërbehem tash. (Milena Dragiqeviq Sheshiq, Fakulteti i Arteve Dramatike, Beograd, Serbi, Konsultimet kombëtare sa organizatat e grave, politikanet, artistet, gazetaret, Beograd, Serbi, 9 tetor 2009.)

Nënat e fëmijëve të vrarë nuk mund të pranojnë që kriminelët të amnistohen. Kriminelët duhet të përkufizohen nga viktimat.

(...) U bë fjalë për amnistinë, por vetëm të pyes, nëse u është vra fëmija, femër e përdhunuar e munduar dhe e vrarë, ose djali- s'është me rëndësi, a do të lijos hit ju menjëherë amnisti? Këtë nuk mund ta bëjmë ashtu thjeshtë, këtë duhet ta përkufizojmë. (...) ta përkufizojmë kriminelin dhe dënimin. Domethënë, viktimat (...) fëmijët tanë që janë vrarë, nënat, baballarët, s'ka rëndësi nga cila anë.. Shihni kjo duket (e kundërt) se këta janë kriminel, e këto viktimat. (Mejra Dautoviq, Gratë Grave, Bihaq, BiH, Konsultimet kombëtare sa organizatat e grave, politikanet, artistet, gazetaret, Beograd, Serbi, 9 tetor 2009.)

KOMRA duhet të merret me përgjegjësinë e kishës dhe të institucioneve tjera.

Mandati (...) konsideroj se nuk duhet të jetë i kufizuar për veprim vetëm në individët, por edhe në institucione. Individët janë kryes (ekzekutor) dhe këto janë vetëm figura të shahut në tërë sistemin.(...) A mundet KOMRA në kohë të afërme, pas paraqitjes së fakteve, ta ngre edhe çështjen e rolit të institucioneve. Historia do të ishte boshe nëse do të mbeteshin vetëm individët që kanë krye krime, nëse prapa kësaj nuk shihet qartë frymëzimi i gjithë kësaj. Kuptohet edhe roli i kishës edhe i arsimit, të gjitha aspektet e shoqërisë tonë. Nuk ekziston vend bosh në sistemin tonë shoqëror i cili nuk ka pasur rol në nxitjen e luftës dhe të urrejtjes luftarake. (Nevena Kostiq, Gratë për Paqe, Leskovc, Serbi, Konsultimet kombëtare sa organizatat e grave, politikanet, artistet, gazetaret, Beograd, Serbi, 9 tetor 2009.)

Komisioni duhet ta bëjë regjistrimin e të gjitha viktimave, përfshirë edhe ushtarët të cilët pushteti në Serbi i trajton si vetëvrasës.

Pra duhet renditur të vrarët, të zhdukurit, kriminelët dhe numrin madh të djelmoshave që janë në kryerjen e shërbimit ushtarak (që konsiderohen vetëvrasës) e ata në realitet vetëm janë vrarë në mënyra të ndryshme. Mendoj se madje ekziston edhe një regjistër prej afër dyzet nga ata dhe duhet dalë hapur me këtë. Duhet të hartohet lista e viktimave. (...) Dhe fajtor kryesor për gjithë këtë është kreu i pushtetit prej Millosheviqit dhe miqve të tij edhe kreu ushtarak, ushtria e cila edhe më tutje po i ruan fshehtësitë nga të gjithë ne këtu dhe po i fsheh kriminelët.. (Zhanka Stojanoviq nga Beogradi, nëna e punëtorit të pësuar të RTS më 1999, Serbi, Konsultimet kombëtare sa organizatat e grave, politikanet, artistet, gazetaret, Beograd, Serbi, 9 tetor 2009.)

KOMRA mund të ndihmojë të ndërtohet kultura e respektimit të viktimave tjera dhe që viktimat civile të marrin reparacion të drejtë.

Memorialët ekzistojnë vetëm për viktimat e popullit shumicë. Ligjet, reparacionet më shumë anojnë nga ish luftëtarët se nga viktimat civil. Secili shtet i krijuar nga ish Jugosllavia ka zgjidhjet e veta për shkëlqen e të drejtave të njeriut, por nevojitet edhe përgjigje unike rajonale. Unë e shoh në formën e KOMRA. (Tamara Kaliterna, Gratë në të Zeza, Beograd, Serbi, Konsultimet kombëtare sa organizatat e grave, politikanet, artistet, gazetaret, Beograd, Serbi, 9 tetor 2009.)

Me viktimat duhet të punohet me kujdes dhe me

ndihmën e ekspertëve nga disiplinat e ndryshme.

...kur jetojmë në këtë sasi të fatkeqësisë nuk di as si mund ti qasemi e të mos kihet mbështetje e madhe ... aty duhet të inkua drohen shumë psikologë, shumë psikiatër. Dhe (...) aty duhet të jetë një kanal që do të ishte në gjithë televizionet në kohën e caktuar i cili do të tregonte ato dëshmime të atyre grave, viktimave, atyre familjeve të cilat kanë përjetuar përdhunime të ndryshme, dhe të gjitha krimet e mundshme që pak të mësohen (...). Së dyti, sasi e madhe e ekspertëve (nevojitet) nga ata gjyqësisë, psikiatrisë, mjekësisë, psikologjisë, sepse këto të gjitha janë gjëra traumatike. (Mensura Lula Mikijeli, Konsultimet kombëtare sa organizatat e grave, politikanet, artistet, gazetaret, Beograd, Serbi, 9 tetor 2009.)

Për suksesin e KOMRA është e domosdoshme strategjia serioze mediatike.

Unë dua ta tërheq vëmendjen në një dimension të rëndësishëm për suksesin e projektit për të cilin është MOMRA, e kjo është strategjia e marketingut dhe mediatike. Do të ishte e domosdoshme që një asociacion i cili do të merrej me kriminelët e luftës dhe viktimat e luftës të arrijë sukses të konsiderueshëm, aq më parë që ky asociacion i cili në njëfarë mënyre është mbi-shtetëror dhe që duhet ta bëjë një punë themelore, e kjo është evidencimi i viktimave të luftës, dhe qëllimet e integritetit të viktimave. Prandaj, mendoj se tash do të duhej të hartohet një strategji serioze mediatike. (Nastasja Radović, gazeta mujore Republika, Serbi, Konsultimet kombëtare sa organizatat e grave, politikanet, artistet, gazetaret, Beograd, Serbi, 9 tetor 2009.)

Dëshmimi i viktimave do të ketë ndikim në qoftë se ato i emetojnë të gjitha televizionet në kohën e caktuar. Viktimat duhet të njoftohen si do të shfrytëzohen deklaratat e tyre.

(...) duhet të ekzistojë një kanal ose në të gjitha televizionet të jetë kohë e caktuar të cilat do ti tregonin dëshmimet e atyre grave, të atyre viktimave, atyre familjeve, të atyre që kanë përjetuar përdhunime nga më të ndryshmet dhe të gjitha krimet e mundshme, që të mund të mësohen pak. (Lula Mikijeli nga Beogradi, Serbi, Konsultimet kombëtare sa organizatat e grave, politikanet, artistet, gazetaret, Beograd, Serbi, 9 tetor 2009.)

(...) si të sigurohet që viktimat pas dëshmimit mund të marrin pjesë në proces, që të mund ta kontrollojnë atë që e kanë ofruar me dëshmimin e vet. (...) si do të mund ta kontrollojnë dhe në çfarë mënyre, a do të jenë

sa duhet të njoftuara mbi atë si do të shfrytëzohen ato dëshmime, si do të marrin pjesë në procesin e mëtejshëm. (Ivana Vitas, Gratë në të Zeza, Beograd, Serbi, Konsultimet kombëtare sa organizatat e grave, politikanet, artistet, gazetaret, Beograd, Serbi, 9 tetor 2009.)

Organizatat joqeveritare dhe shoqatat e viktimave duhet me kohë të përgatisin planin për zbatimin e konkluzioneve të Komisionit. Zgjidhje më e mirë për këtë është puna kolektive gjatë formimit dhe punës së Komisionit, si dhe pas nxjerrjes së raportit.

(...) dua ta theksoj si gjë të rëndësishme punën kolektive, si në procesin i cili i paraprinë krijimit të Komisionit për të vërtetën, ashtu edhe gjatë punës së tij, e sidomos pas nxjerrjes së raportit dhe propozimit që do ti bënte komisioni. Në Guatemala pikërisht kjo ka dështuar. Nuk kemi pasur strategji të qartë çka të bëhet pas marrjes së raportit dhe çdo gjë mbeti në duart e shtetit i cili nuk kishte vullnet ta marrë përgjegjësinë. Është me rëndësi të madhe të ekzistojë plani për zbatimin e konkluzioneve të Komisionit. (Rosalina Tuyuc Velasquez, Congavina, Guatemala, Konsultimet kombëtare sa organizatat e grave, politikanet, artistet, gazetaret, Beograd, Serbi, 9 tetor 2009.)

Organizatat joqeveritare duhet ta zhvillojnë strategjinë për propozimin e anëtarëve. Do të ishte mirë që në të gjitha shtetet në rajon parlamentet ti zgjedhin anëtarët e Komisionit.

Duhet patjetër ta zhvillojmë strategjinë kur të vij momenti për propozim, kë do ta propozojmë. Kjo duhet të jetë e unifikuar. Mendoj se do të ishte shumë e rëndësishme që kudo në rajon këtë ta bëjnë ose parlamenti ose kryetari (i shtetit). Bie fjala do të ishte më thjeshtë të ndikohet nëse këtë e bënë kryetari... varet kush do të jetë në atë moment. Kujtoj se është tepër e rëndësishme të kemi qëndrim unik për mbarë rajonin, që propozimi të kalojë nëpër të gjitha parlamentet. Kjo është shumë më mirë. (Rada Borić, Qendra për Studime Femërore, Zagreb, Kroaci, Konsultimet kombëtare sa organizatat e grave, politikanet, artistet, gazetaret, Beograd, Serbi, 9 tetor 2009.)

Mandati i Komisionit të arrihet me kompromis, por shoqëria civile nuk duhet të frikësohet të ushtrojë trynë mbi shtetet që të formohet Komisioni në harmoni me iniciativën e shoqërisë civile.

Në rregullimin me ligj të mandateve zakonisht janë bërë kompromise të rënda. Shoqëria civile (...) del vetëm me një pjesë të propozimit për atë se si duhet

të duket ai Komision. E pastaj zakonisht vendos shteti, ai që e themelon vendos në fund. Shoqëria civile nuk duhet të frikësohet të ushtrojë tryzni mbi shtetin. (...) Atje ku është përpjekur shteti ta fitojë atë që e ka kërkuar shoqëria civile, është krijuar cirk i vërtetë (...) Shoqëria civile (mund) ti bartë edhe kontaktet me viktimat. (...) Por është me rëndësi që përshkrimi i viktimave, emrat e viktimave dhe përshkrimi kryesor i ngjarjes, janë fakte kryesore të cilat gjithsesi duhet të hyjnë në raport. (Marijana Toma, Impunity Watch, Beograd, Serbi, Konsultimet kombëtare sa organizatat e grave, politikanet, artistet, gazetaret, Beograd, Serbi, 9 tetor 2009.)

KOMRA duhet të merret me pësimin e romëve, për çka nuk ka të dhëna.

KOMRA po ashtu duhet të merret (...) me problemin e popullatës rome. Cila është përqindja e grave (rome) të dhunuara apo cila është përqindja e atyre grave të vrara, askush nuk e dinë. Vetëm e dimë se ajo është popullatë e cila në këto luftëra ka qenë më shumë e skajuar, e ka humbur popullatën, të mos flasim për gratë rurale. Ne tek e kemi nisur çështjen e grave rurale në Serbi (...) gruaja rurale kurrë nuk ka qenë e përfshirë, dhe prandaj mendoj se për suksesin e kësaj çështje është i rëndësishëm KOMRA (...) KOMRA duhet paralel në mjediset e secilit shtet anëtar të Koalicionit ti përcjellë dukuritë e tilla. (Sonja Prodanoviq, Gratë në të Zeza, Beograd, Serbi, Konsultimet kombëtare sa organizatat e grave, politikanet, artistet, gazetaret, Beograd, Serbi, 9 tetor 2009.)

Idetë e KOMRA-s janë racionale, por nuk janë të mjaftueshme për qasje feministe

(...) këto ide të KOMRA janë shumë racionale. Ato janë racionale, por nuk janë të mjaftueshme për kuptimin tim feminist. Domethënë këtë që e sqarova; njësoj është e rëndësishme që të kujdesemi njëri për tjetrin, sikur që është shumë me rëndësi e drejta, kjo njësoj është e rëndësishme. (Lepa Mlagjenoviq, Qendra Autonome e Grave, Beograd, Serbi, Konsultimet kombëtare sa organizatat e grave, politikanet, artistet, gazetaret, Beograd, Serbi, 9 tetor 2009.)

Konsultimet me bashkësinë lokale

**Cazin, Bosnja e Hercegovina
10 tetor 2009.**

Konsultimet i ka organizuar Shoqata "Prijedorçanki

Izvor" (Burimi i Prijedorit), Prijedor, BeH. Në tubim kanë qenë gjithsej 30 pjesëmarrës, përfaqësues të shoqatave të familjeve të të pagjeturve, shoqatave të kampistëve, shoqatave të të verbërve, të organizatave joqeveritare, të Qendrës për Punë Sociale, të gazetarëve dhe tjerë. Ligjërues kanë qenë Bogdan Ivanisheviq nga Qendra Ndërkombëtare për Drejtësinë në Tranzicion dhe Dragan Popoviq (Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi). Moderator ka qenë Vehid Shehiq (Forumi i qytetarëve të Tuzllës, BeH. RTRS, FTV i BHTV1 kanë raportuar nga konsultimet.

Propozimet, mendimet, Rekomandimet

Lidhja e kampistëve të BeH kërkon vizion të qartë të iniciativës dhe rolin e vetë në proces dhe në raport me KOMRA-n.

Lidhja e kampistëve të BeH (...) Çfarë është roli ynë? Çka duhet ne të kontribuojmë në këtë, respektivisht të mos kontribuojmë? Dhe në çfarë mënyre ne do ta bëjmë këtë? E atëherë ne jemi aty dhe atëherë ne do të marrim pjesë në këtë (...) ne po kërkojmë vizion të qartë, rolin tonë në gjithë këtë, konsiderohemi organizatë referente se mund të marrim pjesë në shumë çka, por duhet ta kemi pozicionin e qartë çka është ajo që duhet ta bëjmë, respektivisht cilat janë të drejtat, çka thonë, cilat janë detyrimet (Murat Tahirrovic, Lidhja e kampistëve të BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Cazin, BeH, 10 tetor 2009.)

Në BeH përpos Komisionit për Srebrenicën tjerët nuk kanë bërë asgjë. Ekziston dilema nëse KOMRA duhet të quhet komision apo megjithatë çdo gjë varët nga anëtarët e komisionit.

Njëri nga shtetarët moti pat thënë se nëse nuk doni që diçka të bëhet, formoni komisionin. (...) Druhem se edhe ne nuk do të arrijmë në një qorrsoak të ngjashëm, të paktën ta ndërrojmë emërtimin, që të mos quhet komisioni. Të gjithë e dinë faktin e gjithë njohur se asnjë komision kurrë dhe askund në asnjë fushë, gati nuk ka bërë asgjë. Këtu, në këtë broshurë kemi të cekuar një 4-5 komisione që janë formuar në këtë periudhë të pas luftës, prej Komisionit për Srebrenicën, për Sarajevën, Komisionit për rastin e Avdo Paliqit, Komisioni për Bijeljinën. Pra, vetëm ky Komision për Srebrenicën, nga të gjithë të cekur këtu, e ka kryer, të them, një pjesë të mirë të punës, por tek herën e dytë (...) Komisioni për Sarajevën kurrë nuk ka bërë asgjë. Komisioni për rastin e Avdo Paliqit nuk ka arritur kurrfarë rezultatesh. Komisioni për Bjelinën në veçanti. (Mirsad Duratoviq, Shoqata

e kampistëve Prijedori '92, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Cazin, BeH, 10 tetor 2009.)

Nuk kanë dështuar të gjitha ato komisionet e mëparshme për shkak që janë quajtur ashtu, por sepse në to kanë ndenjur ata të cilët nuk kanë qenë të aftë për t'i bartur. Dhe mu ky le të quhet KOMRA. Por në te të gjenden njerëzit që janë të aftë (Beha Shaqir, Qendra për Punë Sociale në Velika Kladus-ha, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Cazin, BeH, 10 tetor 2009.)

Koalicioni për KOMRA dhe shoqatat e viktimave duhet të luftojnë për të drejtën që të verifikojnë nominimin para se parlamenti ti emërojë anëtarët e komisionit.

Një propozim imi do të ishte që ndoshta të jepet rekomandimi me rastin e emërimit të anëtarëve të këtyre komisioneve se ato emëime nuk mund të kalojnë pa verifikim paraprak nga ana ... A e Këshillit drejtues të këtij Koalicioni, këtij KOMRA, të familjeve të viktimave ... Është e qartë se parlamentet duhet të miratojnë vendimin mbi formimin e komisioneve dhe t'i emërojnë ata anëtarët, por që emërimet të mos bëhen pa verifikim paraprak. (Mirsad Duratović, Shoqata e kampistëve Prijedori '92, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Cazin, BeH, 10 tetor 2009.)

Shumë viktimat ende nuk u kanë dhënë deklaratat prokurorive.

Kam folur personalisht me zotëri Barashanin (Milorad Barashanin, kryeprokuror i BeH). Kam biseduar vet me telefon dhe e kam lutur që ta dërgojë SIPA-n (Agjencia shtetërore për hetime dhe mbrojtje), sepse askush nga viti 1995 nuk ma ka dërguar mua në shtëpi SIPA (Agjencia shtetërore për hetime dhe mbrojtje) të marrin deklaratë dhe unë të them personalisht, sepse kam dosje bukur të trash për të folur mbi krimet e luftës. (Medo Grahović, kampist i kampit nën kontrollin e Mbrojtjes Popullore të Bosnjës Perëndimore, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Cazin, BeH, 10 tetor 2009.)

Anëtarë të Komisionit duhet të jenë viktimat, por edhe intelektualët dhe veprimtarët e organizatave që merren me tolerancë dhe pajtim midis bashkësive.

Mendoj se anëtarët e komisionit nuk mund t'i përbejnë vetëm shoqatat e viktimave. Ato gjithsesi janë të mirëseardhura dhe ato duhet të jenë numër 1.

Mirëpo, nëse do të mbetej vetëm në shoqatat e viktimave duhem se do të shndërrohej në diç ngjashëm me parlamentet shtetërore, qeveritë e shteteve. Pra, tri palë kundërshtarë dhe çështja kurrë s'ka fund. Për Komisionin është shumë e domosdoshme pjesëmarrja e qytetarëve akademik (...) gjithashtu mendoj se lypset inkadruar shoqatat të cilat nuk merren vetëm me viktimat, anëtarësia e të cilave nuk janë vetëm viktimat e krimit, veç shoqatat të cilat merren me proceset e vendosjes dhe të shtytjes së tolerancës, pajtimit (...) që komisionit t'i japin atë notë të pa anshmërisë. (Shefika Muratagić, Shoqata Ključ budućnosti (Çelësi i ardhmërisë), BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Cazin, BeH, 10 tetor 2009.)

Njëri nga qëllimet e komisionit duhet të jetë vendosja e tolerancës dhe e pajtimit midis bashkësive.

Njëri nga mandati i komisionit lypset të jetë që të kontribuojë edhe në procesin e pajtimit e të tolerancës (...) Disa nga ata të cilët, ja, me rregull marrin pjesë në këto tryeza të rrumbullakëta apo në këto ngjarje, kundërshtojnë që të përmendet pajtimi. Po mirë njerëz, a duhet të jetojmë 10 vjet si hordhitë e ngatërruara? Po a nuk është koha e fundit të mendojmë për fëmijët tanë në këto hapësira? (Shefika Muratagić, Shoqata Ključ budućnosti (Çelësi i ardhmërisë), BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Cazin, BeH, 10 tetor 2009.)

Në mandatin e komisionit nuk duhet të jetë dhënia e amnistisë. Ekziston dilema nëse KOMRA duhet ti propozojë gjykatës zvogëlimin e dënimit për të akuzuarit të cilët kanë dëshmuar para komisionit mbi krimet e kryera.

Mirëpo të lëshohet në atë që mandati të jetë amnistia, vërtetë mendoj se kjo nuk mund të jetë mandati i këtij komisioni. (Shefika Muratagić, Shoqata "Ključ budućnosti" (Çelësi i ardhmërisë), BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Cazin, BeH, 10 tetor 2009.)

Nuk është ashtu të amnistosh, por ja, kemi anuar kah hapësira e lehtësirës eventuale (...) që do të ishte me interes si vegël e përhershme apo instrument i punës cilësore të komisionit në zbulimin e të vërtetës (...) Kur flasim mbi ato lehtësira, nuk mendoj se ato mund të jenë një nga instrumentet me të sigurta, apo një nga instrumentet më të arsytueshme kur të japim lehtësinë dhe të vinin bile tek e vërteta. Unë ndonjëherë do ta shfrytëzoja edhe rrugën më legale

dhe më të tërthortë, por të mos amnistojë, që të mos e lehtësojë fajësinë. (Beha Shaqir, Qendra për Punë Sociale në Velika Kladusha, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Cazin, BeH, 10 tetor 2009.)

Gjithmonë kam qenë kundër amnistisë. Ne nuk po flasim këtu mbi krimin. Ne po flasim këtu mbi krimin e luftës (...) I cili kurrë nuk vjetrohët, dhe sigurisht secila gjykatë këtë do ta shfrytëzojë si rrethanë lehtësuese për dikë nëse ka kontribuar në diçka. Këtë e ka detyrim. Ashtu që kjo mund të ketë ndikim dhe duhet pa tjetër të ketë ndikim në lartësinë e dënimit. Nuk di nëse do të ishte mirë që komisioni me njëfarë autoriteti të vetin të thotë këtij duhet zvogëluar dënimin kaq e kaq, apo në vend të 10 t'i jepen shtatë vjet. Gjyqi, si organ, është i obligueshëm që këtë absolutisht ta marrë parasysh gjatë peshimit të lartësisë së dënimit. (Vehid Shehiq, Forumi i qytetarëve të Tuzlës, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Cazin, BeH, 10 tetor 2009.)

Mënyra tjetër është kjo që gjykatat, natyrisht në një mënyrë, më duhet të them, jo humane dhe ofenduese për viktimat në vet pazarllëkun i marrin informacionet nga njerëzit që kanë bërë krim (...) kjo, më duhet të them, është një tezgë (fitim shtojcë) morbide për shkak të asaj që kanë bërë në mënyrë që t'u zbutet dënimi. Në këtë kuptim, mënyrat e tilla personalisht nuk i mbështes. Konsideroj se gjykata duhet të marrë, sipas mendimit tim, aktgjykimin që është në përputhje me krimin e kryer. (Amir Taliq, gazetar, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Cazin, BeH, 10 tetor 2009.)

Komisioni duhet tu ndihmojë gjykatave në rajon të vijnë deri tek dëshmitarët.

E keni të njohur të gjithë se gjykatat e kanë vështirë të gjejnë dëshmitarë, sidomos dëshmitarë adekuat. Atë problem, e di unë, e ka edhe Gjykata e Bosnjës e Hercegovinës. Pra do të ishte shumë e rëndësishme që komisioni në këtë proces të vërtetimit të fakteve ta ndihmojë Gjykatën e Bosnjës e Hercegovinës të vij deri tek dëshmitë adekuate (...) Pajtohem që komisioni të merret me vërtetimin e fakteve dhe që ato fakte t'ia ofrojë Bosnjës e Hercegovinës, por vetëm faktet (...) Domethënë vetëm faktet e thata që ia del t'i vërtetojë, t'i ndihmojë Gjykatës së Bosnjës e Hercegovinës, ose gjykatave në rajon që më lehtë të vijnë tek e vërteta. (Shefika Muratagiq, Shoqata "Ključ budućnosti" (Çelësi i ardhmërisë), BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Cazin, BeH, 10 tetor 2009.)

Ekziston praktika që informacionet mbi varrezat masive të paguhen. Ka propozime të for-

mohen fondet publike për zbulimin e varrezave masive.

Të them kalimthi se bashkë me njërin nga hetuesit kam marrë pjesë në zbulimin e varrezës masive në Kevljane. Ajo është varreza më e madhe masive e zbuluar në territorin e Prijedorit. Ju them se vetëm për informacionin është dashur të përgatisim 300 KM (marka konvertibile) ... Domethënë, për 300 maraka ne kemi marrë informacionin dhe skicën ku e kemi lokalizuar varrezën masive (...) Pra, vetëm faktet se informacioni për varrezat masive mund të merret për para, flet mjaftë se duhet të krijohen fonde për zbulimin e varrezave masive dhe informacionet që mund të merren në teren. (Amir Taliq, gazetar, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Cazin, BeH, 10 tetor 2009.)

Dëshmia publike e viktimave do të na ndihmojë të mësojmë çka u ka ndodhur tjerëve.

Ne të gjithë këtu, veçmas këta nga Prijedor, por edhe këta njerëz përreth e dinë se çfarë ka ndodhur në Prijedor (...) Dhe unë thash herën e kaluar se gjumë gjëra, besoni, nuk i kam ditur derisa nuk nisa të vij këtu dhe t'i dëgjojë viktimat çka po flasin. E pash kur ky djaloshi i ri, ulur pranë meje, Sudbini, tregoj krejt çfarë i ka ndodhur atij. Dhe unë nuk di sa herë e kamë kthyer atë at CD dhe shikuar. Dhe, t'u them sinqerisht dëshmia e tij dhe gjithë ajo që tha, fatkeqësisht ai krejt e ka përjetuar atë, më jep shpresë se megjithatë do të mund të arrijmë deri tek e vërteta mbi gjithë atë që ka ndodhur (Zdravka Karlica, Organizata Republikane e familjeve të luftëtarëve të rrëmbyer e të vrarë dhe të civilëve të zhdukur të Republikës Serpska, Këshilli në Prijedor, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Cazin, BeH, 10 tetor 2009.)

KOMRA duhet të ketë të drejtë t'i ftojë përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare të dëshmojnë para komisionit. Kjo mund të kontribuojë në vërtetimin e kontekstit politik.

E kemi të vërtetën e bashkësisë ndërkombëtare e cila ka qenë dëshmitare e asaj që ka ndodhur. Me qëllim e përmenda bashkësinë ndërkombëtare. Sepse ajo, në hapësirën e ish RSFJ edhe ka qenë dëshmitare, e roli i secilit dëshmitar është që ta flas të vërtetën. Dhe nëse ata do të marrin pjesë në hetime nga KOMRA, ata ndoshta mund të kontribuojnë në vërtetimin e disa fakteve që janë shumë të qenësishme për kuptimin edhe të kontekstit historik edhe politik të asaj që ka ndodhur. (Amir Kulagiq nga Srebrenica, BeH,

Konsultimet me bashkësinë lokale, Cazin, BeH, 10 tetor 2009.)

Fakte janë datat, njerëzit, vendet – kjo kontribuon në njohurinë se krimet janë kryer mbi tjerët.

Pse është i rëndësishëm konfirmimi i fakteve, e jo e vërteta? Sepse në realitet faktet materiale e prekin njëfarë ndjenje tonën subjektive të së vërtetës. Por i kontribuojnë edhe njohurisë se edhe mbi tjerët janë bërë krime (...) Pra, është me rëndësi të konfirmohen faktet e jo e vërteta, sepse e vërteta është njëfarë ndjenje subjektive, kurse faktet janë materiale (...) Këta janë emrat e njerëzve. Këto janë vendet. Këto janë datat (Amir Kulagliq nga Srebrenica, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Cazin, BeH, 10 tetor 2009.)

Komisioni duhet të verifikojë të dhënat mbi viktimat që i kanë shoqatat e viktimave dhe organizatat joqeveritare.

Zotëri Tahiroviqi (kryetar i Lidhjes së kampistëve të BeH) tha se edhe me anë të punës së shoqatës së tij ai veç i ka pa varrezat masive, vende të varrezave masive, të llogoreve e kështu me radhë, atëherë ky komision do të duhej që me anë të një procesi hetues t'i verifikojë ato, e ngjashëm. Nëse IDC (Qendra Hulumtuese Dokumentare, Sarajevë] e vërteton regjistrin, nëse burimi (Shoqata e femrave të Prijedorit] e vërteton regjistrin e të zhdukurve, domethënë ky komision duhet këtë ta verifikojë. (Amir Kulagliq nga Srebrenica, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Cazin, BeH, 10 tetor 2009.)

Lypset të pushohet të flitet mbi viktimën “tonë” e të “atyre”: nocionin e viktimës duhet transferuar nga fusha politike në atë etike.

Nëpërmjet kësaj duhet ndërtuar organizata dhe komunikime të tilla. (...) Është e mundshme të arrihet konsensusi për afërsisht mbi viktimën.. Që mbi viktimën të mos flitet vetëm për viktimën tonë dhe të tyre, por që kjo urë të kapërcehet, të fillohet të flitet ... Që nocioni i viktimës të transferohet nga nocioni ideologjik e politik në atë etik e profesional.. (Besad Haxhiq, psikiatër nga Kljuç, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Cazin, BeH, 10 tetor 2009.)

Në përzgjedhjen e anëtarëve të komisionit përparësi duhet të kenë profesioni dhe morali.

Sepse me siguri sapo të nis kjo (KOMRA), ajo që me siguri do ta bëjë politika është t'i fus njerëzit vet. Është shumë vështirë të jesh apolitik, është shumë

vështirë të jesh liberal dhe të flasësh për diçka. Ky veç është guxim. Këtu kur jeni normal kjo veç është guxim. T'ju them diçka. Shikojeni. Njerëzit që punojnë gjatë kohë me viktimat, e nëse nuk kanë super- kontroll dhe debriefing edhe vet pak kontaminohen dhe nisin t'i mendojnë me paradigma, pra me paradigmat si edhe viktimat. Shfaqni kujdes që të keni bukur më shumë profesion dhe moral. (Besad Haxhiq, psikiatër nga Kljuç, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Cazin, BeH, 10 tetor 2009.)

Bashkësitë fetare kanë përhapur armiqtësi midis komuniteteve në BeH

Edhe bashkësitë fetare që janë një segment i qenësishëm, po ashtu kanë ushtruar mos-durim nacional sidomos kur është fjala për Bosnjën e Hercegovinën. (Safet Muratović, “Ključ budućnosti” (Çelësi i ardhmërisë), BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Cazin, BeH, 10 tetor 2009.)

Numri i komisarëve duhet të jetë midis 20 e 25. Numri i komisarëve nga secili shtet duhet të jetë në harmoni me numrin viktimave.

Numri nuk duhet të jetë tepër i madh. Por nuk guxon të jetë as tepër i vogël. Unë për shembull jam për 20 deri 25 komisarë në përbërje të atij Komisioni. Por jo proporcionalisht, numri i njëjtë nga Mali i Zi, Serbia, Kosova, Bosnja, Kroacia, veç sipas numrit të viktimave (...) Nuk mund të ketë numër të njëjtë në KOMRA të Malit të Zi i cili ka numër shumë të vogël të viktimave në raport me Bosnjën e Hercegovinën (Amir Kulagliq nga Srebrenica, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Cazin, BeH, 10 tetor 2009.)

Komisioni rajonal lypset të ketë zyra në të gjitha shtetet në rajon, të cilave në grumbullimin e deklarave të viktimave dhe të dëshmitarëve do t'u ndihmojnë organizatat joqeveritare.

Të jetë Komisioni rajonal i cili do të ishte një trup rajonal, por duhet të jenë zyrat e shtetit të cilat do t'i japin një mbështetje cilësore kësaj. E kur e them këtë, atëherë prapë është shumë thelbësore sektori qeveritar dhe organizatat e shoqatave të jenë shërbim (servis) dhe mbështetje e kësaj zyre kombëtare, shtetërore në sigurimin e viktimave, deklaratat e viktimave, të provave materiale, dokumenteve e kështu me radhë. (Amir Kulagliq nga Srebrenica, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Cazin, BeH, 10 tetor 2009.)

Komisioni duhet të merret me vrasjet, përndjekjet, përdhunimet, mundimet nëpër kampe.

Këtu u përmenden krimet e luftës dhe shkelje tjera të rënda të drejtave të njeriut. Por cilat janë në të vërtetë ato shkeljet tjera, apo kush janë ato ... Po para se gjithash vrasjet. Së dyti, janë përndjekjet. Së treti, përdhunimet. Së katërti, janë viktimat e terrorit në llogore. (Amir Kulagliq nga Srebrenica, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Cazin, BeH, 10 tetor 2009.)

Raporti i KOMRA duhet të ketë kontekst historik (përgatitja e krimit), listën e vendeve të pësimimit dhe regjistrimin e viktimave.

Raporti që do ta hartonte ky Komision, sipas mendimit tim, duhet të ketë tri segmente (...) segmenti i parë duhet të jetë konteksti politiko-historik si një bazament. E në atë kontekstin politiko-historik lypset ta vëzhgojmë rolin e bashkësive fetare, të mediave e kështu me radhë. Sepse ato janë, kjo i ka paraprijë kryerjes së krimeve. Kjo ka qenë përgatitja. (...) Segmenti i dytë i tij raporti duhet të jetë, do të thosha, metodat dhe formularët e kryerjes së krimit. Domethënë vendet e pësimimit (...) Dhe i treti është regjistrimi i viktimave. (Amir Kulagliq nga Srebrenica, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Cazin, BeH, 10 tetor 2009.)

Në konsultime duhet inkuadruar qendrat për punë sociale, sepse viktimat dhe invalidët e luftës të drejtat e veta po i realizojnë nëpërmjet këtyre institucioneve.

Shfrytëzuesit tanë janë viktimat. Viktimat civile të luftës, invalidët e jo luftës, nëpërmjet qendrave të realizojnë të drejtat e veta dhe mendova të propozoj që një takim i këtillë, respektivisht një debat i tillë të mbahet me drejtorët e qendrave apo përfaqësuesit e qendrave, por jo vetëm, veç me përfaqësuesit e ministrave nga vijën e mjetet, ngase ne po luftojmë për viktimat, gjegjësisht për të ardhurat e tyre që i realizojnë në Qendrën për Punë Sociale. E shpesh kjo po politizohet. (Beha Shaqir, Qendra për Punë Sociale në Velika Klladusha, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Cazin, BeH, 10 tetor 2009.)

E vërteta na duhet për shkak të arsimimit dhe nevojës që të shkruhet historia në harmoni me faktet.

Janë bërë sakat fëmijët tanë nëpër shkolla, sepse ne nuk kemi libra mësimi, e Zoti e di se kur do t'i kemi në këtë mënyrë. Duhet të arrijmë deri tek e vërteta, t'i bashkojmë ato të vërteta që ne serish të caktojmë një grup ekspertësh për t'i përgatitur librat e mësimi,

respektivisht ta shkruaj historinë. Kur do të ndodh kjo, është pyetje e madhe. (Beha Shaqir, Qendra për Punë Sociale në Velika Klladusha, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Cazin, BeH, 10 tetor 2009.)

KOMRA duhet t'ua kthejë besimin viktimave se fjalët dhe deklaratat e tyre do të shfrytëzohen për diçka.

Njerëzit nuk duan të flasin (...) Është shumë vështirë ta fitosh besimin e viktimës që të flas mbi të vetën (...) ... Sepse vet është viktimë. Unë e di çka donë të thotë ta flasësh të vërtetën. E dini? Sepse ju sa herë që kaloni nëpër atë të vërtetë, ju e përjetoni atë ngjarje (...) Thjeshtë, me dhënien e atyre deklaratave të shumta rraskapitëse, me përsëritjen e atyre ngjarjeve personale, njerëzit pak edhe humbasin dhe atëherë thonë „përse këtë“ (...) Dhe njerëzit heqin dorë nga kjo. Unë mendoj se kjo organizatë ndoshta do të jetë orientues apo rrugë e drejtë që njerëzve, para se gjithash, t'u jepet besimi se deklaratat e tyre do të shërbejnë për diçka (Bernada Jukiq-Kličiq, Qendra për Punë Sociale në Bosanski Petrovc, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Cazin, BeH, 10 tetor 2009.)

Konsultimet kombëtare me besimtarët dhe bashkësitë fetare mbi Iniciativën për formimin e KOMRA-s

**Zagreb, Kroaci
16 tetor 2009.**

Konsultimet kombëtare me besimtarët dhe bashkësitë fetare i kanë organizuar Qendra për paqe, jo dhunë dhe të drejta të njeriut në Osijek (Kroaci) dhe organizata Documenta Zagreb (Kroaci). Kanë marrë pjesë gjithsej 47 veta, besimtarë dhe përfaqësues të bashkësive fetare, të shoqatave joqeveritare për të drejtat e njeriut, të gazetarëve dhe vëzhgues nga OSBE, Gjykata e Hagës, Delegacioni i Komisionit Evropian në Kroaci dhe të ambasadave të Australisë, Holandës dhe Kanadasë. Ligjërues kanë qenë ipeshkvi Kevin Dowling (ipeshkvi nga Rustenburg, Republika Jug-afrikane), Vesna Tershić (Documenta, Kroaci), Natasha Kandić (Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi) dhe Ivan Novosell (Legalis, Kroaci). Moderator ka qenë Katarina Kruhonja (Qendra për paqe, jo dhunë dhe të drejta të njeriut, Osijek). Mbi konsultimet kanë raportuar Televizioni kroat (HRT), Novi list, javorja Novosti dhe H-alter.

Propozimet, mendimet dhe Rekomandimet e pjesëmarrësve

Të krishterët duhet të vihen në anën e viktimës. Viktimat mund ti lëvizin shoqëritë për shërim dhe tu ndihmojnë në ndalimin e të keqes.

Këtu jam për faktin që si françeskan, si i krishterë, konsideroj se është më se e nevojshme të vihem në anën e viktimës. Ne fatkeqësisht kemi viktimat dhe ato nuk janë të dëshiruara, por veç kur i kemi, mendoj se (...) Ata janë njerëz më të çmueshëm. Sepse vetëm ata njerëz mund ti lëvizin bashkësitë tona dhe shoqërinë tonë përpara në marrëdhënie të reja, në një shërim, një pastrim të memories tonë (...) E ne jemi këtu për t'ju ndihmuar. Domethënë, të krijojmë një ambient më të volitshëm që viktimat të mund ta bartin me dinjitet hallin e vet, e pastaj të arrijnë atë që është qëllim kryesor i të krishterëve (...) e kjo është që në një vend, në lirinë e zgjedhjes së një njeriut, të ndalët spiralja e dhunës. (Fra Mijo Xholan, Instituti Françeskan për Kulturën e Paqes, Split, Kroaci, Konsultimet kombëtare me besimtarët dhe bashkësitë fetare, 16 tetor 2009.)

Qasja rajonale e mundëson largimin nga interpretimet të cilat e çimentojnë zgjidhjet ekzistuese politike me të cilat njerëzit nuk janë të kënaqur.

Shikoni atë problem tonin me famë e të qëndrueshëm të qasjes rajonale, unë konsideroj se të gjithë këtu duhet të jemi sa duhet guximtar dhe sa duhet të mençur në këtë proces (...) se do të ishte mirë të shmangemi që ky proces fare ti afrohet interpretimit se ky është çimentim i do farë zgjidhjeve ekzistuese politike. Kjo së pari do të na diskualifikojë neve, së dyti do të fitojë bukur shumë njerëz, sepse tepër shumë njerëz ka që nuk janë të kënaqur me zgjidhjen ekzistuese politike (...) Ka shumë njerëz të cilët me këtë nuk janë të kënaqur. (Fra Mijo Xholan, Instituti Françeskan për Kulturën e Paqes, Split, Kroaci, Konsultimet kombëtare me besimtarët dhe bashkësitë fetare, 16 tetor 2009.)

Për bashkësitë fetare dhe besimtarët qëllimi është pajtimi pro përpara nesh gjenden frytet e varfria të kësaj detyre.

Bashkësitë fetare në hapësirën e ish Jugosllavisë (...) ende nuk kanë vesh për iniciative të këtilla. I frikësohen asaj që të gjithë ato projekte që i kalojnë kufijtë e '94, kur papa ishte këtu në Zagreb, Gjon Pali i Dytë i ndërë, vuri para të gjithë besimtarëve detyrën e

pajtimin si detyrë parësore, pra detyrën e ekumenizmit dhe të pajtimin, kjo ka qenë detyrë jona e parë. Pesëmbëdhjetë vjet më pas kësaj kemi fryte të zymta të asaj pune. (Drago Pilsel, Novi list, Zagreb, Kroacia, Konsultimet kombëtare me besimtarët dhe bashkësitë fetare, 16 tetor 2009.)

Para propozimit mbi pajtimin duhet të vërtetohen faktet për atë se kush e ka nisur luftën, përse është zhvilluar lufta dhe cili ka qenë qëllimi i saj.

Do të duhet që para fillimit të atij dialogu (mbi pajtimin) seriozisht të spastrohet kush e ka nisur luftën, përse është zhvilluar lufta dhe cili ka qenë qëllimi i saj. Por kjo duhet të arrihet me fakte deri tek e vërteta. (Ante Shola, CARITAS Dioqeza Varazhdinit, Kroaci, Konsultimet kombëtare me besimtarët dhe bashkësitë fetare, 16 tetor 2009.)

Kishat dhe bashkësitë kishtare kanë ndikim vendimtar në procesin e pajtimin.

Si mund të bëhesh Zot, ose si mund të bëhesh zot i dashurisë, nëse kjo më ka ndodhur mua?" Këtu kishat dhe bashkësitë kishtare janë plotësisht vendimtare për qëndrim para shoqërisë sipas të cilit pajtimi është proces i përgjithshëm holistik i cili i përfshinë dimensionet fizike, emocionale, shumë personale dhe shpirtërore të jetës. (Kevin Dowling, ipeshkvi nga Republika Jug-afrikane, Konsultimet kombëtare me besimtarët dhe bashkësitë fetare, 16 tetor 2009.)

Pajtimi është i rëndë nëse viktimat e humbin dinjitetin

Do të thosha së pari, se pajtimi nuk është diç e thjeshtë për çka thuhet thjeshtë: duhet të pajtohemi. Dhe atëherë e fillojmë një lloj procesi për të cilin konsiderojmë se do të sjellë rezultate në këtë. Përfshinë shumë, sidomos nga ju që jeni viktimat (...) T'ia përmendësh fjalën pajtim dikujt i cili ende vuan aq thellë sa që nuk mund të bartet me këtë ... Përgjigja e tyre instinktive, imediate është: 'duan drejtësi' (...) Duhet të nisni të krijoni strukturë tjetër të jetës për ata, ashtu që të mund të jetojnë me një formë të dinjitetit. (Kevin Dowling, ipeshkvi nga Republika Jug-afrikane, Konsultimet kombëtare me besimtarët dhe bashkësitë fetare, 16 tetor 2009.)

Nga aspekti katolik të krishterë midis viktimave nuk ka dallime, sepse dinjiteti i qenies njerëzore është fakt i shenjtë: të gjithë jemi të barabartë edhe në viktimitë edhe në krim.

Sprovat që po paraqiten ose do të paraqiten rreth barazimit të viktimave, respektimit të krimeve, si teolog i krishterë unë s'kam absolutisht kurrfarë problemi rreth kësaj. Për mua ky nuk ekziston si problem për shkak se për mua dinjiteti i qenies njerëzore është aq fakt i shenjtë sa që të gjithë jemi të barabartë edhe në viktimitë edhe në krim. (Drago Pilsel, Novi list, Zagreb, Kroacia, Konsultimet kombëtare me besimtarët dhe bashkësitë fetare, 16 tetor 2009.)

Faktet janë parakusht për shërimin e shoqërisë.

Propozimi ynë është modest. Të vërtetohen faktet në vitet që gjenden para nesh, sado që kjo mundet, për të gjitha krimet dhe shkeljet ligjore gjatë viteve të nëntëdhjeta, që kjo pastaj të shërbejë si një themel edhe për shërimin, shëndoshjen. (Vesna Tershelec, Documenta, Zagreb, Kroaci, Konsultimet kombëtare me besimtarët dhe bashkësitë fetare, 16 tetor 2009.)

Pajtimi do të arrihet kur të gjitha shtetet të fillojnë të "egërsuarit" e vetë t'i quajnë "egërsira".

Unë mendoj se shumë më lehtë do të arrijmë pajtimin, kuptimin e situatës, ndihma viktimës dhe dërgimin e agresorit në atë si ta pastrojë shpirtin e vet personal, kur ne fillojmë këtu ti quajnë të egërsuarit tanë egërsira dhe kur ju në Serbi filloni ti quani egërsirat e juaja egërsira, ata në Bosnjë njësoj të vetët, dhe atëherë disa gjëra do të nisin të lëvizin. Dhe kur kjo vjen, natyrisht, nga ajo shkallë të cilën dëshiron ta dëgjojë populli, sepse të gjithë veç e kanë mundim nga ajo që të flitet për vuajtjet e të tjerëve si „po, e kanë merituar”, e për vuajtjet tona si “të mjerë jemi ne”. (Mladen Jovanović, Këshilli i Kishave të Krishtit, Kroaci, Konsultimet kombëtare me besimtarët dhe bashkësitë fetare, 16 tetor 2009.)

Nevojitet që iniciativën t'ua afrojmë bashkësive fetare, që për shkak të mos njohjes së mjaftueshme të refuzohet.

Nëse dëshirohet të arrihet bashkëpunimi me personat dhe institucionet relevante (përfaqësuesit e bashkësive fetare), se ndoshta duhet edhe pak të punohet në këtë njohje, domethënë me projektin e këtij asociacionit që po krijohet që të mos ndodh, për shkak të njohjes apo mosnjohjes, të bëhet ndonjë farë refuzimi apo paragjykimi të cilat pastaj do ta pamundësonin ndonjë vepër të mirë. (Marija Znidarčiq, Shoqata e Qytetarëve Rrethi Paqësor i Krishterë, Kroaci, Konsultimet kombëtare me besimtarët dhe bashkësitë fetare, 16 tetor 2009.)

KOMRA lypset ta ndriçojë rolin e bashkësive fetare gjatë luftës. Mirëpo, kjo mund të sjellë përjashtimin e bashkësive fetare, sepse të kritikuarit e rolit të tyre mund të interpretohet si atak në palcën e fesë e të dogmës kishtarë.

Nëse edhe një detyrë e këtij projekti KOMRA do të ishte e vlefshme, kjo bash do të ishte mirë për ta ndriçuar rolin e secilës bashkësi fetare veç e veç, ngase kjo më sa di unë, ja edhe vet kam qenë në ato hapësira ku është luftuar, aty sundon një laramani e madhe (...) Po tash, tek bashkësitë fetare shumë lehtë mund të ndodhë që njerëzit ta ndiejnë se në realitet kur i kritikojmë hapat konkret që duhet ti kritikojmë në emër të fesë, se ne në realitet po e atakojmë palcën e fesë, palcën e dogmës së dikujt. Atëherë njerëzit ofendohen dhe përjashtohen. Ky atëherë është një dëm i madh. (Fra Mijo Xholan, Instituti Françeskan për Kulturën e Paqes, Kroaci, Konsultimet kombëtare me besimtarët dhe bashkësitë fetare, 16 tetor 2009.)

Mediat fetare edhe më tutje e shtrijnë të folurit e urrejtjes, e jo të folurit e pajtimit.

Mendoj se shumica do të pajtohet me mua, se tek ne mediat fetare, sidomos "Glas koncila", edhe më tutje e shtrijnë të folurit e urrejtjes, e jo të folurit e pajtimit. (Petra Pajdaković Shebek, Programi i Kulturës Religjioze HRT (Televizioni kroat), Kroaci, Konsultimet kombëtare me besimtarët dhe bashkësitë fetare, 16 tetor 2009.)

Konsultimet me bashkësinë lokale

Osijek, Kroaci 17 tetor 2009.

Konsultimet i kanë organizuar Qendra për paqe, jo dhunë dhe të drejta të njeriut në Osijek, (Kroaci), Nansen dialog qendra Osijek (Kroaci) dhe Documenta (Kroaci). Në tubim kanë qenë prezent gjithsej 40 pjesëmarrës, aktivistë të organizatave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, shoqatat e viktimave dhe të familjeve të viktimave të pësuar e të zhdukur, të shoqatave të mbrojtësve, organizatave të rinjëve, grupeve të grave, shoqatave profesionale, të besimtarëve dhe përfaqësues të bashkësive fetare të Familisë së Osijekut e Baranjës. Ligjërues kanë qenë Vesna Tershelec (Documenta, Kroaci), Ivan Novosel (Legalis, Kroaci), Eugen Jakovčić (Documenta, Kroaci) dhe ipeshkvi i Afrikës së Jugut Kevin Dowling (Dioqeza e Rustenburg, Republika

Jug-afrikane). Moderator ka qenë Katarina Kruhonja (Qendra për paqe, jo dhunë dhe të drejtat e njeriut, Kroaci). Mbi konsultimet kanë raportuar i HRT – studio Osijek, “Sllavonski dom” dhe “Glas Sllavonije”. Monsinjor Marin Srakiq, krye-ipeshkvi i Gjakovos e Osijekut në selinë e Dioqezës së tij e ka pritur delegacionit e Koalicionit për KOMRA.

Propozimet, mendimet dhe Rekomandimet

Kujtimet dhe tragjeditë luftarake, përpjekja e kontestimit të Luftës Atdhetare, deklaratat mbi barazimin e viktimave me agresorin dhe akuzat paushall të mbrojtësve po e vështirësojnë procesin e pajtimit.

Kujtimet luftarake dhe tragjeditë që u kanë ndodhur shumë familjeve tona dhe individëve ende janë të freskëta, e përpjekja e kontestimit bile e arsyet dhe e dinjitetit të Luftës Atdhetare, deklaratat shpesh të paqarta, që shpijnë në barazimin e e viktimës dhe agresorit, dhe kohë pas kohe apostrofimet e padrejta dhe paushall të mbrojtësve tanë, vetëm e rëndojnë procesin e normalizimit të marrëdhënieve dhe të pajtimit në hapësirat tona. (Imzot Marin Srakiq, krye ipeshkvi i Dioqezës së Gjakovos- Osijekut, Kroacia, Konsultimet me bashkësinë lokale, Osijek, 17 tetor 2009.)

Për të pasur pajtim viktimat duhet të falin, e agresori duhet të pranojë fajësinë dhe dëmin për të keqen dhe dhunën e kryer.

Falja është qëndrimi parësor i viktimës e cila nuk donë hakmarrje, veç që më së shumti të arrijë rehati në shpirtin e vet. Nga ana tjetër, dëshirohet në këtë mënyrë të këputët zinxhiri i të keqes dhe i hakmarrjes dhe të krijohen kushte për normalizimin e marrëdhënieve. Vuajta e Krishtit dhe plagët bëhen shenjë me të cilën identifikohet viktimja dhe me forcën e mëshirës viktimja e tejkalon preokupimin e vet me dhunën e pësimin dhe bëhet bartëse e mesazhit të ri të Perëndisë i cili bënë thirrje për dialog dhe vendosjen e mirëbesimit (...) falja, e pastaj procesi i pajtimit mund të vij vetëm nga ata që janë lënduar. Viktimja e nxjerrë forcën nga përjetimi i mëshirës dhe dashurisë së Perëndisë, dhe gjen forcë të atillë që serish të fitojë besim në njerëzit dhe ta tejkalojë dhunën e shkaktuar me luftë. Apo, sikurse thonë disa teolog, që të ketë pajtim viktimat duhet të falin. (Imzot Marin Srakiq, krye ipeshkvi i Dioqezës së Gjakovos- Osijekut, Kroacia, Konsultimet me bashkësinë lokale, Osijek, 17 tetor 2009.)

Pra, nëse procesi i pajtimit shkon në dëm të së

vërtetës dhe kërkon harrimin e vuajtjes së përjetuar, atëherë në realitet e mohojmë vetë dinjitetin e viktimës. Sjell atë që ta harrojmë edhe vetë viktimën dhe shkaqet e vuajtjes së saj mbetën të pazbuluara, por vetëm të shtyrë anash dhe ashtu bëhen bombë e përhershme e cila mundët vazhdimisht me eksploduar papritmas. Në procesin e pajtimit, prandaj është me rëndësi të zbulohen shkaqet e vuajtjes dhe të dhunës, e vërteta e cila pastaj kërkon edhe drejtësi. Me fjalë tjera, pajtimi për dallim nga falja përfaqëson dy palë. Nga njëra anë viktimën e cila e bënë aktin e faljes, e nga ana tjetër agresorin i cili i nxitur me aktin e viktimës kërkon falje, e pranon fajësinë, e vendos të vërtetën dhe drejtësinë dhe në fund kompensimin për të keqen dhe dhunën e bërë. (Imzot Marin Srakiq, krye ipeshkvi i Dioqezës së Gjakovos- Osijekut, Kroacia, Konsultimet me bashkësinë lokale, Osijek, 17 tetor 2009.)

Nevojitet të formohet komisioni i cili do t'i ndriçonte shkeljet e të drejtave të njeriut prej vitit 1945 deri më 1990.

Edhe ne në mënyrën tonë kemi pasur 45 vjet apartheid. Dhe ajo kohë prej vitit 1945 deri më 1990, ende bartë me vete viktimat e veta. Ndoshta një komision i cili do t'i dëgjonte viktimat e atij sistemi mund të kontribuojë në ndriçimin e të vërtetës edhe për atë periudhë. (Imzot Marin Srakiq, krye ipeshkvi i Dioqezës së Gjakovos- Osijekut, Kroacia, Konsultimet me bashkësinë lokale, Osijek, 17 tetor 2009.)

Ekziston dyshimi se është e mundshme të vërtetohen faktet, sepse prapa kësaj gjithmonë fshihen interesat politike. Përpos kësaj midis dokumenteve ka shumë falsifikime, kurse midis dëshmitarëve shumë të rrejshëm.

Çka në realitet desha të them, e kjo është se jam bukur i rezervuar sa herë që është fjala për cilindo që do me e vërtetua të vërtetën dhe faktet. Sepse prapa të vërtetës dhe fakteve vazhdimisht fshihen interesat, e jemi të vetëdijshëm sa janë të fuqishëm interesat edhe në vendin tonë edhe në shoqëri edhe në vendet përreth, e veçmas nëse ai komision duhet t'i vërtetojë faktet në bazë të dëshmiave dhe të ndonjë dokumenti privat. Sepse midis dokumenteve ka mori falsifikimesh, shtrembërimesh, e midis dëshmitarëve ka veçmas shumë dëshmitarë të rrejshëm që kanë dëshmuar në favor të vetin që të marrin do privilegje personale dhe favore, ashtu që jam tepër skeptik ndaj fakteve që do të gjejë ai komision. (Goran Flauder, gazetar i lirë, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Osijek, 17 tetor 2009.)

Faktet gjithsesi duhet vërtetuar, që të mos manipulohet me numrat.

Absolutisht është e nevojshme të vërtetohen faktet, që të mos përdorët, bie fjala, një shembull të tillë më banal se në Osijek kanë qenë, s'di, 1100, pastaj 1400, pastaj 1700 viktima të luftës, e më pas nga spitali i Osijekut i cili ka mbajtur evidencë, për këtë dalin të dhënat se kanë qenë 430 e diçka apo 47 e diçka. Domethënë nga katër deri pesë herë janë dallimet në interpretim: kujt si i duhet ashtu i përdor numrat. (Goran Flauder, gazetar i lirë, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Osijek, 17 tetor 2009.)

Interesi i të gjitha shteteve në rajon është t'i vërtetojnë faktet, që e kaluara të mos përsëritet.

Mendoj se është interes i çdo qytetari të kësaj shoqërie, shoqërive të Serbisë, Bosnjës e Hercegovinës që përfundimisht të bisedohet hapur mbi këtë, që të vërtetohet disa fakte dhe që njëherë përfundimisht të mbyllet ajo faqe e historisë. Çfarë ndodh në situatën kur shoqëria dhe individët, institucionet nuk janë të gatshme të ballafaqohen me këtë? Ja po shohim. Ende po flasim mbi gjërat që kanë ndodhur dyzet e disa vjet. A ka pasur gatishmëri para pesëdhjetë vitesh të zgjidhet kjo, besoj se gjeneratat e reja sot do të ishin më të edukuara po të mos kishte klithje të ustasëve në stadiumet e klubeve futbolliste kroate e kështu me radhë. Domethënë, për çdo rast të lundrojmë me vela të plota në këtë çështje. (Bojan Laliq, Qendra Civile e Baranjës, Beli Manastir, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Osijek, 17 tetor 2009.)

Dëshmimi publik i viktimave dhe kryesve dhe pranimi i krimit janë më të rëndësishme se satisfakcioni material i viktimave.

Mendoj se atë që ka bërë tregimi nga Republika Jugafrikane për shoqërinë (dëgjimi publik i viktimave dhe i kryesve dhe vërtetimi i fakteve), në kuptimin e spastrimit të plagëve, është shumë e rëndësishme nga situata materiale e viktimave konkrete. Vërtetë mendoj se është shumë më i rëndësishëm rrëfimi se njerëzit, në fund të fundit edhe vetë pjesëmarrës të aparteidit, kanë thënë „kemi bërë këtë e këtë, ai ka qenë krim, për këtë shkak pendohe“. (Bojan Laliq, Qendra Civile e Baranjës, Beli Manastir, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Osijek, 17 tetor 2009.)

KOMRA duhet të ketë ekipe mobile të cilët në terren do t'i mbledhin deklaratat nga viktimat.

Ajo që mendoj si kyçe në funksionimin e një institu-

cioni të tillë, është çështja e mobilitetit të tij. Kjo do të thotë nuk mund të pritet që viktimat të shkojnë në ndonjë derë, viktimës duhet të afrohem. Në këtë kuptim, në atë formacion oragnizativ në fillim duhet menduar se ai duhet të jetë sa duhet mobil që t'i afrohet viktimës kudo që të jetë ajo. (Branislav Vorkapiq, Organizata për Iniciativat Qytetare Osijek, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Osijek, 17 tetor 2009.)

Anëtarë të KOMRA-s nuk do të duhej të ishin politikanët, veç përfaqësuesit e bashkësive fetare, të organizatave joqeveritare, e duhet shfaqur kujdes mbi barazinë gjinore dhe imunitetin e anëtarëve të komisionit.

(...) çështja e përbërjes së komisionit (...) domethënë se kjo nuk duhet të jetë në sferën e politikës, gjegjësisht të politikanëve, veç përfundimisht në sferën e bashkësive fetare, organizatave joqeveritare, duke shfaqur kujdes mbi të gjitha standardet që në Kroaci (...) janë pranuar qysh moti. Mendoj edhe në gjininë dhe në të gjitha gjërat tjera. Mendoj se në funksionimin e një institucioni të tillë qeveritar, është e domosdoshme të mendohet mbi diçka që kemi në Sabor (Kuvendin i Kroacisë), domethënë lidhur me përfaqësuesit e Saborit, kjo është çështja e imunitetit të anëtarëve të një trupi të tillë. (Branislav Vorkapiq, Organizata për Iniciativat Qytetare Osijek, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Osijek, 17 tetor 2009.)

KOMRA duhet të merret edhe me viktimat e institucioneve.

Pra e kemi viktimën e individit, kemi viktimën e grupit, por e kemi edhe viktimën e institucionit. Cili do të jetë ai mekanizëm kur në një proces të tillë hulumtues të shtrohet çështja e viktimës institucionale, e viktimës e cila është produkti institucional, (...) respektivisht se krimi apo ndonjë vepër tjetër penale është bërë në kuadër të institucionit. (Branislav Vorkapiq, Organizata për Iniciativat Qytetare Osijek, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Osijek, 17 tetor 2009.)

Duhet bërë regjistrimin e viktimave dhe t'u jepet viktimave hapësirë të flasin publikisht.

Ajo që mendoj se është jashtëzakonisht e rëndësishme dhe për çka unë këtë koalicion e kam përqaftuar edhe këtë iniciativë e shikojë si diç që është shumë me rëndësi, është që të shënohen viktimat. Ne kemi të shënuara veprimet nëse i gjejmë ditarët e topçinjtë, do ta kemi edhe këtë. Kemi të regjistruara emisionet

televizive, i kemi të shënuar nxitësit, kemi të regjistruara tekstet gazetareske. Çdo gjë në këtë luftë është regjistruar, vetëm viktimat askund nuk janë regjistruar. Dëshira ime dhe përpjekja ime e fuqishme është të orvatemi që parashtrimeve të viktimave t'u jepet hapësirë, dhe me siguri vazhdimisht do të gjendet dikush i cili për shaka të ndonjë interesi do ta interpretojë këtë në ndonjë mënyrë të vetën, dhe nga kjo do të krijojë ndonjë të vërtetë të vetën. (Miroslav Varga, mbrojtës nga Osijeku, Konsultimet me bashkësinë lokale, Osijek, 17 tetor 2009.)

KOMRA duhet të merret me fatin e të burgosurve e të zhdukurve në Vukovar dhe me kërkimin e kriminelëve.

Neve edhe na gëzon që ky KOMRA, të paktën kur t'ia dilte ta gjejë fatin edhe të vetmit të burgosur apo të zhdukurit nga Vukovari, apo nga territori ynë, dhe ta sjellë përpara drejtësisë edhe një kriminel kuptohet me prova, ne banorët e Vukovarit këtë do ta përshëndesnim. (Zheljko Pinjuh, zëvendës kryebashkiaku i Qytetit të Vukovarit, Konsultimet me bashkësinë lokale, Osijek, 17 tetor 2009.)

Prokuroritë duhet obliguar me ligj që ta përcjellin dhe shfrytëzojnë dokumentacionin të cilin e mbledh komisioni.

Këtë po e flas për shkak se të gjitha prokuroritë publike, do të ishin të detyruara ta përcjellin ligjshëm atë që e bënë komisioni. Domethënë komisioni është shumë i rëndësishëm edhe për aspektin e të drejtës ndëshkuese dhe politikës penale. (Slavko Kecman, Shoqata për Paqe Baranje, Kroaci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Osijek, 17 tetor 2009.)

Në Kroaci nuk flitet mbi krimet që janë bërë në Osijek, disa viktima nuk kanë të drejtën as për kompensimin e dëmit.

Askush nuk i përmendi krimet e luftës në Osijek, thua se ne na ka kapluar harresa! Ne nuk e mbajmë mend se kjo ka ndodhur apo nuk duam t'ia pranojmë vetvetes. Unë nuk di... Në këtë shtet askush nuk e ka shtruar pyetjen "po ku janë ato familje, çfarë ka ndodhur me ata fëmijë, a kanë shkuar ata fëmijë në shkollë, a kanë tash punë, a kanë pasur fare çka të hanë?" Për këtë askush nuk ka shfaqur kujdes. Në rrugën time ka 33 shtëpi. Të gjitha janë të thyera. Nga e para deri të e fundit. Dhe të gjithë kanë marrë dëmin luftarak, vetëm unë në këtë nuk kam pasur të drejtë. Për çka? (...) Mua ma kanë shkruar se nuk kam të drejtë. (Marija Lovriq, viktimë, Kro-

aci, Konsultimet me bashkësinë lokale, Osijek, 17 tetor 2009.)

Konsultimet me bashkësinë lokale

Kikindë, Serbi 17 tetor 2009.

Konsultimet me bashkësinë lokale në Kikindë i kanë organizuar Qendra për mbështetje grave (Serbi) dhe Klubi i Kikindës (Serbi). Në tubim kanë qenë të pranishëm gjithsej 33 pjesëmarrës, përfaqësues të vetëqeverisjes lokale, të mediave lokale, institucioneve të kulturës, organizatave për të drejtat e njeriut e të organizatave joqeveritare, si dhe shoqatat e veteranëve. Ligjërues kanë qenë Xhevad Bektasheviq (Shoqata e viktimave civile të luftës, Vllasica 92-95, BeH) dhe Dragan Popoviq (Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi). Moderatorë kanë qenë Miomirka Mila Melank (Klubi i Kikindës, Serbi) dhe Marija Srdiq (Qendra për mbështetje grave, Serbi). Javorja "Kikindske", TVVK, TV Rubin i RTS, kanë raportuar nga ngjarja.

Propozimet, mendimet, Rekomandimet

Gazetari luftënxitës e viteve të 90-ta i ka nxitur të rinjtë në Kikindë të formojnë mediat e pavarura dhe qytetarëve tu ofrojnë alternativë.

Ajo që më intereson mua si gazetarë është fakti që në njëfarë mënyre na ka nxitur neve të rinjtë të atyre viteve të 90-ta të përcaktohem për gazetari, është pikërisht ajo gazetari luftënxitës që ishte dominuese edhe në qytetin tonë dhe në përgjithësi gjatë viteve të 90-ta. Në gjatë vite nuk kemi pasur alternativë për një raportim të tillë dhe në njëfarë mënyre e gjithë kjo na ka nxitur neve që të përcaktohem për gazetari si thirrje jetike dhe nga një pezmatim i tillë me gjendjen ne edhe e kemi iniciuar gazetën dhe mediat tjera në këtë qytet. (Zheljko Bodrozhiq, Kikindske, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Kikindë, 17 tetor 2009.)

Mediat e pavarura duhet ta rikujtojnë opinionin se në pushtetin e sotëm në Serbi gjenden ata të cilët e kanë mbështetur luftën dhe formacionet paramilitare.

Ajo që mund ta bëjmë ne, është që pak të rikujtojmë ato vite dhe të rikujtojmë se si disa njerëz, të cilët sot madje janë në pushtetin demokratik dhe partner të

njohur të koalicionit në pushtet në Serbi, janë sjellë ndaj popujve tjerë, ndaj pakicave dhe ndaj mendimit tjetër faresh në këtë qytet (...) dhe opinioni shumë gjëra i ka harruar, të rikujtohet se si njerëzit pa masë dhe pa fytyrë e kanë mbështetur luftën, e kanë mbështetur atë që kanë bërë formacionet paramilitare nga mbarë Serbia në fushëbetejat tjera. (Zheljko Bodrozhiq, Kikindske, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Kikindë, 17 tetor 2009.)

Nga Kikinda mobilizimit i janë përgjigjur mbi 99 për qind të meshkujve, por në fushëbetejë kanë kuptuar se udhëheqësit i kanë manipuluar dhe shfrytëzuar.

Ne jemi rajon ku mbi 90 për qind e njerëzve i është përgjigjur ftesës për mobilizim dhe ata këtë e kanë bërë për shkak se ashtu e kanë ndier (...) dhe besoj se shumë nga ata kanë pa atje në vend, dhe i dijë shumë nga ata të cilën e kanë vërejtur sa kanë qenë të manipuluar dhe sa ajo propagandë luftarake ka ndikuar që ata të kenë mendim të gabuar mbi fqinjët e vet dhe mbi udhëheqësit e vet të cilët këtë e kanë shfrytëzuar në mënyrën më të keqe të mundshme. (Zheljko Bodrozhiq, Kikindske, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Kikindë, 17 tetor 2009.)

Javorja Kikindske mund të ndihmojë në vërtetimin e fakteve me dokumentacionin e vet i cili mbanë deklaratat e veteranëve e të refugjatëve.

Një nga mënyrat se si revista "Kikindske" mund të ndihmojë në këtë çështje, e këto janë dëshmitë e atyre njerëzve që kanë shkuar në fushëbeteja dhe që e kanë pa tërë budallallëkun e luftës, shumica nga ata bartin edhe pasoja fizike të asaj lufte dhe shumë nga ata me siguri e ndjenë edhe dozën e brejës së ndërgjegjes për shkak që kanë pranuar të marrin pjesë në një luftë të tillë. Mendoj se kjo është interesante edhe për KOMRA. (Zheljko Bodrozhiq, Kikindske, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Kikindë, 17 tetor 2009.)

(...) ne këtu në Kikindë mund të bëjmë shumë edhe në dëshmimin e njerëzve që kanë ikur nga Kroacia dhe Bosnja e Hercegovina. Shumë njerëz kanë ardhur këtu në Kikindë për shkak të atyre lidhjeve familjare, shumë nga ata edhe kanë mbetur këtu dhe kanë, ashtu të them, dëshmi të rënda. Diç nga kjo ne e kemi përshkuar, por kjo meriton një qasje më serioze dhe mendoj se fatkeqësisht ka shumë rrëfime tragjike tek ata njerëz të cilët gjatë viteve të 90-ta kanë shkuar nga shtëpitë e veta dhe kanë vazhduar të jetojnë në Kikindë. (Zheljko Bodrozhiq, Kikindske,

Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Kikindë, 17 tetor 2009.)

Dëshmimi publik i viktimave është me rëndësi, veçmas për shkak të faktit që institucionet shtetërore i kanë asgjësuar dëshmitë mbi urdhërdhënësit dhe kryesit.

Ata që kanë bërë krime, që u kanë kontribuar që i kanë inicuar, që i kanë frymëzuar, të cilët edhe sot i mbrojnë, natyrisht se kanë pasur mjaft kohë të asgjësojnë shumë dokumente dhe për këtë shkak dëshmitë e njerëzve që janë viktimë, janë me rëndësi të jashtëzakonshme. Disa midis nesh që kanë janë marrë në pyetje kanë pasur rastin të dëgjojnë dëshmi të ndryshme. (Marija Srdiq, Qendra për mbështetje grave, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Kikindë, 17 tetor 2009.)

Veteranët nga Kikinda e mbështesin KOMRA dhe dëshirojnë të ndihmojnë në vërtetimin e fakteve mbi të kaluarën.

Ndonjëherë nuk e kam lehtë të flas për atë çka kemi pa, përjetuar e kështu me radhë. Do si do jemi popullatë e cila mund të kontribuojë shumë në punën e KOMRA në qoftë se do të përfshihemi direkt apo jo në formën e përfaqësuesit (...) se me siguri do të kemi shumë çka të themi dhe të kontribuojmë në punën e KOMRA shikuar në përgjithësi (...) dhe për çdo rast do ta keni mbështetjen. (Slobodan Kikiq, Shoqata e luftëtarëve të luftërave të viteve 90-ta, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Kikindë, 17 tetor 2009.)

Sjellja e disa njerëzve (...) dhe kushtet në të cilat kemi jetuar ne (veteranët nga Kikinda në Kopačkom Ritu në Kroaci) e kështu me radhë, do të ishte interesante. Natyrisht, këtë tash po e them nga arsyeja që njerëz të tillë ka shumë në qytet, ka në Vojvodinë, Serbi dhe shtet tjera. Por të gjitha ato dëshmitë nga njerëzit që kanë qenë atje do të ndihmonin të njihet e vërteta dhe që njeriu të mos ndihet fajtor për atë që nuk e ka bërë (Jovan Gvero, Qendra Kreative Novi Sad, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Kikindë, 17 tetor 2009.)

KOMRA mund të kontribuojë që të hiqet njolla nga veteranët të cilët janë sjellë ndershem në fushëbetejë.

Ideja juaj është shumë e mirë, për ne është e mirë. Për ne që kemi luftuar me nderë e kemi bërë punën tonë, e kemi kryer detyrimin tonë kushtetues, sepse është e çmueshme që të hiqet njolla nga ne. Mediat

shtetërore (...) na kanë pështy, na kanë ndyrë pas kthimit nga fushëbeteja. Kanë thënë se ne jemi përdhunues, se jemi plaçkitës, por të gjithë ne kemi pësuar njësojë ekonomikisht si të gjithë qytetarët tjerë. Ndoshta edhe më keq. Përse më keq? Me të kthyer nga veprimet luftarake njerëzit kanë hasur në firma të shkatërruara, ndërmarrje të falimentuara, madje edhe shteti ka luajtur edhe me ligj, me shlyerjen e një pjese të ligjit në Ligjin mbi punën (...) por kur popullatën e madhe të njerëzve që kanë marrë pjesë në veprimet luftarake e pezullojnë dhe ia shkurtojnë të drejtën atëherë shteti dinë çka po bëjnë (...) çka të them që luftëtarët tash të vdesin e familjet e tyre të mbesin, madje as ndihmën sociale nuk po mund të marrin, sepse gjoja nuk i përmbushin disa kushte. (Zoran Kosiq, Shoqata e luftëtarëve të luftërave të viteve të nëntëdhjeta, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Kikindë, 17 tetor 2009.)

Vështirë mund të mësohet e vërteta mbi atë çfarë ka ndodhur para 20 vjetësh, kur nuk dihet e vërteta prej para 50 vjetësh.

Jam këtu me ju për ta shqyrtuar mundësinë që të formohet KOMRA, domethënë që kjo të organizohet ashtu sikurse duhet, që të mundemi të mësojmë çfarë ka ndodhur para 20 vjetësh (...) ne po e kapërcejmë diçka që ka ndodhur edhe para pesëdhjetë vitesh, se të gjitha arkivat e këtij shteti dhe të gjitha shteteve në hapësirën e ish Jugosllavisë janë të mbyllura, të vërtetën nuk e dimë as mbi atë nga koha e Brozit, tash do të mësojmë çfarë ka qenë para 20 apo ndoshta 15 vjetësh, kur në të gjitha shtetet është kufizuar qasja dokumenteve sekrete në një 50 vjet (Zoltan Moldvai, Shoqata e organizatave invalide OSI, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Kikindë, 17 tetor 2009.)

Është e pranishme frika, sidomos tek viktimat, që të thuhet kush e ka bërë krimin.

Shumica do ti ikin, sepse po tutemi ta themi se ai e ka bërë atë. Shikoni, frika është e kuptueshme, por do të gjendet dikush se dikush do të thotë, e unë druham shumë se viktimat nuk do të duan të thonë. (Zoltan Moldvai, Shoqata e organizatave invalide OSI, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Kikindë, 17 tetor 2009.)

KOMRA duhet të bëjë regjistrimin e të pësuarve gjatë bombardimeve të NATO-s, si dhe vërtetimin e shkaqeve që kanë sjellë bombardimin.

A është mandati i KOMRA, sipas ndonjë ideje, të shkojë në atë drejtim që të shtrihet në pyetje e

përgjigje, domethënë në viktima dhe shkaqet e bombardimeve që kemi pasur nga Pakti NATO? Mendoj se shembulli i RTS është shumë i mirë, kemi edhe shkaqet edhe pasojat për ta vëzhguar dhe parë fajësinë edhe nga ana jonë edhe nga ana e atyre tjerëve. (Velimir Lipovan, avokat, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Kikindë, 17 tetor 2009.)

KOMRA lypset ta përfshijë periudhën prej fundit të Luftës së II Botërore deri më sot dhe t'i hulumtojë pësimet e folksdojçerëve (gjermanëve) e të Hungarezëve në Vojvodinë pas Luftës së II Botërore.

Pak jam i pakënaqur me këtë periudhë kohore në punën e KOMRA (1991. – 2001.) dhe do të propozoja (...) që të shtrihet në viktimat pas Luftës së II Botërore në territorin e Vojvodinës. Këtu është fjala për folksdojçerët (gjermanët) dhe hungarezët që kanë qenë viktima (...) njerëzit janë dërguar në kampe të përqendrimit, janë vrarë, përndjekur, fjala ka qenë për spastrimin etnik. (Nenad Talijanov, Forumi i Kikindës, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Kikindë, 17 tetor 2009.)

Në komision duhet të punojnë drejtësidashësit, ata që e duan të vërtetën dhe personat e guximshëm.

Kush në Komision? Mendoj se është çështje kryesore kë të vëmë në komision. Para se gjithash ata që janë drejtësidashës dhe që e duan të vërtetën (...) duke qenë se secila e vërtetë e ndryshon realitetin. Ata njerëz që janë në komision duhet të jenë njerëz që janë të guximshëm (Brana Marjanović, Teatri Popullor në Kikindë, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Kikindë, 17 tetor 2009.)

Konstatimet e KOMRA-s duhet të bëhen përmbytje a teksteve të historisë dhe në atë mënyrë t'i pengojë manipulimet politike dhe interpretimet e ngjarjeve.

Derisa KOMRA do të jepte fakte autentike, fakte të cilat kanë ndodhur, nga ana tjetër ato disa libra të mësimit edhe më tutje do të vazhdonin të japin një pasqyrë të shtrembëruar, dhe aty atëherë nuk ekziston një, si të them, orientim i cili njerëzve të rinj do t'u thoshte qartë, kjo ka ndodhur, kjo nuk ka ndodhur, që aty rreth kësaj të krijohet një atmosferë konfuze, si të them, skizofrene (...) nëse KOMRA mund të merret me këtë, kjo do të ishte ajo që duhet. (Shandor Melank, Klubi i Kikindës, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Kikindë, 17 tetor 2009.)

Thjeshtë nuk janë kontestues vetëm tekstet që gjenden në ato libra të mësimi, veçse me analizë shihet se autorët i shpijnë nxënësit në disa përfundime ku thjeshtë mund të gjendet të folurit e urrejtjes, thirrja në nacionalizëm e gjithçka, dhe nxënësi i shkollës fillore thjeshtë ashtu e kupton si i janë prezantuar, shkruar dhe pastaj krijon një mendim në kokën e vet dhe ashtu futet në shoqëri, dhe atëherë kemi në shoqëri nacionalizëm (Tijana Velmirov, Qendra për mbështetje grave, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Kikindë, 17 tetor 2009.)

KOMRA duhet të merret me vërtetimin e fakteve mbi shkeljet e rënda të drejtave të njeriut që kanë ndodhur në zonat jashtë veprimeve luftarake, por që kanë lidhje me konfliktin.

Kur ndodhë në hapësirë (...) kur fëmijët e shikojnë se nënës ia drejtojnë pistoletën, kjo është njëjtë si kur dikush shkrep, domethënë jashtë hapësirës së veprimeve luftarake, në kohën e luftës (...) tre fëmijë e shikojnë duke ia drejtuar nënës pistoletën në kokë, nuk lejojnë të vjen ndihma, ekipi i mjekëve (...) që megjithatë në këtë takim dikush të thotë a është edhe kjo diçka që duhet gjykuar apo kjo është njëfarë shkelje e të drejtave të njeriut. (Zoran Kosiq, Shoqata e luftëtarëve të luftërave të viteve të nëntëdhjeta, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Kikindë, 17 tetor 2009.)

KOMRA nuk mund të ketë autorizime për dhënën e amnistisë. Ky është mandati i organeve gjyqësore dhe i presidentit të republikës.

Nuk mundet KOMRA ta amnistojë askënd. Nuk di nëse është në plan të jepen Rekomandime për amnistinë, por ato gjëra i bëjnë vetëm organet e shtetit, të gjyqësisë dhe në fund presidenti i republikës në shtet, ashtu ku si është organizuar kjo gjë. Domethënë KOMRA këtu nuk ka mandat dhe kurrë as që mund ta ketë. (Velimir Lipovan, avokat, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Kikindë, 17 tetor 2009.)

Nevojitet që KOMRA ta hulumtojë dëbimin e shqiptarëve dhe rrënimin e objekteve të tyre në Kikindë gjatë bombardimeve të NATO-s.

Në fillim të bombardimeve, më 1999, shumë lokale afariste të qytetarëve të Kikindës të nacionalitetit shqiptarë kanë pësuar dhe janë djegur, qytetarët shqiptarë janë dëbuar dhe thjeshtë dikush është dashur të jetë urdhërdhënës që masa të detyrohet ti shkatërrojë ato objekte. Mendoj se duhet të hetojmë në Kikindë se kush kanë qenë ata urdhërdhënës, kush

kanë qenë ato grupe e individ që e kanë nxitur masën ta shkatërrojë pronën e qytetarëve shqiptarë. (Nenad Talijanov, Forumi i Kikindës, Serbi, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Kikindë, 17 tetor 2009.)

Konsultimet kombëtare me të rinjtë mbi Iniciativën për formimin e KOMRA

**Banja Llukë, BeH
17 tetor 2009.**

Konsultimet e dyta kombëtare me të rinjtë në BeH i ka organizuar Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në BeH. Në tubim kanë marrë pjesë mbi 50 përfaqësues të organizatave të rinjve dhe individë nga Banja Luka, Sanski Mosti, Prijedor, Rudo, Srebrenica, Bihaqi, Bjelina, Shekoviqi. Në konsultime si vëzhgues kanë marrë pjesë përfaqësuesit e partive politike si dhe përfaqësuesja e seksionit për të drejtat e njeriut të OSBE. Ligjërues kanë qenë Mario Mazhiq (Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut, Kroaci), Marijana Toma (Impunity Watch), kurse tubimin e kanë moderuar Alma Mashiq (Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut, Sarajevë, BeH) dhe Aleksandra Letiq (Këshilli i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën Serpska, koordinatore kombëtare e procesit konsultativ të Koalicionit për KOMRA në BeH)

Mendimet, propozimet dhe Rekomandimet e pjesëmarrësve

Detyra e Koalicionit për formimin e KOMRA është të kujdesët që Komisioni të jetë jashtë ndikimit politik.

Koalicioni ka rol të rëndësishëm ta mbikëqyr punën e Komisionit, të shikojë që ai të jetë i pavarur nga themeluesit e vet, respektivisht nga shteti. Sepse nuk guxon të na ndodhë që Komisioni të cilin e kemi themeluar në pjesën më të madhe të varet nga temat e politikës ditore me goditje të vazhdueshme, e kështu me radhë. Ai duhet të jetë i pavarur sipas mënyrës së njëjtë sikur që është gjyqësia. Domethënë, anëtarët e Komisionit, hetuesit e komisionit, nuk guxojnë të jenë nën trysni politike. (...) dhe të hetojnë besueshëm dhe hapur. (Mario Mazhiq, Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Kroaci, Konsultimet kombëtare me të rinjtë, Banja Llukë, BeH 17 tetor 2009.)

Ekziston dilema nëse varësia financiare e

KOMRA nga shtetet themeluese mund të ndikojë në pavarësinë e Komisionit.

(...) në çfarë mënyre do të financohej ai Komision për vërtetimin e fakteve ...Kjo është (...) ajo për të cilën unë kam frikë. Se ato, shtetet themeluese, do ta miratojnë këtë kurs në fund nuk do të japin para dhe Komisioni thjeshtë do të pushojë të punojë. (Ervin Blazheviq, Shoqata Rinore -Mladost, Koza-rac, BeH, Konsultimet kombëtare me të rinjtë, Banja Llukë, BeH 17 tetor 2009.)

Sipas gjyqit tim personal, në realitet, ashtu edhe Komisioni duhet të financohet publikisht, konsideroj se duhet tu drejtohem donatorëve ndërkombëtar. Por nuk mendoj se rreziku i pavarësisë së tij shtojcë do të rrezikohet me financimin publik. (Mario Mazhiq, Iniciativa për të Drejtat e Njeriut, Kroaci, Konsultimet kombëtare me të rinjtë, Banja Llukë, BeH 17 tetor 2009.)

Ekziston rreziku që parlamentet ta pengojnë punën e KOMRA, sepse në ato organe ende janë njerëzit të cilët kanë bërë krime.

(...) frika ime e vetme është se do të ketë pengesa të punës së Komisionit dhe se nuk është problem formimi i Komisionit, veçse problemi kryesor është që ai Komision ta kryej punën e vet. Sepse, nëse parlamenti duhet ta marrë vendimin se Komisioni do të punojë, e që në atë parlamentin e njëjtë ekzistojnë njerëzit të cilët kanë krye ato krime të njëjta të luftës, natyrisht se ata do ta pengojnë punën e Komisionit dhe në të gjitha formate mundshme do ta sabotojnë punën e tij. (Dejan Čabrilo, Grupi rinor i Këshillit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në RS, Bjelinë, BeH, Konsultimet kombëtare me të rinjtë, Banja Llukë, BeH 17 tetor 2009.)

Për gjeneratat nga koha e luftës viktimat e huaja nuk janë viktima. Mbështetje KOMRA mund ti japin vetëm gjeneratat e pas luftës.

(...) grupi destinues në të cilin duhet të bazoheni në realitet janë njerëzit e rinj. Gjeneratat që kanë dalë nga lufta thjeshtë janë të verbra. (...) Të gjithë i kanë plagët e veta dhe hallet e veta, viktimat e veta. Për ata viktimat e huaja nuk janë viktima për të cilat mendojnë. Thjeshtë duan të gjejnë rahat, por në ndonjë zotërim të vetin, të ambientit të vet kombëtar. Ashtu që ata thjeshtë do të luftojnë madje edhe ti mbrojnë personat të cilët e kanë shkaktuar vdekjen e njerëzve tjerë, apo gjenocidin mbi palën tjetër. Ashtu që duhet të orientoheni në vetëdijen e njerëzve të rinj.

(...) njeriu i ri (...) mund ti kuptojë viktimat (...) njësoj të popullit të vetë si edhe të popullit të huaj, pasi që jeta e njeriut është jetë. (Rade Mrgjen, Partia e Progresit Demokratik, Këshilli i të rinjve, Banja Llukë, BeH, Konsultimet kombëtare me të rinjtë, Banja Llukë, BeH 17 tetor 2009.)

Kur të përfundojë procesi (formohet KOMRA) më nuk do të ketë manipulime, as me viktimat as me numrat.

Është qenësore që tash është ngritur iniciativa. Do si do nuk ka hapa mbrapa. Po, përse është qenësore? Pikërisht është qenësore që kur të përfundojë i tërë ky proces, shpresoj pozitivisht, nuk do të ketë më manipulime. Nuk do të ketë më vend për manipulime as me viktimat as me numrat. As kush është hero i luftës, as kush nuk është e kështu me radhë. Këtë do ta lëmë prapa nesh dhe do të shkojmë përpara. (Dalibor Taniq, Iniciativa për të Drejtat e Njeriut në BeH, Konsultimet kombëtare me të rinjtë, Banja Llukë, BeH 17 tetor 2009.)

KOMRA është zgjidhje pozitive në raport me nevojën për të vërtetën dhe pajtimin.

Sipas mendimit tim (...) ky Koalicion i organizatave joqeveritare (KOMRA) është një zgjidhje pozitive për të vërtetën, për pajtimin dhe sikurse theksuat, për ndihmën psikologjike viktimave. KOMRA është një mekanizëm i mirë për dalje nga kjo situatë në të cilën ne gjendemi tash. (Lamija Gudiq, Qendra Rinore, Gornji Vakuf-Uskoplje, BeH, Konsultimet kombëtare me të rinjtë, Banja Llukë, BeH 17 tetor 2009.)

Mendimi im për gjithë këtë është se të ardhmen që e përmendet nuk mund ta kemi derisa nuk flasim për të kaluarën, domethënë ballafaqimi me të kaluarën. Situata ime në Gornji Vakuf, për këtë mund të flas, është e ndarë dhe përfundimisht ai qytet nuk mund të bashkohet derisa nuk ballafaqohemi me të kaluarën. Kjo është karakteristikë shumë esenciale sipas një gjykimi tim dhe e mbështes këtë Iniciativën KOMRA me shpresë se do të jap frytë. (Nejra Jukiq, Qendra Rinore Gornji Vakuf, BeH, Konsultimet kombëtare me të rinjtë, Banja Llukë, BeH 17 tetor 2009.)

KOMRA u jep hapësirë viktimave ta tregojnë atë që e kanë vuajtur, që të lirohen nga barra dhe të bëjnë hapa drejtë bashkëjetesës.

Tu mundësohet njerëzve që thjeshtë ta tregojnë atë që kanë përjetuar, atë që kanë vuajtur dhe kjo është gjëja kyçe, prandaj konsideroj se kjo iniciativë,

Komisioni që duhet të formohet në fund, ka rëndësi bukur të madhe për të ardhmen e mbarë rajonit, sepse sipas mendimit tim ai në njëfarë mënyre ka edhe karakter terapie. Njerëzit (...) të cilët do të kenë mundësi ta tregojnë rrëfimin e vet do të lirohen nga e gjithë barra që e bartin në vete, do të jenë të gatshëm për atë hapin tjetër, hapin e bashkëjetesës.. (Almir Salihović, Asociacioni i Studentëve Srebrenica, Srebrenicë, BeH, Konsultimet kombëtare me të rinjtë, Banja Llukë, BeH 17 tetor 2009.)

Kyçe është se faktet për krimet mbi boshnjakët në Prijedor ti pranojnë serbët, kurse boshnjakët faktet për krimet mbi serbët në Konjicë.

Koalicioni KOMRA do ta marrë mbështetjen në BeH nga ato shoqata të cilat janë viktimat. Në Prijedor boshnjakët do ta mbështesin KOMRA, serbët ndoshta më vështirë. (...) do të doja (...) të ballafaqohemi që ai të thotë po, në Prijedor janë vra kaq e kaq bashkëqytetarë të mi, myslimanë. Domethënë ndryshe nga unë, por janë bashkëqytetarë të mi.

(...)Njëjtë nuk i di tash krimet e boshnjakëve poshtë në Konjicë (...) domethënë poshtë boshnjakët ndoshta do të jenë kundërshtarë të KOMRA. Kjo është njëfarë poente e kësaj çështje. (Ervin Blazheviq, Organizata Rinore Mladost, Kozarac, Konsultimet kombëtare me të rinjtë, Banja Llukë, BeH 17 tetor 2009.)

Prioritet është që në Kroaci ti dëgjojnë dëshmitë nga Knini, e në Serbi dëshmitë nga Vukovari.

(...) të themi (që) ato dëshmitë nga Knini ti dëgjojnë, varësisht nga vitet për të cilat është fjala, në Beograd, ti dëgjojnë në Banja Llukë dhe ti dëgjojnë në Zagreb. Që dëshmitë nga Stolci, nga Prozori të dëgjojnë në Zagreb, që dëshmitë nga Vukovari të dëgjojnë në Beograd, Nish, etj.

Natyrisht, ekzistojnë prioritetet, nuk është aq e rëndësishme që në Zagreb të dëgjojnë për shqiptarët nga Kosova apo serbët nga Kosova, të cilët janë viktimat, por është kyçe të dëgjojmë për '95-tën, është kyçe të dëgjojmë për viktimat që i ka prodhuar pala kroate, jo vetëm HVO, veç edhe (HV) Ushtria kroate, në realitet që i ka bërë viktimat në Bosnjë e Hercegovinë. Dhe kjo është kyçe, që ai zë i viktimës, që ajo platformë, ta ketë karakterin e vet rajonal. (Mario Mazhiq, Iniciativa për të Drejtat e Njeriut në Kroaci, Konsultimet kombëtare me të rinjtë, Banja Llukë, BeH 17 tetor 2009.)

A janë viktimat ata të cilët kanë pësuar derisa kanë pritur ndihmën humanitare apo në fushat e minuara?

(...) shembulli me njerëzit që kanë pësuar në fushat e minuara apo që kanë mbetur pa pjesë të trupit, si i sheh KOMRA ata në të ardhmen (...) çka është me njerëzit që janë vrarë, për shembull, derisa kanë pritur ndihmën humanitare nga helikopteri kur binte, kur e kanë mbledhur ushqimin, si të sillet KOMRA me ata. (Ismar Kasapović, Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në BeH, Konsultimet kombëtare me të rinjtë, Banja Llukë, BeH 17 tetor 2009.)

Dëshmitarët po zhduken dhe një pjesë e të vërtetës me ta. Shumë dëshmitarë janë jashtë dhe ata duhet inkuadruar në proces.

Dëshmitarët- njerëzit të cilët mund ta thonë të vërtetën, ata po zhduken. Në qoftë se ne lejojmë të kalojë koha, domethënë kurrë nuk do të vijmë tek kjo e vërtetë të cilën në esencë po dëshirojmë ta arrijmë. Dhe këtu nga një kënd lokal, të them konkretisht, në Kozarc për shembull mbi 70 për qind të njerëzve janë jashtë. Për tu mbledhur dëshmitë këtë, duhet organizuar anembanë botës dhe ky me siguri është një nga problemet për të cilin duhet menduar. (Rade Mrgjen, Partia e Progresit Demokratik, Banja Llukë, BeH, Konsultimet kombëtare me të rinjtë, Banja Llukë, BeH 17 tetor 2009.)

Një numër i madh i viktimave janë shpërngulur prej shteteve nga vijnë dhe duhet të gjejmë mënyrën si ti inkuadrojmë në procesin e tërësishëm. Sepse ata e bartin lëndën e rëndësishme historike në vete, e nuk kanë pasur rast ta thonë, ta paraqesin kudo qoftë. (Aleksandra Letiq, Këshilli i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në RS, Konsultimet kombëtare me të rinjtë, Banja Llukë, BeH 17 tetor 2009.)

KOMRA është zëvendësim i krejt asaj që institucionet në mbarë rajonin e kanë lëshuar ta bëjnë dhe ti zgjidhin problemet esenciale, veçmas ta zgjidhin problemin e të zhdukurve.

Ato institucione nuk kanë treguar aftësi për ti zgjidhur këto probleme. Ato neve tërë kohën e ekzistimit të vetë na kanë larguar më shumë nga njëri tjetri. Mendoj, nuk na kanë afruar aspak, ashtu e shoh unë këtë dhe unë po pres plotë 17 vjet që ato institucione ti gjejnë eshtrat e vëllait tim i cili ka pas 15 vjet kur është vrarë, dhe eshtrat e babës tim, të gjyshit, gjyshes dhe të gjithë familjes. Ashtu që konsideroj se institucionet nuk do të na sjellin në qëllimin e dëshiruar, por mendoj se KOMRA po. (Mirsad Duratović, kryetar i Shoqatës së Kampistëve Prijedor '92, Prijedor, BeH, Konsultimet kombëtare me të rinjtë, Banja Llukë, BeH 17 tetor 2009.)

Është inkurajuese pjesëmarrja e të rinjve nga partitë politike në procesin konsultativ. Kjo do të jetë mbështetje e madhe për formimin e Komisionit kur propozimi të mbërrijë në nivelin politik, por brengos mungesa e Lidhjes së Kampistëve dhe e shoqatave të viktimave civile në BeH.

Gjithashtu jam anëtar i rinisë së një partie politike (...) e inkurajojë sot prezencën e rinisë së disa (...) partive politike. Dhe mendoj se kjo do të jetë një erë e fuqishme në shpinën e këtij Koalicioni për KOMRA. Sepse politika deshëm ne ta pranojmë apo jo, ka ndikim dhe guxoj këtë edhe ta them madje e drejton politikën e shoqatave më të mëdha si të viktimave ashtu edhe të disa organizatave më të mëdha joqeveritare në këtë vend. Mund të vërehet mungesa (...) të paktën këtu në BeH, e atyre organizatave. Pra të atyre kulmore, siç e quajnë vetveten, organizatat kulmore të njërit popullit, të tjetrit dhe të popullit të tretë – Lidhjes së kampistëve, Lidhjes së shoqatave të atyre viktimave civile të luftës dhe të personave të zhdukur e ngjashëm. (Mirsad Dautović, kryetar i Shoqatës së Kampistëve Prijedor '92, Prijedor, BeH, Konsultimet kombëtare me të rinjtë, Banja Llukë, BeH 17 tetor 2009.)

Fushata 1.000.000 nënshkrime për KOMRA që është planifikuar në kohën e zgjedhjeve në BeH, duhet të shtyhet.

Ndoshta është gjë e rrezikshme të flitet për KOMRA në vitin 2010, për shkak se fushata parazgjedhore, po e shihni edhe vet, veç ka filluar me të madhe (Sudbin Musiq, Shoqata e Kampistëve Prijedor 92, Konsultimet kombëtare me të rinjtë, Banja Llukë, BeH 17 tetor 2009.)

Konsultimet kombëtare me grupet e grave mbi Iniciativën për formimin e KOMRA-s

**Podgoricë, Mali i Zi
23 tetor 2009.**

Konsultimet kombëtare me grupet e grave në Mal të Zi mbi Iniciativën për formimin e KOMRA-s janë mbajtur nën organizimin e ANIMA-s – Qendra për Arsimim Femëror dhe Paqësor dhe Qendra për Arsimim Qytetar në Podgoricë. Në tubim kanë marrë pjesë 43 veprimtare të organizatave joqeveritare, politikane, gazetares dhe qytetare. Mbi përvojat personale luftarake kanë folur Mejra

Dautović (Bihac, BeH), Zhanka Stojanović (Beograd, Serbi), Jany Hansel dhe Aida Cvjetković (të dyja nga Dubrovniku, Kroaci). Ligjëruese kanë qenë Tijana Rolović (Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi) dhe Mira Arsović (Lidhja për Gratë Votuese, Nikshiq, Mali i Zi) ndërsa moderator Daliborka Uljarević (Qendra për Arsimim Qytetar, Mali i Zi). Mbi debatin e zhvilluar kanë raportuar gazeta "Vjesti" dhe Boshnjaci.net.

Mendimet, propozimet dhe rekomandimet e pjesëmarrëseve

KOMRA duhet të merret me rolin e institucioneve, veçmas të sistemit të arsimit, kurse aktgjykimet e Gjykatës së Hagës të futen në tekste shkollore.

Çka shkruan në librat tonë ? Kriminelët e luftës janë heronj. A duhet Komisioni të jap rekomandime që aktgjykimet nga Haga të futen në libra, në tekste shkollore? Mendoni se nuk duhet të merremi me amnistinë (...) mendoj se duhet të merremi me institucionet, sidomos me mediat, me policinë dhe do të ketë mjaftë punë. (Sabina Talović, Bona fide, Plevlje, Mali i Zi, Konsultimet kombëtare me grupet e grave në Mal të Zi, Podgoricë, 23 tetor 2009)

Duhet filluar nga Komisionet kombëtare, dhe ato mund të lidhen në shkallë rajonale.

Thjeshtë është problem (i madh) të jetë komisioni në shkallë rajonale. (..) Më mirë do të ishte që kjo të nis të mbledhet në kuadrin e (një) shteti; të përgatitet çdo gjë e pastaj ato të ndërlidhen edhe në shkallë rajonale (...) Njerëzit do të tregojnë më lehtë kur është ndonjë komision i përzier, rajonal, por njëfarë baze duhet të nis nga brenda, nga secili shtet. (Olivera Vukadinović, TV Mali i Zi, Konsultimet kombëtare me grupet e grave në Mal të Zi, Podgoricë, 23 tetor 2009)

KOMRA duhet t'i vërtetojë shkaqet e luftës.

Anëtarët të cilët do të merren me modelin e KOMRA duhet të marrin parasysh edhe shkaqet, sepse nëse do të flasim vetëm për pasojat, nëse i numërojmë se kemi 100.000 viktima, 16.000 të pagjetur, prapë nuk do të dijmë për çka është fjala. (..) në qoftë se nuk do të jetë ky KOMRA, ky komision, druaj se do ta përsërisim historinë dhe luftërat në këto hapësira. (Sonja Radoshević, gazetares dhe lirë nga Podgorica, Mali i Zi, Konsultimet kombëtare me grupet e grave në Mal të Zi, Podgoricë, 23 tetor 2009)

Mendoj se vërtetimi vetëm i fakteve mbi atë çfarë ka ndodhur, pa kontekst, është shumë problematik. Pa rrëfimet e grave të cilat përfundimisht duhet të integrohen në rrëfimin historik të këtyre hapësirave. (Ljupka Kovačević, Anima, Kotor, Mali i Zi, Konsultimet kombëtare me grupet e grave në Mal të Zi, Podgoricë, 23 tetor 2009)

KOMRA duhet të rekomandojë reforma institucionale dhe hapjen e dosjeve të fshehta, pro në veçanti duhet të merret me rolin e kishës.

Njëri nga rekomandimet e KOMRA është që të bëhen reformat institucionale; hapja e dosjeve të fshehta dhe lustrimi –pastrimi i figurës (...), i cili do ti përfshinte institucionet më të rëndësishme; (...) Kishën Ortodokse Serbe e cila e ka ndërsyer luftën, i ka arsyetuar krimet e luftës dhe ka marrë pjesë në lavdërimin e kriminelëve, i ka bekuar dhe i ka kanonizuar në të shenjtë, të cilët ose kanë marrë pjesë ose i kanë miratuar krimet e luftës. (Stasha Zajeviq, Gratë në të Zeza, Beograd, Serbi, Konsultimet kombëtare me grupet e grave në Mal të Zi, Podgoricë, 23 tetor 2009)

KOMRA duhet ta rishikojë rolin e mediave dhe të disa gazetarëve në nxitjen për luftë.

Duhet vërtetuar faktet dhe të rishikohet roli i mediave në nxitje (për luftë) dhe të (vërtetohen) emrat individual. Ne në Mal të Zi mundemi saktë t'i emëtojmë dhe të tregojmë kush është përgjegjës (...) gazetarët dhe gazetarët nuk janë të gjithë të njëjtë, nuk kanë përgjegjësi të njëjtë. Ljupka Kovačević, Anima, Kotor, Mali i Zi, Konsultimet kombëtare me grupet e grave në Mal të Zi, Podgoricë, 23 tetor 2009)

Mendoj se Radiotelevizioni i Malit të Zi duhet të apostrofohet me të gjitha institucionet, sepse e ka bërë atë që e ka bërë. (...) Pra, me politikanët, gjyqësinë, policinë, ushtrinë, të gjithë, sepse kjo as sot nuk po funksionon. Dhe kjo është gëlqerosje e biografisë (...) vetëm kështu me disa iniciativa që vazhdimisht të flitet për këtë, por pa ndërprerë (mund të arrihet diçka). (Ervina Dabizhinović, Anima, Kotor, Mali i Zi, Konsultimet kombëtare me grupet e grave në Mal të Zi, Podgoricë, 23 tetor 2009)

Në mandatin e komisionit duhet të përfshihet mobilizimi i dhunshëm i refugjatëve dhe i qytetarëve të Serbisë.

(Propozoj) që të radhitet edhe një krim i luftës, e ky

është mobilizimi i dhunshëm i refugjatëve që është bërë në Serbi, dhe ne për këtë, sa kemi mundur, kemi mbajtur një evidencë shumë të saktë. (...) viktima duhet të jenë të gjithë meshkujt që janë mobilizuar dhunshëm. Gjithashtu është rekomandimi që të shihet nëse këto shtetet dëshirojnë të thonë sa të rinjtë kanë qenë të mobilizuar dhunshëm. (Stasha Zajeviq, Gratë në të Zeza, Beograd, Serbi, Konsultimet kombëtare me grupet e grave në Mal të Zi, Podgoricë, 23 tetor 2009)

KOMRA nuk mund ta anashkalojë aspektin gjinor të drejtësisë.

(...) a do të mbetet KOMRA vërtetë e verbër dhe e shurdhër ndaj aspektit gjinor të drejtësisë? Gratë po duan që edhe për këtë të flitet, t'i kujtojmë dhe të vërtetojmë se kush kujt çka i ka bërë. (...) Dua të di përse dikush ka mundur të flejë derisa dikujt jeta i është shkatërruar. (Ervina Dabizhinović, Anima, Kotor, Mali i Zi, Konsultimet kombëtare me grupet e grave në Mal të Zi, Podgoricë, 23 tetor 2009)

Viktimat e përdhunimit duhet të dëshmojnë për përvojat e tyre para KOMRA-s, por atyre duhet siguruar mbrojtja adekuate.

(...) kjo ka qenë luftë kundër popullatës civile, që ka shkuar nëpër trupin e gruas. Janë të qenësishme dëshmitë e grave mbi këto krime, por gjithashtu është me rëndësi si përgatiten ekspertizat të cilat i udhëheqin, çfarë lloji mbrojtje duhet ofruar. (Biljana Zeković, SOS Podgoricë, Mali i Zi, Konsultimet kombëtare me grupet e grave në Mal të Zi, Podgoricë, 23 tetor 2009)

Organizatat e grave kërkojnë që për ato të organizohet konsultime të veçanta, e jo vetëm si pjesë e të gjitha konsultimeve.

(...) ne duhet t'ia dalim brenda udhëheqjes së KOMRA që konsultimet e grave të mos jenë vetëm pjesë e të gjitha konsultimeve, ato duhet të jenë të veçanta nëse nevojitet për secilën nga ne. (Memnuna Zvizdiq, Gratë -Grave, Sarajevë, BeH, Konsultimet kombëtare me grupet e grave në Mal të Zi, Podgoricë, 23 tetor 2009)

Shumë gra në rajon dëshirojnë të ndihmojnë në formimin e KOMRA-s, atyre duhet ofruar rastin.

Mendoj se ka tepër shumë gra në Mal të Zi, Serbi, BeH dhe kudo në këto hapësira të cilat dëshirojnë të

marrin pjesë në gjithë këtë e nuk kanë shansë, nuk u ofrohet rasti. Kujtoj, se ky është numri më i madh që duhet të aktivizohet. (Tanja Jovović, Anima, Kotor, Mali i Zi, Konsultimet kombëtare me grupet e grave në Mal të Zi, Podgoricë, 23 tetor 2009)

Konsultimet kombëtare me grupet e grave mbi Iniciativën për krijimin e KOMRA-s

Konsultimet lokale me mbrojtësit

Donja Stubica, Kroaci
28 tetor 2009.

Konsultimet lokale në Donja Stubica i ka organizuar Qendra MIRAMIDA nga Grozhnjani (Kroaci). Në tubim kanë qenë të pranishëm gjithsej 23 pjesëmarrës. Fjalët hyrëse i kanë mbajtur Eugen Jakovčiq (Documenta, Kroaci), Vesna Tershe-liq (Documenta, Kroaci), Dragan Popović (Fondi për të Drejtat e Njeriut, Serbi), Gordan Bosanac (Qendra për Studime Paqësore, Kroaci) dhe Suzana Kunac (B.a.b.e, Kroaci). Moderatorë kanë qenë Goran Božićević (Miramida, Kroaci) dhe Mirjana Bilopavloviq (Del-fin, Kroaci).

Propozimet, mendimet, Rekomandimet

Me vërtetimin e fakteve mbi luftërat e viteve të 90 –ta do të pengohet manipulimi me të dhënat, që ka ndodhur pas Luftës së II Botërore.

Ne e shikojmë të kaluarën, por me vërtetimin e fakteve (mbi luftërat e viteve të 90-ta) e spastrojmë dhe krijojmë pozicionin më të mirë fillestar edhe për të sotmen edhe për të ardhmen, që të mos përsëritën ato gabime dhe ato manipulime me të dhënat çfarë i kemi përjetuar në kohën pas Luftës së II Botërore dhe lidhur me likuidimet jashtë gjyqësore të pasluftës. Duke dëshiruar të mësojmë nga ajo përvojë, e kemi marrë këtë iniciativë dhe debatet (Vesna Tershe-liq, Documenta, Kroaci, Konsultimet lokale me mbrojtësit, Donja Stubica, Kroaci, 28 tetor 2009)

Faktet lypset të vërtetohen që të pengohet lufta e re në të ardhmen

Njëmend faktet duhet të vërtetohen për të shkuar më tutje në të ardhmen, sepse pa vërtetimin e fakteve si do të marrim vendime në të ardhmen. Çka është në realitet ajo për të cilën do të vendosim,

a do të mundemi ne t'ua përcjellim të rinjve atë libër dhe t'u themi „e tash e tutje është përgjegjësia juaj”, apo pas 25, 50 vitesh do të kemi luftë të re në këto hapësira. Pikërisht këtu e shoh këtë mundësi, domethënë vërtetimin e fakteve si pikënisje esenciale për krijimin e mëtejme të mundësive të ndryshimit të raportit ndaj disa gjërave, aktivitete praktike parandaluese që luftërat në këto hapësira të mos ndodhin më. (Ljiljana Canjuga, UDVDR PGZ, Kroaci, Konsultimet lokale me mbrojtësit, Donja Stubica, Kroaci, 28 tetor 2009.)

Mbrojtësit në Kroaci nuk kanë informacione mbi iniciativën KOMRA.

Po e lexoj këtu regjistrin e këtyre njerëzve që do të duhej të ishin të pranishëm, nga ata ne jemi, nuk di sa, ndoshta 10 për qind apo, as aq jo. E kuptoni njerëzit nuk dinë për çka është fjala, nuk janë të njoh-tuar (...) Pra njerëzit nuk kanë, nuk kanë informacione (Ivan Buriq, HVIDRA Treshnjevka, Kroaci, Konsultimet lokale me mbrojtësit, Donja Stubica, Kroaci, 28 tetor 2009.)

Veteranët kanë potencial të ndihmojnë që të përshpejtohet procesi i pajtimit në rajon.

Mendoj se kjo është një iniciativë (për formimin e KOMRA-s) ku veteranët kanë potencial shumë të madh të ndihmojnë, dhe që disi të përshpejtohet ai procesi i pajtimit në rajon, pa të cilin mendoj se do të ketë ... Sa të ketë pajtim aq do të ketë edhe shoqëri më të shëndosh (Adnan Hasanbegović, Qendra për Aksionin pa dhunë, BeH, Konsultimet lokale me mbrojtësit, Donja Stubica, Kroaci, 28 tetor 2009.)

Pa veteranët Iniciativa KOMRA nuk do ta marrë mbështetjen e të gjitha shtresave të shoqërisë. Mbrojtësit duhet sa më shumë inkuadruar në proces.

Pa veteranët këto procese (Iniciativa për KOMRA) nuk do të kalojnë, thjeshtë nuk do ta marrin mbështetjen, e për një proces të tillë është jashtëzakonisht esenciale mbështetja e shtresave sa më të gjera të shoqërisë civile. (Ljiljana Canjuga, UDVDR PGZ, Kroaci, Konsultimet lokale me mbrojtësit, Donja Stubica, Kroaci, 28 tetor 2009.)

Ja, ne me ardhjen tonë këtu edhe jemi inkuadruar në punën e kësaj iniciative dhe e mbështes. Them më në fund një iniciativë ku mundemi vetë të krijojmë historinë tonë, vetë t'i vërtetojmë faktet, por dërgim se do të duhet të ndryshojmë diçka në qasjen ndaj mbrojtësve apo që mbrojtësit t'i inkuadrojmë më shumë në punën

e kësaj iniciative dhe të shohim me anë të shoqatave të tyre veç e veç çka mendojnë ata mbi këtë (Jelena Laiq, koordinimi i shoqatave të mbrojtësve, të dala nga Lufta Atdhetare e Famullisë së Karlovci, Kroaci, Konsultimet lokale me mbrojtësit, Donja Stubica, Kroaci, 28 tetor 2009.)

Deklarata mbi Luftën Atdhetare që e ka miratuar Kuvendi i Kroacisë është kornizë dhe bazë për mbrojtësit kroat.

Do ta apostrofoj Deklaratën mbi Luftën Atdhetare të Kuvendit të Kroacisë, këtë çdo kund po e theksojmë, pra mendoj se mbrojtësit janë baza e jonë. Ne kemi luftuar për këtë shtet dhe organi më i lartë i pushtetit ka thënë çka mendon mbi Luftën Atdhetare. Këto sot janë korniza nga të cilat ne nuk mund të largohemi dhe atyre do t'u përmbahemi. (Veljko Vičević, UDVR PGZ, Kroaci, Konsultimet lokale me mbrojtësit, Donja Stubica, Kroaci, 28 tetor 2009.)

Veteranët kanë interes të inkuadrohen në proces për t'u hequr njolla nga ata, për t'i gjykuar krimet e luftës që janë bërë në emrin e tyre, në emër të ushtrive dhe emër të shtetit.

Veteranët këtu kanë interes, cilat do ushtri që... Më parë ta lajmë njollën e identiteteve të veta, të ushtrive të veta, pikërisht t'i gjykojnë krimet e luftës të bëra në emrin tonë, në emrin e ushtrisë time ose në emër të shtetit tim për të cilin kam luftuar, apo veç si e përjetojmë atë luftën e kaluar (Adnan Hasanbegović, Qendra për aksionin pa dhunë, BeH, Konsultimet lokale me mbrojtësit, Donja Stubica, Kroaci, 28 tetor 2009.)

Komisioni duhet të merret me bombardimet jo përzgjedhëse të qyteteve, vrasjen me snajper, me torturën e robërve, etj. Në këtë mund të kontribuojnë veteranët.

Atë që e kemi obligim për shkak tonin, për shkak të fëmijëve tanë, është që të paktën ta bëjmë hapin e parë, e kjo është që ato vepra më brutale nga lufta e fundit, domethënë shkeljet e të drejtave primare të njeriut dhe krimet e luftës, pra në kuptimin e gjerë të asaj fjale, të mos e hap tash nëse bombardimi i qyteteve është krim lufte apo vrasja me snajper ose keqtrajtimi i robërve e kështu me radhë. Krejt këto janë gjëra me të cilat ai komision duhet të fillojë të merret dhe mendoj se ne, si veteran, mund të kontribuojmë bukur shumë në këtë kuptim. (Adnan Hasanbegović, Qendra për aksionin pa dhunë, BeH, Konsultimet lokale me mbrojtësit, Donja Stubica, Kroaci, 28 tetor 2009.)

A janë veteranët viktimë, sepse kanë qenë të detyruar ta braktisin familjen për të luftuar?

A ka qenë familja ime viktimë gjatë Luftës Atdhetare për shkak që unë kam shkuar në Luftën Atdhetare dhe e kam qenë unë si mbrojtës viktimë? Kjo ka të bëjë me këtë çështja këtu, me listën e viktimave: kush mundet, kush mund të konsiderohet viktimë? Në këtë rast unë mund të konsiderohem viktimë, sepse nuk kam mbetur me familjen time, nuk kam mbetur të punojë në punën time që e kam punuar dhe të jetojë rehat me bashkëqytetarët e mi, miqtë e mi e kështu me radhë. Vet nuk mund të gjejë përgjigje nëse edhe unë si pjesëmarrës i Luftës Atdhetare, jam viktimë. (Hajro Vanxhiq, Shoqata e Luftës Atdhetare e Brigadës 150, Kroaci, Konsultimet lokale me mbrojtësit, Donja Stubica, Kroaci, 28 tetor 2009.)

Përparësi duhet dhënë komisioneve kombëtare: KOMRA lypset të verifikojë atë se çfarë kanë bërë komisionet kombëtare. Nevojitet të standardizohet procedura në mënyrë që secili komision të punojë në mënyrë të njëjtë.

Kur flasim mbi KOMRA, si Komision rajonal, atëherë kur unë e shikoj KOMRA, unë e shoh ekskluzivisht si komision verifikues i cili thotë se të gjitha komisionet kombëtare kanë punuar sipas metodologjisë unike, sipas mostrës unike statistike, në sjellje unike ndaj viktimave dhe qasje unike, që atë të cilën e kanë bërë komisionet kombëtare është ajo që duhet dhe ne e konfirmojmë nga ana jonë si diçka që është ashtu. Domethënë, unë megjithatë përparësi u jap komisioneve kombëtare pikërisht për shkak të lirisë së qasjes edhe dokumentacionit, mënyrës së lirë të deklarimit edhe të viktimës edhe të kryesit. Kurse qasjes rajonale i jap vetëm si diku i cili në fund do të miratojë se vërtetë kjo ka qenë ashtu. (Ljiljana Canjuga, UDVR PGZ, Kroacia, Konsultimet lokale me mbrojtësit, Donja Stubica, Kroaci, 28 tetor 2009.)

(...) të gjithë ne dëshirojmë të bisedojmë mbi mandatin e KOMRA, sa dhe si ai duhet të duket e kështu me radhë. Por unë e shoh esencën në standardin ose standardizimin e procedimeve dhe të veprimeve tek të cilat, me të cilat dhe me ndihmën e të cilave do të arrijmë rezultate në shkallë kombëtare. Nëse kjo do të miratohet, sipas meje, ai standard i procedimit dhe veprimit, kjo do të thotë se komisioni i cilit do rang dhe nivel në Serbi, Bosnjë e Hercegovinë, në Kosovë, Mal të Zi e Kroaci, thjeshtë me faktet të cilat ai do t'i vërtetojë se janë të tilla, do t'i qaset në mënyrë standardizuese dhe do t'i përshkruaj ato në mënyrë të njëjtë. Këtë e konsideroj me atë standardin e procedimit dhe të veprimit. Atëherë niveli rajonal,

nëse ndërtohet, mund të merremi vesh më shpejtë se kush do ta përbejë komisionin rajonal. (Veljko Vičević, UDVR PGZ, Kroaci, Konsultimet lokale me mbrojtësit, Donja Stubica, Kroaci, 28 tetor 2009.)

Nevojitet të formohet Komisioni rajonal i cili do ta respektojë identitetin e Luftës Atdhetare. Kroacia posedon 80 për qind të fakteve të vërtetuara mbi Luftën Atdhetare. Selia e komisionit kombëtar nuk është e domosdo të jetë në Zagreb.

Ajo që po e shoh në realitet është respektimi i komisionit rajonal i cili do të respektojë identitetin e luftës dhe do të niset nga e njohura drejtë të panjohurës. Që do të thotë se nëse ne e konfirmojmë metodologjinë unike sipas të cilës pastaj do të punojnë të gjithë në kuadër të një gjëje, ne qysh tash veç mund të themi lirisht se Kroacia posedon 80 për qind të fakteve të konfirmuara e verifikuara nga anë të ndryshme. Se ekzistojnë regjistrat e viktimave sipas mënyrës të cilën e ka pranuar shteti, se ekziston regjistri i mbrojtësve, se ekziston përcjellja statistike e vdekjeve të dhunshme prej vitit 1989, që gjithashtu disponon standarde të caktuara statistikore. Pra veç posedojmë disa të dhëna nga të cilat duhet të nisemi. Por gjithashtu lypset ta respektojmë edhe vullnetin e bashkësisë lokale nëse selia e komisionit duhet të jenë atje. Mendoj se bashkësia lokale më së miri mund të vendos nëse për atë është e pranueshme që selia e komisionit të jetë në Vukovar ose në Pakrac ose në Osijek, apo kudo tjetër kund. (Ljiljana Canjuga, UDVR PGZ, Kroaci, Konsultimet lokale me mbrojtësit, Donja Stubica, Kroaci, 28 tetor 2009.)

Nuk është mirë që dëshmitarët në dëgjimet publike të flasin nga dora e dytë, veç në emrin e vet dhe për atë çfarë ju ka ndodhur atyre.

Ajo që mendoj se nuk është mirë pikërisht është ai dëgjimi publik. Ne kemi dëshmuar në Budvë (Forumi i pestë rajonal për drejtësinë në tranzicion) në një dëgjim që ishte përtej kritereve të deriatëhershme të shprehjes së nocionit të viktimës, shprehja e asaj që ka ndodhur. Ishte kjo dëshmi nga dora e pestë në bazë të aktiviteteve të pre-supozuara dhe në realitet tek ne shkaktoj bukur revolt. Mundësi të tilla do të ekzistojnë në çdo dëgjim publik. (Ljiljana Canjuga, UDVR PGZ, Kroaci, Konsultimet lokale me mbrojtësit, Donja Stubica, Kroaci, 28 tetor 2009.)

Paraqitja e të vërtetave kur shtatë thonë “unë flas” e i teti nuk thotë “unë flas unë kam dëgjuar, mua më ka thënë komshiu.” A po më kuptoni? Kjo

në mua ka lënë përshtypje të gabueshme, unë e kam përjetua këtë dhe prandaj mendoj se ai të folur duhet të jetë kompas kur është fjala për dëgjimin. Atë që e ka thënë njeriu ai me siguri atë do ta përjetojë dhe qëndron prapa kësaj, ai do ta argumentojë edhe mënyrën edhe faktin si të vërtetohet kjo që e ka thënë. E kjo thash e them është pikëpyetje dhe nga kjo duhet ikur. (Veljko Vičević, UDVR PGZ, Kroaci, Konsultimet lokale me mbrojtësit, Donja Stubica, Kroaci, 28 tetor 2009.)

Nuk është mirë që puna e përgjithshme të mbështetet në parashtrimin e viktimës, sepse mund të krijohen hipoteza të gabueshme për faktet historike.

Nëse e gjithë puna mbështetet në dëshminë e viktimës, kush do ta konstatojë se është e vërtetë dhe a është relevante ajo viktimitë. Këtu ka shumë pyetje, sepse është e mundshme të konstruktohen rrëfime nga më të ndryshmet dhe të krijohet pasqyrë e gabueshme, jo vetëm tek në personalisht veç në opinion, në tërësi, dhe të krijohen hipoteza të gabueshme për faktet historike mbi të cilat ndërtohet e ardhmja. (Zheljko Shpeliq, tubimi i oficerëve kroat të Pakracit dhe Lipikit, Kroaci, Konsultimet lokale me mbrojtësit, Donja Stubica, Kroaci, 28 tetor 2009.)

Viktimat nga bindja më e thellë mund ta shpallin ndonjë person kriminel dhe ta stigmatizojnë, e që ai në procedimin gjyqësor të lirohet.

Unë mund të them njëmend nga bindja më e thellë se sikur dikush mua të ma kishte bërë atë e atë, e pastaj në procedimin hetues e gjyqësor vërtetohet se kjo nuk është ashtu, çka atëherë, çka me atë stigmatizim që do të shqiptohet publikisht? A jemi ne të gatshëm të ballafaqohemi me këtë, apo megjithatë më me ëndje do t'i shfrytëzojmë mundësit teknike të incizimit, verifikimet e atij fakti e pastaj prezantimet me dorëza. (Ljiljana Canjuga, UDVR PGZ, Kroaci, Konsultimet lokale me mbrojtësit, Donja Stubica, Kroaci, 28 tetor 2009.)

Viktima duhet të dëshmojë vullnetarisht, e jo me detyrim me bindje. Nëse kërkojnë duhet mbrojtur identiteti edhe i viktimës edhe i kryesit.

Nga ana tjetër ne po flasim mbi viktimen e cila është e mundshme të ketë qenë fëmijë kur është bërë viktimitë, ndoshta ajo nuk dëshiron ta thotë identitetin e vet. Po flasim mbi përdhunimin, ndoshta viktima e përdhunuar nuk do ta tregoj identitetin e vet, e këtu

edhe pse flitet mbi komisionin hetimor, ne megjithatë punojmë mbi baza vullnetare, domethënë viktima dhe kryesi duhet të ofrohen vullnetarisht dhe t'i paraqesin disa fakte. Këtu tash shtrohet pyetja se në çfarë mënyre të sigurohet ai vullnetarizëm, në çfarë mënyre të mbrohet identiteti i viktimës dhe në çfarë mënyre, në fund të fundit, të mbrohet identiteti i kryesit? (Ljiljana Canjuga, UDVDR PGZ, Kroaci, Konsultimet lokale me mbrojtësit, Donja Stubica, Kroaci, 28 tetor 2009.)

Nuk duhet thirrur me emër e mbiemër viktimat, vullnetarizmi duhet të jetë qasje kryesore, gatishmëri e viktimës se dëshiron publikisht ta shpreh atë që e bartë në vete. Sipas meje, mendoj se kjo do të ishte mirë, e jo kur ne i dimë disa njerëz që janë viktima i dimë dhe themi „hajt Shtef bash ti ke ardhur këtu të thuash diçka” dhe ai druhet, e ne pastaj pak e bindim, mendoj se kjo nuk është mirë (...) Domethënë evidentimi deri në viktimën e fundit po, por dëgjimi apo të mundësuarit që secila viktima të dëgjohet apriori jo, vetëm ata që janë të gatshëm, e shprehin në njëfarë mënyre gatishmërinë dhe dëshirën ta bëjnë këtë. (Veljko Viçević, UDVDR PGZ, Kroaci, Konsultimet lokale me mbrojtësit, Donja Stubica, Kroaci, 28 tetor 2009.)

Dëgjimi publik për viktimat ka rëndësi terapie.

Unë gjithashtu kam marrë pjesë në dëgjime dhe kam pa se kjo ka rëndësi të jashtëzakonshme terapie, dhe kjo ka ndikuar pozitivisht në viktimat të cilat e kanë shkundur në njëfarë mënyre, të them ashtu, atë hidhërim të keq që e bartin në vete. Dhe ndryshe i kanë shikuar më vonë gjërat pas kësaj paraqitje. Unë vërtetë jam dëshmitar i kësaj dhe them e kam pa këtë, e këta janë ata që këtë kanë dashur ta bëjnë dhe mendoj se kjo është mirë.. (Veljko Viçević, UDVDR PGZ, Kroaci, Konsultimet lokale me mbrojtësit, Donja Stubica, Kroaci, 28 tetor 2009.)

Është e pamundshme të arrihet konsensusi mbi të gjitha çështjet deri në dhjetor të vitit 2010. Opinioni ende nuk është sensibilizuar me iniciativën.

Sa kuptova herën e fundit kur ishim në Vukovar (Konsultimet me bashkësinë lokale në Vukovar më 30 shtator 2009.), tani veç ekziston ajo që thuhet deadline (dita e skadimit), momenti kur dokumenti (modeli dhe mandati) do të dorëzohet Saborit, e ne praktikisht akoma si kemi definuar themelet. Kjo është keq, kjo është tepër keq sepse duhet lënë të paktën gjashtë muaj j kohë për ta aktivizuar sen-

sibilizimin e opinionit ndaj kësaj. (Ljiljana Canjuga, UDVDR PGZ, Kroaci, Konsultimet lokale me mbrojtësit, Donja Stubica, Kroaci, 28 tetor 2009.)

Ndryshe, ne vazhdimisht në jetë jemi të kufizuar me diçka, me këtë rast jemi mjaftë të kufizuar me kohën (10.12.2009), ngase për konsultime të tilla, respektivisht që të fitojmë njëfarë konsensusi apo mendimin e ndonjë populli mbi diçka, lypset pak më shumë kohë. (Bruno Çaviq, UDVDR PGZ, Kroaci, Konsultimet lokale me mbrojtësit, Donja Stubica, Kroaci, 28 tetor 2009.)

Ndaj cilave viktima do t'i vërtetojë faktet ky komision, kush është këtu viktima, këtu ka shumë pyetje. E sikurse u tha koha për paraqitjen e kërkesave qeverive është gjithsej një vit, nuk i kemi të definuar pikënisjet për përcaktimin e rregullave që di t'i miratojnë qeveritë. Mund të ndodh që ne qeverisë tonë t'ia imponojmë me një milion nënshkrime njëfarë detyrimi të cilin nuk është e gatshme ta pranojë. (Zheljko Shpeliq, tubimi i oficerëve kroat të Pakracit dhe Lipikit, Kroaci, Konsultimet lokale me mbrojtësit, Donja Stubica, Kroaci, 28 tetor 2009.)

A do të mundemi në atë mënyrën të tillë të njëjtë, nëse e unifikojmë qasjen, a do të marrim miratim të tillë tek tjerët, apo njerëzit që do të punojnë në këtë a do të pranojnë njësojë. A do të ndodhë situata e njëjtë se dikush vërtetë do të donë ta thotë se si e ka përjetuar realisht kur ta definojmë edhe kush në esencë do të thërret të deklarohet si viktima apo viktima në proces, gjegjësisht se ka qenë në ndonjë formë të viktimit. A do të mundet kjo të zbatohet edhe në republikat, shtetet tjera, e të gjitha ato janë republika, të gjitha janë deklaruar si republika, pra a është kjo e mundshme? Unë vërtetë duke e njohur ish republikat, e shtetet e tashme, duke e njohur njerëzit atje dhe situatën që është, nuk jam optimist për atë që po e shoh dhe dëgjoj edhe me anë të mediave, dhe çfarë janë reagimet ndaj disa gjërave, për shembull, vizitat e vendeve të burgosjes e të mundimit të mbrojtësve kroat në Stajiqevë dhe Begejci e kështu me radhë. Nuk jam sa duhet i entuziazmuar. Jo, jo nuk shoh se është ndonjë klimë e mirë, e dita e skadimit është 12. 2010. (Bruno Çaviq, UDVDR PGZ, Kroaci, Konsultimet lokale me mbrojtësit, Donja Stubica, Kroaci, 28 tetor 2009.)

Mbledhja e nënshkrimeve duhet të mbështetet në kriteret e qarta.

Unë personalisht nuk kam hasur në mundësinë që t'ia sqarojë vetvetes një milion nënshkrime, pra një

milion nënshkrime në Kroaci do të nevojiten, që do të mbliidhen në mbarë territorin e ish Jugosllavisë, domethënë këto shtatë shtete. Mund të nënkuptojë se atëherë në Kroaci të mbliidhen dyzetmijë nënshkrime, diku në Maqedoni gjysmë milioni, që kjo në realitet do të thotë se Kroacia nuk është e gatshme për këtë, kurse Maqedonia po shpreh vullnet më të madh. (Ljiljana Canjuga, UDVDR PGZ, Kroaci, Konsultimet lokale me mbrojtësit, Donja Stubica, Kroaci, 28 tetor 2009.)

Komisioni në Kroaci duhet ti fillojë hetimet prej vitit 1990, sepse Mbrojta Territoriale është çarmatosur më 1990, kurse edhe mitingjet e urrejtjes dhe fjalët e urrejtjes në media kanë filluar më 1990.

Për këtë shkak është jashtëzakonisht esenciale për Kroacinë që të përcillet prej vitit 1990. Përse prej vitit 1990? Jo vetëm pse Kuvendi e ka miratuar Deklaratën mbi Luftën Atdhetare, jo vetëm pse në Ligj prej vitit 1990 deri më 1996 trajtohet se ka qenë luftë në kuptimin e ngushtë të fjalës, veç për shkak se atëherë është bërë çarmatosja e Mbrojtjes Territoriale, që është esenciale sepse kjo në realitet gjithë Kroacinë e trajton si viktimë. Sepse nëse dikuja ia merrni mundësinë të mbrohet, atëherë ai automatikisht në raport me dhunën e veprimit ndaj vetes dhe dëmit që ka përjetuar, bëhet viktimë, sido që ta kthejmë. Nga ana tjetër edhe mitingjet edhe fjalët e urrejtjes edhe ndryshimet në media janë bërë më 1990, më pas vetëm është çështje e superstrukturës (Ljiljana Canjuga, UDVDR PGZ, Kroaci, Konsultimet lokale me mbrojtësit, Donja Stubica, Kroaci, 28 tetor 2009.)

Institucionet duhet t'i hapin arkivat e veta dhe gjithë dokumentacioni duhet të ketë qasje.

Ai komision nuk guxon të ketë mandat tepër të gjatë, por këtu atëherë është rëndësia e të gjitha organeve, organeve zyrtare të cilët tash veprojnë dhe merren përafërsisht me ato disa çështje në shtetet kombëtare, që thjeshtë t'i hapin arkivat e veta sipas mënyrës se krejt çfarë kanë siguruar deri më tash, automatikisht të ketë qasje dhe pastaj, sipas këtyre standardeve, mund t'i qasemi secilit fakt. (Veljko Viçević, UDVDR PGZ, Kroaci, Konsultimet lokale me mbrojtësit, Donja Stubica, Kroaci, 28 tetor 2009.)

Nëse KOMRA e pranojnë të gjitha shtetet, atëherë e kemi tërhequr vijën dhe e kemi pamundësuar manipulimin me faktet.

Loja me historinë mund të jetë e rrezikshme. Çfarë po dua të them me këtë, në qoftë se ashtu do ti qasemi KOMRA dhe do të arrihet përfundimi apo ndonjë rezultat, pra përfundimi, ai nuk do t'u mundësojë disa kinse historianëve që një ditë nipit tim, nëse do të kem fare, ndonjë dr, mr, vjen dhe për shkak të prosperitetit dhe interesit të vet nis të nguc ndonjë fakt nga Lufta atdhetare (...) Kjo po na ndodh në këto hapësira pas Luftës së II Botërore, të gjithë po lajkatojnë dhe të gjithë për qëllime të politikës ditore (...) nëse ato të dhëna do të miratohen në një platformë të gjerë dhe në qoftë se janë të gatshëm njerëzit më përgjegjës të politikës së shteteve kombëtare t'i pranojnë ato të dhëna dhe t'i konfirmojnë si të tilla, atëherë e kemi tërhequr vijën çfarëdo që të jenë ata. (Veljko Viçević, UDVDR PGZ, Kroaci, Konsultimet lokale me mbrojtësit, Donja Stubica, Kroaci, 28 tetor 2009.)

Qëllimi përfundimtar duhet të jetë vërtetimi i të vërtetës. Që të arrihet e vërteta duhet vërtetuar shkaqet. Kur të vërtetohet shkaqet, do të dihet kush është viktimë.

Mendoj se e vërteta është qëllim përfundimtar, jo faktet veç e vërteta në fund. Mirëpo, që të arrijmë këtë duhet më përpara t'i krijojmë disa parakushte, domethënë duhet të dimë kah shkon ajo e vërtetë, kur ka filluar e gjithë kjo, për çka e konfirmojmë të vërtetën, çka janë shkaqet? Domethënë kemi pasur një luftë, në Kroaci ajo është definuar, prej vitit 1990 deri më 1996 quhet Lufta Atdhetare dhe thuhet ka përfunduar më 1996. A ka përfunduar, kur ka filluar, 1990., 1991., 1941. apo nuk e dimë nëse Arsenija i III Çarnojëviq i ka sjellë serbët në Kroaci në ikje para turqve, apo me ekspeditë pushtuese? Deri kur do të kthehemi në këtë dhe ku do të nisim të mbledhim fakte mbi shkaqet e luftës (...) A e kemi pranuar ne të gjithë në rajon dënimin e atij fakti të shkakut të luftës. Kur ta kemi këtë, kur ta dimë çka është shkak, çka është fillimi i luftës, atëherë do të dimë kush është viktimë. (Zheljko Shpeliq, tubimi i oficerëve kroat të Pakracit dhe Lipikit, Kroaci, Konsultimet lokale me mbrojtësit, Donja Stubica, Kroaci, 28 tetor 2009.)

Nëse vërtetimi i fakteve reduktohet në deklaratat e viktimave, do të kemi vetëm kryesisht imediat, nuk do t'i kemi udhëheqësit, iniciatorët e politikave dhe bartësit e funksioneve të shtetit të cilët krejt e kanë organizuar dhe zbatuar.

Kryesisht, kush janë ata? Nëse çështjen e reduktojmë në viktimën, nëse viktima paraqet kundrimin e vet të

pësimi personal, në fund do të fitojmë se kanë pësuar vetëm njerëzit e vegjël dhe se kryesit janë vetëm ata ekzekutorët direkt, nuk do t'i kemi ata udhëheqësit, ata iniciatorë të politikave, bartësit e funksioneve shtetërore të cilët këtë e kanë organizuar dhe zbatuar. Pra nuk do ta arrijmë qëllimin e dëshiruar. (Zheljko Shpeliq, tubimi i oficerëve kroat të Pakracit dhe Lipikit, Kroaci, Konsultimet lokale me mbrojtësit, Donja Stubica, Kroaci, 28 tetor 2009.)

Që të mblidhen faktet duhet fituar besimin e njëri tjetrit.

Duhet ti definojmë raportet e ndërsjella dhe të fitojmë besimin, atëherë do të mundemi atë (mblidhjen e fakteve) ta punojmë, ndryshe nuk jam fortë optimist lidhur me këtë. (Zheljko Shpeliq, tubimi i oficerëve kroat të Pakracit dhe Lipikit, Kroaci Konsultimet lokale me mbrojtësit, Donja Stubica, Kroaci, 28 tetor 2009.)

KOMRA duhet të merret me vërtetimin e fakteve, kurse pajtimi e vërtetimi i shkaqeve është hapi tjetër.

Unë KOMRA-n para se gjithash e shoh si një hap, ndoshta tingëllon banale, por mu ai vërtetimi i fakteve mbi krimet e luftës, pra thuaja të shifrave, të provohet të arrihet të ndonjë e dhënë sa njerëz kanë pësuar dhe eventualisht të arrijmë ndonjë fakt mbi kryesit, dhe atë në atë mënyrë që nga hierarkia të zbulohen sa më shumë që është mundshme, ashtu të themi edhe ato përgjegjësi komanduese, vetë iniciatorët e aksioneve të cilat në realitet kanë pasur pasojë direkt krimin e luftës (...) Ashtu që unë po mundohem disi të insistoje në atë që KOMRA një-mend të fokusohet vetëm në faktet, kurse çështja mbi pajtimin, mbi shkaqet, në realitet duhet të jetë hapi tjetër. (Adnan Hasanbegović, Qendra për aksionin pa dhunë, BeH, Konsultimet lokale me mbrojtësit, Donja Stubica, Kroaci, 28 tetor 2009.)

Bashkësia ndërkombëtare është fajtori më i madh. Në qoftë se ka pasur forcë ta ndal luftën, ka mundur edhe ta pengojë të fillojë.

Po kush e ka bërë atë krim? Unë do ta thirrsha bashkësinë ndërkombëtare dhe mendoj se janë fajtorë të vetëm dhe fajtorë më të mëdhenj. A thua vallë zotërinjtë nga shoqëria civile ndonjëherë kanë pasur guxim të dalim me këtë tezë? Ta pyesin dikë nga bashkësia ndërkombëtare pavarësisht që ata financojnë pjesërisht, e kështu me radhë. Sepse ata këtë luftë edhe e kanë nisur edhe e kanë bitisur. Në

Bosnjë e kanë lënë luftën e papërfunduar e cila, unë besoj, nuk do të marrë fund në mënyrë paqësore, dhe për njëqind vitet e ardhshme do të shpërthej serish (...) sepse nëse bashkësia ndërkombëtare ka pasur forcë dhe mundësi ta ndal luftën, ka mundur edhe ta pengojë të fillojë (Ivan Buriq, HVIDRA Treshnjevka, Kroaci, Konsultimet lokale me mbrojtësit, Donja Stubica, Kroaci, 28 tetor 2009.)

Janë tri shkallë për vërtetimin e fakteve: komisioni lokal mbledh të dhëna në terren, Komisionin kombëtar e formon Kuvendi dhe Komisioni rajonal, të cilin e përbejnë përfaqësuesit e komisioneve kombëtare, verifikon se të gjitha komisionet kombëtare kanë punuar sipas standardeve të njëjta, dhe atëherë ua dorëzon për miratim parlamenteve kombëtare.

Domethënë, unë organizimin e komisionit e shoh në tri shkallë: e shoh komisionin lokal i cili vepron në terren dhe atje kryen mbledhjen e të dhënave, të fakteve, dokumenteve, dëgjimin e viktimave, eventualisht mundësinë e të gjitha njohurive që i ka të kapshme dhe që i janë në dispozicion, kjo për mua është shkalla lokale. Komisionet kombëtare janë ato të cilat në realitet i formon Kuvendi dhe i cili delegon anëtarësinë e vet kombëtare brenda. Në kuadrin e atyre komisioneve kombëtare, që fare të arrijmë deri tek KOMRA, pra Komisionet rajonale, duhet të hyjnë edhe përfaqësuesit e komisioneve tjera kombëtare, që të ruhet ai neutralitet, gjegjësisht, praktikisht që ata të cilët vijnë nga shtetet tjera të mundën vërtet të dëshmojnë se janë zbatuar mostrat unike, është punuar në mënyrë unike. Ndërsa komisionin rajonal, këtë e thash, unë e shoh vetëm si verifikim, në realitet që në ndonjë takim të përbashkët, në ndonjë kuvend të përbashkët, t'i miratojë konkluzionet se të gjitha komisionet, komisionet kombëtare, kanë punuar sipas standardit unik, sipas mostrave unike, në mënyrë unike. Dhe atëherë, në të vërtetë, ata t'ua japin atë në miratim parlamenteve të vendeve të veta, që pastaj ato fakte të merren si ligjshmëri në kuadrin e atyre ligjshmërive kombëtare. (Ljiljana Canjuga, UDVDR PGZ, Kroaci, Konsultimet lokale me mbrojtësit, Donja Stubica, Kroaci, 28 tetor 2009.)

Komisioni duhet të jetë i pavarur nga implikimi i politikës, por ka obligim t'i raportojë opinionin.

(...) vazhdimisht po theksohet ajo nevojë për pavarësi (...) kjo është numër një. Unë pajtohem me këtë, ai duhet të jetë i pavarur nga implikimi i politikës (...) ai komision pavarësinë e vetë nuk guxon ta shtrojë në dëm të detyrimit të raportimit të opinionit, detyrimi

të jetët i kontrolluar nga ana e opinionit që të mos ndodh se ai tri vjet tash diku po gropohet, dhe ne tani heshtim e punojmë, e ndërkohë humbët interesi i opinionit (Ljiljana Canjuga, UDVDR PGZ, Kroaci, Konsultimet lokale me mbrojtësit, Donja Stubica, Kroaci, 28 tetor 2009.

Konsultimet lokale me shoqërinë civile mbi Iniciativën për formimin e KOMRA-s

Mitrovicë, Kosovë
29 tetor 2009.

Konsultimet lokale me shoqërinë civile i ka organizuar, organizata joqeveritare Youth Step (Vushtrri, Kosovë). Në tubim kanë qenë prezentë 46 pjesëmarrës: përfaqësuesit e organizatave joqeveritare nga rajoni i Mitrovicës, Vushtrrisë dhe Skenderajt, pastaj gazetarë, studentë, përfaqësuesit e Bashkësisë Fetare Islame, mjekë, historian dhe qytetarë të interesuar.

Ligjërues kanë qenë Ylber Maxhuni (Youth Step, Vushtrri, Kosovë) dhe Amir Kulagliq (Srebrenicë, BeH). Diskutimet i ka moderuar Nazim Bahtiri (Youth Step, Vushtrri, Kosovë).

Propozimet, mendimet dhe Rekomandimet e pjesëmarrësve

Komisioni duhet të merret me faktet por edhe me traumat e viktimave.

(...) jam për atë që ky komision përpos të vërtetës dhe gjithë atyre gjërave që po thuhen aty, ndoshta do të kontribuojë duke bërë trajtimin e njerëzve të cilët janë me këto plagë, fizike, psikike dhe të gjitha tjera. (Xhavit Mehmeti, Sektori i rinisë, komuna Vushtrri/Vučitrn, Kosovë, Konsultimet lokale me shoqërinë civile, Mitrovicë, Kosovë, 29 tetor 2010.)

Kërkim-falja nuk mjafton. Serbia lypset të paguaj reparacion për të gjitha krimet e kryera.

Nuk ndikon vetëm kërkim-falja mirëpo shteti i Serbisë duhet të bëjë pagesë, duhet në ta bëjë dëmshpërblimin për të gjitha krimet. (Mentor Hasani, Youth Step, Vushtrri/Vučitrn, Kosovë, Konsultimet lokale me shoqërinë civile, Mitrovicë, Kosovë, 29 tetor 2010.)

A është mundur të formohet Komisioni duke

pasur parasysh se Serbia nuk e njeh Kosovën?

Sa do të jetë i qëndrueshëm krijimi i një komisioni të tillë kur dihet se Serbia është kundërshtare e përherë e pavarësisë së Kosovës dhe ende e konsideron Kosovën si pjesë të saj. (Flakadan Azemi, student, Vushtrri/Vučitrn, Kosovë, Konsultimet lokale me shoqërinë civile, Mitrovicë, Kosovë, 29 tetor 2010.)

Komisioni i pavarur mund të bëjë shumë në qoftë se do të jetë neutral dhe i drejtë. Nuk guxon të anojë vetëm kah njëra bashkësi.

Nëse dëshirojmë të formojmë një komision, atëherë ky komision duhet të jetë neutral, një komision i cili do të punojë në mënyrë të drejtë për të gjitha komunitetet, një komision i cili nuk do të shikojë të anojë nga asnjë komunitet por do të punojë në mënyrën e vet, në mënyrë të pavarur.

Sepse KOMRA, vetë emri tregon se është komision rajonal, që e përfshin rajonin dhe nuk mund të jetë e drejtë nëse në të përfshihet vetëm një komunitet, por duhet të jenë të gjitha komunitetet të përfshira që të mund të nxirret realiteti në shesh. (...) është me rëndësi që serbët të jenë pjesë e këtij procesi. Pse është me rëndësi? Zotëri Amiri e ceku se ne duhet të fillojmë që të bëjmë hulumtime secili në anën e vet, jo vetëm për ne, që na janë bërë krimet, por t'i hulumtojmë ndoshta edhe rastet që dikush prej neve i ka bërë të tjerëve. (Rexhep Lushta, Bashkësia Islame në Mitrovicë/Mitrovica, Kosovë, Konsultimet lokale me shoqërinë civile, Mitrovicë, Kosovë, 29 tetor 2010.)

KOMRA lypset ti përfshijë edhe krimet që i kanë kryer forcat serbe mbi shqiptarët në Luginën e Preshevës, gjatë kohës së konfliktit me Ushtrinë Çlirimtare të Preshevës, Bujanocit e Medvegjës.

Nuk e di sa është futur në këto rrjedha edhe Lugina e Preshevës, sepse edhe atje ka pasur krime të mëdha, shumë njerëz janë zhdukur dhe nuk dihet se ku kanë përfunduar. Do të thotë duhet të përfshihet Lugina e Preshevës, Presheva-Bujanovci dhe Medvegja. Aty ka pasur një luftë përafërsisht njëvjeçare, ndoshta s'ka qenë ose si doni e quani atë, por ne e quajmë si luftë, sepse ka familje shumë anëtarësh që janë zhdukur ose janë vrarë, kështu që edhe ajo është një lloj lufte. Kisha dashur të dij a do të futet në komisioni edhe kjo pjesë. (Nexharije Islami Pllana, Dona, Mitrovicë/Mitrovica, Kosovë, Konsultimet lokale me shoqërinë civile, Mitrovicë, Kosovë, 29 tetor 2010.)

Shqiptarët e bartin barrën për dhunë në vitin 2004.

(...) nuk duhet me i bërë bashkë ngjarjet e vitit 2004 me ngjarjet e luftës. Për vitin 2004 ne jemi fajtor, ne e kemi bërë, ne jemi përgjegjës edhe për kisha, edhe për shtëpia dhe për të gjitha ato përgjegjës jemi ne dhe atë barrë duhet ta bartim ne. Ne edhe prej luftës duhet të mësojmë, duhet me marrë mësim se çka nuk guxojmë të bëjmë, çka nuk guxojmë me i bërë një etniteti tjetër. (Musa Mustafa, Koha Ditore, Kosovë, Konsultimet lokale me shoqërinë civile, Mitrovicë, Kosovë, 29. tetor 2010.)

Ka propozime që KOMRA të rishikojë, nëse NATO ka bërë krime lufte gjatë bombardimeve.

(...) Nuk di se NATO ka kryer ndonjë krim gjatë bombardimeve. Ajo ka bombarduar caqet ushtarakë, politike dhe komanduese të forcave serbe të cilat kanë bërë krime dhe kanë bërë deportimin e popullatës shqiptare nga Kosova. (Musa Mustafa, Koha Ditore, Kosovë, Konsultimet lokale me shoqërinë civile, Mitrovicë, Kosovë, 29. tetor 2010.)

(...) ne duhet të kërkojmë të dhëna nga NATO (...) të shohim se sa ka uranium këtu. Pas këtyre ne e dimë që uraniumi shkakton edhe sëmundje te njeriut, i kemi mjekët dhe duhet të kërkojmë nga mjekët të na tregojnë sa mund të ndikoj uraniumi te njeriut, sepse të gjitha këto sëmundje e gjithë këto lëngime, të mundohemi të dijmë që në ato caqe të bombardimeve të serbëve, që kanë qenë Kosovë, ato kanë pasur uranium të lartë. (Nexhmedin Munishi, Partia demokratike Turke, Vushtrri/ Vuçitër Kosovë, Konsultimet lokale me shoqërinë civile, Mitrovicë, Kosovë, 29. tetor 2010.)

Ka mendime të ndryshme mbi atë nëse duhet të jepet amnistia apo të propozohet zbutja e dënimeve për kryesit të cilët i zbulojnë varrezat masive.

Sa i përket amnistisë, apo lehtësimit të dënimit, në qoftë se është fjala për kryesit e veprave, unë mendoj se ata s'duhet as të amnistohen, as t'u lehtësohet dënimi. (Nexharije Islami Pllana, Dona, Mitrovicë/ Mitrovica, Kosovë, Konsultimet lokale me shoqërinë civile, Mitrovicë, Kosovë, 29. tetor 2010.)

(...) Ne kemi rastin e të zhdukurve në Kosovë dhe përafësisht i kemi diku rreth 1. 900 të zhdukur ende, dhe nëse e vetmja shans të gjenden ato trupa është që kryesit e krimeve, të thonë vendet e sakta

se ku gjenden ato trupa, me kusht që ti jepet amnistia apo ti lehtësohet dënimi. Në të kundërtën çfarë interesi ka të tregoj se ku është trupi i familjarit nëse nuk ka përfitim. (Besarta Vasija, Fondi për të drejtën humanitare, Kosovë, Prishtinë, Kosovë, Konsultimet lokale me shoqërinë civile, Mitrovicë, Kosovë, 29. tetor 2010.)

Viktimat kanë nevojë që ti dëgjojnë të tjerët dhe ti pranojnë vuajtjet e tyre.

Ne çdo ditë ballafaqohemi me atë sindromën postramatike te personat që kanë përjetuar krimet e vërteta të luftës (...)Këta persona vazhdimisht kërkojnë ndihmë mjekësore, vazhdimisht jetojnë me atë psikozë të ndryshme, ndërsa qeveria jonë ka bërë shumë pak. Shumë pak po them kanë bërë edhe organizatat joqeveritare sepse vazhdimisht do të kishte qenë mirë nëse këto organizata do të organizonin vende ku ata do të mund të drejtohen për ta qarë hallin e tyre dhe të paktën të dëgjohen nga dikush. (Nexharije Islami Pllana, Dona, Mitrovicë/ Mitrovica, Kosovë, Konsultimet lokale me shoqërinë civile, Mitrovicë, Kosovë, 29. tetor 2010.)

Shoqëria civile duhet të ndihmojë që të krijohet kujtesa kolektive mbi të kaluarën, që të mos harrohet çfarë ka qenë, jo vetëm në Kosovë. Prandaj është i rëndësishëm Komisioni Rajonal.

Ata [familjet] asnjëherë nuk do të harrojnë çfarë ka ndodhur. Mirëpo, është obligim i yni, si shoqëri civile dhe si shoqëri në përgjithësi që të krijojmë një kujtesë kolektive për të kaluarën, pra ne nuk guxojmë ti harrojmë, dhe jo vetëm ne në Kosovë, prandaj kjo është edhe një nga arsytet pse duhet të ekzistoj komisioni rajonal (Bekim Blakaj, Fondi për të drejtën humanitare, Kosovë, Prishtinë, Kosovë, Konsultimet lokale me shoqërinë civile, Mitrovicë, Kosovë, 29. tetor 2010.)

(...) mendoj se e kemi detyrë ti ndihmojmë këtij komision(...), mos të merremi shumë me serbët, se a të na kërkojnë falje apo jo. Nuk është shumë me rëndësi ajo, për atë do të vijë koha më vonë. Pra, problemi është që ne t'i identifikojmë rastet, t'i shkruajmë, t'i evidentojmë, t'i qesim në letër. (Musa Mustafa, Koha Ditore, Kosovë, Konsultimet lokale me shoqërinë civile, Mitrovicë, Kosovë, 29. tetor 2010.)

KOMRA duhet ti hetojë vendet për të cilat dyshohet se ka varreza masive. Në Mitrovicë veç 10 vjet nuk është lejuar të ngrihet xhamia e rrënuar, sepse besohet se aty janë trupat e të

vrarëve. Pavarësisht kërkesës së qytetarëve, kjo ende nuk është hetuar.

Në Mitrovicë është xhamia që dikur ka qenë buzë lumit Ibër. Kjo xhami tash e dhjetë vite s'lejohet të ndërtohet e as të rindërtohet. Fatkeqësia më e madhe është se nën gërmadhat e asaj xhamie, ka dëshmitarë të cilët dëshmojnë, se ka kufoma E kemi alarmuar çështjen por kurrë askush nuk ka ardhur për me marrë përsipër hulumtimin e atij vendi. edhe pse është mu në qendër të qytetit. (Rexhep Lushta, Bashkësia Islame në Mitrovicë/Mitrovica, Kosovë, Konsultimet lokale me shoqërinë civile, Mitrovicë, Kosovë, 29. tetor 2010.)

KOMRA duhet të merret me fatin e të zhdukurve dhe viktimat e të dhunës seksuale e psikologjike.

KOMRA përveç asaj se duhet të merret me identifikimin e personave të zhdukur, nuk duhet të anashkaloj edhe çështjen e viktimave të dhunës, qoftë dhunës psikike, qoftë edhe dhunës seksuale. (Rexhep Lushta, Bashkësia Islame në Mitrovicë/Mitrovica, Kosovë, Konsultimet lokale me shoqërinë civile, Mitrovicë, Kosovë, 29. tetor 2010.)

Komisarët dhe anëtarët e Komisionit duhet të jenë njerëz profesionistë dhe të drejtë; juristët, ekonomistët, sociologët, mjekët, anëtarët e familjeve të viktimave, përfaqësuesit e shoqërisë civile.

Komisionarët dhe anëtarë e komisionit, mendoj se duhet të jenë njerëz profesional, siç janë juristët, ekonomistët, sociologët, mjekët, anëtarët e familjeve të viktimave, përmes të cilëve mund të mbledhim të dhënat më të sakta dhe ti zbulojmë faktet. (Musa Mustafa, Koha Ditore, Kosovë, Konsultimet lokale me shoqërinë civile, Mitrovicë, Kosovë, 29. tetor 2010.)

(...) njerëz më të duhur për ofrim të këtyre fakteve do të ishin mirë me qenë me një përgatitje profesionale, si juristë dhe si anëtarë të familjarëve të zhdukurve dhe edhe një pjesë e shoqërisë civile. (Bashkim Asllani, Exploring Intelligence, Bequk/Bećuk, Kosovë, Konsultimet lokale me shoqërinë civile, Mitrovicë, Kosovë, 29. tetor 2010.)

KOMRA duhet tu garantojë siguri personave të cilët e zbulojnë informacionin mbi lokacionin ku janë fshehur trupat e të zhdukurve.

Kur t'i kemi serbët të pranishëm duhet ti ofrojmë siguri, nëse na zbulojnë se ku i kemi njerëzit. Sëpse

edhe ata janë të frikësuar, janë të shtypur prej qeverisë së tyre sepse mund ti vrasin edhe ata, apo tua kidnapojnë familjen, po i dënojnë me burg apo me ndonjë send tjetër, (. .) prandaj ne këtë aspekt duhet me u ofru garanci, një siguri kur për shembull: t'i ofron material ku janë personat dhe ne s'kemi me dhënë dëshmi (...) kush na ka treguar. (Nexhmedin Munishi, Partia demokratike Turke, Vushtrri/ Vuçitrn Kosovë, Konsultimet lokale me shoqërinë civile, Mitrovicë, Kosovë, 29. tetor 2010.)

KOMRA duhet ta mbrojë identitetin e viktimave të përdhunimit. Nëse e fitojnë besimin në ndonjë person apo institucion, me siguri do ta tregojnë tregimin e vet.

Ne në mjekësi kemi raste pa e dhënë identitetin e plotë të personit, e tregojmë moshën, regionin, ndodhinë në përgjithësi dhe kjo duhet me qenë njëjtë edhe për personat që kanë qenë viktimat të dhunimit. Do të thotë duhet me qenë NN, mosha e saj, regionin, si i ka ndodhur kjo, por jo të shkohet me detaje, domethënë me të identifikohet. (...) Këtu është problemi më i madh stigmatizimi i këtyre njerëzve, sepse në qoftë se ata do ta kishin fituar besimin te një person ose te një institucion dhe do të mbështeteshin në mënyrë, do të thotë pa u stigmatizua, sigurisht do ta tregonin tërë historien e vet. (Nexharije Islami Pllana, Dona, Mitrovicë/Mitrovica, Kosovë, Konsultimet lokale me shoqërinë civile, Mitrovicë, Kosovë, 29. tetor 2010.)

Bashkësitë fetare duhet të inkuadrohen në proces. Udhëheqësit fetar mund ti përfitojnë viktimat për të treguar çka ju ka ndodhur.

Sa i përket çështjes së rolit të Bashkësisë fetare apo të liderëve fetarë në këtë proces unë mendoj se liderët fetarë patjetër duhet të jenë të kyçur në këtë proces, sepse ata mund të luajnë një rol jashtëzakonisht të madh, nga fakti se njerëzit kanë një besim të madh te ta. (. .) Unë mendoj se sikur liderët fetarë të jenë të sigurtë te të gjitha komunitetet dhe të mos përzihen në politikë dhe të mos jenë të njëanshëm, mendoj se njerëzit kishin me pas një besim të madh që atyre me ua shpreh atë çka u ka ndodhur. (Rexhep Lushta, Bashkësia Islame në Mitrovicë/Mitrovica, Kosovë, Konsultimet lokale me shoqërinë civile, Mitrovicë, Kosovë, 29. tetor 2010.)

Në debatin mbi KOMRA-n duhet inkuadruar Kryqin e Kuq Ndërkombëtar dhe të gjitha organizatat tjera të cilat kanë fakte mbi atë çfarë ka ndodhur në Kosovë.

Unë e kisha pa të arsyeshme që Kryqi i Kuq Ndërkombëtar, Kryqi i Kuq i Kosovës dhe organizatat që luftojnë për të drejtat e njeriut dhe ata që kanë fakte e argumente të cilat flasin për gjithë atë që ka ndodhur në Kosovës dhe sidomos për krimet, të jenë të kyçura në këtë proces. (Blerim Ibrahim, Vushtrri/Vuçitri Kosovë, Konsultimet lokale me shoqërinë civile, Mitrovicë, Kosovë, 29. tetor 2010.)

Konsultimet kombëtare me intelektualët

Sarajevë, Bosnja e Hercegovina
7 nëntor 2009.

Shoqata e Gazetarëve të BH ka organizuar konsultime kombëtare me intelektualët në të cilat kanë marrë pjesë profesorët dhe asistentët e Fakultetit Juridik, përfaqësuesit e organizatave joqeveritare, të Institutit për personat e pagjetur në Bosnjë e Hercegovinë, organizatave për mbështetje psikologjike viktimave të luftës dhe krimet, Këshillit Qytetar Serb, Qendrës Hulumtuese të Dokumentacionit, Këshillit të Kongresit të Sindikalistëve Boshnjake dhe intelektualë të pavarur. Fjalën e hyrjes e kanë mbajtur Natasha Kandiç (Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi) dhe Bogdan Ivanisheviç (Qendra Ndërkombëtare për Drejtësinë në Tranzicion), kurse tubimin e kanë moderuar Xhenana Karup-Drushko (nënkryetaria e Shoqatës së Gazetarëve të BeH, BeH) nga Sarajeva dhe Vehid Shehiç (Forumi i Qytetarëve të Tuzllës, BeH).

Propozimet, mendimet dhe Rekomandimet

Për të gjitha viktimat është me rëndësi të jenë të njohura e të respektuara në mbarë rajonin e ish RSFJ

Asnjë viktime nuk i mjafton të jetë e njohur vetëm në mjedisin e vet, qoftë ajo edhe bashkësi lokale, qoftë ai shteti në të cilin jeton. Për të gjithë ato është me rëndësi që tjerët të dinë çfarë u ka ndodhur atyre. Edhe ky proces yni konsultativ po tregon se për viktimat është shumë me rëndësi që t'i dëgjojnë viktimat nga shoqëritë tjera që edhe tjerët të cilët nuk kanë qenë viktimat t'i dëgjojnë dhe se u janë qenësore viktimat (Natasha Kandiç, Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Sarajevë, BeH, 7 nëntor 2009.)

Pengesa më e madhe e sqarimit të së kaluarës janë politikanët dhe opinioni publik të cilët të gjykuarit e “vetë” për krime të luftës i shohin si heronj.

(...) nuk ka gatishmëri që të pranohen krimet, veç zyrtarët e këtij shteti e pëlqejnë, a po, të dërgojnë avion për dikë i cili publikisht ka pranuar se ka marrë pjesë, vërtetë më vonë e ka mohuar. Pra, e kanë dërguar avionin për kriminelin e luftës dhe të gjithë neve na ka përcjellë mesazhin e qartë. Ne nga ata njerëz presim që nesër t'i çojnë dy gishta për çfarëdo qasje, pra, qoftë për këtë qasje rajonale qoftë për këtë kombëtare të sqarimit të asaj që ka ndodhur në të kaluarën. Prandaj, mendoj thjeshtë se nuk është as momenti as koha. (Amor Mashović, Instituti për personat e pagjetur BeH, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Sarajevë, BeH, 7 nëntor 2009.)

Dhe në fund të fundit edhe kriminelët e luftës të dënuar, mendoj në ata të Hagës, janë kthye me ngadhënjim në mjedisin e vet dhe atë jo vetëm pse kjo është pjesë e manipulimit, veç që kjo është ndjenjë e opinionit publik. (Zdravko Grebo, profesor, Fakulteti Juridik në Sarajevë, BeH, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Sarajevë, BeH, 7 nëntor 2009.)

(...) këtu në një qytezë, jo larg Sarajevës, një kriminel lufte pritët në stadium me flamuj e muzikë. Një tjetër pritët në ndërtesën e Presidencës së Bosnjës e Hercegovinës. Për një të tretin shkojnë avionët. Dhe nuk jam i sigurt se strukturat shtetërore mund të japin ndonjë kontribut në vërtetimin e fakteve. (Josip Muslimović, avokat, Mostar, BeH, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Sarajevë, BeH, 7 nëntor 2009.)

Komisioni mund ta avancojë procesin e kërkimit të të pagjeturve, por ekziston frika se ai komision do të mund të nxjerrë mjete të donatorëve për zhvarrosje dhe identifikime.

Ideja si ide është jashtëzakonisht fisnike. Natyrisht se komisioni rajonal apo kombëtar mund ta avancojë këtë proces (kërkimin e të pagjeturve), mund të vij më lehtë se organi i shtetit apo institucioni tek dëshmitarët që do t'i flasin më lehtë Fondit për të Drejtën Humanitare, ose nesër komisionit kombëtar apo rajonal, se sa ndonjë institucioni (kombëtar) shtetëror. Kam frikë, kam frikë se komisioni rajonal apo kombëtar mund të nxjerrë mjete potenciale të donatorëve apo të pushtetit në rajon ose prej njërit nga këto shtete të rajonit, që të mund të nxjerrë mjete të cilat do të duhen për identifikimin e mëtejme, dhe

identifikimin e mëtejme në veçanti, sepse deri më tash shtetet janë marrë me zhvarrosjen e viktimave. (Amor Mashoviq, Instituti për personat e pagjetur BeH, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Sarajevë, BeH, 7 nëntor 2009.)

Edhe pse nga aktgjykimet e Gjykatës së Hagës del se çka janë shkaqet dhe karakteri i luftërave në ish Jugosllavi, komisioni nuk do të mund të merret me shkaqet.

Pjesa e konsiderueshme e të vërtetave veç është dhënë, ato të vërtetat më qenësore mbi shkaqet, mbi karakterin nëse doni, (aktgjykimet e Gjykatës së Hagës), mundemi ne të mohojmë sa të duam. Mund t'i mjegullojmë gjërat. Gjërat e qarta dalin nga aktgjykimet çka është shkaku dhe çfarë ka qenë karakteri i luftës në hapësira. Respektivisht i të gjitha luftërave në hapësirën e ish Jugosllavisë (...) do të jetë i pamundshëm, kushdo që të jetë në atë komision, që ai të merret me shkaqet e ndodhive në hapësirën e ish Jugosllavisë. (...) (Amor Mashoviq, Instituti për personat e pagjetur BeH, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Sarajevë, BeH, 7 nëntor 2009.)

Dëshmimi publik i viktimave ndihmon të mësojmë për vuajtjet e tjerëve.

Dëgjimet publike gjithsesi -po. Duhet menduar mirë mënyrën si duhet të bëhet kjo. Ato u nevojiten edhe viktimave. Ato na nevojiten edhe të gjithë neve, të gjithë neve të cilët akoma nuk dimë as një pjesë të vërtetës mbi vuajtjet e tjerëve. Pra, unë e mbështes qasjen e tillë (...) atë që nuk e dimë janë ato të vërtetat e njerëzve të vegjël të cilët nuk kanë media, nuk kanë mënyrë që ta thonë të vetën, por duan. Ata nuk janë dëshmitarë në gjyqime. Ata nuk kanë shprehur të shkruajnë libra. Ata duan me gjuhën e thjeshtë, me gjuhën e atij nën qielli të vetë ta shprehin çka është ajo që u dhemb. E, kjo është ajo që na mungon neve dhe që me siguri nuk do të mund ta arrijmë me anë të gjyqimeve, por mundemi sipas mënyrës që na orien-ton kjo iniciativë dhe unë këtë mbështes. Por, por pa pretendime. (Amor Mashoviq, Instituti për personat e pagjetur BeH, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Sarajevë, BeH, 7 nëntor 2009.)

Ajo që është problem yni, e nuk di si ta tejkalojmë, është si të qasemi që ai segment i kornizës instituci-onale, që është i domosdoshëm për të qenë valide, e gjithë kjo bashkë të arrihet duke qenë se e kemi poli-tikën të atillë çfarë është. Nga të nisemi? Sipas meje, nuk mund të shkojmë në historinë e shekullit të kalu-ar 18, 19, 20, por të nisemi nga kjo që është prapa

nesh, në 20 vitet e fundit çfarë ka ndodhur. Por cilës rrugë? Dëshmitë publike janë diç që mund të arrijnë efekte të mira tek popullata duke qenë se njerëzit nuk kanë rast ta dëgjojnë këtë, por të përfshihen sa më shumë media, sepse këto vërtetë janë rrëfime të cilat s'mund t'i mohoni, e rrallë ballafaqohen (...) Shtrohet pyetja përse jam vetëm unë këtu nga Banja Luka? (...) I jap mbështetje edhe të organizatës në të cilën veproj, por nuk dua të jam skeptike. (Lidi-ja Zhivanoviq, Parlamenti i Helsinkit i Qytetarëve të Banja Llukës, BeH, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Sarajevë, BeH, 7 nëntor 2009.)

Viktimat tona mbrohen me dënimin e viktimave tona

Nëse do të ishte e mundshme të ri-pozicionohet vik-tima në gjithë këtë çështje që të mos jetë vetëm dëshmi-tar, por të jetë edhe akuzues (prokuror), atëherë mund të bëhet diçka. Pasi që krimi nuk mund të arsyetohet me kurrigje dhe pasi që krimi vetëm mund të gjyko-het, atëherë gjykimin e krimit në vete duhet ta marrë pikërisht viktimat. Përfundimisht, viktimat duhet t'u thotë kriminelëve të vet, kriminelëve nga ana e vet – nuk është dashur të na mbronin me krim dhe mos u thirrni në ne gjatë mbrojtjes së juaj. (...) Viktimat tona mbrohen me gjykimin e kriminelëve tonë. (Esad Baj-tal, filozof, BeH, Konsultimet kombëtare me intelek-tualët, Sarajevë, BeH, 7 nëntor 2009.)

Askush nuk po e mohon nevojën për vërtetimin e fakteve.

(...) vërtetimi i fakteve është diçka që vështirë mund të mohohet si nevojë që fare të nis biseda serioze dhe e ndershme mbi ato tmerre që kanë ndodhur në këto hapësira. (Zdravko Grebo, profesor, Fakulteti Juri-dik në Sarajevë, BeH, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Sarajevë, BeH, 7 nëntor 2009.)

Qasja rajonale jo vetëm që është e nevojshme, por edhe e domosdoshme. Ajo e hap rrugën për balla-faqim me krimet dhe përgjegjësinë personale.

Nëse kjo është diç që duhet të jetë detyrë jona pri-mare, që më parë të ballafaqohemi me krimet që janë bërë direkt apo ndoshta tërthorazi, krejt është njëjtë, sepse flasim për vendin e përgjithshëm të përgjegjësisë. Mirëpo, nëse, si do të thosha, unë nuk marrë inkurajim nga njerëzit të cilëve u besojmë edhe nga Beogradi, Zagrebi, Prishtina, Podgorica, atëherë kjo detyrë në interpretim të përgjithshëm del tradhti apo tradhti e madhe. Dhe ju thotë – a, po ata. Jo, ata flasin për krimet e veta, apo, e hajde edhe

ne për tonit, apo. Qasja rajonale jo vetëm që është e nevojshme, por është edhe e domosdoshme. (Zdravko Grebo, profesor, Fakulteti Juridik në Sarajevë, BeH, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Sarajevë, BeH, 7 nëntor 2009.)

(...) nuk duhet pritur ndonjë kontribut të madh të këtyre organizatave shtetërore, por ndoshta pikërisht në një komision të tillë që do të formohej dhe i cili edhe do të bashkëpunonte në një plan rajonal, mund të jap ndonjë kontribut të konsiderueshëm.. (Josip Muselimi, avokat, Mostar, BeH, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Sarajevë, BeH, 7 nëntor 2009.)

Kushti për tu formuar KOMRA është që Serbia dhe BeH ta njohin Kosovën, e për këtë nuk ka gjasë në të afërm e shpejt. Si të zgjidhet ai problem?

Ai që to ta pëlqejë KOMRA dhe vërtetimin rajonal të fakteve, duhet ta njoh Prishtinën, duhet ta njoh Kosovën dhe anasjelltas. Unë realisht nuk po shoh në këtë moment, nuk po shoh në të ardhmen e afërt se do të ndodhë që Sarajeva dhe Beogradi për shkaqe të ndryshme, apo arsyeje të njëjta, ndoshta ta njohin Prishtinën. (Amor Mashoviq, Instituti për personat e pagjetur BeH, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Sarajevë, BeH, 7 nëntor 2009.)

Në debatin mbi formimin e KOMRA duhet shfaqur kujdes mbi atë se të gjithë pjesëmarrësit nuk janë njësojë të informuar, e pastaj të thuhet qartë cilat janë mangësitë e cilat përparësitë e komisioneve për të vërtetën.

Mendoj se në tubimet dhe konsultimet si këto i mbështes por, që tha edhe profesor Grebo, duhet disi t'ua prezantojmë tjerëve që nuk janë të njoftuar sa duhet, cilat janë përparësitë eventuale dhe cilat janë mangësitë, dhe në atë mënyrë ta hapim diskutimin. (Midhat Izmirlija, Fakulteti Juridik në Sarajevë, BeH, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Sarajevë, BeH, 7 nëntor 2009.)

Me fakte do ta pengojmë manipulimin me të vërtetën.

Gjykata e Hagës me anë të aktgjyqimeve të veta ka vërtetuar se të gjithë kanë bërë krime. Dhe ky është fakt jo kontestues, dhe kjo për mua është shumë e qenësishme. Ajo që duhet të bëjmë, e me këtë të gjithë pajtohemi, është që t'u ndihmojmë edhe institucioneve zyrtare, këtu më parë mendoj në organet gjyqësore,

por ja kemi edhe institutet për të pagjeturit dhe disa institucione tjera që janë formuar në shkallë të shtetit. Shanset për komisionin janë që megjithatë të vijë deri tek faktet që, themi ne në popull, t'ia hapë shpirtin viktimës apo ndonjë dëshmitari që të mund të prezantojë kundrimin e vet të ngjarjet së caktuar. Dhe këtu unë e shoh rolin e madh të ardhshëm të KOMRA-s dhe kjo është detyra jona kryesore. Me fakte do ta pengojmë manipulimin me të vërtetën. (Vehid Shehiq, Forumi i Qytetarëve të Tuzllës, BeH, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Sarajevë, BeH, 7 nëntor 2009.)

Në tubimet e këtilla duhet ftuar edhe ata që kanë komanduar e nuk janë akuzuar për krime të luftës, të thonë kush u ka urdhëruar të bëjnë vepra të këqija.

Është me rëndësi që ne në tubime të tilla, ndonjëherë, mund t'i ftojme edhe ata që kanë komanduar, kanë luftuar në luftë, por jo edhe kriminelët e luftës që të janë shënuar për Hagë, veç bie fjala, komandantët të cilëve deri tash kush nuk u ka bërë vërejtje, e kanë qenë komandant. Ata të na thonë se kush u ka urdhëruar të bëjnë vepra të këqija? Çka kanë urdhëruar vetë? Përse të vetët, në mbrojtjen e vetë komandës më të lartë kanë pranuar organizata paramilitare të cilat kanë bërë krime. (...) Jam i bindur personalisht se ai Komision ka edhe çka të bëjë, por dhëntë Zoti të merren vesh. (Veljko Droca, Këshilli i Qytetar Serb, BeH, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Sarajevë, BeH, 7 nëntor 2009.)

Në mandatin e KOMRA duhet të kemi obligimin të punojmë me mjedisin social, që procesi i kërkimit të drejtësisë dhe i ballafaqimit me të vërtetën, të jetë nevojë e mjedisit e jo nevojë e strukturave të caktuara.

Unë jashtëzakonisht e mbështes këtë ide. Gjatë pesë viteve të fundit më me intensitet po punoj me viktimat nga Srebrenica. Organet gjyqësore bien aktgjykimin. E identifikojnë fajtorin. Viktima është stigmatizuar në mjedis për arsyen që i është pranuar statusi i viktimës dhe torturës nëpër të cilën ka kaluar. Vetëdija e njerëzve të rinj në mjedisin një-nacional në rajonin e Bosnjës veriore-lindore është formësuar, kemi bërë një mini hulumtim, është që ata janë luftëtarët e ardhshëm të cilët do ta korrigojnë padrejtësinë nga kjo luftë. Ky është fakt. (...) Unë do të propozoja që në mandatin e KOMRA-s të kemi obligim të punojmë me mjedisin social, që procesi i kërkimit të drejtësisë dhe i ballafaqimit me të vërtetën të jetë nevojë e mjedisit e jo nevojë e strukturave të caktuara. Pa atë që

këtë proces ta reduktojmë në shkallë të rrethit social, që nevoja për të vërtetën të jetë nevojë e mjedisit, ne nuk do të shkojmë larg. (Salih Rasavac, Kori-dor, BeH, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Sarajevë, BeH, 7 nëntor 2009.)

Është e paevitueshme përfshirja e bashkësive fetare në debatin mbi të kaluarën.

Është e paevitueshme edhe përfshirja e bashkësive fetare duke marrë parasysh ndikimin e tyre të madh. Por ata duhet sinjerisht të tregojnë, jo për hir të formës, se dëshirojnë të ballafaqohen me të kaluarën. (Vehid Shehiq, Forumi i qytetarëve të Tuzllës, BeH, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Sarajevë, BeH, 7 nëntor 2009.)

Komisioni duhet ta hartojë antologjinë e teksteve të gazetareve që e kanë përgatitur materializimin e idesë e cila ka sjellë deri ke krimet.

E përshëndes iniciativën, sepse pavarësisht sa kemi punkte të tilla që merren me këtë çështje, gjithmonë ka pak, ngase krimi është planetar. Sipas meje do të duhej që ky institucion (KOMRA) ta hartojë antologjinë e teksteve të gazetareve të cilët janë luftë nxitës, kriminel, të cilët i përgatisin shpirtat për materializimin e idesë. Jam për atë që të futet, nëse mundet, një klauzolë e shkurtër mbi ata gazetarë dhe të hartohet antologjia, antologjia empirike që është reprezentative dhe të shihet qartë se si dikush i ka përgatitur shpirtat për disa gjëra. (Ibrahim Bushatlija, Këshilli i Kongresit të Intelektualëve Boshnjak, BeH, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Sarajevë, BeH, 7 nëntor 2009.)

Arsyeja elementare dhe logjike e ekzistimit të komisionit: kemi varreza, kemi viktima, kemi eshtra, por nuk i kemi kriminelët dhe fajtorët.

Arsyeja elementare dhe prapë e logjikshme për ekzistimin e komisionit është kjo, shumë e shkurtër, shkollore, e shkollës fillore: shumë varreza, kemi varre, kemi eshtra, kemi viktima. Pra, kemi krimet e nuk kemi kriminelët dhe nuk kemi fajtorët. (Esad Bajtal, filozof, BeH, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Sarajevë, BeH, 7 nëntor 2009.)

Komisioni rajonal është i rëndësishëm edhe për shkak të regjistrimit të viktimave i cili do të tregojë se edhe tek ata tjerët gjithashtu ka viktima.

E kam pasur të rëndësishme të vi sepse këtë ide e mbështes, kam dëgjuar më herët, kam lexuar ca

materiale, përcjellë dhe prandaj jam këtu. Mendoj se ky Komisioni rajonal është shumë i rëndësishëm për ne. Nëse asgjë tjetër, kur ti marrim ata regjistra, shumica do të kuptojnë e shohin se edhe tek ata tjerët, ta përdori fjalorin e tyre, gjithashtu ka viktima. Përse këtë po e reduktojë mu në atë shembullin më banal? Vi nga qyteti ku ende gjithçka pra edhe kjo që po e frymojmë, është e ndarë në ajër. Çdo gjë është e dyfishtë, edhe qyteti ku po shkollohen e edukohen luftëtarët e ardhshëm mbi këto fakte. Nga qyteti ku kopshtet e fëmijëve, shkollat fillore, shkollat e mesme, universitetet, institucionet e kulturës dhe krejt e jona dhe e tyrja. (...) Ende nuk e kam dëgjuar cilëndo viktima pas cilitdo aktgjykim të shqiptuar, në cilëndo gjykatë, qoftë ai aktgjykim edhe 40 vjeç burg, të ketë thënë se është e kënaqur. Nuk ka katarzë pas aktgjykimit. Çdo gjë mbetet njëjtë. Mbetet mos kënaqësia. Mbetet boshllëku. Mbetet ndjenja- s'ka drejtësi. (Sead Gjuliq, Qendra për edukatë dramatike dhe Teatri i të rinjve të Mostarit, BeH, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Sarajevë, BeH, 7 nëntor 2009.)

Pengesat më të mëdha janë religjioni i bashkuar dhe politika e keqe.

Ky është akt i guximshëm dhe moral, meriton respektim dhe mbështetje, që të arrijmë të vërtetën dhe njohuritë e mirëfillta. Sipas njohurive të mia, tek ne pengesat më të mëdha janë religjioni i bashkuar dhe politika e keqe. Religjioni është bërë sot politikë më e rrezikshme. Ai harron gjërat e veta elementare, sepse për te politika është më e rëndësishme. Bashkësitë religjioze janë parti politike dhe ato i pranojnë këta ashtu sikurse janë. (Lazar Manojloviq, profesor nga Bjeljina, BeH, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Sarajevë, BeH, 7 nëntor 2009.)

Konsultimet kombëtare me grupet e grave mbi formimin e KOMRA-s

**Tuzëll, BeH
11 nëntor, 2009.**

Konsultimet i ka organizuar Shoqata Vive Gratë nga Tuzlla. Kanë marrë pjesë 40 përfaqësues të organizatave joqeveritare nga Bosnja e Hercegovina, të cilat merren me të drejtat e grave, por edhe me pozitën e grave viktima të luftës. Kanë marrë pjesë dy përfaqësues nga Kroacia si dhe dy përfaqësuese të zyrës rajonale të OSBE në cilësi të vëzhguesit. Fjalët

e hyrjes e kanë mbajtur Vesna Tersheliq (Documenta, Kroaci), Aleksandra Letiq (Këshilli i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në RS) dhe Teufika Ibrahimefendi (Shoqata Vive Gratë, Tuzëll, BeH).

Mendimet, propozimet dhe Rekomandimet e pjesëmarrësve

Në mbarë rajonin ekziston rezistenca e pushtetit ndaj vërtetimit të fakteve mbi krimet e luftës, në radhë të parë sepse në organet janë edhe ata që janë përgjegjës për vepra të këqija.

Në Bosnjë e Hercegovinë por edhe më gjerë, ekziston rezistenca e pushtetit ndaj vërtetimit të fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljet tjera të rënda. Serish përse? Sepse në sistemet e pushteteve, në organet e pushtetit me siguri rrinë ata që janë përgjegjës për ndonjë vepër të keqe nga e kaluara. Dhe atyre hapja e kësaj çështje nuk u shkon në favor. (Amir Kulagliq nga Srebrenica, BeH, Konsultimet kombëtare me grupet e grave, Tuzëll, BeH, 11 nëntor 2009.)

Duhet hartuar regjistrin e viktimave, të dihen emrat se kush ku e ka humbur jetën, me çka është marrë.

Unë angazhohem që të hartohet regjistri por të individualizohen viktimat, që saktë ta dimë cili ka qenë ai njeri apo ai person, çfarë ka bërë, me çka është marrë, ku e ka humbur jetën, cilat janë rrethanat. (Amir Kulagliq nga Srebrenica, BeH, Konsultimet kombëtare me grupet e grave, Tuzëll, BeH, 11 nëntor 2009.)

Faktet do të tregojnë ravijëzimin e shkaqeve të luftës. KOMRA duhet të konfirmojë përse këtu çdo 30, 40, 50 vjet njerëzit bëjnë krime.

(...) në bazë të fakteve unë mendoj se mund të shihen ravijëzimet e shkaqeve të kësaj krize tonë në Ballkan.(...) Shkaqet janë shumë qenësore. Në qoftë se KOMRA faktikisht nuk arrin ndonjë ravijëzim të shkaqeve, atëherë s'kemi bërë asgjë.(...) Këtu për ne është shumë rëndësi që të arrijmë njohurinë se cilat janë ato shkaqe që vazhdimisht pas çdo 30, 40, 50 vitesh i shtynë njerëzit të bëjnë krime. (Fikret Grabovica, Shoqata e prindërve të fëmijëve të vrarë të Sarajevës së rrethuar, 92-95, Sarajevë, BeH, Konsultimet kombëtare me grupet e grave, Tuzëll, BeH, 11 nëntor 2009.)

KOMRA lypset ta përfshijë periudhën e përgatitjes së luftës.

Bie fjala në Srebrenicë tri vjet para se të filloj lufta, i hapën rrugët nëpër mal. Pse po hapën rrugët nëpër mal? Thotë, po duan të eksportojnë dru. Përgatitjet janë bërë. E transferuan armatimin territorial nga Srebrenica. Burri im ka qenë intelektual. E ka ditur çka do të thotë kjo. E pyet Sava Aleksiçin krye-shefin e Sekretariatit të Punëve të Brendshme të Komunës: 'Çka po bëjnë këtë Savo?' Thotë: 'Ndoshta janë vjetruar. Po duan ti zëvendësojnë.' Mirëpo e lanë qytetin pa mbrojtje. Kjo ka qenë përgatitje. Dhe duhet të nisemi nga këto fakte edhe në KOMRA për të konfirmuar përse na ka ndodhur e gjithë kjo. Dikush këtë e ka planifikuar paraprakisht. (Kada Hotiq, Shoqata e BeH, Konsultimet kombëtare me grupet e grave, Tuzëll, BeH, 11 nëntor 2009.)

Viktimat kanë nevojë të flasin por duhet të kenë besim, që dikush ti dëgjojë dhe kuptojë ato. Duhet t'ua kthejmë besimin në potencialin dhe dinjitetin e vet. Vetëm ashtu mund të marrin forcë për të dëshmuar.

Viktimat kanë nevojë të flasin.(...), duan që dikush ti dëgjojë, ti kuptojë, respektojë, që tu kthehet dinjiteti. (...) Ato duhet të besojnë në potencialin e vet personal se mund ta thonë atë, të kenë besim, (...) të besojnë se këtë mund ta bëjnë, të kenë forcë ta bëjnë këtë (...) që ai të jetë dokument në bazë të së cilit mund ta konfirmojmë rrjedhën e ngjarjeve.

Institucionet gjyqësore e konfirmojnë, sikurse thash, të vërtetën por nuk mund ti kënaqin nevojat e viktimave. Viktimat kanë nevojë të flasin. Unë e kam thënë diku edhe këtë se nuk ka kush ti dëgjojë. Ne duhet të jemi të ndershëm, se bëjnë bisht ti dëgjojnë viktimat. Ne po themi dëgjimi i viktimave, por viktimat po duan të ekzistojë dikush që ti dëgjojë. Ato nuk mund ti flasin murit. Ato po duan të dëgjohen, të kuptohen, të respektohen, tu kthehet dinjiteti. (Teufika Ibrahimefendi, Shoqata Vive Gratë, Tuzëll, BeH, Konsultimet kombëtare me grupet e grave, Tuzëll, BeH, 11 nëntor 2009.)

Duhet të dëgjohen rrëfimet e të gjitha viktimave. Ky është respektim e jo njëjtësim.

(...) Nuk dua të përziehem në atë që ka ndodhur në Kalinovik, çfarë ka ndodhur në Konjicë, në Mostar, sepse ato gjëra nuk i di. Dua ti pranojë me respekt, jo me vlerësim, jo me cilësimin se rrëfimi im është më i rëndë, rrëfimi im është tjetër faresh e kështu me radhë. Kjo është mënyrë e vetme. Ky nuk është njëjtësim, sepse ne e dimë çka na ka preokupuar më së shumti, Srebrenica dhe fillimi i luftës, edhe Kapi-

ja dhe Markalle në Sarajevë e kështu më radhë, kjo domethënë ku kanë ndodhur krimet që kanë qenë me numër të madh. (Teufika Ibrahimefendi, Shoqata Vive Gratë, Tuzëll, Konsultimet kombëtare me grupet e grave, Tuzëll, BeH, 11 nëntor 2009.)

Komisioni rajonal mundëson të mësohet e vërteta për banorët e Srebrenicës, të cilët në prill të vitit 1992 kanë ikur në Mal të Zi, nga atje janë internuar dhe prej atëherë ju humbët çdo gjurmë.

Përse qasja rajonale për vërtetimin e fakteve? Sepse nuk mund të mësojmë çfarë ka ndodhur në Srebrenicë; një grup i banorëve të Srebrenicës, komshinj të mi, në prill të vitit '92, kanë shkuar në Mal të Zi (...) autoritetet e Malit të Zi ata ia kanë dorëzuar policisë së të ashtuquajturës Republika Serpska. Ata njerëz janë vvarë. Kurrë asgjë nuk kemi mësuar për ta. (...) Po si do ta mësojmë të vërtetën për ata njerëz nëse nuk do të ketë qasje rajonale, në qoftë se autoritetet në Mal të Zi nuk e hapin arkivin dhe nuk thonë çfarë ka ndodhur dhe ku janë ata njerëz, dhe nëse nuk përgjigjen kriminelët. (Amir Kulaglic, nga Srebrenica, BeH, Konsultimet kombëtare me grupet e grave, Tuzëll, BeH, 11 nëntor 2009.)

KOMRA duhet të merret edhe me pësimin e fëmijëve.

Po flasim për të zhdukurit, për të vvarët, për mbrojtësit, për përdhunimet. Mendoj se është mirë që zotëriu sot është këtu dhe që e përmendi dhe duhet folur për fëmijët, se fëmijët kanë qenë viktimë e madhe në rajon dhe në Bosnjë e Hercegovinë. (Rosama Miliq, Shoqata 22 Maji, Kapija, Tuzëll, BeH, Konsultimet kombëtare me grupet e grave, Tuzëll, BeH, 11 nëntor 2009.)

Komisioni qendror duhet të jetë urë midis shoqatave të viktimave dhe organeve gjyqësore dhe të ketë nën-komisione me qarkullim të rregulluar të informacioneve.

Unë mendoj se ky (...) duhet të jetë Komisioni qendror me një varg nën-komisione individuale, të cilat (...) funksionojnë me qarkullimin e përsosur të informacioneve. (...) Komisioni qendror edhe duhet të jetë urë midis shoqatave që merren me viktimat e luftës dhe vetë organeve gjyqësore (...) ta shtrëngojmë shtetin të ndihmojë në zgjidhjen e atyre problemeve. (Aida Omeragiq, Medica, Zenicë, BeH, Konsultimet kombëtare me grupet e grave, Tuzëll, BeH, 11 nëntor 2009.)

Faktet mbi viktimat dhe krimet do ta ndërpresin komplotin e heshtjes dhe të mohimit.

Është shumë e rëndësishme të jepet emri e mbiemri, viti i lindjes dhe çdo gjë tjetër që do të jetë në mandatin e Komisionit. Kjo duhet të rregullohet në mënyrën (...) që të ndërpritet komploti i heshtjes dhe i mohimit, sepse është tepër e rëndësishme të vërtetohen faktet mbi krimet, numri i saktë. (...) (Teufika Ibrahimefendi, Shoqata Vive Gratë, Tuzëll, BeH, Konsultimet kombëtare me grupet e grave, Tuzëll, BeH, 11 nëntor 2009.)

Në organet e KOMRA nuk duhet të jenë politikanët as personalitetet publike nga shkenca, kultura, sporti. Duhet të jenë personat me moral të lartë sipas profesionit, të pangarkuar me të kaluarën, individët që do ta shikojnë interesin e të gjithëve.

(...) në organet e administratës që do ta formojmë, nuk duhet të jenë as politikanët, as shumë personalitete aktuale nga bota e shkencës, kulturës, sportit (...) në krye të Koalicionit (KOMRA) duhet të jenë ekskluzivisht personat që janë të interesuar dhe të cilët do ta zbatojnë interesin e shoqatave. (...) Duhet të keni njerëz të ndershëm, të respektuar në këtë, të cilët nuk do ta shikojnë interesin e vet e personal meskin, por do ta shikojnë interesin e të gjithëve. (Edin Turiq, Shoqata e Qytetarëve 25 Maji – Kapija, Tuzëll, BeH, Konsultimet kombëtare me grupet e grave, Tuzëll, BeH, 11 nëntor 2009.)

Unë mendoj se duhet përcaktuar kriteret të cilët do ti respektonin të gjithë anëtarët e Komisionit. Që ata të marrin profilin e personave me moral të lartë nga profesioni, nga të gjitha profilet e mundshme, të pangarkuar me të kaluarën. Vetëm njerëzit e atillë mund të përfaqësojnë realisht, respektivisht që në fund të nxjerrin ndonjë konkluzion nga e gjithë kjo. (Fikret Grabovica, Shoqata e prindërve të fëmijëve të vvarë të Sarajevës së rrethuar, 92-95, Konsultimet kombëtare me grupet e grave, Tuzëll, BeH, 11 nëntor 2009.)

Në BeH nuk ka zgjidhje sistimore të reparacionit. KOMRA duhet ta zgjidh këtë.

Forma sunduese të reparacionit [në BeH] janë vetëm kompensimet e shtetit që u ndahen viktimave civile të luftës, invalidëve ushtarak të luftës. (...) nuk ka zgjidhje sistimore (...) veç qasje në mënyrë të ngushtë, duke u reduktuar në pagimin e kompensimeve mujore individuale për shkak të dëmtimeve

trupore dhe në bazë të personit të vrarë, të vdekur apo të zhdukur. Në bazë të keqtrajtimit seksual, në bazë të përdhunimeve...(Teufika Ibrahimoviq, Shoqata e Qytetarëve Vive Gratë, Tuzëll, Konsultimet kombëtare me grupet e grave, Tuzëll, BeH, 11 nëntor 2009.)

Shoqata 25 Maji Kapija do ti bashkohet Koalicionit për KOMRA në qoftë se është i pavarur nga ndikimi politik.

Edhe ne me ëndje do ti bashkohemi këtij Koalicioni, por në qoftë se ai nuk është nën përkujdesjen e cilitdo opsioni politik, në cilindo rajon...(Edin Turiq, Shoqata 25 Maji, Kapija, Tuzëll, BeH, Konsultimet kombëtare me grupet e grave, Tuzëll, BeH, 11 nëntor 2009.)

Mosinteresi i mediave është tregues se shteti nuk ka interes të dëgjojë për të kaluarën. Vazhdimisht po dërgohet mesazhi se duhet harruar të kaluarën, duhet kthyer ekonomisë.

(...) problemi esencial i mediave dhe i gjithë kësaj teme është se në esencë shteti për momentin nuk ka interes për këtë (...) Mendimi imë është se në realitet shteti nuk ka interes të dëgjojë për të kaluarën, sepse vazhdimisht kemi parullat, jemi dëshmitar të kësaj, se duhet ta harrojmë të kaluarën, kjo pareshtur po sforcohet. Duhet ta harrojmë të kaluarën dhe ti kthehemi ekonomisë. (Jasna Zečević, Vive Gratë, Tuzëll, Konsultimet kombëtare me grupet e grave, Tuzëll, BeH, 11 nëntor 2009.)

Për gazetarë lypset organizuar trajnime të veçanta, që ti kuptojnë instrumentet e drejtësisë në tranzicion.

Mendoj se nevojiten të organizohen trajnime dhe seminare të veçanta pikërisht për gazetarët lidhur me këtë temë. (Zorica Rikiq, PAN radio, Bjelinë, BeH, Konsultimet kombëtare me grupet e grave, Tuzëll, BeH, 11 nëntor 2009.)

Konsultimet me bashkësinë lokale mbi Iniciativën për KOMRA

**Shabac, Serbi
13 nëntor 2009.**

Konsultimet me bashkësinë lokale në Shabac i ka organizuar Zyra për të rinj e Qytetit të Shabacit (Ser-

bi). Kanë marrë pjesë gjithsej 23 veta, përfaqësues të vetëqeverisjes lokale, të këshillave komunale të partive parlamentare, të gazetarëve, institucioneve kulturore dhe të organizatave joqeveritare. Ligjërues kanë qenë Marijana Toma (Impunity Watch, Serbi) i Dragan Popoviq (Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi). Moderator ka qenë Dragan Popoviq (Fondi për të Drejtën Humanitare).

Mendimet, propozimet dhe Rekomandimet e pjesëmarrësve.

KOMRA do tu ndihmojë gjeneratave të reja e të vjetra që të kuptojnë çfarë ka ndodhur në të kaluarën.

Komisioni Rajonal për konfirmimin e të vërtetës dhe iniciativa e cila ka lindur që ai Komision rajonal të formohet, mendoj se do tu shërbejë pikërisht gjeneratave të reja të kuptojnë çfarë ka ndodhur kjo, kurse neve të moshuarve me siguri të na njoh edhe me të vërtetën e mirëfilltë. (Ana Llaziq, Zyra për të rinj e Qytetit të Shabacit, Konsultimet me bashkësinë lokale, Shabac, Serbi, 13 nëntor 2009.)

Nëse nuk vërtetohen faktet e kaluara do të na ngarkojë.

Lidhur me ballafaqimin me të kaluarën. Mendoj se ky është proces i domosdoshëm dhe është e nevojshme të hyhet në të sa më shpejtë. Sepse neve vetvetiu e kaluara do të na ngarkojë nëse nuk vërtetohet çka janë faktet. (Ivan Dosković, Arkivi historik ndërkomunal, Shabac, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Shabac, Serbi, 13 nëntor 2009.)

Në kompetencë duhet të jetë mbledhja e atyre fakteve rreth të cilave të gjithë pajtohen, si për shembull që të vërtetohet fati i të zhdukurve.

Kjo, nga aspekti teknik, është punë shumë e madhe dhe mendoj se ajo shkallë e fakteve, rreth së cilëve të gjithë pajtohen që të konfirmohet numri i të zhdukurve, të vërtetohet fati i tyre, veç kjo nënkupton mund të madh hulumtues (...). Kujtoj se është qenësore të mendohet mirë shkalla e duhur e operacionit që të realizohet ajo që është aspekt politik i një organizate të këtillë dhe ajo rreth të cilës pajtohen të gjithë, që kjo të bëhet ashtu si duhet. Unë mendoj se popujt, elitat politike nga këto hapësira, shpesh janë të prirë për avashllëk, të marrin vendime të madha e që në fund të mos bëhet asgjë. Dhe kujtoj se ky është një rrezik latent kur flitet për çfarëdo lloji veprimi. (Gjorgje Radović, Klubi Rotarian Shabac, Serbi,

Konsultimet me bashkësinë lokale, Shabac, Serbi, 13 nëntor 2009.)

Konfliktet që kanë ndodhur në BeH, Kroaci dhe në Kosovë kanë specifika dhe nuk mund të radhitën në një kontekst.

Nuk është i njëjtë konflikti në Bosnjë e Hercegovinë, raporti i serbëve dhe boshnjakëve, i serbëve dhe kroatëve, nuk është raporti i njëjtë i serbëve dhe shqiptarëve. Në njëfarë mënyre secila nga këto tema është bilaterale, kurse përgjegjësia e të gjithë popujve, organizatave dhe individëve që të merren veç e veç me secilin nga ato konflikte ... Në njëfarë kuptimi kjo është hapësirë unike, ajo ka qenë RSFJ, por në esencë secili nga ato konflikte ka llojin e dimensionit të vetë specifik, gjenezën dhe kjo nuk mund të futet në të njëjtin kontekst. (Gjorgje Radoviq, Klubi Rotarian Shabac, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Shabac, Serbi, 13 nëntor 2009.)

Viktimat duhet të marrin satisfaksion e me anë të kësaj do të arrihet pajtimi.

Mendoj se është më me rëndësi që viktimave tu jepet satisfaksion, e me anë të kësaj do të arrihet pajtimi dhe vazhdimi i jetës normale në këto territore.. (Marica Llazareviq, Partia Liberal Demokratike, Shabac, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Shabac, Serbi, 13 nëntor 2009.)

Pajtimi është proces shumë i gjatë dhe varet nga viktimat të cilat akoma nuk i kanë gjetur mbeturinat mortore të më të afërmeve të vet.

Do të thosha se vetëm pajtimi si pajtim, si proces është shumë i gjatë dhe nuk mund të realizohet tek ashtu. Sepse nuk varet vetëm nga ne që jemi për këtë, veç nga njerëzit që janë viktimat dhe të dëshirojnë ti gjejnë të zhdukurit e vet dhe të kenë ku të lutën për shpirtin e tyre. (Ksenija Pantiq, Partia Liberal Demokratike, Shabac, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Shabac, Serbi, 13 nëntor 2009.)

Që të arrihet pajtimi nevojitet të dihen shkaqet e konflikteve

Nëse flasim për pajtimin midis kombeve të cilat, si të them, janë grindur, më parë duhet të dimë cila ka qenë natyra e atij konflikti. (Zhivan Llazareviq, Iniciativa Rinore e të Rinjve të Shabacit, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Shabac, Serbi, 13 nëntor 2009.)

Rruga drejtë katarzës (pastrimi moral i shpirtit) është gatishmëri të pranohet se pjesëtari i popullit "tim" ka bërë krim.

Rruga e vetme e katarzës (pastrimit) tuaj është që qartë të përcaktoheni ndaj kësaj dhe të thoni "po, këtë e ka bërë pjesëtari i popullit tim, por unë me këtë nuk pajtohem thellësisht. Kjo është për dënim më të ashpër, kjo nuk guxon kurrë të përsëritet, kjo është e paparë, më vjen keq që këta kanë qenë pjesëtarë të popullit tim, do të më vinte njëjtë keq sikur këtë ta kish bërë edhe dikush tjetër." Thjeshtë të kuptohet se krimi është ai që është problem, se secila viktimë meriton të paktën atë që është kujtesë, ajo kujtesë e gjallë është diç e cila pengon që gjërat e tilla të përsëriten. (Gjorgje Radoviq, Klubi Rotarian Shabac, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Shabac, Serbi, 13 nëntor 2009.)

Me amnisti nuk mund të inkurajohen kryesit të cilët kanë nevojë të flasin për atë çfarë kanë bërë. Ashtu mund të zbulohen krimet më monstruoze.

Mendoj se ideja për ndonjë amnisti është e mirë në kuptimin e hierarkisë së krimit (...) që krimet më monstruoze të mund të procedohen, duhet tu jepet njëfarë inkurajimi njerëzve të cilët e ndiejnë nevojën të flasin për atë çfarë kanë bërë. (Ivan Doskoviq, Arkivi historik ndërkomunal, Shabac, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Shabac, Serbi, 13 nëntor 2009.)

Mbi amnistinë nuk mund të arrihet konsensusi në rajon.

Kemi mjaftë prova edhe pa i sjellë ata kriminel për të dëshmuar, atëherë nuk ka nevojë të flitet për amnistinë, por në qoftë se nuk ka atëherë ndoshta do të ishte mënyra më e mirë sigurimi i të dhënave (...) Konsensusi nuk mund të arrihet në ndonjë bashkësi më të madhe shoqërore, kur unë vet në kokën time nuk mund ta sqarojë nëse kjo është metodë e mirë apo jo. (Ivan Qosiq, Partia Liberal Demokratike, Shabac, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Shabac, Serbi, 13 nëntor 2009.)

Me vërtetimin e fakteve dhe me pranimin e krimit nga ana e kryesve do të pengohet relativizmi i krimit.

Konsideroj se kjo luftë kundër relativizmit të krimit, respektivisht ngritja e shkallës së vetëdijes në popullatë duhet të jetë një nga modeli i veprimit. (...) Pra,

kjo me siguri do të bëhet më mirë me vërtetimin e fakteve dhe së dyti, me pranimin e krimit nga ana e vetë kriminelëve, respektivisht kryesve të krimit. (Ivan Dosković, Arkivi historik ndërkomunal, Shabac, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Shabac, Serbi, 13 nëntor 2009.)

Nga ana morale nuk është mirë që KOMRA të hartojë listën e kryesve, sepse secili është i pafajshëm derisa nuk dëshmohet e kundërta.

Konsideroj se nuk duhet hartuar direkt regjistrat e kriminelëve, respektivisht të njerëzve që kanë bërë krime, sepse mendoj se kjo është e gabueshme nga aspekti moral, ngase nisem nga preambula -se secili është i pafajshëm derisa nuk dëshmohet e kundërta. Me këtë nuk do të pajtohesha me që mendoj se është më i madh dëmi se dobia nga këta far regjistra, sepse kjo më duket diqysh si dëbim nga vendi (përndjekje). (Ivan Dosković, Arkivi historik ndërkomunal, Shabac, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Shabac, Serbi, 13 nëntor 2009.)

KOMRA duhet ti hetojë ngjarjet që kanë ndodhur midis vitit 1991 dhe 2000.

Konsideroj se korniza e fillimit kohor që duhet ta marrë KOMRA për punën e vetë të jetë viti 1991 (...) deri në mesin e vitit 1999. Ndoshta madje edhe deri vitin 2000. (Ivan Dosković, Arkivi historik ndërkomunal, Shabac, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Shabac, Serbi, 13 nëntor 2009.)

Dokumentacionin që e mbledh KOMRA duhet ta shfrytëzojnë prokuroritë deh gjykatat.

Sa i prehtë procedimit të përgjegjësve për ato krime, mendoj se ai dokumentacion që do ta mbledh KOMRA duhet të shfrytëzohet për procedime të mëtejshme dhe për vërtetimin e përgjegjësive së gjithë kriminelëve. (Ivan Dosković, Arkivi historik ndërkomunal, Shabac, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Shabac, Serbi, 13 nëntor 2009.)

Ekziston dyshimi se në Serbi ka vullnet politik për tu themeluar KOMRA. Edhe organizatat joqeveritare lypset të zhvillojnë fushatë për KOMRA.

Mendoj se në Serbi, konkretisht po flas për ne, nuk di nëse për momentin ekziston vullneti politik që të mbështetet kjo ide. Unë kujtoj se KOMRA në Serbi mund të ketë sukses në qoftë se do ta ketë mbështetjen e plotë politike, e kjo do të thotë mbështetjen e pus-

htetit ekzekutiv (...) mendoj se edhe organizatat joqeveritare të cilat e mbështesin KOMRA, duhet pak të punojnë më shumë, të kenë një lloji të fushatës dhe ta prezantojnë pozitivisht qëllimin e vet. (Milan Nikoliq, G17 plus, Shabac, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Shabac, Serbi, 13 nëntor 2009.)

Unë fare nuk dyshoj në qëllimet humane të secilit që është i pranishëm këtu, por nuk duhet lënë anash realitetin, e kjo është se vështirë mund të bëhet çfarëdo në mungesë të vullnetit adekuat politik që, fatkeqësisht, në shoqërinë tonë është fakt.. (Dushan Kostadinović, Rinia Demokratike DS, Shabac, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Shabac, Serbi, 13 nëntor 2009.)

Të gjitha shtetet në rajon bartin barrën e të kaluarës së afërt: a do të kenë vullnet ato ta formojnë KOMRA?

Mua më intereson si do të zgjidhet kjo, pasi që këtu po flitet mjaftë për barrën nga e kaluara e afërt në Serbi. Një barë e njëjtë ekziston edhe në Kroaci, në Bosnjë e Hercegovinë, në Kosovë. Në të gjitha territoret në të cilat janë zhvilluar konfliktet ekziston ajo barrë dhe mund të them se shumë vështirë shoqëria dhe tërë ajo hapësirë e ish RSFJ po ballafaqohet me atë të kaluar të afërt (...) Mendoj se nuk ekziston vullneti politik në asnjë shoqëri që të formohet një komision i atillë, respektivisht të funksionojë. (Ivan Dosković, Arkivi historik ndërkomunal, Shabac, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Shabac, Serbi, 13 nëntor 2009.)

Nevojitet të formohet Stacioni televiziv rajonal ose të sigurohet një termin në televizionet kombëtare në mënyrë që opinioni nëpër shtete ti përcjellë dëshmitë publike të viktimave.

Mendoj se do të ishte e mirë ideja që të formohet një stacion televiziv rajonal i cili do të emetonte ato dëshmime publike, ose të sigurohet një termin në televizionet kombëtare në mënyrë që të kemi fotografinë unike dhe që njerëzit nga të gjitha ato shtete do të kishin vend për informacion mbi të gjitha ato dëshmime. (Ivan Dosković, Arkivi historik ndërkomunal, Shabac, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Shabac, Serbi, 13 nëntor 2009.)

Selia e KOMRA duhet të jetë në BeH ngase atje kanë ndodhur krimet më të mëdha.

Sa i përket centralizimit dhe decentralizimit të KOMRA, mendoj se pjesa më e madhe e punës

është në Bosnjë e Hercegovinë, prandaj ndoshta do të ishte mirë që selia e tij të jetët atje. (Marica Llazareviq, Partia Liberal Demokratike, Shabac, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Shabac, Serbi, 13 nëntor 2009.)

Anëtarët e Komisionit duhet të jenë vetëm nga rajoni, por ekziston frika se për këtë shkak edhe mund të shpërbëhet.

A duhet që në komision të ketë edhe të huaj, si dhe kush ti zgjedh ata? Mendoj se nuk duhet. Kujtoj se vetëm popujt që kanë marrë pjesë në gjithë këtë duhet të ulën dhe në mënyrë konstruktive, që ndoshta është më e rëndë por ngadalë, të bisedojnë.

Frikohem që të mos shkatërrohet edhe KOMRA sikurse u shkatërrua edhe ish RSFJ. Këtë frikë e kam nga fillimi qysh se kam nisur të mendoj për gjithë këtë, ndoshta të huajt duhet të kenë implikim vetëm që të shikojnë që ky të mos shkatërrohet. (Dushan Vishnjq, Zyra për të rinj e Qytetit të Shabacit, Shabac, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Shabac, Serbi, 13 nëntor 2009.)

KOMRA duhet ti hetojë ngjarjet në Slloveni dhe Maqedoni.

Mendoj se (KOMRA) duhet të merret me ngjarjet në Slloveni dhe Maqedoni. (Dushan Vishnjq, Zyra për të rinj e Qytetit të Shabacit, Shabac, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Shabac, Serbi, 13 nëntor 2009.)

KOMRA duhet të sigurojë ndihmën psikologjike edhe viktimave edhe kryesve të cilët dëshirojnë të bashkëpunojnë me Komisionin. Ndoshta në këtë mënyrë mund të arrihen informacionet mbi krimet.

Që KOMRA në realitet të jetë organizatë e cila u ofron ndihmë viktimave dhe disa njerëzve të cilët direkt apo indirekt kanë marrë pjesë në krimet e luftës (...) Domethënë nuk është e thënë që ne ti procedojmë ata njerëz në gjykatë. Duhet bërë ndonjë mënyrë të marrëveshjes sepse nëse mund të merret vesh gjykata, pse të mos merret vesh organizata me kryesit. (Millan Nikoliq, G17 plus, Shabac, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Shabac, Serbi, 13 nëntor 2009.)

Që të arrihen qëllimet dhe rezultatet e procesit, nevojitet mbështetja e Bashkimit Evropian dhe në përgjithësi e bashkësisë ndërkombëtare.

Bashkimi Evropian të gjejë mënyrë që t'ia përdredhë krahun diku këtu, atje në Kroaci e me radhë, në mënyrë që i gjithë ky proces të kishte njëfarë kuptimi dhe rezultat (...) mendoj se ndonjë trysni nga jashtë ndoshta do të ndihmonte. (Marica Llazareviq, Partia Liberal Demokratike, Shabac, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Shabac, Serbi, 13 nëntor 2009.)

Konsultimet me bashkësinë lokale mbi Iniciativën për formimin e KOMRA

Vllasenicë, Bosnjë e Hercegovinë, 14 nëntor 2009.

Konsultimet me bashkësinë lokale në Vllasenicë i ka organizuar Shoqata e Familjeve të Viktimave të Luftës Vllasencia '92-95 (BeH) në bashkëpunim me Këshillin e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën Serpska –RS (BeH). Kanë qenë të pranishëm gjithsej 57 pjesëmarrës, përfaqësues të familjeve të viktimave nga Vllasencia, Miliqi, Bratunci, Haxhiqi, Zvorniku dhe Vogoshqa, përfaqësues të bashkësisë lokale, këshilltarë të Komunës së Vllasenicës dhe krye-shefat e komunave Vllasencia e Miliqi. Ligjërues kanë qenë Amir Kulagliq (nga Srebrenica, BeH), Xhevad Bektasheviq (Shoqata e Familjeve të Viktimave të Luftës Vllasencia '92 – '95, BeH) dhe Aleksandra Letiq (Këshilli i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në RS, BeH). Tubimin e ka moderuar Hazim Mujčinović (Shoqata e Familjeve të Viktimave të Luftës Vllasencia '92 – '95, BeH).

Propozimet, mendimet dhe Rekomandimet e pjesëmarrësve

Faktet duhet të hetohen, përvojat të tregohen dhe të shënohet që tu mbeten si vërejtje gjeneratave të ardhshme.

Viktimat e përndjekjes, torturës, të dhunimeve si dhe familjet që i kanë humbur më të dashurit e vet, atë që kanë përjetuar ose humbur kurrë nuk mund ta harrojnë, sepse me ato fshehtësi të vetat, me mendimet e dhimbjen dhe me humbjet, jetojnë çdo ditë (...) në qoftë se veç faktet e cekura nuk mund të anashkalohen, të evitohen ose harrohen, atëherë lypset të hetohen, vërtetohen, dokumentohen, interpretohen por në mënyrë objektive, të vërtetë dhe të ndershme (...) përvojat të tregohen dhe të shënohen që të mbeten si kujtim, respektivisht vërejtje për gjë-

neratat e reja që atyre të mos u përsëritet ajo që kemi përjetuar ne. (Amir Kulagliq nga Srebrenica, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Vllasënica, BeH, 14 nëntor 2009.)

KOMRA do të ketë sukses vetën në qaftë se në tërësi privohet nga ndikimi politik.

Politikanët që punojnë në Bosnjë e Hercegovinë po manipulojnë me shkathtësi (...) popullin e vet (...) Ky është rrëfim i mirë lidhur me atë Komision rajonal, por ai do të ketë sukses në punën e vetë vetëm në qoftë se do të privohet nga çështjet e mëdha politike, (ndikimi) politikanizmi. (Mlladen Popović, kryeshf i Kuvendit të Komunës së Vllasënicës, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Vllasënica, BeH, 14 nëntor 2009.)

Viktimat presin që të zgjidhet fati i të zhdukurve, që të vdekurit të varrosën me dinjitet dhe të tregohet përse ka ndodhur dhe kush e ka iniciuar.

Të gjenden të gjithë që janë zhdukur, vrarë dhe të varrosën me dinjitet. Dhe tjetër, që të identifikohen dhe dënohen kriminelët e luftës (...) të gjithë ne dëshirojmë që në njëfarë mënyre të tregohet e dëshmohet përse ka ndodhur kjo dhe kush e ka iniciuar që të ndodh e gjithë kjo. (Alija Dautović, Shoqata e Viktimave të Luftës Vllasënica 92 – 95, Tuzëll, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Vllasënica, BeH, 14 nëntor 2009.)

Eshtrat e prindërve të mi i kam varrosur vet. Dhimbja e ime e dinë çfarë është, por më besoni se do ta kisha më lehtë vetëm sikur ta dija shkakun përse. Dhe kjo është një lehtësi për shumë viktima të luftës. (...) Familja ime është autoktone në këtë Vllasënicë dhe vërtetë do të doja ta dija përse. (Temima Begović, Shoqata e Familjeve të Viktimave të Luftës '92-'95, Tuzëll, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Vllasënica, BeH, 14 nëntor 2009.)

KOMRA lypset të bashkëpunojë me institucionet të cilat punojnë në evidencimin dhe formimin e bazës së të dhënave mbi viktimat.

Një gjë shumë qenësore kur është fjala për KOMRA, ne nuk mund ti anashkalojmë institucionet e shtetit, entiteteve, komunave (...) disa institucione e organe që merren me këtë problem, që po punojnë në hartimin e regjistrave, që punojnë në formimin e bazës së të dhënave (Ahmet Grahic, Lidhja e Shoqatave Boshnjake të të Zhdukurve, Sarajevë, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Vllasënica, BeH, 14 nëntor 2009.)

Komisioni nuk guxon të jap amnisti, por mund të jap rekomandim për zbutjen e dënimit të kryesve të cilët japin informata të besueshme mbi varrezat masive.

Unë si njeri nuk do ta lejoja amnistinë. Por ndonjë formë e zbutjes së dënimit si këmbim për informacione të mirëfillta mbi të pësuarit, mbi varrezat masive, mbi mbetjet mortore, do të angazhohesha për këtë. (Amir Kulagliq nga Srebrenica, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Vllasënica, BeH, 14 nëntor 2009.)

Viktimat nuk janë luftëtarë që kanë pësuar në luftë.

Kur është fjala për mospajtimin rreth nocionit dhe definicionit të viktimës edhe unë këtu kam mendime të ndryshme. Normalisht se nëse i barazojmë viktimat i barazojmë kriminelët, që nuk mund të jetë se kjo është ashtu. Dallimi është ku është dërgimi masiv, pushkatimi dhe megjithatë janë dallime, sipas meje janë dallime nga ata njerëz që kanë pësuar në luftime. Do të isha i lumtur sikur vëllezërit të kishin pësuar në luftë, sikur të mos ishin pushkatuar me duar dhe sy të lidhur (Ahmet Grahic, Lidhja e Shoqatave Boshnjake të të Zhdukurve, Sarajevë, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Vllasënica, BeH, 14 nëntor 2009.)

Qëllimi i KOMRA-s duhet të jetë që me fakte të ndikojë në sistemin e arsimit në BeH.

Ne, nga përfundimi i luftës veç i kemi të prodhuara katër gjenerata të nxënësve nga arsimimi fillor, i mesëm, i lartë dhe superior. Këto katër gjenerata janë me mijëra fëmijë tanë të cilët i kanë mësuar tri histori (...) do të isha i kënaqur vetëm kur me vërtetimin e fakteve të KOMRA të mund të ndikojmë në sistemin e arsimit në Bosnjë e Hercegovinë dhe në rajon. (Ahmet Grahic, Lidhja e Shoqatave Boshnjake të të Zhdukurve, Sarajevë, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Vllasënica, BeH, 14 nëntor 2009.)

Përpara do të shkohet kur viktimat të nisin të flasin çfarë u ka ndodhur dhe kur kriminelët të përgjigjen.

Mendimi im është se vetëm dialogët e viktimave të familjeve mund të sjellë të vërtetën, dhe krejt çka është politike të evitohet (...) Të bëhet njëfarë mbrojtje e viktimave që të mund të dëshmojnë (...) shumë viktima kanë frikë. Nuk guxojnë të flasin çka ju ka

ndodhur (...) E kur bëhen bisedat me viktimat dhe ushtrohet trysni në prokuroritë që ata kriminel të jenë në vendin ku duhet të jenë, atëherë do të ketë përparim. (Kadefa Rizvanović, Shoqata e Grave të Podrinjës, Bratunac, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Vllasenica, BeH, 14 nëntor 2009.)

Suksesi i KOMRA do të jetë nëse e gjen të paktën një viktimë dhe e identifikon të paktën një kriminel.

Për këtë shkak e mbështes gjithë këtë iniciativë dhe për këtë jam falënderues se (...) ndoshta në njëfarë mënyre mund të bëhet ndonjë satisfaksion për të gjitha viktimat dhe nëse kjo iniciativë dhe ky program rezulton me gjetjen e një viktime apo identifikimin e një kriminel, ky do të jetë sukses. (Alija Dautović, Shoqata e Viktimave të Luftës Vllasenica 92' – 95', Tuzëll, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Vllasenica, BeH, 14 nëntor 2009.)

Njerëzие e rinj që kanë lindur në kohën e luftës, kanë qëndrime më radikale, që krijojnë hapësirë për konflikte të reja. Për këtë shkak është e nevojshme të vërtetohen faktet dhe të ndërpriten interpretimet.

Ajo që gjithë neve mund të na inkurajojë përfundimisht në situatat e caktuara është fakti se njerëzit e rinj, të cilët ndoshta atëherë kanë pasur 2-3 vjet, tash kanë qëndrime më radikale se ata që kanë marrë pjesë në vetë konfliktet në hapësirën e ish Jugosllavisë. Dhe kjo krijojnë mundësi për ndonjë konflikt të ri. Mënyra e vetme që kjo vërtetë të pengohet është që njëherë e përgjithmonë ta vëmë pikën në interpretimet e shumta, interpretimet etnike të asaj që ka ndodhur. Duhet ti shfletojmë faktet. Duhet të krijojmë një shkrim autentik, të vërtetë të asaj që ka ndodhur, të radhiten në mënyrë kronologjike gjërat dhe të quhen me emër të duhur. (Aleksandra Letiq, Këshilli i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën Serpska, Bijeljina, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Vllasenica, BeH, 14 nëntor 2009.)

Familjet e viktimave duhet të inkadrohen në proces dhe qartë ta shprehin qëndrimin e vetë dhe dëshirojnë Komisionin, çfarë Komisioni dhe çka duhet të jetë mandati dhe qëllimi i atij komisioni.

Familjet e viktimave (...) të inkadrohen në procesin e konsultimeve sepse fjala jonë, tragjedia jonë duhet të dëgjohet, duhet të jetë publike dhe ky është

rast (...) që të mos lejojmë të flasin tjerët për ne, veç të flasim ne vetë dhe të themi çfarë Komisioni po dëshirojmë, a e dëshirojmë fare, çfarë komisioni duam dhe çka janë qëllimet e tij, respektivisht mandati i tij dhe krejt ajo që duhet ta bëjë ai (Mevludin Lupiq, Shoqata e Familjeve të Personave Robër e të Zhdukur të Komunës Zvornik, Zvornik, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Vllasenica, BeH, 14 nëntor 2009.)

Raporti i KOMRA duhet të jetë i obligueshëm për të gjitha qeveritë në hapësirën e ish Jugosllavisë.

Që qëllimi i fundit i gjithë kësaj (puna e KOMRA) të jetë ai dokumenti i cili në fund të ishte (...) i obligueshëm për të gjitha qeveritë në hapësirën e ish Jugosllavisë (Alija Dautović, Shoqata e Viktimave të Luftës Vllasenica 92' – 95', Tuzëll, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Vllasenica, BeH, 14 nëntor 2009.)

Qeveritë që do të marrin pjesë në formimin e KOMRA duhet të sigurojnë mjete për funksionimin e tij.

Propozimi im është që (KOMRA) ta mbështesin financiarisht të gjitha qeveritë që janë të përfshira në këtë, respektivisht nga hapësira e ish Jugosllavisë, të cilat marrin pjesë në këtë Komision (Alija Dautović, Shoqata e Viktimave të Luftës Vllasenica 92' – 95', Tuzëll, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Vllasenica, BeH, 14 nëntor 2009.)

Anëtarët e Komisionit duhet të jenë njerëz me respekt e të ndershëm të cilët do të kenë respekt dhe autoritet në rajon. Anëtarë të Komisionit mund të jenë edhe viktimat. Politikantët nuk guxojnë të jenë anëtarë të Komisionit.

Disa kritere qenësore që duhet ti zbatojnë komisarët (...) asnjëri nga komisarët nuk do të duhej të ishte politikan aktiv pikërisht që të orvatët, të them, të realizohet kjo pavarësi politike (...) E dyta, që të gjithë ata njerëz të cilët do të jenë në Komision si komisar, duhet të jenë njerëz me respekt, të ndershëm të cilët gëzojnë autoritet dhe respektim në rajon (...) dikush nga komisarët duhet të jetë edhe viktimë. Përse? Sepse do të mund ti jap ton dhe ndihmë punës së KOMRA. (Amir Kulaglic nga Srebrenica, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Vllasenica, BeH, 14 nëntor 2009.)

Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare mbi Iniciativën KOMRA

Sarajevë, Bosnjë e Hercegovinë
21 nëntor 2009.

Konsultimet i ka organizuar Shoqata e BH Gazetarëve. Në diskutim kanë marrë pjesë 43 aktivistë të organizatave joqeveritare nga të gjitha pjesët e BeH. Me Iniciativën për formimin e KOMRA pjesëmarrësit i kanë njoftuar Xhenana Karup-Drushko (Shoqata BE Gazetarëve), Natasha Kandiq (Fondi për të Drejtën Humanitare) dhe Aleksandra Letiq (Këshilli i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën Serpska).

Mendimet, propozimet dhe Rekomandimet e pjesëmarrësve

Krimet kanë gjurmë nëpër mbarë rajonin e ish RSFJ. Prandaj është i rëndësishëm ky Komision Rajonal.

Më duket se nuk ekziston në nomenklaturën e krimeve të luftës diçka që nuk ka ndodhur në territorin e Bosnjës e Hercegovinës. Edhe mua më intereson që ta përgatisim një dokument të tillë gjithëpërfshirës për njërin nga takimet e ardhshme, që bashkë të shohim sa është ai vëllim i asaj që duhet të hetohet. (...) në atë sulm në Bjelinë ka pësuar numri më i madh i banorëve shqiptarë në Bosnjë e Hercegovinë, dhe ai ka qenë cak i përzgjedhur që shqiptarët të vriten dhe pastaj të thuhet se ky ka qenë sulm i irredentistëve shqiptarë. Ata fshehtas janë transportuar dhe varrosur në Kosovë dhe Maqedoni. Dhe tash shikojeni situatën. Ata që e kanë bërë këtë kanë ardhur nga shteti tjetër dhe pastaj kryesisht janë kthyer. Trupat janë në shtetet e dyta e të treta, dhe kemi atë problem sepse ne jemi të pafuqishëm edhe në shkallë lokale edhe në atë shtetërore. Ky përafërsisht është motivi im dhe i organizatës të cilën e përfaqësojë, përse midis tjerash e kemi mbështetur qasjen rajonale. (Salem Çorbo, Shoqata e Qytetarëve Kthimi dhe Ekzistencë të Qëndrueshme, Bjelinë, BeH, Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare, Sarajevë, BeH, 21 nëntor 2009.)

Komisioni duhet të merret me faktet mbi atë ku, nën cilat kushte dhe si ka pësuar secili me emër e mbiemër. Kërkimi i shkaqeve na kthen neve në grupe etnike.

Ajo që unë mendoj se me çka duhet të merret ky

komision, janë faktet që reduktohen, ashtu të them në një hapësirë shumë të ngushtë, e kjo është: ku, nën cilat rrethana dhe si ka pësuar secili me emër e mbiemër. Nëse hyjmë në do farë interpretimesh, kërkimin e arsyesh përse çfarë ka ndodhur, ne domosdo serish do të kthehemi në grupet tona etnike. (Nexhad Horozoviq, Qendra për Aksion pa Dhunë, Sarajevë, BeH, Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare, Sarajevë, BeH, 21 nëntor 2009.)

Shoqata e familjeve të civilëve të zhdukur dhe luftëtarëve të Semberisë e mbështet Iniciativën për formimin e KOMRA, dhe do të hyjë në Koalicion nëse ai Komision do ti pranojë njësojë të gjitha viktimat.

Më falni, por duhet të them çka mendon anëtarësia ime. Unë u kam thënë: do të shkojë dhe do ta përcjellë, kurse ata më dhanë propozimin që ne të takohemi me ju dhe që ju (i drejtohet Natasha Kandiqit) si personalitet që e drejtoni KOMRA (fushatën për formimin e KOMRA) ta paraqitni para anëtarësisë sime çdo gjë dhe sa më shumë të njihen shoqatat, dhe që kjo (deklarata për anëtarësim në Koalicionin për KOMRA) të nënshkruhet, të bëhemi anëtar tuaj. Kurse unë si individ vetëm kam ardhur ta them këtë. Dhe natyrisht, se duhet të ketë barazi, që thatë ju, që të gjitha viktimat duhet të pranohen njësojë, se duhet të dihet çdo gjë. (Smilja Mitrovic, Shoqata e Familjeve të Civilëve të Zhdukur dhe të Luftëtarëve të Semberisë, Bjelinë, BeH, Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare, Sarajevë, BeH, 21 nëntor 2009.)

Pajtimi si proces shoqëror është i domosdoshëm në Bosnjë e Hercegovinë.

E marrë edhe parasysh se pajtimi është çështje individuale dhe nuk mundet askush ta detyrojë askënd të falë diçka apo me dikë të pajtohet. Por thjeshtë mendoj se procesi i pajtimit si ndonjë proces shoqëror, është i domosdoshëm në Bosnjë e Hercegovinë. (Nexhad Horozoviq, Qendra për Aksion pa Dhunë, Sarajevë, BeH, Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare, Sarajevë, BeH, 21 nëntor 2009.)

Nënat e Srebrenicës i ofendon fjala pajtim.

Unë më parë të them në emër të Shoqatave të Lëvizjes së Nënave të Enklavës Srebrenica dhe Zhepa se ne i përshëndesim të gjitha komisionet, jo vetëm këtë, por cila do të formohet në Bosnjë e Hercegovinë dhe jashtë BeH, sepse gjithmonë është më mirë që dikush të punojë diçka sa të mos bëhet asgjë. Është normale

se dialogu nevojitet, por më duhet të them se mu në gjithë këtë disi më ofendon fjala pajtim. Unë mund ta dijë nëse dikujt do t'ia fali a do ta harroj dikë, por në emër të mijëra nënave unë për këtë nuk mund të vendosi.(...) Domethënë, unë do të doja që ky komision i cili do të formohet të mos e përmend fjalën pajtim. (Munira Subashiq, Shqata Lëvizja e Nënave të Enklavës Srebrenica dhe Zhepa, Sarajevë, BeH, Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare, Sarajevë, BeH, 21 nëntor 2009.)

Të gjitha viktimat dhe të pësuarit duhet të marrin emrin dhe mbiemrin. Për këtë nevojitet të formohet baza e të dhënave për të zhdukurit, të vrarët dhe të pësuarit.

Ja, për shembull na nevojitet baza e të dhënave. Ne vërtetë nuk e kemi bazën e të dhënave për të zhdukurit. Për 14 vjet akoma nuk e ka bërë askush, e do të ishte mirë kjo të ndërtohet. Sikur të ndërtohet baza e të dhënave do të bëhej shumë, sepse askush më nuk do të mund të fliste janë vra kaq, janë zhdukur kaq. Por të jetë e saktë. Unë e mbështes që ka punuar edhe Tokaça dhe gjithë tjerët, por kjo nuk është e mjaftueshme. Nevojitet të shkojmë edhe më larg, ngase fëmijët tanë nuk mund të jenë numra. Fëmijët tanë duhet të kenë emër e mbiemër. Për tu bërë kjo, vërtetë duhet punuar shumë, të shkohet prej rrugës në rrugë, prej qytetit në qytet, prej katundit në katund që vërtetë të bëhet. (...) Atëherë në fund të fundit do ta dinim realisht sa janë zhdukur, nëse veç po dëshirojmë ta dimë edhe njëri edhe tjetri edhe i treti. Por mendoj, zhdukja e çdo fëmije është dhimbje vetëm për nënën dhe për askënd më. (Munira Subashiq, Shqata Lëvizja e Nënave të Enklavës Srebrenica dhe Zhepa, Sarajevë, BeH, Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare, Sarajevë, BeH, 21 nëntor 2009.)

Viktimat kanë nevojë ta paraqesin vuajtjen e vetë dhe të dëgjoen.

(...) për mua është evidente sa ekziston nevoja e madhe tek njerëzit që kanë përjetuar vuajtje, padrejtësi, dhunë në lëkurën e vet, ose njerëzit të cilët janë të afërt me ta, sa ekziston nevoja që të shprehet ajo vuajtje, të thonë çka ju ka ndodhur dhe kjo të dëgjoet. (Nexhad Horozović, Qendar për Aksion pa Dhunë, Sarajevë, BeH, Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare, Sarajevë, BeH, 21 nëntor 2009.)

Nevojitet të hapet çështja mbi krimet ndaj të sëmureve shpirtëror. Për disa nga ata nuk ka gjurmë.

Nuk do ta përsëritja, por e kemi harruar një grup të qytetarëve, një grup marginal të qytetarëve, e këta janë të sëmurit shpirtëror mbi të cilët janë bërë krime. Sa di unë, informata nuk ka për hetime, çka është bërë me të sëmurit shpirtëror, qoftë për ata që kanë qenë nëpër institucione apo në shtëpitë e veta, madje edhe humbën gjurmët e disa njerëzve. (...) Mua më intereson si ta tejkalojmë edhe këtë dhe për këtë problem njësoj të fillohet të flitet, sepse tek ata edhe nëse duan të flasin ekziston frika e caktuar (Vahid Gjulović, Fenix, Tuzëll, BeH, Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare, Sarajevë, BeH, 21 nëntor 2009.)

Ekziston frika që parlamentet nuk do ta përqafojnë Iniciativën.

Unë para se gjithash e mbështes në tërësi këtë Iniciativë. Ne me këtë temë po merremi prej vitit 2001, me anë të hetimeve që i kemi bërë. Problemi konkret që mua më mundon në përgjithësi është në çfarë mënyre mund ti detyrojmë parlamentet e rajonit ta përqafojnë këtë Iniciativë? (Goran Bubalo, organizata TERCA, pjesë e Këshillit të Bosnjë- Hercegovinës të organizatave joqeveritare (BHVNVO), Sarajevë, BiH, Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare, Sarajevë, BeH, 21 nëntor 2009.)

Koalicioni për KOMRA duhet të bëjë vëzhgimin e punës së KOMRA.

Qysh tash mund të them, në emër të Qendrës për promovimin e shoqërisë civile, se do ti japim mbështetje të plotë Komisionit. (...) Njëri nga mekanizmat që duhet të jetë me Komisionin gjithsesi duhet të jetë mekanizmi i vëzhgimit të punës së atij komisioni, respektivisht ndoshta është tepër e ashpër fjala pasi që institucionet qeveritare kur diçka formojnë nuk e duan fjalën vëzhgim e çdo gjëje që formojnë. Mendoj se këtë Koalicion (për KOMRA) duhet shfrytëzuar që ai të gjenerojë, tash do ti përmendi shifrat arbitrare të 10, 50 apo 100 organizatave që do ta përbejnë atë trup për këshillim, vëzhgim apo partneritet. Që ai trup të jetë përfaqësues i këtij Koalicioni, por të jetë edhe njëfarë lloji i partnerit i cili do të marrë mbi vete rolin dhe ushtrimin e trysnisë dhe të mobilizimit të shoqërisë së gjerë civile. (...) Propozimi pra është që Komisioni të ketë partner në përfaqësuesit e Koalicionit dhe trupin të cilin do ta gjenerojë koalicioni, që do të bëjë vëzhgimin, orientimin, bisedim me komisionin, të jetë partner në gjithë këtë proces. (Shefko Bajiq, Qendra për Promovimin e Shoqërisë Civile, Sarajevë, BeH, Konsultimet kombëtare me

organizatat joqeveritare, Sarajevë, BeH, 21 nëntor 2009.)

Anëtarët e KOMRA duhet të jenë të liruar nga paragjykimet dhe ndikimi i partive politike.

Mendoj se lypset përgatitur mirë terrenin për atë Komision dhe që anëtarët e komisionit duhet të jenë njerëzit të cilët janë çliruar edhe nga paragjykimet edhe ndikimi i partive politike, sidomos të partive nacionaliste, sepse retorika nacionaliste edhe na ka sjellë këtu ku jemi sot. (Fadila Haxhiq, La Strada, Mostar, BeH, Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare, Sarajevë, BeH, 21 nëntor 2009.)

Organizatat joqeveritare, anëtare të Koalicionit për KOMRA, duhet të organizohen nëpër seksione që të kontribuojnë më mirë në formimin e Komisionit.

Në qoftë se ne veç e veç, secili prej nesh, nga secila organizatë nga e cila vjen e vështrojmë misionin e organizatës tonë, atëherë do të shohim se misioni i organizatave tona shkon në favor të realizimit të objektivave të KOMRA. Por tash, si të realizohet kjo? Si të arrihet realizimi i objektivit? Do të ishte më mirë që në mënyrë organizative të (Koalicionit për) KOMRA ashtu të përbëhet që organizatat joqeveritare të cilat inkuadrohen si anëtare të (Koalicioni për) KOMRA të përbëhen, organizohen sipas tipit sektorial, nëpër misione ashtu që nga secili misioni mund të kontribuojmë në objektivat e shtruara. (Salih Rasavac, Koridor, Sarajevë, BeH, Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare, Sarajevë, BeH, 21 nëntor 2009.)

Mbi Iniciativën KOMRA lypset të flitet në bashkësitë lokale në mënyrë që qytetarët, viktimat dhe refugjatët të mund ta japin mendimin e vet.

Unë do të doja pra që këto konsultime të zbresin edhe në vende më të vogla ku do të mund të vijnë njerëzit e zakonshëm, viktimat, refugjatët. Viktimat nga ato vende të cilat do të mund të marrin pjesë aktive në këto konsultime. (Svetlana Vuković, Luna, Rudo, BeH, Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare, Sarajevë, BeH, 21 nëntor 2009.)

Koalicioni KOMRA duhet të llojë për miratimin e Ligjit mbi formimin e këtij komisioni. Për lobim duhet shfrytëzuar infrastrukturën e organizatave joqeveritare dhe të rrjeteve ekzistuese të organizatave joqeveritare.

Unë propozoj që njëri nga qëllimet në këtë pjesë programore të këtij Koalicioni të jetë lobimi, miratimi i Ligjit i cili do të definojë qartë qëllimet dhe kuptimin e themelimit të këtij komisioni dhe që në këtë proces organizatat e shoqërisë civile të inkuadrohen që nga fillimi. E përshëndes që tha zonja Natasha në fillim, se ky është një proces i hapur, nuk ka zgjidhje të gatshme dhe se nuk shkon ky proces nga lartë, veç thjeshtë nga rrethi i gjerë i konsultimeve. Ashtu që kujtoj se kjo është një qasje e re dhe e përshëndes mënyrën e tillë dhe këtë që e tha zotëri Shevko. Pasi që ne jemi bashkë në atë proces të rrjetëzimit, ta shfrytëzojmë atë infrastrukturë e cila ekziston si tek organizatat individuale të shoqërisë civile ashtu edhe të rrjeteve ekzistuese. (Milena Saviq, Qendra e Ndihmës Informative Juridike, Zvornik, BeH, Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare, Sarajevë, BeH, 21 nëntor 2009.)

Koalicioni duhet të ketë strategji në rast se shtetet në rajon nuk e përqafojnë Iniciativën.

Disa përvoja tregojnë se sektori joqeveritar mund të bëjë diçka. Mund ti regjistrojë viktimat. Këtë e ka treguar IDC, po e tregon Fondi për të Drejtën Humanitare, pra thjeshtë që e gjithë ajo energji të cilën po e shpenzojmë dhe që do ta shpenzojmë edhe më tutje deri në pranverën e vitit 2011, të mos mbetet pa rezultate. Në qoftë se deri atëherë ne mundemi ta kristalizojmë se çka mund të bëjë sektori joqeveritar me kapacitetin i cili dëshiron ti bashkohet kësaj ideje me ndihmën, s'di, të KB që të fitojë ndonjë besueshmëri, atëherë unë propozoj që të mendohet edhe për këtë. Domethënë, nëse hasim në dyer të mbyllura apo në reagime çfarë nuk i presim të kemi përgjigje në këtë situatë. (Sinan Aliq, Fondacioni e Vërteta, Drejtësia dhe Pajtimi, Tuzëll, BeH, Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare, Sarajevë, BeH, 21 nëntor 2009.)

Nevojitet që të formohet Qendra rajonale e mediave e cila do të disponojë të gjitha informatat që kanë të bëjnë me Iniciativën KOMRA.

Kam një pyetje: a do të inkuadrohen pakicat në konsultime? Mendoj në romët, hebrenjtë e kështu me radhë. Dhe ajo që tash dua ta them si profesionist, si gazetar është që të formohet, bie fjala, jo një qendër e mediave, por një Qendër Rajonale e mediave ku duke filluar që nga sot të këmbehen të gjitha lajmet. Çka po ndodhë në Kroaci lidhur me Koalicionin? Çka po ndodhë në Serbi? Çka po ndodhë në Bosnjë? Çka po ndodhë në Prishtinë? Domethënë Qendra Rajonale e mediave. (Dalibor Taniq, Iniciativa e të

Rinje për të Drejtat e Njeriut në BeH, Sarajevë, BeH, Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare, Sarajevë, BeH, 21 nëntor 2009.)

Në procesin e konsultimeve duhet inkuadruar sindikatat.

Unë e kam prapavijën sindikale. Kam punuar kohë të gjatë në sindikatë këtu në rajon. Në sindikatë ekziston potencial për këtë në çka po punon KOMRA, prandaj më intereson a i keni dhe si i keni inkuadruar sindikatat, veçmas në pjesën në flasim për kohërat e luftës dhe shkeljet e vrazhda të drejtave të njeriut në fushën e punës ku kemi punë të detyrueshme dhe pezullime jo legale, e tjera, të mos i numëroj. Kjo është një forcë në shoqëri që ka tepër shumë anëtarë të cilët mund të jenë të dobishëm në gjithë këtë. (Emina Abraham-Stoter, SIPU International, Sarajevë, BiH, Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare, Sarajevë, BeH, 21 nëntor 2009.)

Qasja 'nga poshtë -lartë' është garanci e suksese të Iniciativës.

Të them se më ka pëlqye tepër shumë qasja juaj e cila shkon nga poshtë-lartë, ngase çdo gjë është anasjelltas dhe mendoj se kjo shpesh është arsyeje përse gjërat nuk po kanë sukses. (Emina Abraham-Stoter, SIPU International, BeH, Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare, Sarajevë, BeH, 21 nëntor 2009.)

Nevojitet të hartohet projekti apo pasqyra e propozimeve të deritashme për mandatin KOMRA.

(...) do të doja që në konsultimet e ardhshme veç të kemi të përgatitura temat serioze të cilat në Bosnjë e Hercegovinë do të shqyrtoheshin në kuadër të mandatit. (Salem Çorbo, Shoqata e Qytetarëve Kthimi dhe Ekzistenca e Qëndrueshme, Bjelinë, BeH, Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare, Sarajevë, BeH, 21 nëntor 2009.)

Atë që do të lutja unë pra të shfrytëzohet, që të mos thirrrem unë ja për të shtatën herë, në njërin nga konsultimet e këtilla, të mos e kalojmë rendin e ditës. Por që për konsultimet e ardhshme që do ti organizoni kështu në Bosnjë, ta përgatisni atë propozimin e modelit. Atëherë unë do të vija sepse unë, më besoni, nuk do të paraqitem më në konsultime të këtilla edhe pse jam shumë i interesuar. (Edin Ramuliq, Shoqata Prijedorçanki Izvor, Prijedor, BeH, Kon-

sultimet kombëtare me organizatat joqeveritare, Sarajevë, BeH, 21 nëntor 2009.)

Duhet inkuadruar bashkësitë religjioze e akademike. Koalicioni për KOMRA është mundësi që ndarjet dhe konfliktet të tejkalohen në strukturat qeveritare.

Këtë duhet zgjeruar dhe në fillim mendova se kjo mungon edhe në strukturat tjera, jo vetëm në shoqërinë civile. Folëm se aty janë edhe bashkësitë religjioze dhe bashkësitë akademike. Mirëpo, edhe ato janë të ndara sikur që janë të ndara organizatat joqeveritare. Madje edhe organizatat joqeveritare janë ato të cilat nuk e mbështesin qeverinë, ashtu që edhe këto procese në të cilat gjendemi tash dhe ky Koalicioni KOMRA është një nga mënyrat që të tejkalohen ato konflikte që ekzistojnë edhe në qeveri edhe në strukturat qeveritare. (Jovan Divjak, Arsimimi e Ndërton Bosnjën e Hercegovinën, Sarajevë, BeH, Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare, Sarajevë, BeH, 21 nëntor 2009.)

Krejt duhet bërë për të rinjtë në mënyrë që të mund të pranojnë, kuptojnë dhe falin.

Ende ka familje të cilat pas 17 vitesh nuk i kanë gjetur prindërit e vet. Kemi studentë-bursist të cilët ende nuk e kanë bërë atë veprim njerëzor, human që ta varrosin prindin e vet, fëmijë që nuk i mbanjnë mend prindërit. Krejt çka bëhet duhet të bëhet për shkak të gjeneratave të cilat sot, dhe të cilat në ndonjë kohë tjetër faresh, në ndonjë ambient tjetër do të mund të pranojnë, të kundrojnë dhe thjeshtë edhe të falin, ashtu sikurse foli zonja Subashiq. (Jovan Divjak, Arsimimi e Ndërton Bosnjën e Hercegovinën, Sarajevë, BeH, Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare, Sarajevë, BeH, 21 nëntor 2009.)

Mandati i Komisionit duhet të jetë i qartë dhe i saktë në mënyrë që Komisioni të mos i dëshpërojë disa kategori të viktimave.

Mendoj se duhet ngushtuar çka do të jetë mandati i Komisionit, me çka në esencë do të merrej Komisioni. Për dy arsyeje. Që të mos i dëshpërojmë disa kategori të viktimave në konsultimet e ardhshme, e thuhet se do të shkojmë vetëm pas të zhdukurve, apo vetëm pas kampistëve, ose vetëm pas viktimave të luftës e kështu me radhë. Është e sigurt se ai Komision nuk do të mund të punojë në rrafshin e tërësishëm të krimit. (Muhamed Xhemixhiq, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Sarajevë, BeH, Konsultimet

kombëtare me organizatat joqeveritare, Sarajevë, BeH, 21 nëntor 2009.)

Konsultimet me bashkësinë lokale

Zrenjanin, Serbi
28 nëntor 2009.

Konsultimet i kanë organizuar Klubi i Kikindës dhe Qendra për mbështetje grave nga Kikinda, në bahs-këpunim me Qendrën Edukative të Zrenjaninit. Në konsultime kanë marrë pjesë 28 përfaqësues të vetëqeverisjes lokale, partive politike, parlamenteve të nxënësve, të organizatave joqeveritare, shoqatave të veteranëve dhe të invalidëve ushtarak të luftës, të gjithë nga territori i Komunës së Zrenjanit. Në cilësi të vëzhguesit ka marrë pjesë Dragan Popoviq (Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut, Serbi). Miomirka Mila Melank (Klubi i Kikindës, Serbi) dhe Mirjana Ivançeviq (Qendra Edukative e Zrenjaninit, Serbi) e hapën tubimin me motive personale të angazhimit në Koalicionin për KOMRA. Marija Srdiq (Qendra për mbështetje grave, Serbi) foli mbi arsyet *Përse KOMRA*. Natasha Kandiç (Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi) i njoftoj pjesëmarrësit e konsultimeve me mendimet, propozimet dhe Rekomandimet e pjesëmarrësve të konsultimeve të deritashme, ndërsa Maja Stojanoviq (Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut, Serbi) foli mbi përvojat e mira të Komisionit për të Vërtetën. Debatin e ka moderuar Marija Srdiq (Qendra për mbështetje grave, Serbi).

Propozimet, mendimet dhe Rekomandimet e pjesëmarrësve

Iniciativa KOMRA shpie drejtë pajtimit dhe integritet në Bashkimin Evropian. Si erdhi deri tek të lufta është çështje tjetër.

(...) *absolutisht e mbështes këtë dhe jam i gatshëm të marrë pjesë në punën, jo në Komision, por në punën për përgatitjen e terrenit, ta jap kontributin tim që të arrihet kjo, meqë kjo shpie edhe drejtë pajtimit dhe njohjes tonë nga Evropa dhe në kuptimin tonë të Evropës, se këtu nuk jetojnë njerëzit e egër, por njerëz krejt normal, kurse për atë si kemi shkuar në luftë, si ka ndodhur ajo, kjo veç është çështje tjetër.* (Milan Milivojeviq, Shoqata e veteranëve dhe të invalidëve ushtarak të luftës prej viteve të 90-ta, Zrenjanin, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Zrenjanin, Serbi, 28 nëntor 2009.)

(...) *Kjo gjithsesi do të ketë dobi largpamëse për të gjitha gjeneratat në këto hapësira, dhe të bëhemi për diçka shembull në Evropë e kemi bërë këtë.* (Milan Milivojeviq, Shoqata e veteranëve dhe të invalidëve ushtarak të luftës prej viteve të 90-ta, Zrenjanin, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Zrenjanin, Serbi, 28 nëntor 2009.)

Sikur diçka ngjashëm të ishte bërë pas Luftës së II Botërore, krimet nuk do të përsëriteshin. Prandaj është e rëndësishme që kjo punë të kryhet deri në fund.

Sikur (debati mbi të kaluarën) diçka e ngjashme të ishte bërë pas Luftës së II Botërore, sikur ne ta kishim mësuar se çfarë ka ndodhur në Jasenovc, ta kishim ditur më herët, këtë nuk do ta përsëritshim. Domethënë hajde të mos e përsërisim gabimin e Luftës së II Botërore që tash këtë, disi, të çojmë deri në fund në mënyrë të ndershme. (Milan Milivojeviq, Shoqata e veteranëve dhe të invalidëve ushtarak të luftës prej viteve të 90-ta, Zrenjanin, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Zrenjanin, Serbi, 28 nëntor 2009.)

Veteranët nga Serbia presin që KOMRA tua bëjë me dije tjerëve se kanë bërë krime. Vetëm nëse të gjithë marrin pjesë ka shans që të vërtetohet gjendja e cila do të inkorporohej në kulturën dhe adetin tonë.

(...) *KOMRA mundet me anë të këtyre shembujve të jap kontribut që ne këtë ta përqafojmë me dy duar, që tjerëve t'ua vëmë në dijeni se dimë për krimet e tyre dhe hajde atëherë t'u drejtohem edhe atyre njerëzve që nga ana tjetër kanë bërë krime, që të jemi sa më të suksesshëm, që të marr pjesë një numër sa më i madh dhe që sa më shumë njerëz të japin deklaratat e veta dhe të kontribuojnë, jo vetëm në këtë evidencë por, në përgjithësi, në vërtetimin e gjendjes faktike, dhe në përgjithësi çka thotë dikush ta inkorporojmë në adetet tona, në shprehitë tona, në kulturën tonë.* (Milan Milivojeviq, Shoqata e veteranëve dhe të invalidëve ushtarak të luftës prej viteve të 90-ta, Zrenjanin, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Zrenjanin, Serbi, 28 nëntor 2009.)

Në debat duhet përfshirë komandantët luftarak – ka shumë që janë njerëz të ndershëm. Duhet përfshirë partitë politike dhe parlamentarët.

(...) *Unë do të propozoja që ne ti thërrasim edhe ata komandantët luftarak që janë pjesëmarrës të luftës. Shikoni, unë jam njëri nga ata i cili është i gatshëm të shkojë çdo kund, sepse s'kam arsye të mos vi kudo*

qoftë. Ne jemi shumë, ka shumë pjesëmarrës në luftë, njerëz të ndershëm që kanë marrë pjesë në luftë dhe të cilët për arsye të ndershme kanë shkuar atje. Unë mund t'i numëroj dy tri parti politike të cilat me siguri do të merrnin pjesë ... Por për çdo rast, nuk është keq që në tubimin e ardhshëm të kemi përfaqësuesit e kuvendeve dhe komunave tona, e të mos flas që nga Kuvendi Republikan të thirret dikush si mysafir të vij këtu, le të dëgjojë, dhe në atë mënyrë të luftojmë. (Milan Milivojeviq, Shoqata e veterarëve dhe të invalidëve ushtarak të luftës prej viteve të 90-ta, Zrenjanin, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Zrenjanin, Serbi, 28 nëntor 2009.)

Në qoftë se formimi i KOMRA-s varet nga mjetet financiare të shteteve në rajon, ai komision nuk do të formohet kurrë, para se gjithash sepse shtetet nuk dëshirojnë që të flitet mbi krimet e luftës.

Më atë rast (nëse shtetet në rajon e financojnë KOMRA) mendoj se përpjekja paraprakisht është gjykuar për dështim si dhe të gjitha deri më tash. Ja pse mendoj. Sepse shtetet e njëjta të kishin dashur deri më tash veç do t'i depononin mjetet qysh moti dhe do të bënin diçka. (Danilo Babiq, Shoqata e invalidëve ushtarak të luftës, Konsultimet me bashkësinë lokale, Zrenjanin, Serbi, 28 nëntor 2009.)

Sepse shtetet tek ne u treguan të atilla se nuk duan të flasin për këtë. Interesi shtetëror është që të mos flitet mbi krimet e luftës. (Zlatko Jelisivac, qytetar i interesuar nga Zrenjanini, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Zrenjanin, Serbi, 28 nëntor 2009.)

Në ballafaqimin me të kaluarën duhet nisur nga vetë-rishikimi personal. Prej tjetrit kah vetvetja.

Duhet pranuar dhimbjen e secilit, por të nisemi nga ajo çka u dhëmb tjerëve, dhe e kemi bërë ne, domethënë është shumë e rëndësishme të iniciohet edhe vetë-rishikimi si ndodhi ajo vepër e cila na dhëmb. (Sanja Milosavljeviq, Forumi Grave të Ligës Socialdemokrate të Vojvodinës, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Zrenjanin, Serbi, 28 nëntor 2009.)

Refugjatët janë viktima dhe kanë të drejtë të jetojnë me dinjitet. Njerëzit kanë pasur dhimb-suni ndaj tyre kur kanë ardhur, e pastaj i kanë gjykuar që kanë ardhur.

Ata edhe sot janë të zi në shpirt sepse janë bërë kamare në këtë hapësirë, e nuk kanë dashur të jenë aty. Kurse njerëzit që i kanë pranuar, me një pjesë kanë pasur dhimb-suni e me pjesën tjetër i kanë

gjykuar ashpër, sepse po ua zënë vendet e tyre të punës, se u kanë ardhur e askush nuk i ka thirrur. Atyre (refugjatëve) u dhëmb fakti se për këtë nuk po flitet sa duhet dhe ata thjeshtë nuk kanë më status të disa të përndjekurve, të ikurve dhe ata kanë status të njerëzve që jetojnë me dinjitet kudo qoftë, tash falë rrethanave me apo pa dëshirë, por të mund të jetojnë normalisht. (Sanja Milosavljeviq, Forumi Grave të Ligës Socialdemokrate të Vojvodinës, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Zrenjanin, Serbi, 28 nëntor 2009.)

Mediat lokale do ta mbështesin iniciativën por mbi te pak dihet. Anëtarët e Koalicionit në nivel lokal duhet t'i njoftojnë mediat me iniciativën.

Ka media që kanë interes. Hajde nga pak të kyçemi në punën e mediave. Unë mendoj se këtu në Santos apo KTV mund ta marrim (mbështetjen) nëse ne këtu në lokal aktivizohemi...ky është fillim për të cilin pak kush dinë e pak çka dinë. Sepse kjo është gjë jashtëzakonisht e dobishme për të ardhmen e këtij rajoni, jo vetëm të Serbisë por të komplet rajonit. (Milan Milivojeviq, Shoqata e veterarëve dhe të invalidëve ushtarak të luftës prej viteve të 90-ta, Zrenjanin, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Zrenjanin, Serbi, 28 nëntor 2009.)

(...) të mblidhemi t'i vizitojmë ato shtëpi televizive dhe t'ua sqarojmë direkt këtë, sepse nga ky material ndoshta tash do ta kuptojnë, dhe do të shkojnë nëpër të gjitha komunat, nëse ashtu nisemi, unë them me sukses mundemi opinionit t'ia tregojmë rëndësinë e këtij KOMRA që duhet të formohet. (Milan Milivojeviq, Shoqata e veterarëve dhe të invalidëve ushtarak të luftës prej viteve të 90-ta, Zrenjanin, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Zrenjanin, Serbi, 28 nëntor 2009.)

Të rinjtë në Zrenjanin nuk janë të njoftuar me iniciativën. Në shkollat e mesme nuk ekziston lënda që merret me luftërat prej vitit 1991. Profesorët e historisë po i ikin kësaj teme, kurse në orët e edukatës qytetare çdo gjë varët nga vullneti personal i profesorit.

Ne kemi pasqyrën se sa rinia, vërtetë mjedisi ynë nuk dinë asgjë mbi këtë dhe sa janë të verbër me disa ide, të them, të njerëzve kryesor që kanë dëshirë të manipulojnë dhe është i mirë fakti që të mësohet e vërteta e cila mund të jetë vetëm një, se nuk mund secili popull me e pas historinë e vet por ekziston vetëm një histori. (Jasna Janoshev, Qendra për fëmijë dhe të rinj -Mashtalishte, Zrenjanin, Konsultimet me

bashkësinë lokale, Zrenjanin, Serbi, 28 nëntor 2009.)

(...) nuk ekziston asnjë lëndë që merret me këtë, libri i mësimit për klasën e IV-të ka një tekst me disa fjali mbi gjitha ngjarjet ku kanë qenë fushëbetejat, kjo vetëm në orët e edukimit qytetarë mësohet, por edhe kjo varët nga profesori dhe vullneti i tij personal nëse do të merret me këto tema. Profesorët e historisë kryesisht po i ikin asaj pjese të lëndës mësimore, sepse thonë se ende është herët të flitet mbi këtë, ashtu që askush edhe nuk e përpunon atë pjesë, atë çështje mbi luftërat e viteve të 90-ta. (Andrea Koçish Parlamenti i nxënësve të gjimnazit dhe grupi komunal i Këshillit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Zrenjanin, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Zrenjanin, Serbi, 28 nëntor 2009.)

Pjesëtarët e ushtrisë dhe të policisë së rregullt e bartin barrën e krimit të formacioneve paramilitare. KOMRA mund ta korrigjojë këtë.

Ta marrin si shembull fushëbetejën kroate. Sa paraushtri kemi pasur, sa paramilitar tanit janë paraqitur? E ne i bartin pasojat e gjithë atyre, si nga njëra ashtu edhe nga ana tjetër. Dhe krejt na ngarkohet neve dhe në fytirën tonë, në të gjitha fushëbetejat. (Zharko Beshtanski, Konsultimet me bashkësinë lokale, Zrenjanin, Serbi, 28 nëntor 2009.)

KOMRA duhet ta mbështes nevojën e rehabilitimit të veteranëve.

Problemi që po e shosh unë është se një numër i mirë i tyre (veteranëve) fare nuk ka mundësi për shërim, as që dinë se në çfarë mënyre mund të marrin mbështetje, ndihmë. Kjo tash me siguri nuk bënë pjesë në mandatin e KOMRA, por me siguri është një nga gjërat në të cilat mund të ndikohet sikur që ndikohet në shtetin për ta mbështetur iniciativën e KOMRA. Ekzistojnë shumë pakë qendra në Serbi në të cilat ata mund të marrin ndihmë, e unë këtë në kokën time po e ndërlidhi me atë se shumë njerëz pa shërim po rrinë në shtëpi, traumat e veta i mbytin me alkool apo me diç tjetër. Nga kjo është edhe dhuna e madhe në familje dhe të rinjtë po na rritën në familjet që janë të shpërndara, ku fëmijët rrahën. Thjeshtë ky është një problem tepër i madh në shoqërinë tonë të cilin nuk po e prekim. (Danijela Jelisavac, qytetare e interesuar nga Zrenjani, Konsultimet me bashkësinë lokale, Zrenjanin, Serbi, 28 nëntor 2009.)

Organizatat dhe bashkësitë religjioze janë edhe viktima dhe kanë përgjegjësi dhe rol në gjithë atë që ka ndodhur në të kaluarën.

Domethënë, religjionet dhe bashkësitë fetare janë viktima për shkak që janë rrënuar aq e aq xhamia, aq e aq kisha, manastire... e nga ana tjetër është e nevojshme të bisedohet dhe të dëgjohet nga vetë ata mbi rolin e tyre, mbi përgjegjësinë e tyre për atë që ka ndodhur. Dhe ky në të realitet është ai teren rrëshqitës ku dikush është edhe viktimë, e duhet të ketë raport tejet të madh vetëkritikë ndaj institucionit të vetë karshi asaj që është bërë. (Natasha Kandiç, Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Zrenjanin, Serbi, 28 nëntor 2009.)

Shënimi i përbashkët e vendeve të krimit, përrshirë edhe vendet e burgosjes, është instrumenti më i fortë kundër përsëritjes së krimit.

Nëse këtë bënë KOMRA, nëse filluar nga janari i vitit 1991, e rendit në mënyrë kronologjike çdo vend ku është kryer ndonjë krim dhe nëse ato vende i shënojmë, do ta krijojmë hartën e kujtimit. Jam plotësisht i sigurt se ky është instrumenti më i fuqishëm, mjeti më i fortë kundër përsëritjes së mundshme të krimeve. (Natasha Kandiç, Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Zrenjanin, Serbi, 28 nëntor 2009.)

Është në interes të së vërtetës që të zbatohen standardët ndërkombëtare për klasifikimin e objekteve për burgosje, që të dihet çka janë llogoret, qendrat e grumbullimit, burgjet dhe kampet e përqendrimit.

Hajt atëherë me këta të pafatët nga Stajiçeva dhe Begeji të spastrohet përfundimisht çfarë ka ndodhë aty. Për këtë shkak duhet të punojmë bashkë, pavarësisht se në cilën anë janë gjetur. T'i vërtetojmë saktë gjërat. Nëse ju vërtetë mendoni, keni prova, dëshmi të forta se kjo ka qenë Qendër e grumbullimit apo burg ushtarak, paraqisni me anë të këtij koalicioni, organizatës së këtillë e cila pra është organizatë shtetërore ku mund t'i paraqisni faktet relevante dhe pastaj kjo është çështje e kryer. (Zlatko Jelisavac, qytetar i interesuar, Zrenjanin, Konsultimet me bashkësinë lokale, Zrenjanin, Serbi, 28 nëntor 2009.)

Çdo dëshmim publik duhet të verifikohet nga më shumë burime të pavarura.

Kur ... dikush dëshmon mbi ndonjë krim apo thotë se ka marrë pjesë direkt ose në ndonjë mënyrë ka qenë i keqtrajtuar dhe krejt këtë, në bazë të çka vërtetohet se ai është pikërisht kjo që po prezantohet se është. (Aleksandra Mlladenović, Këshilli Komunal i Partisë Liberal

Demokratike në Zrenjaninu, Serbi. Konsultimet me bashkësinë lokale, Zrenjanin, Serbi, 28 nëntor 2009.)

Çdo dëshmim duhet të verifikohet nga dy apo tri burime të pavarura që të mos vijmë në situatë që ne të marrim pjesë, për shembull, në paraqitjen e ndonjë të dhënë që nuk janë të sakta. (Natasha Kandiç, Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Zrenjanin, Serbi, 28 nëntor 2009.)

Mbledhja e nënshkrimeve për KOMRA duhet të organizohet në nivel lokal. Të shfrytëzohen bashkësitë lokale. Veteranët do të marrin pjesë në këtë.

Dhe në fund ju po thoni një milion nënshkrime. Po duhet Serbia të ketë bile një milion, nëse në Serbi s'ka një milion nënshkrime atëherë nuk do të bëhej shumë. Hajde të aktivizohemi nëpër gjitha komunat, që ai nënshkrim të jetë i organizuar, sikurse edhe ndryshe punohet, do të ketë shumë që do të na pranojnë kur të kuptojnë rolin e kësaj (...) nëse mendoni t'i mblidhni një milion vota kjo është rrugë për të hyrë tek qytetarët që të vijnë ta nënshkruajnë në bashkësinë lokale atë regjistër se dëshiron të bashkohet dhe ta mbështes këtë aksion i cili nuk është as nacional, as personal veçse domosdo dhe nevojë e këtij rajoni, (Millan Milivojeviq, Shoqata e veterarëve dhe të invalidëve ushtarak të luftës prej viteve të 90-ta, Zrenjanin, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Zrenjanin, Serbi, 28 nëntor 2009.)

Duhet të ndikohet në gjendjen indiferente të shoqërisë.

(...) ky mjedis kryesisht është „nuk ka të bëjë me mua, po i ndodh dikujt tjetër”. Në realitet duhet të arrijmë të kundërtën „ka të bëjë me mua dhe duhet të bisedojmë për këtë” dhe të arrijmë deri tek e vërteta dhe që njëmend të gjithë bashkë t'ia dalim në këtë përpjekje që ky Koalicion për KOMRA të gjallërohet si duhet. (Tijana Zhivanov, Këshilli Komunal i Partisë Demokratike në Zrenjanin, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Zrenjanin, Serbi, 28 nëntor 2009.)

Konsultimet me bashkësinë lokale mbi Iniciativën për formimin KOMRA-s

**Bërçko, BeH
5 dhjetor 2009.**

Më 5 dhjetor të vitit 2009, në Bërçko, janë mbajtur

konsultimet lokale mbi themelimin e Komisionit Rajonal për vërtetimin e fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljet tjera të rënda të drejtave të njeriut në ish RSFJ (KOMRA). Organizator ka qenë Forumi i Qytetarëve të Tuzllës. Mbi iniciativën dhe rrjedhën e procesit konsultativ në rajon, ka folur Eugen Jakovciq (Documenta, Kroaci), kurse mbi përvojat më të mira të komisioneve tjera për të vërtetën Branko Todoroviq (Këshilli i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën Serpska -RS), ndërsa Vehid Shehiq (Forum i Qytetarëve të Tuzllës, BeH) e ka moderuar diskutimin. Pjesëmarrësit e konsultimeve (24) kanë qenë përfaqësues të shoqatave të viktimave, të kampistëve, familjeve të luftëtarëve dhe civilëve të zhdukur, të organizatave joqeveritare, bashkësive fetare, si dhe përfaqësuesit e pushtetit: prefekti i Distriktit të Bërçkos në BeH, Dragan Pajić dhe kryetari i Kuvendit të Distriktit të Bërçkos, Mirsad Gjapo.

Propozimet, mendimet dhe Rekomandimet e pjesëmarrësve

Në Distriktin e Bërçkos ekziston vullneti politik që të konfirmohet e vërteta mbi atë çfarë ka ndodhur në luftë. Përfaqësuesit e pushtetit e mbështesin idenë mbi formimin e KOMRA.

ne (...) kemi nevojë që kjo e vërtetë mbi ndodhitë në këto hapësira të sillet deri në fund. (...) të arrihen të vërtetat e mirëfillta, sepse ato të vërteta do të ndihmojnë që ai ambient të konsolidohet dhe mjedisi shumetnikë të forcohet edhe më tepër. (...) dhe në Distrikt thoni çka (...) duhet bërë që ne ta mbështesim këtë, ngase Distrikti dhe e ardhmja e tij, dhe Bosnja e Hercegovina dhe e ardhmja e saj, nuk mund të ekzistojnë me të tri vërteta. (Mirsad Gjapo, kryetar i Kuvendit të Distriktit Bërçko, Konsultimet me bashkësinë lokale, Bërçko, BeH, 5 dhjetor 2009.)

(...) pa kurrfarë rezerve e mbështes këtë iniciativë. Nga ju pres ide konkrete, gjegjësisht çka dëshironi nga ne të bëjmë që tu ndihmojmë dhe me vendime të caktuara në kuadër të qeverisë e të kuvendit të hymë në këtë aktivitet (...) (Dragan Pajić, prefekti i Distriktit Bërçko, BeH. Konsultimet me bashkësinë lokale, Bërçko, BeH, 5 dhjetor 2009.)

(...) ne akoma as në Bërçko nuk jemi hapur ndaj njëri tjetrit, më parë se kemi vetëdijesuar këtë si nevojë për vetveten, jo për shkak të Bashkimit Evropian apo integriteteve dhe të kërkesës që para nesh po e shtron bota, veç për shkak se është premisë për një të ardhme më fatlume, më të sigurt të jetesës këtu.

(Qazim Suljeviq, Bashkësia Boshnjake e Kulturës -Preporod, Bërçko, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Bërçko, BeH, 5 dhjetor 2009.)

Është pjekur nevoja shoqërore për të vërtetën dhe për ballafaqim me barrën e së kaluarës. Kjo iniciativë është nevojë e të gjitha viktimave.

(...) kjo është një ide shumë e shëndosh, e dobishme e konstruktive dhe gjithsesi të gjithë ne bashkë, si anëtarë të shoqërisë në një kuptim të gjerë, duhet këtë ta mbështesim edhe individualisht dhe sa mundemi me anë të institucioneve që eventualisht i përfaqësojmë (...) është pjekur një klimë e përgjithshme shoqërore, psikologjike, emocionale, shpirtërore këtu brenda të gjitha kombeve, të gjitha këtyre korpuseve kombëtare, se duam të arrijmë të vërtetën, se dëshirojmë të afrohem dhe dëshirojmë në njëfarë mënyre të gjithë të shkarkohemi nga ajo barrë e madhe që po na mundon. (Mustafa Gobelij, krye-imami i Mexhlisit të Bashkësisë Islame Bërçko, Konsultimet me bashkësinë lokale, Bërçko, BeH, 5 dhjetor 2009.)

(...) bashkë-ndiejmë me të gjitha viktimat, sepse edhe vet jam viktimë dhe do të doja që kjo qasje që ne po e sforcijmë dhe ky (Koalicioni për KOMRA) të cilit ne do ti bashkohemi edhe si shoqatë edhe unë si individ, të ketë sukses. Kjo është dëshira e viktimave. Kjo është nevojë e pashterur e viktimave, por edhe nevojë e paqes, e ardhmërisë së BeH dhe e mbarë rajonit. (Vlado Dragoljloviq, Shoqata e Robërve dhe Kampistëve të Luftës, Lidhja e Kampistëve të RS, Modriçë, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Bërçko, BeH, 5 dhjetor 2009.)

Iniciativa përshëndetet dhe presim se do të rritet vetëdija dhe kjo do të marrë mbështetjen e gjerë (...) ne shpesh po flasim mbi përgjegjësinë penale. Mirëpo, (...) konkretisht në Bërçko ekzistojnë (...) 10 ose më shumë gra që kanë kaluar tortura të tmerrshme të përdhunimit (nga aktet e tilla kanë lindur edhe fëmijët të cilët sot kanë 13, 14 vjet), të cilat nevojën për psikoterapi e realizojnë me shkuarje në Tuzëll, por nëse janë në prag të statusit social (e më shumë ka të tilla) ato vuajnë dhe jetojnë me atë mundimin e vet dhe problemet brenda mureve të shtëpisë. Tash shpejtë në Bërçko një femër ka bërë vetëvrasje. Jetojnë (...) midis botëve të ndara e të mbyllura, ose të robërimit në të vërtetat e veta. (Qazim Suljeviq, Bashkësia Boshnjake e Kulturës -Preporod, Bërçko, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Bërçko, BeH, 5 dhjetor 2009.)

KOMRA duhet të fokusohet në ngjarjet nga lufta e fundit në territorin e ish RSFJ.

(...) duhet të fokusohemi nëse duam të arrijmë tek viktimat, në atë që ka ndodhur këtu edhe në këtë luftën e fundit. (Llazar Bllagojeviq, Organizata e Luftëtarëve të RS, Shamac, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Bërçko, BeH, 5 dhjetor 2009.)

Zëri publik i viktimave do të ndikojë që të ndryshohet vetëdija jonë dhe të flakën gjysmë të vërtetat. Është me rëndësi që politikanët ti dëgjojnë viktimat.

Duhet (...) dhënë shansin viktimave të flasin dhe pas një kohe të caktuar, mendoj se vetëdija e të gjithë neve ngadalë do të ndryshohet (...) shumë gjysmë të vërtetat dh shumë të quajtura të vërteta që po plasohen për arsye nga më të ndryshmet, do të bien në ujë dhe të arrihet formimi i asaj që do të na ndihmojë të gjithë neve që pas krejt asaj që na ka ndodhur në të kaluarën, ta mësojmë njëmend të vërtetën e mirëfilltë. (Dragan Pajiq, prefekt i Distriktit Bërçko, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Bërçko, BeH, 5 dhjetor 2009.)

KOMRA (Koalicioni për KOMRA) do të duhet ta mbajë në të gjitha parlamentet një konsultim të këtillë me anëtarët e tashëm të kuvendeve parlamentare. Jo vetëm ajo që tash të themi përse nevojitet KOMRA, veç thjeshtë që ti sjellim viktimat, që ata ti dëgjojnë viktimat. (Sead Golij, Shoqata e Boshnjakëve të Zhdukur, të marrë me dhunë e të vrarë në Komunën Bërçko, Bërçko, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Bërçko, BeH, 5 dhjetor 2009.)

Për familjet e të zhdukurve është më e rëndësishme që ti gjenin mbeturinat mortore të të afërmeve të vet dhe ti varrosin me dinjitet, se sa të gjykojnë kryesit.

(...) Është më mirë që ai i cili ka krye krim të thotë ku janë trupat që ne familjarët të qetësohemi. Nuk është e domosdoshme që unë ta padis askënd (...). Le të mi jap eshtërtat, fëmijën. Dhe ashtu të kënaqura do të ishin të gjitha këto familje nga ana ime, që të gjenden mbetjet mortore dhe të varrosen me dinjitet. (Milorad Zimoviq, Shoqata për Kërkimin e Personave të Zhdukur të Komunës Bërçko, Konsultimet me bashkësinë lokale, Bërçko, BeH, 5 dhjetor 2009.)

Viktimat duhet të kenë emër e mbiemër. Defi-

nicioni i viktimës duhet të jetë i saktë, të vrarët e të pësuarit duhet të përkufizohen qartë.

Si njeri më ofendon kur dikush viktimën e quan numër. Viktima nuk mund të jetë numër. Viktima ka emër e mbiemër. Dhe mendoj se institucionet legale ose institucionet e rregullta të pushtetit në entitete është dashur ta bëjnë menjëherë regjistrimin e viktimave edhe ku ka pasur mundësi dhe si ka pësuar. Edhe sot e kësaj dite kjo ende nuk është bërë. Atë moment kur është kapur rob dhe e ka lënë pushkën, më tutje ai është viktimë. Dhe për atë duhet të përgjigjet. Prandaj duhet qartë të përkufizohen të mbyturit nga të vrarët. (Rado Puriq, Shoqata e Invalidëve Usharak të Luftës, Bërçko, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Bërçko, BeH, 5 dhjetor 2009.)

Të regjistrohen të gjitha viktimat. Të regjistrohen të gjithë të pësuarit e pastaj sipas atyre kritereve të thuhet çka është viktima, çka janë humbjet luftarake e kështu me radhë. (Llazar Blagojeviq, Organizata e Luftetarëve, Shamac, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Bërçko, BeH, 5 dhjetor 2009.)

Vetëm viktima ka të drejtë të flas mbi atë se çfarë i ka ndodhur asaj dhe kush i ka bërë të keqe. Gjykata e Hagës ka qenë e domosdoshme, por aktgjykimet po merren me politik.

(...) kur është fjala për këto çështje që janë tepër shumë të ndjeshme, duhet afruar viktimës dhe vetëm viktima ka të drejtë të flas mbi veten dhe për atë kush i ka bërë të keqe asaj. Duke shkuar kësaj rruge më lehtë do të arrijmë të vërtetën. Nëse do të jemi të ngarkuar me aktgjykimet e Gjykatës së Hagës, e unë do të jam i lirë të them dhe i takojë popullit cilit i takoj, Gjykata e Hagës ka qenë e domosdoshme, të hap diçka që ne nuk kemi dashur dhe nuk kemi guxuar ta hapim në këto hapësira, dhe kurrë nuk e kishin hapur. Mirëpo, aktgjykimet e Gjykatës së Hagës në të shumtën janë komprometuese për shkak se merren me politik dhe merren me politik të lartë. Viktimave nuk u nevojitet politika. (Vlado Dragojloviq, Shoqata e Robërve dhe Kampistëve të Luftës, Modriçë, Lidhja e Kampistëve të RS, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Bërçko, BeH, 5 dhjetor 2009.)

Nuk ka amnisti për krimin e luftës.

Krimi i luftës nuk vjetrohet. Dhe shtrohet një pyetje logjike. Kush ka të drejtë, kur është fjala për krimin e luftës, të flas mbi amnistinë? Nuk ka amnisti për

krimin e luftës. (Vehid Šehiq, Forumi i Qytetarëve të Tuzllës, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Bërçko, BeH, 5 dhjetor 2009.)

Organizatat e veteranëve nevojitet të përkufizohen nga luftëtarët e vet që kanë kryer vepra të këqija.

Mua më kanë detyruar ta marrë pushkën në dorë. Nuk më ka ra ndërmend ta marrë. Kemi veteran që i kanë rrokur pushkët për t'ju keqtrajtuar juve, mua, tjetrin, të pestin dhe të dhjetin. E dini? Ashtu që në botën e veteranëve duhet të përkufizohen njerëzit. Të këtille e të atillë. Unë këta tjerët, të këqij i gjykoj. Gjithmonë i gjykoj dhe kurrë askujt nuk ia kam dhënë mbështetjen për këtë. Por këtë duhet ta bëjnë edhe organizatat tjera të veteranëve. (Narcis Mishanoviç, Shoqata e Luftëtarëve të Demobilizuar të Armatës së BeH, Sarajevë, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Bërçko, BeH, 5 dhjetor 2009.)

Është më së miri që KOMRA ta verifikojnë parlamentet. Pa këtë Komisioni nuk do të ketë peshën dhe jehonën e nevojshme që do ta dëshironim.

Do të ishte më mirë që (KOMRA) (...)ta verifikojnë parlamentet e shteteve. (...) në qoftë se nuk do të jetë kjo mbështetje, atëherë rezultatet e atyre komisioneve nuk do të kenë atë peshë që do të duhej ta kishin dhe atë jehonë të cilën do ta dëshironim (...) (ef. Mustafa Gobeliq, Mexhlisi i Bashkësisë Islame, Konsultimet me bashkësinë lokale, Bërçko, BeH, 5 dhjetor 2009.)

Anëtarët e KOMRA duhet të jenë persona profesionist prej autoriteti. Fjalën kryesore lypset ta kenë viktimat.

(...) Duhet të jenë njerëzit të cilët (...) e njohin tematikën profesionalisht, (...) njerëzit të cilët gëzojnë besim tek të gjithë, të cilët nuk do të përçmohen, dhe rezultatet e tyre nuk do të kontestohen. Ata njerëz që do të emërohen në atë Komision, nuk do të duhej të jenë të ngarkuar me politik dhe ti nënshtrohen trysnisë së politikës. (Llazar Blagojeviq, Organizata e Luftëtarëve, Shamac, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Bërçko, BeH, 5 dhjetor 2009.)

Konsideroj se ata duhet të jenë njerëz të cilët, para se gjithash, do të jenë profesionist por me autoritet në të gjitha mjediset nga shkalla lokale dhe rajonale. (Marija Arsliaq, Shoqata Josip Broz Tito, Bërçko,

BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Bërçko, BeH, 5 dhjetor 2009.)

(...) shumicën dhe fjalën kryesore duhet ta kenë viktimat. (...) viktimat të jenë në atë Komision, sepse ato nuk mund ti paguaj askush. Mendoj se edhe veteranët mund të jenë këtu. Ndoshta jo bash anëtarë të Komisionit, por si këshilltar, si mik të Komisionit. (Narcis Mishanoviq, Shoqata e Luftëtarëve të Demobilizuar të Armatës së BeH, Sarajevë, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Bërçko, BeH, 5 dhjetor 2009.)

Lypset të mësojmë të flasim mbi krimet, ta dëgjojmë njëri tjetrin dhe ta kuptojmë vuajtjen e tjetrit.

Kur është (...) fjala për këtë problematik, atëherë gjendemi në një para-fillimi, (...) që mbi krimet, përvojat e krimit të flasim, që për këtë të përpigemi të vetëdijesohemi dhe ta (...) arrijmë shkallën e domosdoshme për vënien e dialogut, e kjo është që ta dëgjojmë tjetrin kur flet mbi pësimin e vet dhe këtë të orvatemi gjithashtu ta kuptojmë. (Qazim Suljeviq, Bashkësia Boshnjake e Kulturës Preporod, Bërçko, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Bërçko, BeH, 5 dhjetor 2009.)

KOMRA nuk është në interesin e politikanëve, do të orvatën të ndikojnë në formimin, mënyrën e punës dhe aktivitetet e Komisionit.

(...) politikanët nuk kanë interes që ata ta formojnë (KOMRA). Nuk është interes sepse edhe ata do të prekën. (Rado Puriq, Shoqata e Invalidëve Ushtarak të Luftës të Komunës Bërçko, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Bërçko, BeH, 5 dhjetor 2009.)

(...) politikat aktuale të cilat janë (...) më përgjegjëse për një gjendje të këtillë, më parë do të orvatën të ndikojnë në formimin dhe mënyrën e punës si dhe në vëllimin e punëve të këtij Komisioni rajonal. (Qazim Suljeviq, Bashkësia Boshnjake e Kulturës -Preporod, Bërçko, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Bërçko, BeH, 5 dhjetor 2009.)

Ekziston frika nëse KOMRA do ti marrë dokumentet nga shtetet në rajon. Kësaj nuk ia ka dalë as Gjykata e Hagës.

Ne e dimë se as Haga nuk mund t'i marrë disa dokumente, andaj për këtë shkak po frikohem si do ti marrë tek ai Komision, nëse nuk do ta kemi mbështetjen e të gjitha strukturave politike në

shkallë të mbarë ish Jugosllavisë. (Qazim Suljeviq, Bashkësia Boshnjake e Kulturës Preporod, Bërçko, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Bërçko, BeH, 5 dhjetor 2009.)

Konsultimet kombëtare me kampistët (llogorashët) mbi Iniciativën për formimin e KOMRA-s

Sarajevë, BiH
10 dhjetor 2009.

Konsultimet i kanë organizuar Lidhja e Kampistëve të BeH dhe Shoqata e BH Gazetarëve. Kanë marrë pjesë 31 përfaqësuesit e Lidhjes së Kampistëve të BeH dhe Shoqatat e Kampistëve të Luftës Atdhetare në BeH. Kryetari i Lidhjes së Kampistëve nga Republika Serpska (RS) e ka pezulluar pjesëmarrjen e paralajmëruar të tetë përfaqësuesve dy ditë para mbajtjes së tubimit. Mbi Iniciativën për formimin e Komisionit Rajonal për vërtetimin e fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljet tjera të rënda të drejtave të njeriut në ish Jugosllavi (KOMRA) në tubim kanë folur Natasha Kandiq (Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi), Zoran Shangut (Shoqata e Juristëve Vukovari '91) dhe Bogdan Ivanisheviq (Qendra Ndërkombëtare për të Drejtën në Tranzicion). Tubimin e ka moderuar Xhenana Karup-Drushko. Mbi tubimin kanë raportuar... FTV dhe lajmet në

Mendime, propozime dhe Rekomandime

Iniciativa KOMRA është e mirëseardhur dhe të gjithë duhet ta mbështesin.

Pikërisht për shkak të gjithë kësaj, për shkak të lëshimeve sidomos të Gjykatës së Hagës, mospërfilljen e viktimave në shtetet tona, si dhe të atyre që i kanë bërë ato krime të luftës, mendoj se secila iniciativë që vjen nga organizatat joqeveritare është mirëseardhur. Këtu në radhë të parë mendoj në KOMRA dhe kujtoj se këtë të gjithë duhet ta mbështesim dhe të gjithë të qëndrojmë prapa kësaj. (Zoran Shangut, Shoqata e Juristëve Vukovar '91, Vukovar, Kroaci, Konsultimet kombëtare me kampistët, Sarajevë, BeH, 10 dhjetor 2009.)

Më vjen mirë që (...) e ka ngritur një iniciativë të këtillë. Hajde ta përqafojmë atë që vlen, e për atë që nuk është për ne, që nuk mund të adaptohet,

të merremi vesh. (Zlatko Prkić, Shoqata Kroate e Kampistëve të Luftës Atdhetare në BeH, Varesh, Konsultimet kombëtare me kampistët, Sarajevë, BeH, 10 dhjetor. 2009.)

KOMRA është zgjidhje mirëpo duhet të fitojë përmbajtje, të bëhet yni.

Unë vetëm dua t'ju ftoj që të flisni lirshëm, të propozoni, ne nuk kemi ndonjë zgjidhje, zgjidhje jona është ai komisioni, por ai komision duhet të marrë përmbajtje, duhet të bëhet yni. (Natasha Kandić, Fondi për të Drejtën Humanitare, Beograd, Serbi, Konsultimet kombëtare me kampistët, Sarajevë, BeH, 10 dhjetor 2009.)

Ne mundemi edhe me anë të KOMRA ti ngremë edhe këto çështje, si çështja e fakteve dhe e krimeve, e krimeve dhe e të drejtave statusore, dhe të drejtave sociale nëse do të flasim sipas mënyrës si duhet të arrihet kjo. (Irfan Ajanović, Lidhja e Kampistëve të BeH, Sarajevë, Konsultimet kombëtare me kampistët, Sarajevë, BeH, 10 dhjetor. 2009.)

KOMRA do të jetë i suksesshëm në qoftë se i regjistron të gjitha kampet, i zbulon varrezat masive dhe nëse e heton fatin e të zhdukurve.

Dhe pikërisht për shkak të gjitha netëve që i kemi kaluar duke mos fjetur, për shkak të torturave dhe krejt asaj që na ka ndodhur në kampe, mendoj se në radhë të parë është qenësore që ta orientojmë gjithë energjinë tonë në të vërtetën. Që të gjithë ta gjejmë definicionin çka është në realitet kampi e çka qendra e grumbullimit. Dhe ato vende të gjithë bashkë ti shënojmë pavarësisht nga cila anë kanë qenë kampet, për hir të gjeneratave të ardhshme, për hir të paqes së ardhshme dhe për shkak të vërtetës. (...) Nëse kjo iniciativë gjallërohet, unë do ta konsideroj të suksesshme vetëm në qoftë se i mbulon tri segmente: nëse i mbulon të gjitha kampet që kanë ndodhur në këto hapësira, nëse i mbulon të gjitha varrezat masive dhe nëse i heton të gjithë ata që janë zhdukur. (Zoran Shangut, Shoqata e Juristëve Vukovar '91, Vukovar, Kroaci, Konsultimet kombëtare me kampistët, Sarajevë, BeH, 10 dhjetor. 2009.)

KOMRA është rast unik që viktimat të bëjnë aleancën, të nisin ta respektojnë njëri tjetrin dhe që ata ti respektojnë pushteti.

Ne (viktimat) nuk po e respektojmë njëri tjetrin dhe atëherë si mund të presim që neve të na respektojë

pushteti dhe neve të na jepen disa të drejta të cilat na takojnë. Pushteti, pushtetarët këtu kanë bërë, e kanë kthye mbrapsht tezën mbi viktimat, ashtu që tash të shumtën kriminelët po trajtohen si viktimat kurse ne viktimat përfundimisht jemi harruar në çdo pjesë të këtij vendi. Domethënë, vet qëndrimi i pushtetit ndaj nesh do të jetë i atillë çfarë është, derisa ne nuk ulemi bashkë rreth tryezës dhe ne mes veti nuk lidhim ndonjë aleancë unike. Ne këtë nuk mund ta bëjmë, por ja KOMRA për ne është rast unik të arrijmë atë qëllim. (Mirsad Duratović, Shoqata e Kampistëve Prijedor '92, Prijedor, BeH, Konsultimet kombëtare me kampistët, Sarajevë, BeH, 10 dhjetor. 2009.)

Bashkërisht duhet definuar çka është kampi e çka qendra e grumbullimit. Duhet shënuar të gjitha vendet e pësimeve.

(...) të tri palët në Bosnjë e Hercegovinë kanë shoqatat e kampistëve, mendoj se do të ishte mirë që të tri palët ta shkruajnë çka është definicioni e kampit dhe përse ata konsiderojnë se atje ku kanë qenë të zënë rob janë kampe, por pastaj ai definicion që e kanë shkruar ata, nënkupton se në qoftë se edhe pjesëtarët e popullit të tyre respektivisht të entiteteve të tyre kanë organizuar diç të tillë, që kjo po ashtu të konsiderohet kamp. Domethënë, jo vetëm ku kam qenë unë veç edhe dikush nga ana ime këtë e ka organizuar, atëherë kjo po ashtu konsiderohet kamp. Mendoj se propozimi im, ai definicion, është mënyrë sipas të cilës mund të zgjidhet kjo pyetje-çka është qendra e grumbullimit e çka kampi? Dhe konsideroj se duhet shënuar të gjitha vendet e pësimeve sikur që janë shënuar pas Luftës së II Botërore kampet, sidomos siç janë Jasenovac, Aushvic etj. (...) çdo krim të luftës pavarësisht nga cila anë është kryer, unë e gjykoj dhe do të më vinte mirë në qoftë se në vendosjen e pllakës përkujtimore në Stajiqevë vinë edhe ato viktimat e Lorës (burgu), e po ashtu nëse ata vendosin një ditë ta vënë pllakën përkujtimore në Split, në Lora, do ta kenë mbështetjen time. (Zoran Shangut, Shoqata e Juristëve Vukovar '91, Vukovar, Kroaci, Konsultimet kombëtare me kampistët, Sarajevë, BeH, 10 dhjetor. 2009.)

Ne nuk mund të diskutojmë derisa nuk e zgjidhin çështjen tonë bazë, e ky është Ligji mbi kampistët. Çka është kampi? Çka do të debatojmë ne mbi KOMRA? Ne nuk e kemi zgjidhur Ligjin tonë bazë. (Zheljko Vladić, Shoqata Kroate e Kampistëve të Luftës Atdhetare në BeH, Mostar, Konsultimet kombëtare me kampistët, Sarajevë, BeH, 10 dhjetor 2009.)

E vërteta, para se gjithash, arrihet në proceset gjyqësore.

Si mund ti japim kontribut të vërtetës? Para se gjithash të dëshmojmë në proceset gjyqësore. Vështirë është të dakordohet e vërteta pa procese gjyqësore. (Irfan Ajanović, Lidhja e Kampistëve të BeH, Sarajevë, Konsultimet kombëtare me kampistët, Sarajevë, BeH, 10 dhjetor. 2009.)

Dëshmitet publike mund të prodhojnë efekt të kundërt nëse nuk ka sanksione për paraqitjen e të pavërtetës.

(...) Unë këtë e pranoj (dëgjimin publik). Ne me anë të aktiviteteve tona jemi orvatur të bëjmë diç të atillë por çka ndodh me dëgjimet publike. Dëgjimet publike u japin shansin atyre të cilët nuk e duan që të vërtetën ta thonë të pavërtetë. Ato janë pa sanksione dhe shkojnë në etër, shkojnë në opinion, shkojnë në medie dhe atëherë në fund të fundit dëgjimet e tilla, deklaratat e tilla, fjalimet e tilla, sidomos fjalimet e zjarra, e sjellin në mëdyshje opinionin publik. Thjeshtë krijojnë kaos dhe ne atëherë, jam i sigurt, mund të arrijmë kundër efekt. (Irfan Ajanović, Lidhja e Kampistëve të BeH, Sarajevë, Konsultimet kombëtare me kampistët, Sarajevë, BeH, 10 dhjetor 2009.)

Dëshmitet publike janë të rëndësishme, sepse shumë viktimat nuk kanë qasje në mediat publike dhe mundësi të paraqesin çka u ka ndodhur atyre.

Dëgjimi publik? Unë konkretisht jam për dëgjim publik për shkak se nuk kam mundësi, nuk kam vëmendje mediale të na përcjellë. E kemi televizionin lokal – Televizionin e Hercegovinës – i cili dëgjohet deri diku dy kilometra. Domethënë, unë nuk mund ta paraqes të vërtetën time. (...) Pra, mendoj se duhet respektuar njëri tjetrin. E të mohohet se unë e kam kaluar atë që e kam kaluar, dhe se vetëm individët kanë kaluar, mendoj se atëherë e gjithë kjo nuk mund të shkojë në kuptimin pozitiv.. (Darko Matković, Shoqata Kroate e Kampistëve të Luftës Atdhetare në BeH, Konjicë, Konsultimet kombëtare me kampistët, Sarajevë, BeH, 10 dhjetor 2009.)

Shkenca dhe koha me ndihmën e asociacionit të viktimave dhe iniciativave të mira, do të kontribuojë të ndodh e vërtetata dhe pajtimi.

Vetëm shkenca dhe koha me ndihmën e këtyre aso-

ciacioneve, këtyre iniciativave, por shkenca dhe koha në vend të parë, jo ne më parë dhe përpara shkencës dhe kohës. Që ne të bëhemi suport (mbështetje) e shkencës dhe e kohës. Atëherë mund ta presim atë që duhet të ndodh në këtë hapësirë fatkeqe, në hapësirën e Ballkanit Perëndimor të ndodh e vërteta dhe drejtësia. Në bazë të drejtësisë edhe sanksioni, dhe në bazë të gjithë kësaj pajtimi dhe ne nuk mund të jetojmë nëse nuk pajtohemi. (...) KOMRA si ide është e jashtëzakonshme, por nëpërmjet KOMRA do të kalojë shumëçka që në fund të fundit do të jetë kundër produkt, dhe që nuk shkon në drejtim të drejtësisë dhe pajtimit. (Irfan Ajanović, Lidhja e Kampistëve të BeH, Sarajevë, Konsultimet kombëtare me kampistët, Sarajevë, BeH, 10 dhjetor 2009.)

Jam pesimist, sepse në pushtetin aktual në kulltukët e ministrave rrinë njerëzit që kanë qenë organizatorë të kampeve.

Tu them të vërtetën unë rreth kësaj jam pesimist i madh. Shumë të pavërteta janë shkruar në letër dhe po shiten si të vërteta. Shumëçka është thënë, janë shumë më të mëdha ato forca të cilat e përhapin të pa vërtetën. Ne këtu po luftojmë me mullinj të erës. Të mos mashtrohemi gjithashtu, sepse edhe mes nesh këtu rrinë njerëzit të cilët nuk mund të besojnë tash apo këtë ata nuk e dinë apo nuk po duan ta dinë se, bie fjala, dikush ka qenë në ndonjë kamp. (...) Pse po bëhet kjo? Kjo po bëhet për shkak që edhe tash në pushtetin aktual njerëzit që janë në kulltukët e ministrave kanë qenë organizator të kampeve. Pra, nuk është në interesin e tyre të flitet mbi kampin dhe të shkruhet diçka për kampin. As që u bie ndërmend të nxjerrin ndonjë ligj mbi viktimat e torturës. Lëre këtë. Domethënë, kjo do të mundet dikur kur të kalojë ndonjë kohë, që dikush e tha këtu, kjo do të shërohet dikur. Dhe kur të mos jenë në kulltukun e ministrit apo të deputetit njerëzit që kanë qenë përgjegjës për kampet, ndoshta do të mund të flasin më lirshëm mbi atë të vërtetë. (Mirko Zelenika, Shoqata Kroate e Kampistëve të Luftës Atdhetare në BeH, Mostar, Konsultimet kombëtare me kampistët, Sarajevë, BeH, 10 dhjetor 2009.)

Nëse duan të punojnë bashkë, kampistët duhet t'i pranojnë të gjitha krimet.

Nuk guxon as një krim, asnjë shkelje e të drejtave të njeriut të mohohet! Nëse ka pasur krime, ne kampistët duhet vërtetë të themi: kjo ka qenë, e jo të ngremë barrikada midis njëri tjetrit, e po duam

të punojmë bashkë. (Zlatko Prkić, Shoqata Kroate e Kampistëve të Luftës Atdhetare në BeH, Varesh, Konsultimet kombëtare me kampistët, Sarajevë, BeH, 10 dhjetor 2009.)

Përfaqësuesi i kampistëve në KOMRA duhet të jetë person i cili pranon se edhe në popullin e tij ka pasur krime.

Ai person duhet më parë atë egon e vet, nëse është deri në kulm, ta zbret në xhep dhe të pranojë se ka pasur në popullin e tij ndonjë nga krimet, që të mund ma lehtë ta dëgjojë palën tjetër kur të bëhen dëgjime publike. E jo që në të të aktivizohen emocionet dhe të thotë: ndal, edhe tek ti atje ka ndodhur ky...! Domethënë, më parë gjendja faktike që unë të mund ta shikojë në sy Perën dhe Pera mua. Që unë të mund ta dëgjojë atë si njeri dhe të mundët ai të më dëgjojë mua, tek atëherë mund të bisedojmë mbi KOMRA. Përpara kësaj nuk ka asgjë! Më falni, tek atëherë mund të flasim për rastet tona veç e veç. Duhet të bisedojmë a jemi për KOMRA, kush duhet të jetë aty, çka duhet të jetë aty, e jo cilat janë problemet e mia personale. (Mirsad Dizdare, Lidhja e Kampistëve të BeH, Jajce, Konsultimet kombëtare me kampistët, Sarajevë, BeH, 10 dhjetor 2009.)

Lidhja e Kampistëve të BeH kërkon vizion të qartë të Iniciativës KOMRA dhe rolin e vet në proces.

Ne po duam vizion shumë të qartë çka mund të na sjellë KOMRA. Cili është qëllimi i tij? Cila është e mira e tij? Çka do të jetë ai? Në çfarë mënyre do të formohet? A do të elidoj diçka, respektivisht nuk do të elidoj? Përse nuk është Lidhja e Kampistëve të RS? (...) Unë tash po flas vetëm në emrin tim, por deri tash unë se pash këtë vizion. Vërtetë jo. Nuk pash se çka po ofrohet konkretisht në miratimin e qëllimeve që do të japin përgjigje në të gjitha ato pyetjet të cilat edhe neve ndonjëherë nuk na janë të qarta, ndonjëherë nuk dëshirojmë ti pranojmë e nganjëherë janë edhe të rrejshme. (Murat Tahiroviq, Lidhja e Kampistëve të BeH, Sarajevë, Konsultimet kombëtare me kampistët, Sarajevë, BeH, 10 dhjetor. 2009.)

Shoqatat e Kampistëve mund të ndihmojnë në përkufizimin e mandatit të KOMRA-s në grumbullimin e 1.000. 000 nënshkrimeve, sigurimin e dokumentacionit dhe marrjen e deklaratave nga viktimat.

(...) në këtë fazë përpara formimit të KOMRA gjatë

kësaj faze konsultative, nëse natyrisht ju e konsideroni se kjo është vlefshme, roli dhe inkudrimi juaj do të mund të ishte ndikimi në përmbajtjen e modelit të KOMRA. Roli i shoqatave të këtilla si shoqatat e kampistëve do të ishte që të marrin pjesë në mbledhjen e nënshkrimeve. Natasha Kandiq i përmendi një milion nënshkrime me të cilët ajo kërkesë do të shoqërohej, me të cilët do ti jepej legjitimitet më i madh kësaj kërkesë. Pas formimit të komisionit të atillë, anëtarët e shoqatave do të mund të ishin pjesë e personelit të atij Komisioni. (...) në disa vende me qindra njerëz kanë punuar në ato komisione, diku 700-800, diku më pak, varët nga vendi në vend. Një pjesë e mirë e asaj pune ka të bëjë me marrjen e deklaratave nga dëshmitarët dhe është mirë që deklaratat e tilla ti marrin edhe ata të cilët dinë se për çfarë dhe çka duhet të pyesin. Për të cilët nuk është diçka me të cilën po ndeshën për herë të parë në jetë, e shumica nga ju, fatkeqësisht, i dinë dhe i njohin ato pyetje. Ndoshta përbëhet edhe nga dëshmimi, dhënia e deklaratave, ndoshta përbëhet nga fakti i materialeve të kapshme të cilat i keni të gjithë. Shumica nga ju sot e përmendi bazat që i keni ju, ashtu që mendoj se ka shumë që mund të jetë rol i shoqatave edhe para edhe pas formimit të Komisionit. (Bogdan Ivanisheviq, Qendra Ndërkombëtare për të Drejtën në Transicion, Konsultimet kombëtare me kampistët, Sarajevë, BeH, 10 dhjetor. 2009.)

Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare mbi Iniciativën për formimin e KOMRA-s

**Beograd, Serbi
17 dhjetor 2009.**

Konsultimet me organizatat joqeveritare janë mbajtur në organizimin e Fondit për të Drejtën Humanitare dhe të Agjencisë për bashkëpunim me organizatat joqeveritare dhe harmonizim evropian, të Administratës së qytetit të Beogradit. Kanë marrë pjesë 44 përfaqësues të organizatave joqeveritare nga të gjitha pjesët e Serbisë. Vëzhguesit kanë qenë nga ambasada e Britanisë së Madhe dhe Holandës. Ligjërues kanë qenë Natasha Kandiq (Fondit për të Drejtën Humanitare) dhe Bogdan Ivanisheviq (Qendra Ndërkombëtare për Drejtësi në Transicion), ndërsa tubimin e ka moderuar Dragan Popović (Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut, Serbi).

Mendimet, propozimet, dhe Rekomandimet e pjesëmarrësve

Qyteti i Beograd e mbështet formimin e KOMRA.

Para se gjithash ju dëshiroj mirëseardhje në emër të Qytetit të Beogradit, Administratës së qytetit. Përse mbështetja për KOMRA? Viteve të nëntëdhjeta qytetarët e Beogradit dhe në një farë mase edhe pushteti opozitar në Beograd, kanë treguar gatishmëri që ta ngrenë zërin kundër luftës. Kur them qytetarët e Beogradit, mendoj në radhë të parë në përfaqësuesit e organizatave joqeveritare. Njëri nga prioritetet e Agjencisë tonë është edhe bashkëpunimi rajonal në përpjekjet që natyrisht po bëhen drejtë ripërtëritjes së lidhjeve të rrënuara, ndriçimin e të kaluarës për hir të një të ardhme më të qartë, para se gjithash, kuptohet me qëllim të ofrimit të satisfaksionit adekuat viktimave. (Danko Runiq, drejtor i Agjencisë për bashkëpunim me organizatat joqeveritare, Administrata e qytetit të Beogradit, Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare, Beograd, Serbi, 17 dhjetor 2009.)

KOMRA duhet të formojë një trup i cili do të punonte me personat profesionistë që kanë marrë pjesë në luftë për lokalizimin e dëshmitarëve dhe të lokaliteteve të krimit.

Si ish pjesëtar i njësive speciale të Republikës së Serbisë kam pasur rastin të bisedoj me oficerët e atëhershëm dhe pjesëtarët e formacioneve profesionale të Republikës së Serbisë. Ashtu që konsideroj se në kuadrin e KOMRA duhet të ekzistojë një komision i cili do të punonte me personat profesionist, të cilët tash janë në kontakt me dëshmitarët imediat, me shumicën e rasteve, me numrin më të madh të krimeve në hapësirën e ish Jugosllavisë, veçanërisht në Kosovë. (Nenad Petroviq, Palestra, Krushevc, Serbi, Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare, Beograd, Serbi, 17 dhjetor 2009.)

Është koha të shkruhet pasqyra e gjithë asaj që është kristalizuar në debat, përfshirë dilemat dhe mendimet e ndryshme.

Mendoj se ka ardhur koha të shkruhet ndonjë propozim nga e gjithë kjo që është bërë gjatë 68 takimeve. Unë pak u frikova kur dëgjova 68 takime, kjo më ngjanë në disa gjëra nga politika. Natyrisht se akoma ka dilema, por mendoj se pas katër vitesh e gjysmë kemi arritur në diçka që është e pa dyshimit dhe duhet qitur si skelet në atë propozim. Dhe

pastaj në atë tekst të jepen edhe të gjitha dilemat ku ato ekzistojnë, hamendjet apo mendimet e ndryshme. Jam i sigurt se njerëzit më shumë dhe në mënyrë më aktive do të marrin pjesë në diskutimet e mëtejshme kur të kenë rreth çka të deklarohen. (Zoran Zhivković, Milenijum – Qendra për zhvillimin e shoqërisë civile, Beograd, Serbi, Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare, Beograd, Serbi, 17 dhjetor 2009.)

Një milion nënshkrime do të jetë vështirë të mbliidhen, edhe teknikisht edhe me motivacion.

Më duhet të them se jam pesimist për mënyrën se si do të deklarohen autoritetet, ato aktuale dhe disa të ardhshme, në qoftë se diçka nuk ndryshohet në cilindo nga këto shtete, suksesor të ish Jugosllavisë. Ndoshta gaboj. Do si do. duhet dal me atë pasqyrë dhe të bëhet trysni. Të grumbullohen një milion nënshkrime fare nuk është punë e thjeshtë as teknikisht e lëre më me motivacion dhe në çdo mënyrë tjetër. E gjithë kjo duhet të nis më herët, ndryshe vitet më të mira të jetës do ti kalojmë në diskutime mbi Iniciativën, e është koha që këtë ta përfundojmë. (Zoran Zhivković, Milenijum – Qendra për zhvillimin e shoqërisë civile, Beograd, Serbi, Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare, Beograd, Serbi, 17 dhjetor 2009.)

Komisioni Rajonal mund të përbëhet vetëm nga komisionet kombëtare të cilët do të ishin të pavarur. Në Serbi theksi duhet të jetë që shteti ta pranojë përgjegjësinë për krime.

Mendoj se janë të dobishme të gjitha këto konsultime që janë zhvilluar, kjo megjithatë është njëfarë informate, të paktën për njerëzit në terren të cilët në këtë marrin pjesë për herë të parë, thjeshtë sensibilizohen për një qasje ndaj gjithë kësaj. Mirëpo, unë edhe më tutje konsideroj se Komisioni Rajonal mund të përbëhet vetëm nga komisionet kombëtare, ashtu që ato të jenë të pavarura. Tubimi si ky këtu, i përbërë nga organizatat joqeveritare në Serbi, duhet të vazhdojë punën dhe të ushtrojë trysni mbi pushtetin në vetë Serbinë. Mendoj se është shumë më me rëndësi që në vetë Serbinë të vendoset bashkëpunimi i institucioneve të shtetit dhe organizatave joqeveritare. Kjo do të ishte shumë më efikase të fokusohet në Serbi (...) që të vihet theksi në kryesit dhe në shtetin, që aktivisht të kërkohet nga shteti ta pranojë përgjegjësinë për krime, përfshirë edhe gjenocidin. (Sonja Biserko, Këshilli i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Serbi, Beograd, Konsultimet

kombëtare me organizatat joqeveritare, Beograd, Serbi, 17 dhjetor 2009.)

Duhet vendosur a është zgjidhje më e mirë më parë të formohen komisionet nëpër shtetet e pastaj Komisioni Rajonal.

(...) Do të dëshiroja të përfshihen të gjitha shtetet, por ndoshta Sllovenia e Maqedonia nuk është e thënë. Por të gjitha tjerat duhet të përfshihen në punën e komisionit. Pastaj në ndonjë tubim të madh çfarë ka qenë ai në Beçiqi, kur të jenë të gjithë kryetarët e shteteve, do të mund të përcaktoheni nëse do të formohet komisionet nëpër shtete e pastaj ai i përbashkëti, apo nga ata Komisioni Rajonal. Duhet të japim përgjigje çka nëse ndonjë shtet nuk pranon të marrë pjesë në Komisionin Rajonal dhe si do ta zëvendësojmë mungesën e tij në konfirmimin e të vërtetës. Në qoftë se të gjitha shtetet i formojnë veç e veç komisionet, atëherë nga ato mund të formohen mekanizmat, me ndihmën e bashkësisë ndërkombëtare, për formimin e një komisionit të përbashkët rajonal për konfirmimin e të vërtetës. (Alija Halilović, Forumi Qytetar i Novi Pazarit, Rrjeti i këshillave për të drejtat e njeriut CHRIS, Serbi, Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare, Beograd, Serbi, 17 dhjetor 2009.)

Në qoftë se autoritetet nuk e pranojnë KOMRA, do të mbetemi të shkurtuar për të vërtetën.

Mendoj se nëse KOMRA nuk do të ketë sukses, nëse autoritetet dhe politikanët tanë nuk e mbështesin, nuk e pranojnë këtë si model për konfirmimin e të vërtetës, ne në realitet do të jemi të shkurtuar për të vërtetën. Sepse historitë tek ne i shkruajnë të kualifikuarit e të pakualifikuarit, dhe që gjatë pesëdhjetë viteve të ardhshme të mos kemi histori boshe apo të shkruar nga amatorët apo luftëtarët a luftënxitësit. Tash edhe ata po dëshirojnë të shkruajnë ditarë, dhe për çdo gjë dikush tjetër është fajtor, e unë nuk jam. Më falni, kaq.. (Alija Halilović, Forumi Qytetar i Novi Pazarit, Rrjeti i këshillave për të drejtat e njeriut CHRIS, Serbi, Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare, Beograd, Serbi, 17 dhjetor 2009.)

Komisionet kombëtare nuk mund ta krijojnë klimën në të cilën shtetet në rajonin e ish Jugosllavisë me vullnetin e vetë ta pranojnë përgjegjësinë për krimet e kryera. Faktet nuk mund të vërtetohen në shkallë kombëtare.

Si arrihet kjo, të kërkojmë përgjegjësi dhe nga shtetet ta marrim atë pranimin e tyre për përgjegjësi. Apo për shembull, si do ta vërtetojë komisioni kombëtar në Bosnjë e Hercegovinë të vërtetën kur kjo është e pamundshme pa Serbinë e Kroacinë. Ju lutëm, kryesit në pjesën më të madhe gjenden në Serbi po ashtu gjenden në Kroaci. Apo si ndonjë komision kombëtar, në Kosovë me kë do të ballafaqohet? Në çfarë mënyre do të arrihej ajo formë e pastër që secila shoqëri të përcaktohet ndaj të kaluarës së vet, ndaj historisë së vetë, ndaj përgjegjësisë së vetë dhe që çdo kund të përfaqësojë këtë rishikim ideal, vetëkritik. Unë, bie fjala, nuk besoj se kjo fare është e mundshme me anë të qasjes kombëtare ... (Natasha Kandiq, Fondi për të Drejtën Humanitare, Beograd, Serbi, Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare, Beograd, Serbi, 17 dhjetor 2009.)

Organizatat joqeveritare duhet të ushtrojnë tryzni që Serbia të ballafaqohet me vetveten.

(...) mendoj se është shumë me rëndësi që këtu (në Serbi) të zhvishen ato plane për krijimin e shtetit të përbashkët të serbëve dhe për këtë ka mjaftë material në Gjykatën e Hagës. (...) Kush do të na detyrojë neve, Kroacia, Bosnja e Hercegovina, Kosova, të pranojmë se ka qenë agresioni? Jo. Mendoj se është shumë më e rëndësishme që brenda vendit të flitet për këtë, sepse kjo është mënyrë e vetme që Serbia të ballafaqohet me vetveten. (Sonja Biserko, Këshilli i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Serbi, Beograd, Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare, Beograd, Serbi, 17 dhjetor 2009.)

Serbët e shqiptarët nga Kosova duhet të mbështeten dhe të inkurajohen që të hyjnë në këtë proces.

(...) Serbët e shqiptarët të cilët veç merren me këtë proces në Kosovë duhet forcuar, pasi që tani më kanë thënë se askush nga Beogradi nuk ka të drejtë ti hap proceset në Kosovë. Në anën e tyre duhet të jetë edhe bashkësia ndërkombëtare dhe pastaj me ndihmën e saj të hapet një proces i ngurtë dhe i dhimbshëm. (Aleksandar Stojanović, Qendra për zhvillimin e mjedisve lokale, Mitrovicë, Kosovë, Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare, Beograd, Serbi, 17 dhjetor 2009.)

KOMRA duhet të ketë një ekip multidisiplinarë, në mënyrë që ngjarjet të kundrohen nga këndet e ndryshme.

(...) Do të shtroja pyetje, diku zonja Biserko e përmendi kualifikimin e atyre njerëzve, mendoj se në këtë duhet të punojë ekipi multidisiplinar dhe gjërat duhet kundruar nga kënde të ndryshme. (Sedat Vrciq, Flores, Sjenica, Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare, Beograd, Serbi, 17 dhjetor 2009.)

Në procesin rreth formimit të KOMRA-s lypset inkuadruar bashkësitë fetare dhe partitë politike.

Do ta përshëndetja (...) shtrirjen e gjithë këtij procesi, në radhë të parë në kuptimin e aktorëve, sepse mendoj se është koha e fundit për këtë. Ndoshta proceset e ngjashme edhe kanë përfunduar ashtu siç kanë përfunduar, sepse nuk janë inkuadruar disa nga aktorët kryesor. Këtu, në radhë të parë, mendoj në bashkësitë fetare të cilat i përmendet dhe partitë parlamentare. Natyrisht se cili nga ne ka të drejtë që ndonjë lloji i aktorit të pëlqej apo jo. Para se gjithash edhe ata mes veti janë heterogjen, por mendoj se hapësira manovruese për arritjen e qëllimit është minimale nëse ata nuk inkuadrohen. (Milan Sitarski, Qendra për hulumtimin e religjionit të Shkollës së Hapur të Beogradit, Serbi, Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare, Beograd, Serbi, 17 dhjetor 2009.)

Më e rëndësishme është që të de-etnicohen viktimat dhe që në rajon të krijohet bashkë-ndjenja ndaj tyre.

Ne duhet ti de-etnicojmë viktimat, duhet tua sqarojmë njerëzve në republikat tona si janë ndier ato viktima. Ne lypset atyre më parë tua afrojmë atë ndjenjë të dhimbjes dhe tek pastaj mund të ushtrojmë trysni mbi shtetin, në çfarëdo mënyre (nga shkalla rajonale apo kombëtare). Dhe pastaj kjo nuk do të jetë problem. Por ne, së pari duhet ta gjejmë mënyrë si ta spastrojmë me modelin e dhunës si zgjidhje të problemit në shoqëri dhe familje, e tek atëherë të gjejmë mekanizma si do të shtrëngohet shteti. (Simon Simonoviq, student nga Beogradi, Serbi, Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare, Beograd, Serbi, 17 dhjetor 2009.)

Rreth kryesve është më lehtë të arrihet pajtueshmëria në shkallë rajoni se sa në shkallë kombëtare.

(...) shumë lehtë arrihet pajtueshmëria e rajonit në çështjet e fatit të të zhdukurve, të kampeve e tjera, por për kriminelët kurrqysh. Mendoj se në radhë të parë, në shkallë rajoni, duhet të arrihet njëfarë paj-

tueshmërie. Kjo atëherë është forcë më e madhe për të mundur me veprua edhe në shkallë kombëtare. (Milovan Radonjiq, Evrokontakt, Krushevc, Serbi, Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare, Beograd, Serbi, 17 dhjetor 2009.)

KOMRA është instrument i dialogut demokratik.

(...) mendoj se ky grup duhet të fokusohet në çështjen çka mundemi dhe duhet, domethënë çka është e domosdoshme ta bëjmë që shtetet ta përqafojnë KOMRA. Sepse, vet Koalicioni për KOMRA është instrument i dialogut demokratik, dhe se në ndonjë punë të mëtejshme do të gjejë përgjigje për të cilat besoj se do të jenë të mirëfillta për këtë diskutim. (Boshko Nektarijeviq, Forumi për Marrëdhënie Etnike, Beograd, Serbi, Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare, Beograd, Serbi, 17 dhjetor 2009.)

Organizatat joqeveritare duhet të ushtrojnë trysni mbi vetëqeverisjen lokale që KOMRA ta mbështesin si pjesë të integriteteve evropiane.

Nëse zotërinjtë (vetëqeverisja lokale) nuk duan të marrë pjesë në këtë çështje, atëherë edhe ne do ti stigmatizojmë ata. Domethënë, komuna që ka marrë tre milion e gjysmë euro nga Komisioni Evropian në emër të integriteteve evropiane, nuk dëshiron të marrë pjesë në llojin tjetër të integriteteve evropiane, prandaj do të flasim ndryshe: Unë nuk shoh instrument tjetër pos që edhe ne të ushtrojmë trysni.. (Virxhinija Marina Guzina, Parlamenti Qytetar Vrsnac, Serbi, Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare, Beograd, Serbi, 17 dhjetor 2009.)

Ambasadorët në Serbi (bashkësia ndërkom-bëtare) duhet ta mbështesin Iniciativën KOMRA si pjesë e mbështetjes Serbisë.

(..) nëse ambasadorët vitin e kaluar kanë qenë për të ushtruar trysni nga vendi në vend, nga lokali në lokal që të formohet ky koalicion monstruoz që është në pushtet, përse ata ambasadorë nuk do të vinin e të thoshin prisni pak njerëz edhe ne juve po ju japim para, hajde bëni diçka konkrete. Virdxhinija Marina Guzina, Parlamenti Qytetar Vrsnac, Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare, Beograd, Serbi, 17 dhjetor 2009.)

KOMRA duhet të merret me njerëzit që janë pasuruar, sepse ata janë në prapavijë të krimeve.

(...) ne jemi të sëmure nga disa gjëra të cilat ndoshta qytetarëve nuk ua kemi sjell qartë ndërlidhjen me krimet që kanë ndodhur. E këto janë, bie fjala, korrupsioni, monopoli, qeveritë e paqëndrueshme që janë mbështetur nga ana e atyre njerëzve të cilët janë pasuruar tepër shumë, ashtu që unë mendoj se ky diskutim duhet ti prek edhe këto gjëra. Domethënë, edhe pse kemi lista shumë të sakta të kriminelëve të luftës, a janë duke u gjykuar apo duhet të gjykohen, ndoshta lista të pasakta të viktimave. Ne fare nuk kemi lista të sakta cilët janë ata njerëz që janë pasuruar mbi këtë fatkeqësi, që emrat e tyre qartë të ndërlidhen me krimet që ndoshta janë ekonomikisht në ndonjë prapavijë, e ata njerëz tërthorazi ndikojnë në standardin e jetës. (Gordan Velev, Grupi 484, Beograd, Serbi, Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare, Beograd, Serbi, 17 dhjetor 2009.)

Edhe viktimat edhe dëshmitarët duhet të dëshmojnë publikisht. Duhet të flasin lirshëm, por me mbikëqyrje profesionale.

Sa i përket çështjes kur do të flas në sesionet me dëgjim publik, mendoj se është shumë e rëndësishme ti kemi rrëfimet edhe të viktimave edhe të dëshmitarëve. Sa i përket asaj se në çfarë mënyre të dëgjohen publikisht viktimat, mendoj se është me shumë rëndësi që tu lejohet viktimave të flasin lirshëm por megjithatë jo pa mbikëqyrje profesionale. Domethënë, aty duhet të jetë pyetësi i cili ka një shkathtësi të dëgjimit aktiv por edhe të orientimit të lehtë. (Natasha Lubomiroviq, Grupi 484, Beograd, Serbi, Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare, Beograd, Serbi, 17 dhjetor 2009.)

Diskutimi mbi KOMRA është proces më i gjerë shoqëror që ka ndodhur në Serbi dhe rajon. Vetë KOMRA ka potencial që viktimave t'ua kthejë identitetin.

KOMRA është shumë, shumë i qenësishëm që përfundimisht tua kthejë emrat dhe personalitetin e plotë atyre viktimave. Pra unë konsideroj, duke përcjellë tërë procesin e konsultimeve, forumit e tjetër, se ky është një proces më i gjerë i mundshëm që ka ndodhur në Serbi dhe në mbarë shoqërinë por edhe në rajon. (Goran Miletic, Civil Rights Defenders, zyra në Serbi, Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare, Beograd, Serbi, 17 dhjetor 2009.)

Nëse KOMRA angazhohet për reparacionin e të gjitha viktimave, këtu komisioni do të

sigurojë mbështetje të madhe në të gjitha shtetet në rajon.

Unë mendoj se reparacioni i viktimave duhet të parashikohet me këtë Komision për të vërtetën, për dy arsyeje. Së pari, konsideroj se parimi kryesor i drejtësisë detyron që ai i cili është i dëmtuar, sidomos në mënyrën e atillë monstruoze, duhet të kompensohet në mënyrë që ti krijohen disa mundësi për ta vazhduar jetën e vet, që fëmijët e viktimave të kenë ndonjë shans për arsimim apo për jetë më të mirë. (...) nëse nisëmi nga ajo se të gjitha viktimat duhet të kompensohen, ky mund të jetë motor i madh i tërë çështjes për çka në Serbi, bie fjala, theksi do të vihej në atë se qytetarët e Serbisë duhet të kompensohen, në Bosnjë e Hercegovinë qytetarët e saj, ashtu që viktimat të mos ndahen sipas përkatësisë kombëtare apo fetare. (Bojan Gavrilovic, Qendra e Beogradit për të Drejtat e Njeriut, Serbi, Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare, Beograd, Serbi, 17 dhjetor 2009.)

Organizatat joqeveritare duhet të jenë bartëse të fushatës 1.000.000 nënshkrime për KOMRA.

(...) organizatat joqeveritare që janë të përfshira në këtë çështje, duke filluar nga konsultimet, do të duhej që në fillim të këtij viti të inkuadrohen pak më shumë, domethënë të nisin punën, të themi nga shkurti, në grumbullimin e nënshkrimeve dhe kjo mund të përshpejtohet shumë dhe organizatat joqeveritare në çdo qytet mund të jenë bartës të mëdhenj të tërë këtij projekti. (Nenad Porobic, Qendra për Aksionin pa Dhunë, Beograd, Serbi, Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare, Beograd, Serbi, 17 dhjetor 2009.)

Shtrohet pyetja nëse është e mundshme në kohën e zgjedhjeve në BeH, të mbledhen nënshkrimet për KOMRA.

Ne kemi menduar që në fund të fundit ta dorëzojmë modelin (parlamenteve në rajon). Mirëpo, në Bosnjë e Hercegovinë fillon fushata zgjedhore në shtator, dhe në tetor janë zgjedhjet. Dhe shtrohet pyetja nëse do të jetë e mundshme të zbatohet fushata jonë një milion nënshkrime për KOMRA. (Natasha Kandiq, Fondi për të Drejtën Humanitare, Beograd, Serbi, Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare, Beograd, Serbi, 17 dhjetor 2009.)

(...) mendoj se është keq të ndërlidhet mbledhja e

nënshkrimeve me atë nëse do të ketë zgjedhje në atë periudhë apo jo, pasi që jemi në Ballkan ku vazhdimisht ka ndonjë zgjedhje. (Zoran Zhivković, Milenijum, Beograd, Serbi, Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare, Beograd, Serbi, 17 dhjetor 2009.)

Bërçko është vend i mirë për selinë e KOMRA-s.

Vetëm një sugjerim i shkurtër lidhur me qendrën KOMRA, veç si e quani komitetin rajonal. Mendoj se Bërçko imponohet vetvetiu pasi që nuk është askund, e është gjithkund. Domethënë, ndoshta gjithkund do të ekzistojë ndonjë përpjekje e trysisë politike të këtij apo atij pushteti. Falë rrethanave në atë qytet të bukur, i cili përndryshe gjeografikisht është pozicionuar bukur, mendoj se aty më pak është e mundshme që ndonjë garniturë politike të ushtrojë trysni. Si seli, po. Testoni entuziazmin e komisarëve potencial. (Zoran Zhivković, Milenijum, Beograd, Serbi, Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare, Beograd, Serbi, 17 dhjetor 2009.)

KOMRA nevojitet të merret me faktet për atë çfarë ka ndodhur, e jo me shkaqet historike.

Mendoj se faktet historike janë mjaft të njohura, se për to është folur bukur shumë dhe kjo nuk është temë për KOMRA. Kjo është temë për shkencën, për historinë, për sociologët, antropologët e kështu me radhë, dhe mendoj se KOMRA veç ka shumë punë rreth vërtetimit të fakteve për gjërat konkrete, se sa të merret me shkaqet historike (...) domethënë të shkojmë deri, siç tha dikush, në Kongresin e Berlinit, Lufta e I Botërore, Betejat e Kosovës e ku di unë, dyndja e sllavëve në këto territore. Thjeshtë, nuk ka dëshmitarë për këto. (Sandra Farkash, Shoqata e Grave "Peshçanik", Krushevc, Serbi, Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare, Beograd, Serbi, 17 dhjetor 2009.)

Mendoj se historia është qenësore ama konsideroj se kjo deri diku do ta komplikonte tërë procesin. Nuk duhet harruar se aty kihet të bëhet për gjashtë, tri, shtatë histori të ndryshme që duhet përmbledhur në një të vërtetë. Ashtu që nga aspekti i motivit të kriminelëve përse i kanë kryer krimet, përgjigja është sepse konsiderojnë se janë dëmtuar gjyshërit e tyre në të kaluarën, apo s'di çka. Ka kuptim të fute mi në këtë, por kam frikë se kjo, bie fjala, do ta hapte Kutinë e Pandorës dhe do ta largonte vëmendjen nga puna që duhet ta bëjmë. E për mua këto janë

ato rrëfimet e viktimave dhe, para se gjithash, reparacioni i viktimave. (Bojan Gavrilović, Qendra e Beogradit për të Drejtat e Njeriut, Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare, Beograd, Serbi, 17 dhjetor 2009.)

KOMRA lypset të merret edhe me shkaqet edhe me kontekstin historik.

Viktimat presin që këtu të jepen disa përgjigje, e që shkojnë pak më larg nga faktet, se personi A ka ardhur në katund me këtë e këtë emër dhe e ka vra personin B. Pra, këtu duhet të shkohet më larg. (Goran Miletić, Civil Rights Defenders, zyra në Serbi, Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare, Beograd, Serbi, 17 dhjetor 2009.)

Domethënë ne do të merremi vetëm me viktimat, dhe (...) do ta hartojmë ndonjë material nga kjo, kurse me shkaqet dhe me tërë kontekstin nuk do të merremi. Mendoj se kjo pak është pamundshme. (Virxhinija Marina Guzina, Parlamenti Qytetar Vršac, Serbi, Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare, Beograd, Serbi, 17 dhjetor 2009.)

Pra, nuk është kjo marrje me historinë për hir të marrjes me te, për hir të ndonjë stërvitje intelektuale apo diç ashtu, por marrja me atë pjesë të historisë apo me atë aspekt të saj që është relevant për ne këtu, që të mos ndodhë përsëritja. Kjo është ideja edhe për marrjen me histori nga ana e Komisionit për të vërtetën. (Bogdan Ivanishević, Qendra Ndërkombëtare për Drejtësinë në Tranzicion, Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare, Beograd, Serbi, 17 dhjetor 2009.)

KOMRA duhet të merret me përgjegjësinë e mediave.

Shkaqet politike veç janë diçka tjetër edhe kur është fjala për ato mendoj se aty nuk mund të evitohet çështja e shqyrtimit të përgjegjësisë së mediave, sepse dihet se sa, në fillim të viteve të 90-ta dhe gjatë tërë kohës së luftës, mediat i kanë mobilizuar masat e gjera në luftë, krime e kështu me radhë. Konkretisht mendoj se është shumë qenësore të shqyrtohet roli i RTS në Serbi. (Sandra Farkash, Shoqata e Grave "Peshçanik", Krushevc, Serbi, Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare, Beograd, Serbi, 17 dhjetor 2009.)

Sa më shumë të bisedohet me njerëz në bashkësitë lokale që të njihen me iniciativën

Mendoj se është shumë me rëndësi që në shkallë lokale, respektivisht në mjedise të ndryshme në rajon, të flitet, të bisedohet. Kujtoj se njëri nga shkaqet e konflikteve të armatosura është që njerëzit nuk kanë pasur mundësitë të flasim për diçka që i ka munduar qysh moti, nga e kaluara e kështu me radhë. (Natasha Lubomiroviq, Grupi 484, Beograd, Serbi, Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare, Beograd, Serbi, 17 dhjetor 2009.)

Legjitimiteti i Iniciativës është në karakterin rajonal, një milion nënshkrime, dhe në atë që Iniciativa është nga poshtë - e jona për ne.

(...) legjitimitet tërë iniciativës i jep ky dimension i rajonal, karakteri rajonal i iniciativës, debati rajonal dhe një milion nënshkrime njëkohësisht i japin edhe legjitimitete dhe besueshmëri. (Natasha Kandi, Fondi për të Drejtën Humanitare, Beograd, Serbi, Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare, Beograd, Serbi, 17 dhjetor 2009.)

Segmenti i tretë i cili KOMRA i jep legjitimitet është se kjo është iniciativë nga poshtë - e jona për ne, dhe mua më duket se ai është fokusi që e dallon dhe që është argument serioz që ajo të mund të jetë, të them, e suksesshme. (Natasha Govedarica, Iniciativat Qytetare, Beograd, Serbi, Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare, Beograd, Serbi, 17 dhjetor 2009.)

Serviset publike duhet të kenë vend qendror në shtrirjen e iniciativës KOMRA

(...) ekzistojnë serviset publike të cilët e kanë obligim, të cilët ne si qytetarë, secili në vendin e vet në rajon i paguajmë, dhe (...) drejtorja e parë e iniciativës mediale për shtrirjen e kësaj ideje dhe grumbullimin e mbështetjes, në atë mënyrë duhet të orientohet kah serviset publike. (Natasha Govedarica, Iniciativat Qytetare, Beograd, Serbi, Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare, Beograd, Serbi, 17 dhjetor 2009.)

Përpos televizioneve publike, mediat lokale janë të rëndësishme për formimin e opinionit publik.

(..) më duket se nuk ekziston mbështetja e duhur mediale për tërë këtë çështje. Mediat janë vendimtare për ndikim edhe në politikanët edhe në formimin e opinionit publik në një shtet. Kujtoj se vërtetë është e domosdoshme jo vetëm në mediat qendrore, por para se gjithash në mediat lokale, të flitet sa më

shumë për këtë e madje ndoshta të tregohen edhe rrëfimet e viktimave nga të gjitha bashkësitë që kanë pësuar në luftërat e shkuara. Madje ndoshta edhe në terminet e paguara. (Lilana Stojanović, Qendra për Zhvillimin e Demokracisë dhe Jugut të Serbisë, Vranje Serbi, Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare, Beograd, Serbi, 17 dhjetor 2009.)

Konsultimet kombëtare me intelektualët mbi formimin e KOMRA

**Podgoricë, Mali i Zi
17 dhjetor 2009.**

Konsultimet kombëtare me intelektualët dhe intelektualët mbi Iniciativën për formimin e KOMRA janë mbajtur në organizimin e Qendrës për Arsimim Qytetar (CGO) në Podgoricë. Në tubim, të cilin e ka moderuar Daliborka Uljareviq, drejtoreshë ekzekutive e CGO, kanë qenë 44 pjesëmarrës, kurse kryefjalën e kanë mbajtur Vesna Tersheci (Documenta, Kroaci) dhe Dragan Popović (Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi).

Në tubim kanë marrë pjesë intelektualët dhe intelektualët e njohura – profesorë të universitetit, shkrimtarë, sociologë, analistë, persona ushtarakë dhe diplomatë në pension, gjykatës, veprimtarë për të drejtat e njeriut, gazetarë dhe politikanë. Mbi tubimin kanë raportuar gazetatat Vijesti dhe Dan, Radio Antena M, NTV Montena, Mina, Radio Mali i Zi, TV Pink M dhe TV IN.

Mendimet, propozimet dhe Rekomandimet e pjesëmarrësve

KOMRA është përgjigje ndaj kufizimeve të mekanizmave ekzistues në procesin e ballafaqimit me të kaluarën.

Mekanizmat ekzistues në shtetet e rajonit dhe në shkallë ndërkombëtare që janë shumë të vlefshëm e të çmueshëm, evident nuk janë të mjaftueshëm që disa gjëra të çohen deri në fund, dhe pikërisht këtu arrijmë tek rëndësia e KOMRA. (Daliborka Uljareviq, Qendra për Arsimim Qytetar, Podgoricë, Mali i Zi, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Podgoricë, Mali i Zi, 17 dhjetor 2009.)

Viktimat janë lënë anash në të gjitha shtetet e ish RSFJ. KOMRA mund të krijojë hapësirë

për të gjitha viktimat dhe të pengojë që faktet të prezantohen në mënyrë përzgjedhëse.

Më duhet të them se viktimat sot, pavarësisht se cilit grup etnik i takojnë, janë lënë anash edhe në Kroaci e jo vetëm në vendet tjera. Mendoj se atëherë është esenciale të krijohet hapësira dhe të flitet më shumë për viktimat, por jo vetë mbi ato për të cilët faktet megjithatë janë më të pranishme në opinion, veç për të gjitha viktimat. Nga dëshira që të ofrojmë ndonjë model, ndonjë propozim që në opinion të mos prezantohen më faktet në mënyrë përzgjedhëse, veç kur flitet për krimet e luftës dhe për viktimat, të jetë e mundshme të flitet për fatin e të gjitha viktimave. (Vesna Tersheliq, Documenta, Kroaci, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Podgoricë, Mali i Zi, 17 dhjetor 2009.)

Është me rëndësi që KOMRA ta formojnë shtetet, ngase vetëm shtetet kanë fuqi ta pengojnë mohimin e krimit dhe ti ndryshojnë programet shkollore.

Është shumë me rëndësi që llojet e tilla të trupave të jenë zyrtar që konstatimet e tyre të jenë më të besueshme. Shteti ka fuqinë për të detyruar dhe penguar mohimin se ka ndodhur krimi, domethënë të pengojë çdo mohim të krimit. Madje, të nxjerrë ndonjë ligj të caktuar sikurse ka qenë kjo në Gjermani – Ligji mbi ndalimin e mohimit të holokaustit. Gjithashtu vetëm shteti ka mundësi ti ndryshojë programet shkollore, ti ndryshojë librat e historisë, etj. (...) komisionet e mirëfillta duhet të jenë të pavarura. (Dragan Popović, Fondi për të Drejtën Humanitare, Beograd, Serbi, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Podgoricë, Mali i Zi, 17 dhjetor 2009.)

Ekziston dyshimi se qeveritë e tashme do ta respektojnë mëvetësinë dhe pavarësinë e KOMRA nga secili pushtet.

(...) a është e mundshme të arrihet që qeveritë dhe parlamentet e tashme të jenë themelues dhe finances të KOMRA, që të mos përzihen në punët e tij dhe ta respektojnë mëvetësinë dhe pavarësinë e tij të plotë nga cilido pushtet? (Milika Pavloviq, letrar nga Tivari, Mali i Zi, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Podgoricë, Mali i Zi, 17 dhjetor 2009.)

Ekziston dilema a më parë të formohen komisionet kombëtare që do të lidheshin në KOMRA, apo direkt të formohet KOMRA.

(...) eventualisht të formohen më përpara komisionet kombëtare të cilat pastaj do të lidheshin në KOMRA, apo që menjëherë të shkojmë direkt në formimin e KOMRA? (Branimir Jukić, ambasador i BeH në Mal të Zi, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Podgoricë, Mali i Zi, 17 dhjetor 2009.)

Secili shtet duhet ti regjistrojë të vrarët, të zhdukurit, kampet, burgjet dhe veprat tjera të këqija, dhe pastaj në nivel rajoni.

Me që padyshim ka shumë të vrarë, shumë të zhdukur, njerëz që kanë kaluar burgjet, kampet e kështu me radhë, ai propozim është si bazë filluese, të komisionit kombëtar, sikurse tha ai njeri. Që të merremi mirë me këtë problem në oborrin tonë. (...) Kur gjithë këtë e mblidhni dhe kur e grumbullo-ni, ky është rezultat i viteve të 90-ta. Atëherë mund të kërkon nga shteti juaj, pushteti juaj, që rreth kësaj të ndërmarrë diçka për zgjidhjen e problemeve të këtyre njerëzve. Dhe pastaj me këtë problem të lidhemi në nivel rajoni. (Goran Rodiq, avokat nga Podgorica, Mali i Zi, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Podgoricë, Mali i Zi, 17 dhjetor 2009.)

Faktet e vërtetuara në nivel kombëtar vështirë do të përqafoheshin në mbarë rajonin.

Sa i përket vërtetimit të fakteve, nëse ato vërtetohen vetëm në nivel kombëtar kujtoj se është shumë vështirë se do të përqafohen në mbarë rajonin, e kjo është një pjesë shumë qenësore. Është esenciale që për luftërat të flitet dhe që faktet të vërtetohen sipas mënyrës e cila do të jetë autentike në vendet e ndryshme. Pastaj, kjo mund të jetë themel edhe për ndërtimin e besimit e ndoshta edhe ndonjë kontribut për pajtimin. (Vesna Tersheliq, Documenta, Kroaci, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Podgoricë, Mali i Zi, 17 dhjetor 2009.)

Komisionet rajonale nuk mund të kenë qasje në arkivat e shteteve tjera në rajon.

Çështja qëndron në faktin që këto iniciativa kombëtare vërtetë kanë dështuar për shkak se, siç tha Vesna, nuk e kanë pasur mbështetjen në vendet tjera. Gjithashtu komisionet kombëtare vështirë se do të mund të japin përgjigje dhe vështirë do të mund të kenë qasje në arkivat dhe dokumentacionin e ndonjë shteti tjetër. Trupat kombëtar vështirë mund ti inkurajojnë viktimat nga bashkësitë tjera, që jetojnë në ndonjë shtet tjetër, që ata tash të kenë

besim në ndonjë trup kombëtar të shtetit, institucionet e të cilit e kanë vvarë familjen e tij. (Dragan Popoviq, Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Podgoricë, Mali i Zi, 17 dhjetor 2009.)

Pjesëtarët e pakicave kombëtare do ta mbështesin komisionin rajonal e jo atë kombëtar

Dhe në fund, a Komisioni nacional apo rajonal? Përgjigja ime është Komisioni Rajonal, sepse secili komision kombëtar do të ishte anemik, do të ishte i dekurajuar e jo i fuqizuar nga pjesëtarët e nacionaliteve dhe kombeve tjera. (Azra Jasoviq, avokate nga Podgorica, Mali i Zi, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Podgoricë, Mali i Zi, 17 dhjetor 2009.)

Faktet relativisht janë të njohura, por problemi qëndron në ballafaqimin e elitave politike, mediale e religjioze me ato fakte – në qëndrimin e tyre ndaj krimeve të veta dhe viktimave tjera.

(...) këtu madje janë relativisht mirë të njohura faktet, në hapësirën e ish Jugosllavisë, qoftë me anë të aktgjyqimeve të Hagës, qoftë me anë të aktgjyqimeve të disa gjykatave kombëtare. Për mua puna shumë më e madhe është ballafaqimi me vetë ato fakte, respektivisht ballafaqimi i elitave politike, mediale e religjioze. A i pranojnë ata fare ato fakte, çfarë është qëndrimi i tyre ndaj krimeve të veta, gjegjësisht ndaj viktimave të huaja? Pa qëllim të theksimit të kujtdo qoftë, domethënë po flas për rajonin në përgjithësi, për të gjitha vendet, a janë ndryshuar ato matrica të politikës, respektivisht mentaliteti i vetë asaj politike në ballafaqim me krimet, ndaj krimeve të veta dhe në raport me viktimat e huaja? (Branimir Jukiq, ambasador i BeH në Mal të Zi, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Podgoricë, Mali i Zi, 17 dhjetor 2009.)

KOMRA mund të llogaris në mbështetjen e Komisionit të KNKK për vërtetimin e fakteve mbi shkeljen e të drejtave të njeriut.

Edhe një ide. Ekziston në shkallë të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKK) Fact-Finding Commission (Komisioni për vërtetimin e fakteve), i cili pikërisht merret me vërtetimin e fakteve mbi shkeljen e të drejtës humanitare ndërkombëtare. Ai është komision i ekspertëve, nga ky rajon anëtar i atij komisioni është vetëm profesori Starcheviq. Shpresoj se ky fakt edhe ka rëndësi se do të

mundemi me anë të këtij njeriu, i cili është luftëtar i denjë për të drejtën humanitare, i cili është edhe ish ushtar që ka punuar në ushtri e që e ka braktisur ushtrinë atë çast kur kanë filluar të bëhen shkeljet dhe i është bashkuar Kryqit të Kuq dhe asaj lëvizje, shpresoj se do të mund ta kemi mbështetjen të atij komisioni të rëndësishëm, do të thosha unik në shkallë të organizatës ndërkombëtare. Ashtu që ai bashkëpunim do të ishte i shkëlqyeshëm për KOMRA. (Ivana Jeliq, Fakulteti Juridik, Podgoricë, Mali i Zi, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Podgoricë, Mali i Zi, 17 dhjetor 2009.)

KOMRA do të ketë probleme në vërtetimin e shkaqeve, sepse të gjitha shtetet do të vihen në mbrojtje të shtetit të vet.

Për këtë shkak unë sugjeroj KOMRA që gjatë vendosjes për mandatin a do të merret me shkaqet e luftës apo do të futemi në problem, sepse të gjithë do të vihen në mbrojtje – jo populli im apo shteti im. (...) Ju lutëm sugjeroni të gjithë këtë opsion, të flasim të gjithë – po bashkëkombësi im, përfaqësuesi im i pushtetit dhe i shtetit. Ju sugjeroj që në mandat të jenë shkaqet e luftës, pasi që shkencëtarët edhe kohë të gjatë nuk do të marrin qëndrim të përbashkët cili është shkaku i luftës. Por jam i sigurt se luftë ka pasur dhe se lufta kurrë nuk ndodhur spontanisht, por planifikohet. Po flasim për planifikuesit e luftës. Kush janë planifikuesit, do të shohim kush ka udhëhequr politikën, kush ka qenë pushtet dhe do të arrijmë tek planifikuesit. (Blagoje Grahovac, gjeneral në pension, Podgoricë, Mali i Zi, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Podgoricë, Mali i Zi, 17 dhjetor 2009.)

KOMRA duhet të merret me shkaqet dhe planifikuesit e luftës.

Përgjigja ime është se është nevojshme që (KOMRA) të merret edhe me shkaqet e luftës edhe me planifikuesit e luftës. (Azra Jasoviq, avokate nga Podgorica, Mali i Zi, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Podgoricë, Mali i Zi, 17 dhjetor 2009.)

Të gjithë ne si filloristë, si nxënës të shkollës së mesme, në librat e historisë e kemi pasur atë fjalë të njohur – shkaqet dhe motivet e luftërave të mëdha. Të gjithë e kemi ditur se motivi është diç sipërfaqësore, kurse shkaku fshihet shumë thellë. Prandaj, pajtohem absolutisht edhe me gjeneralin Grahovac dhe me njerëzit të cilët në diskutime e mbështetën atë ide se duhet fokusuar në planifikuesit e luftës. (Sllaven Lekiq, analistist nga Podgorica,

Mali i Zi, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Podgoricë, Mali i Zi, 17 dhjetor 2009.)

Më parë duhet të vërtetohen faktet kurse konteksti në hapin tjetër.

(...) a duhet ta ketë ky komision mandatin që ta vërtetojë kontekstin? Unë do të doja të mund ta ketë, por mendoj se nuk duhet ta ketë. Mirëpo konteksti nënkuptohet. Mund të ndodhë që konteksti të sigurohet në ndonjë hap tjetër. Më parë duhet ti kemi faktet. Domethënë më parë duhet të përgjigjemi në pesë pyetje, tash serish po sillem si instruktor i gazetarisë. Më parë duhet ti vërtetojmë faktet e pastaj do ta konfirmonim atë që është e vërtetë, kurse më vonë duhet ta sigurojmë kontekstin. Po kush do ta vërtetojë atë kontekst, historianët e ndershmë, inteligjencia e ndershme, etj? Por ai kontekst duhet të vërtetohet për ata, prapë për gjeneratat e ardhshme. Ato duhet patjetër ta dinë çfarë ka ndodhur. (Dragoljub Vuković, gazetar nga Podgorica, Mali i Zi, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Podgoricë, Mali i Zi, 17 dhjetor 2009.)

KOMRA duhet të merret me kontekstin, sepse në bazë të njohjes së tij mund të nxirren Rekomandime për të ardhmen.

Pra, unë do të nisem nga pyetja nëse KOMRA lypset të merret me kontekstin në të cilin janë kryer krimet? Menjëherë do të përcaktohem se për mua kjo është shumë e dëshirueshme. Jo vetëm që duhet të merremi me kontekstin si diçka që e ka favorizuar mbylljen e popullatës shumë të gjerë, e cila e ka përqafuar krimin si mjet të zgjidhjes së problemit të ndryshimeve në shtetin e atëhershëm të përbashkët e deri në shkatërrimin e tij, por edhe me kontekstin i cili është i dëshirueshëm që sa më mirë ta njohim, që në bazë të kësaj të nxjerrim konkluzione dhe Rekomandime për të ardhmen e cila, nëse do të kemi sa duhet fat i cili, në masë të madhe a të vogël, serish do të jetë i përbashkët. (Radomir Llaković, Fakulteti Natyror Matematikor, Podgoricë, Mali i Zi, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Podgoricë, Mali i Zi, 17 dhjetor 2009.)

Koalicioni për KOMRA duhet ta përfitojë opinionin, sepse marrësit e vendimeve do të shpijnë në atë çka mendon opinioni.

(...) iniciativa që e përfaqëson KOMRA, kërkon një mbështetje të fuqishme të publikut, sepse për këtë do të duhet të marrin vendime disa vendimmarrës tanë, në radhë të parë këta janë politikanët. Ata,

para se gjithash, do ta drejtojnë opinionin publik për atë çka mendon opinioni dhe më duket se në këtë kontekst KOMRA duhet të punojë shumë me publikun, dhe duhet të bindet publiku me atë se çka janë qëllimet e një iniciative të këtillë. (Aleksandar Zeković, hulumtues i të drejtave të njeriut, Mali i Zi, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Podgoricë, Mali i Zi, 17 dhjetor 2009.)

Duhet shfrytëzuar përcaktimin mbisundues të qytetarëve dhe të elitave politike për integritet evropianë që në kuadër të kësaj të formohet KOMRA.

Për mua shtrohet dilema çka nëse pushteti ynë, i cili edhe këtë që e ka bërë e ka bërë nën trysni dhe jo sa duhet, në fund të fundit të mos jetë për këtë Komision. Mendoj se përkundër kësaj ai duhet të formohet, madje jam për atë që edhe sektori joqeveritar edhe mediat, pra e gjithë shoqëria në planin kombëtar e planin rajonal, të angazhohet që të ushtrohet trysni ashtë që pushtetet të detyrohen ta pranojnë këtë. Mirëpo, edhe nëse nuk e pranojnë mendoj se me rëndësi është të formohet. (...) Domethënë, të shfrytëzohet ajo që sot është përcaktim mbisundues i qytetarëve dhe elitave politike, e ky është procesi integruar që ne përfundimisht të ballafaqohemi me të vërtetën si parakusht për përgjegjësi dhe për pajtim në këto hapësira. (Branko Llukovac, Iniciativa e Igmanit, Podgoricë, Mali i Zi, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Podgoricë, Mali i Zi, 17 dhjetor 2009.)

Qëllimi i KOMRA duhet të jetë demistifikimi i heronjve kombëtar.

Njëri nga qëllimet e KOMRA, sipas mendimit tim, do të duhej të ishte heqja e oreolit të heroit kriminelëve në shkallë kombëtare, që janë me famë dhe të lavdëruar në mjediset e veta. (Azra Jasović, avokate nga Podgorica, Mali i Zi, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Podgoricë, Mali i Zi, 17 dhjetor 2009.)

Për momentin Serbia nuk po merr pjesë në asnjë iniciativë zyrtare ku ka përfaqësues të Kosovës. Si të zgjidhet ky problem në raport me nevojën që edhe Serbia edhe Kosova të marrin pjesë në formimin dhe punën e KOMRA

(...) ajo që tash është fakte se Serbia nuk dëshiron të marrë pjesë në çfarëdo iniciative zyrtare ku gjenden përfaqësuesit shtetëror të Kosovës së njohur

ndërkombëtare. Dhe a do të mundët që një qasje e tillë e Serbisë të reflektohet edhe në rastin e Bosnjës e Hercegovinës, e që edhe Bosnja e Hercegovina ndoshta do të bllokohet në marrjen e një vendim i të tillë për tu anëtarësuar në këtë trup. Kjo është diçka për të cilën gjithsesi duhet menduar. (Aleksandar Zeković, hulumtues i të drejtave të njeriut, Mali i Zi, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Podgoricë, Mali i Zi, 17 dhjetor 2009.)

Grumbullimi i fakteve është me rëndësi, sepse pushteti po i asgjëson dëshmitë mbi përgjegjësinë e vet.

Mendoj se roli jashtëzakonisht i dobishëm i KOMRA mund të jetë pikërisht në pjesën e grumbullimit të fakteve, sepse jemi të vetëdijshëm se po asgjësohen dëshmitë; po digjen arkivat, prandaj hajde ta mbledhim atë që mundemi. (Sllaven Lekić, analistist nga Podgorica, Mali i Zi, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Podgoricë, Mali i Zi, 17 dhjetor 2009.)

Viktima janë edhe qytetarët që i kanë manipuluar pushtetet e tyre dhe mediat.

KOMRA ndoshta do të duhej ta shtrijë nocionin e viktimës në kategorinë e njerëzve të manipuluar nga pushtetet dhe mediat e veta...Mendoj se kjo në veçanti është e rëndësishme në shtetet si është ia malazez ku po e ëndërrojmë ndryshimin e esencës së pushtetit. (Budisllav Minić, avokat nga Kolashini, Mali i Zi, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Podgoricë, Mali i Zi, 17 dhjetor 2009.)

Spektori joqeveritar, veçmas në Mal të Zi, nuk guxon të lejojë që të zhvlehtësohet zgjedhja e anëtarëve të Komisionit, sikurse bëhet kjo me rastin e zgjedhjes së funksionarëve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut,

Duhet të kemi mënyrë transparente të zgjedhjes së anëtarëve të Komisionit, nuk guxojmë të lejojmë ne nga sektori joqeveritar, veçmas në Mal të Zi, që të zhvlehtësohet zgjedhja e anëtarëve të Komisionit, sikurse bëhet me rastin e zgjedhjes së funksionarëve të rëndësishëm të cilët merren me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut nga aspekti i integritetit të vet, kapacitetit profesional dhe të interesimit për realizimin, para se gjithash, të punës së vet. (Azra Jasović, avokate nga Podgorica, Mali i Zi, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Podgoricë, Mali i Zi, 17 dhjetor 2009.)

Mbështetja viktimave është parakusht për formimin e KOMRA.

Vetëm ta tërheq vërejtjen, me rastin formimit të trupit (Komisionit) gjatë formimit të tij, duhet siguruar mekanizëm që një ditë të mos e keni në njërin anë trupin e tillë e në anën tjetër familjen e viktimave. Të evitohet shembujt e tillë që ekzistojnë në botë. Supozoj se ekziston ndonjë mekanizëm, por vetëm po dua të tërheq vëmendjen për këtë. (Gordan Stojović, publicist, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Podgoricë, Mali i Zi, 17 dhjetor 2009.)

Ndoshta është tepër herët që pushtetet ta formojnë Komisionin i cili do ta bëjë punën e vet.

(...) ne jemi dëshmitarë se për gjëra shumë më pa djallëzore pushteti nuk dëshiron ta kyç në cilindo trup askënd i cili ka integritetin dhe qëndrimin e ve. (...) E lërë më ti procedojmë krimet e luftës, dhe që pushteti në atë komisioni ta instalojë ndonjë levë, ndonjë intelektual apo njeri të mendimit të lirë, të guximshëm dhe përgjegjës të cilët e dinë këtë... ndoshta ende është shumë herët që pushtetet ti formojnë këto komisione, e formalisht mund të kemi Komisionin i cili nuk do ta kryej punën e vet. (Stanko Marić, Senati i Shoqatës së Juristëve të Malit të Zi, Konsultimet kombëtare me intelektualët, Podgoricë, Mali i Zi, 17 dhjetor 2009.)

Konsultimet nacionale me organizatat joqeveritare mbi Iniciativën KOMRA

**Prishtinë, Kosovë
19 dhjetor 2009.**

Konsultimet me organizatat joqeveritare i ka organizuar Fondi për të Drejtën Humanitare, Kosovë. Kanë marrë pjesë 40 veprimtarë dhe ekspertë të organizatave joqeveritare. Nuk kanë marrë pjesë përfaqësues të organizatave joqeveritare serbe.

Komisioni Rajonal do të sigurojë faktet mbi të kaluarën në bazë të ngjarjeve të cilat kanë ndodhur, që është në dobi të mbarë rajonit.

(...) ne përkrahim qasjen rajonale, për arsye se mendojmë që qasja rajonale do të kishte efekt ku pjesëmarrësit do ta mandatonin Komisionin i cili do ta interpretonte historinë në mënyrë burimore

duke u bazuar në ngjarjet që kanë ndodhur dhe nuk do të lënte anime sipas interesit të shoqërisë së caktuar, por do të ishte në dobi të gjithëve në rajon. (Ylber Mahxuni, Youth Step, Vushtrri/Vučitrn Kosovë, Kosultimet nacionale me organizatat joqeveriater, Prishtinë/ Priština, Kosovë, 19 dhjetor 2009.)

KOMRA ofron shërimin e plagëve dhe mbylljen e dhimbjes, e ky është hap i domosdoshëm drejtë pajtimit.

(...) po flitet si në heshtje roli i iniciativës se a do të duhej të jetë i ndërlidhur me pajtimin apo jo, e kjo varet thjeshtë nga perceptimi se si dhe në çfarë mënyre. Kjo shihet dhe më duket se disi është krijuar një averzion, të them, i panevojshëm ndaj kësaj që në fund të fundit është pozitive për të gjithë. Një aktivitet i kësaj iniciative mund të ofrojë atë që ne e quajmë në gjuhën terapeutike përmbyllje të plagës apo përmbyllje të dhembjes dhe kjo e ka një efekt terapeutik dhe ndoshta mund të them se mund të jetë një hap i domosdoshëm drejt një rruge e cila si e tillë ndoshta do të jetë e gjatë dhe e ndërlikuar që do të çojë herë do kurdo drejt pajtimit. (Lulzim Arapi, Shoqata për ndihmë psiko sociale për fëmijët dhe familjen, Gjakovë/Đakovica, Kosovë, Kosultimet nacionale me organizatat joqeveriater, Prishtinë/ Priština, Kosovë, 19 dhjetor 2009.)

KOMRA ka potencial të madh të afrimit, pajtimit dhe shtrirjes së fushës së interesit të përbashkët.

Nuk është lehtë për palët në konflikt të gjejnë terrenin e interesit të përbashkët, dhe them sado që viktimat edhe interesi për t'u ndriçuar krimi dhe kryesit e ndryshëm të cilët atyre viktimave ua kanë shkelur të drejtën njerëzore, dhe ja ai interes i përbashkët ka potencial të madh të afrimit të njerëzve. Ai madje ka edhe njëfarë vlere diplomatike, sepse është i karakterit përtej kufitar dhe unë besoj se ai pavarësisht që niset nga një fakt i cili është ashtu edhe pikëlluese dhe i ngjanë në ndonjë problem juridik, ai në realitet ka potencial t'i afrojë njerëzit dhe ta shtrijë atë terrenin e interesit të përbashkët. Ajo që përfundimisht është epilog i kësaj është pakësimi i tensioneve. (Lazar Stojanović, rezhisor nga Beogradi, Srebi, Kosultimet nacionale me organizatat joqeveriater, Prishtinë/ Priština, Kosovë, 19 dhjetor 2009.)

Qëllimi kryesor duhet të jetë pajtimi i cili është i mundshëm vetëm me anë të ballafaqimit me të kaluarën.

(...) të kihet parasysh që kusht për procesin e zhvillimit të pajtimit duhet të jetë proces i zhvillimit të ballafaqimit me të vërtetën, që është tepër e nevojshme për të mundur të arrihet qëllimi kryesor, e ai qëllim kryesor është procesi i pajtimit dhe se e nesërmja e kërkon. (Nafije Kuqi, Sindikata e pavarur e penzionerëve dhe invalidëve të Kosovës, Prishtinë /Priština, Kosovë, 19 dhjetor 2009.)

KOMRA u jep rastin kryesve të krimeve të luftës që publikisht ti paraqesin veprat e këqija në të cilat kanë marrë pjesë, që të pendohen ose ta pakësojnë përgjegjësinë e vet.

Edhe një gjë që po më bije ndërmend lidhur me atë cilat do të ishin pasojat, pasoja pozitive shoqërore e veprimit të KOMRA-s është që, këtë e treguan edhe këto komisione për pajtim në pjesë të ndryshme të botës, kjo u ofron rastin njerëzve të cilët kanë bërë ndonjë të keqe, qoftë me atë që do ta kumtojnë ose me atë që do të bashkëpunojnë në çfarëdo mënyre me atë komision, ose të paktën me atë që do të marrin pjesë në tubimet dhe bisedimet e këtij lloji, të fitojnë rastin edhe përpara shoqërisë edhe përpara vetvetes të çlirohen, ta pastrojnë apo të paktën ta zvogëlojnë përgjegjësinë e vet. (Lazar Stojanović, rezhisor nga Beogradi, Srebi, Kosultimet nacionale me organizatat joqeveriater, Prishtinë/ Priština, Kosovë, 19 dhjetor 2009.)

KOMRA mund të ndikojë në krijimin e memories ndaj të kaluarës dhe viktimës. Ky është borxh shoqëror ndaj viktimave dhe familjeve të tyre.

(...) iniciativa mund të ndikojë që të kujtohet ajo se çka ka ndodhur dhe unë mendoj që ndoshta kjo është e vetmja gjë, që ne si qenie njerëzore u kemi borxh atyre të cilët në një kohë të caktuar ishin viktima. U kemi borxh pra atyre të cilët nuk janë tani me ne, por u kemi borxh edhe vetvetes, por edhe gjeneratave të cilat do të vijnë pas nesh. Prandaj, ndoshta është diçka që në fund të fundit është shumë humane edhe për ne edhe për të tjerët, e veçanërisht një borxh ndaj atyre të cilët nuk janë më me ne. Ndoshta kjo është edhe përkrahja e vetme të cilën familjarët e shumë të personave të zhdukur e presin. (Lulzim Arapi, Shoqata për ndihmë psiko sociale për fëmijët dhe familjen, Gjakovë/Đakovica, Kosovë, Kosultimet nacionale me organizatat joqeveriater, Prishtinë/ Priština, Kosovë, 19 dhjetor 2009.)

KOMRA duhet të merret edhe me pensionistët

në Kosovë të cilëve Serbia ka pushuar tua paguaj pensionet më 1999.

(...) ne në Kosovë kemi edhe viktimat të reja, viktimat të cilat pas luftës. Sikur se dihet, është një grupacion, janë 80.000 njerëz pensionistë dhe invalidë, të cilët nuk i marrin pensionet e veta, nuk e marrin kontributin të cilin ata e kanë dhënë gjatë moshës kur kanë mund të punojnë, kur kanë mund të kontribuojnë për ndërtimin e kuadrove, për ndërtimin fizik dhe psikik të gjitha gjeneratave. Andaj, 80.000 njerëz kanë mbet pa përkrahje materiale dhe sot është pikëpyetje të mbesin edhe në aspektin e ekzistencës fizike e mos të flasim për aspektin psikik dhe sa janë deformimet, sa janë degradimet, d nënçmimet... (Nafije Kuqi, Sindikata e pavarur e penzionerëve dhe invalidëve të Kosovës, Prishtinë /Priština, Kosovë, 19 dhjetor 2009.)

Ka mendime se nuk është zgjidhje e mirë që shtetet ta financojnë punën e Komisionit.

(...) kur krijohet krejt ky proces kërkohet miratimi i parlamentit dhe zgjedhja buxhetore të kërkohet nga parlamenti. Atëherë me siguri se do të ketë varrshmëri direkte prej qeverisë dhe si rezultat i kësaj – kjo vetëm po ndërthuret, po thuhet për dikë që është i keq, në fund kërkohet ndihma e tij dhe askush nëse i është thënë se është i keq nuk do ta mbështet në aspektin financiar dhe më vonë do të jetë problematike zgjidhja e krejt këtij problemi. (Atdhe Berisha, Kalaja, Pejë/Peć, Kosovë, Kosultimet nacionale me organizatat joqeveriater, Prishtinë/ Priština, Kosovë, 19 dhjetor 2009.),

Viktimat do të flasin më lirshëm nëse identiteti i tyre është i mbrojtur.

(...) unë mendoj se është shumë e qëlluar që të ruhet identiteti i saj [viktims]. Pra, në këtë aspekt, identiteti i viktims, kur është i mbrojtur, do të thotë nuk është publik për opinionin ai shprehet më lirshëm. (Bashkim Asllani, Exploring Intelligence, Vushtrri/Vučitrn, Kosovë, Kosultimet nacionale me organizatat joqeveriater, Prishtinë/ Priština, Kosovë, 19 dhjetor 2009.)

Është kyçe që në debat të inkuadrohen arsimtarët dhe institucionet arsimore, qoftë formalisht apo jo formalisht.

Pra, duke u ballafaquar me këtë, si do të ndryshojmë gjendjen, si do të ndryshohen qasjet, mendoj se edhe sektori i arsimit, prapëseprapë, qoftë

formal, qoftë edhe jo formal, është me rëndësi të kyçet këtu sepse është çelës për këtë. (Karmit Zysman, Kosovë, Kosultimet nacionale me organizatat joqeveriater, Prishtinë/ Priština, Kosovë, 19 dhjetor 2009.)

Viktimave të cilat dëshmojnë duhet patjetër tu sigurohet mbështetja profesionale psikologjike. Institucionet kanë detyrim të sigurojnë mjete për procesin e rehabilitimit të viktimave pas dhënies së deklaratës.

(...) marrja në intervistë e një personi mund të paraqet konsekuenca të mëtutjeshme të cilat mund të paraqesin edhe komplikime të mëtejshme psikologjike. Me rëndësi është se ata persona përveç se do tu merren informata, aty do të ekzistonte edhe një trajtim ndaj tyre dhe jo vetëm nxjerrja e informatave, por edhe trajtim nëse ata persona do të kenë ndonjë reagim si rezultat i këtyre intervistave që do të bëhet me ta.. (...)trajtimi i personave me çrregullim – të traumatizuar, me stresin posttraumatik është një periudhë më afatgjatë. Dhe a do të ketë do të thotë një seancë tutje, mirëpo dihet se kërkohet një numër më i madh i seancave. Unë këtu flas për konsekuencat financiare që mund të jenë, për shembull se një person mund të ketë pas asaj një vit trajtim, dhe është mirë ndoshta të fliet edhe me institucione në Kosovë këtu sikur që është Ministria e Mirëqenies Sociale, Ministria për Shëndetësi dhe të gjendet një mënyrë që pas këtyre intervistave ata ta ndihmojnë procesin e rehabilitimit të këtyre personave. (Imri Zabeli, psikolog nga Glogoci, Kosovë, Kosultimet nacionale me organizatat joqeveriater, Prishtinë/ Priština, Kosovë, 19 dhjetor 2009.)

Ekziston nevoja që të themelohet Qendra rajonale për mbështetje viktimave. Kjo mund të jetë një nga Rekomandimet e KOMRA-s.

Pra, ne duhet të parashikojmë dhënien jo vetëm të mbështetjes psiko-sociale gjatë kohës së mbledhjes së të dhënave, marrjes së deklaratave, por në realitet mbështetje të veçantë psikike atyre viktimave që do të dëshmojnë publikisht, e pastaj të bëjmë ndonjë program. Pra këto Rekomandime duhet të jenë serioze dhe të fuqishme, e pastaj Koalicioni duhet të jetë në pozicion të përcjellë nëse po realizohen Rekomandimet. Unë njëmend po e shoh nevojën e formimit të një Fondi rajonal për viktimat. (Nataša Kandić, Fondi për të drejtën humanitare, Beograd, Serbi, Kosovë, Kosultimet nacionale me organizatat joqeveriater, Prishtinë/ Priština, Kosovë, 19 dhjetor 2009.)

Konsultimet me bashkësinë lokale mbi iniciativën për formimin e KOMRA-s

Novi Pazar, Serbi
21 dhjetor 2009

Konsultimet lokale në Novi Pazar i kanë organizuar Këshilli i Sanxhakut për të Drejtat e Njeriut *Impuls* nga Tutini. Në debat kanë marrë pjesë 71 përfaqësues të organizatave joqeveritare, të punëtorëve të arsimit e kulturës, të gazetarëve, viktimave dhe qytetarë të interesuar. Mbi atë përse nevojitet KOMRA dhe cilat janë përvojat në punën e komisioneve në botë, kanë folur Sandra Orloviq (Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi) dhe Dragan Popović (Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Serbi). Si vëzhgues në tubim kanë marrë pjesë: Frantusanu Iulian, përfaqësues i OSBE, Ahmet Halilagiq, SCOPES, Novi Pazar, shefi i Zyrës rajonale të USAID Programi forcimi i sigurisë ekonomike, Marko Vujačić, nëpunës për marrëdhënie me publikun i Programit të zhvillimit të komunave në Serbinë Jugperëndimore PRO dhe Asmir Coković, zyra Forumi Civilian Friedensdienst në Novi Pazar. Mbi tubimin kanë raportuar "TV Jedinstvo" dhe "Sanxhačke novine."

Mendimet, propozimet dhe Rekomandimet e pjesëmarrësve

KOMRA është i rëndësishëm për Sanxhakun për shkak të gjithë asaj që ka ndodhur në periudhën prej vitit 1991 deri më 1995: rrëmbimet, vrasjet, shkatërrimi i pasurisë dhe përndjekja e myslimanëve.

KOMRA ka rëndësi të veçantë për Sanxhakun (...) duke pasur parasysh krejt atë që ka ndodhur në këtë hapësirë neuralgjike prej vitit '91 deri më '95. Por edhe më vonë (...) shkeljet e rënda të drejtave të njeriut, rrëmbimet, vrasjet, djegiet, rrethimi me topa e me tanke i qyteteve e katundeve, diskriminimi, përndjekja masive e popullatës, represioni masiv policor, kanë qenë në hijen e ngjarjeve në Kroaci, në Bosnjë dhe në Kosovë. Shumë krime në Sanxhak i janë lënë harresës. (...) Shteti duhet ta hetojë fatin e viktimave dhe familjeve të tyre t'ua kumtojë informatat relevante. (Semiha Kaçar, Këshilli i Sanxhakut për të Drejtat e Njeriut, Novi Pazar, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Novi Pazar, Serbi, 21 dhjetor 2009.)

Nëse mblidhen vetëm faktet mbi krimet e

luftës e të pasluftës vetëm pjesërisht do të arrihet qëllimi. Lypset edhe vërtetimi i shkaqeve.

Në qoftë se KOMRA do t'ia dilte vetëm ti mblidhte faktet mbi krimet e kryera gjatë luftës dhe pasluftës dhe mbi shkeljen e rëndë të drejtave dhe lirive të njeriut, dhe e gjithë kjo të dokumentohet, atëherë pjesërisht do të arrihej qëllimi i caktuar sepse, sipas rregullit, ajo që nuk është shënuar as që ka ndodhur. (Xhemal Halilović, Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Veprimtari Humanitare Priboj, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Novi Pazar, Serbi, 21 dhjetor 2009.)

(...) pra, nevojitet edhe vërtetimi i shkaqeve.. Ato shkaqe po veprojnë në vazhdimësi dhe ato janë diç që e bënë se pikërisht të gjitha viktimat kanë qenë viktimat pa fajësi. (Mehmed Slezović, Qarku Intelktual i Sanxhakut, Novi Pazar, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Novi Pazar, Serbi, 21 dhjetor 2009.)

(...) konsideroj se shkaqet e të gjitha këtyre ngjarjeve në këto hapësira duhet kërkuar në programet nacionaliste serbe, nga Naçertanja deri më sot, domethënë prej para rreth 150 vjetësh, sepse boshnjakët në këto hapësira veç kanë përjetuar një dhjetë gjenocide dhe kjo po përsëritet në vazhdimësi nga e kaluara në të ardhmen, dhe periodikisht po përsëritet çdo njëzetë, tridhjetë deri pesëdhjetë vjet. Dhe në qoftë se eliminohen ato shkaqe, respektivisht në qoftë se shteti nuk heq dorë publikisht nga këto programe të veta nacionaliste, ato do të përsëriten edhe në të ardhmen. (Xhemal Halilović, Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Veprimtari Humanitare Priboj, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Novi Pazar, Serbi, 21 dhjetor 2009.)

KOMRA duhet ta mbulojë kohën nga vdekja e Josip Broz Titos, dhe lypset të merret me shkaqet.

Mendoj se do të ishte mirë që të fillohet me kohën nga vdekja e Josip Brozit e këndeje. Ndryshe, në atë kohë të veprimt të tij dhe në të gjitha kohët e mëparshme do të ishte tepër gjerë me këtë të merremi tash dhe është thënë çka është thënë. Natyrisht shkaqet janë qenësore për të gjitha ngjarjet e viteve të 90-ta, dhe gjithsesi shkaqet edhe nisin pas vdekjes së Josip Brozit, kuptohet edhe periudha e kësaj gjendje të luftës gjatë viteve 1991- 1995. (Shemsudin Kurtović, qytetar nga Tutini, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Novi Pazar, Serbi, 21 dhjetor 2009.)

KOMRA u ofron viktimave hapësirë që ta zbulojnë çka u ka ndodhur, kurse shoqërisë mbështetjen për rishikim moral të së kaluarës.

(...) kjo është mundësi më shumë për viktimat që thjeshtë të kenë një front bukur më të gjerë të paraqitjes së vet, të veprimit të vet dhe të zbulimit të vet të gjithë asaj me çka akoma po ballafaqohen duke qenë se drejtësia ende nuk ka arritur tek ata dhe se drejtësia vërtetë po përballët me pengesa të mëdha.

(...) ky KOMRA, mund të jetë mbështetje në ndonjë kuptim pozitiv për ata, por edhe një rishikim i madh moral për krejt atë që sot është e pranishme këtu. (Mehmed Slezoviq, Rrethi Intelktual i Sanxhakut, Novi Pazar, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Novi Pazar, Serbi, 21 dhjetor 2009.)

Theksin duhet vihet në mbrojtjen e viktimave civile. Në sigurimin e mjeteve për reparacione duhet të marrin pjesë shtetet dhe ata që janë pasuruar në luftë.

Theksi ynë duhet të vihet në mbrojtjen e viktimave civile. Në reparacion, domethënë në kompensimin viktimave të dëmtuara ose familjeve të tyre (...) shteti duhet të marrë pjesë në reparacionin e viktimave dhe sidomos duhet futur që edhe përfituesit e luftës, ata që kanë formuar firma që janë pasuruar gjatë kohës së luftës e tash janë afarist dhe tajkun prestigjioz (...) edhe ata duhet nga kapitali privat, gjegjësisht të firmave të tyre, të marrin pjesë në reparacion (...) shkalla e shkëljes së të drejtave të njeriut në Serbi, në Sanxhak, ka qenë mbi shkallën e shkëljes së të drejtave të njeriut në Kosovë. Këtu (...) viktimat civile i janë nënshtruar torturës, para se gjithash të policisë shtetërore, shërbimeve sekrete, sigurimit të shtetit, gjykimeve joparimore e jo të ndershme, gjykatave tona, prokurorive dhe kryesisht sistemit të drejtësisë. (Alija Haliloviq, Forumi Qytetar, Novi Pazar, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Novi Pazar, Serbi, 21 dhjetor 2009.)

Për viktimat nga katundet e dëbuara në komunën e Pribojit është drejtësi të dëmshpërblehen dhe tu kompensohet pasuria.

Mënyra e vetme e mundshme që një pjesë e drejtësisë (...) tu ofrohet atyre qytetarëve është që (...) ata njerëz të dëmshpërblehen, tu kompensohet pasuria, sepse dhjetë vjet nuk kanë mundur të shkojnë në pronat e veta, nuk kanë mundur ta punojnë tokën. E ato dhjetë vjet kanë qenë të detyruar të paguajnë tatim, sepse nuk ka mundur ta vërtetojë librezën e

shëndetësisë nëse nuk e ka paguar tatimin. (Ekrem Haxhiq, Shoqata për Mbrojtjen e të Drejtave të të Dëbuarve dhe të Shpërngulurve nga Komuna Priboj, Konsultimet me bashkësinë lokale, Novi Pazar, Serbi, 21 dhjetor 2009.)

Amnistia mundëson që kryesit ti paraqesin të dhënat mbi krimet të cilat viktimat nuk i dinë.

(...) tek krimet e luftës me rëndësi të jashtëzakonshme mund të jetë premtimi i faljes apo amnistisë për krimet. (...) dëgjimi i kryesit është jashtëzakonisht i rëndësishëm, ndoshta madje me rëndësi edhe më të madhe nga dëgjimi i viktimave. Sepse ne në esencë e dimë çka kanë përjetuar viktimat, por nuk e dimë çfarë kanë të thënë për këtë kryesit. (Emir Fetahoviq, Këshilli i Sanxhakut për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, Novi Pazar, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Novi Pazar, Serbi, 21 dhjetor 2009.)

Familjet e viktimave presin që KOMRA të kontribujë që kryesit të dënohen, që të gjenden mbeturinat mortore të personave të zhdukur e të vrarë dhe ti mbrojnë ata nga poshtërimi.

(...) ne familjarët presim nga ky komision që të procedohen të gjithë kryesit, e që ne të vijmë tek mbetjet mortore dhe që këtyre familjeve (prindërve të viktimave) t'u mundësohet në njëfarë mënyre të vdesin me dinjitet. (Nail Kajeve, Shoqata e Familjeve të të Rrëmbyerve në Shterpci, Prijepole, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Novi Pazar, Serbi, 21 dhjetor 2009.)

KOMRA ka potencial të ndërtojë sistemin e vlerave të pranueshëm për të gjithë në rajon.

KOMRA duhet ti nis aktivitetet e veta, të orvatët të (ndërtojë) një sistem komplet të vlerave i cili mund të jetë i pranueshëm për të gjithë. (Dushan Nicevqi, Universiteti Internacional në Novi Pazar, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Novi Pazar, Serbi, 21 dhjetor 2009.)

Mediat janë të rëndësishme për afirmimin e Komisionit, por KOMRA lypset ta shqyrtojë rolin e tyre në shpërthimin e urrejtjes..

Viktimat qo po dëshmojnë në Gjykatën e Hagës po përjetojnë turp sa i përket raportimit nga gjykimi i të burgosurve të Hagës. (...) Roli i veçantë i mediave është i dyfishtë. Në shqyrtimin e rolit të tyre në aktin e shpërthimit të urrejtjes, por edhe në rolin

e afirmimit të përpjekjeve të KOMRA-s që të dilet nga e kaluara. Domethënë, kërkon qëndrim më të pavarur të mediave ndaj viktimave dhe krimeve në këtë vend. (Shaban Sharenkapiq, Qendra Kulturore -Damad, Novi Pazar, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Novi Pazar, Serbi, 21 dhjetor 2009.)

Duhet gjetur mënyrën se si mediat që i kanë kontribuar fashistizimit të përfshihen në de-fashistizimin e shoqërisë.

(...) në faktin se shtetet nuk kanë bërë asgjë, KOMRA është përgjigje. Dhe kjo e arsyeton karakterin rajonal të Komisionit.(...) unë pajtohem plotësisht se KOMRA duhet ta përfshijë tërë sistemin, edhe mediat të cilat edhe kanë kontribuar në fashistizimin e shoqërisë, lypset gjetur model që po ato medie të njëjta të përfshihen në de-fashistizimin e shoqërive tona. (Sabina Taloviq, Gratë në të Zeza, Pljeve, Mali i Zi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Novi Pazar, Serbi, 21 dhjetor 2009.)

Dëshmimi publik i viktimave është aktivitet i rëndësishëm i KOMRA, por do të ketë ndikim nëse e transmetojnë mediat me frekuenca kombëtare.

Pra, dëgjimet publike absolutisht po, por ekskluzivisht në media që kanë frekuenca kombëtare. Mendoj se nuk ka kurrfarë dobie nëse këtë do ta emetonte "Polimlja" ime apo mediat me dëgjueshmëri lokale (...) dhe elitat nacionale dhe ekstremiste të viteve të 90-ta me rrëfimet e veta mbi luftëtarët kanë cekur se ata atje po punojnë diçka pikërisht në mediat me frekuenca kombëtare dhe mbulim kombëtar. (Muharem Mutavxhija, TV Polimlje, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Novi Pazar, Serbi, 21 dhjetor 2009.)

Fëmijët edukohen dhe arsimohen në gënjeshttrat mbi të kaluarën.

E keqja është mbjell në librat shkollor dhe ne që sot kemi rastin të edukojmë e arsimojmë, çdo ditë po i shkelim të drejtat elementare të fëmijëve; bie fjala, pjesëtarin e pakicës kombëtare boshnjake apo të kombit, si të doni, dhe pjesëtarët e të gjithë atyre për të cilat demokracia është e shenjtë, secilin të ri e të re imanente, bashkëkohore dhe të arsimuar. (Kemal Xhemiq, Shoqata e Qytetarëve "Gest" nga Tutini, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Novi Pazar, Serbi, 21 dhjetor 2009.)

KOMRA lypset ta pranojë dallimin midis

ideologjisë e cila bënë thirrje për krim, për gjenocid dhe ideologjisë së zakonshme.

(...) Komisioni nuk mund të jetë neutral ndaj ideologjive. (...) Fjala është për ideologjinë e të keqes e cila bënë thirrje për urrejtje, për vrasje, nëse shpie në spastrim etnik, nëse është eufemizëm për krim, gjenocid e kështu me radhë. Dhe, ne duhet të bëjmë dallimin midis ideologjisë së të keqes dhe ideologjisë së zakonshme.... (Ramiz Crnishanin, Rrethi Intelktual i Sahnxahkut, Novi Pazar, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Novi Pazar, Serbi, 21 dhjetor 2009.)

KOMRA duhet të ketë zyrat në bashkësitë ku kanë ndodhur krimet.

(...) ja ky është një propozim që kjo zyrë që planifikohet të jetë në Novi Pazar. Pazari si një qendër e Sanxhakut duhet ta ketë atë Komisioni i cili do ti hetojë, shqyrtojë dhe të gjithë atyre personave, viktimave, tu ndihmojë. (Nazim Haliloviq, Forum i për Tolerancë dhe Jetë të Përbashkët, Tutin, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Novi Pazar, Serbi, 21 dhjetor 2009.)

(...) nga arsyet praktike konsideroj se duhet të paktën të formohet ndonjë nën-zyrë në ato hapësira ku më së shumti kanë ndodhur shkeljet më të rënda të drejtave dhe lirive të njeriut. Natyrisht se unë konkretisht po mendoj në Pribojin, në rrethinën e tij të afërt e të largët. Sepse atje kanë ndodhur krime masive, spastrime etnike, eksode, që ka rezultuar me ndryshimin e strukturës demografike të popullatës dhe shpërnguljen e më shumë se gjysmës së popullatës boshnjake. (Xhemal Haliloviq, Këshilli për të Drejtat e Njeriut dhe Veprimtarinë Humanitare, Priboj, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Novi Pazar, Serbi, 21 dhjetor 2009.)

KOMRA është rrugë e mirëfilltë për t'u shtuar e vërteta dhe që viktimat të shikohen si qenie njerëzore, e jo si pjesëtarë të grupeve etnike. Për punën e pavarur të komisionit është qenësore të përzgjidhen njerëzit profesionist dhe të moralshëm.

(...) kjo është mënyra dhe rruga e mirëfilltë që të arrihet e vërteta e caktuar (...) mënyra si do të përzgjidhen njerëzit është shumë qenësore, besueshmëria e tyre moral dhe profesionale, kjo pjesë e menaxhmentit është shumë e rëndësishme. Ssepse nga përzgjedhja e njerëzve varet se do të funksionojë e gjithë kjo në mënyrë organizative. Dhe e dyta (...)

është si të arrihet kjo formulë që viktimën të mos e shikojmë vetëm me anë të pjesëtarëve të popullit të vet, por të arrijmë një formë njerëzore që pavarësisht cilit grup etnik i takon viktimja, viktimën ta kundrojmë në atë mënyrë. (Sllobodan Martinović, Argument, Prijepole, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Novi Pazar, Serbi, 21 dhjetor 2009.)

Për boshnjakët është me rëndësi që të gjithë qytetarët të jenë të barabartë përpara ligjit.

Sa i përket pajtimit nuk di me kë ne duhet të pajtohemi, e ky është një nga qëllimet e KOMRA. Sepse ne boshnjakët në Sanxhak nuk jemi përta me askënd, as jemi rrahur, nga ne nuk ka qarë asnjë fëmijë serb, askujt nuk i kemi bërë kurrfarë dëmi. Prandaj s'kemi me kënd të pajtohemi, ne vetëm po kërkojmë që ky shtet të ketë ndaj nesh qëndrim si ndaj gjithë qytetarëve në harmoni me ligjin. (Xhemal Halilović, Këshilli për të Drejtat e Njeriut dhe Veprimtarinë Humanitare, Priboj, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Novi Pazar, Serbi, 21 dhjetor 2009.)

KOMRA duhet ta iniciojë dhe të rekomandojë rehabilitimin psikik-social, punues e familjarë të viktimave.

(...) a mund t'u ndihmojë KOMRA në ndonjë mënyrë viktimave, të paktën që në raportet e veta ta paraqet çështjen e rehabilitimit të viktimave. (...) cilat janë mundësitë që vërtetë tu ndihmohet atyre njerëzve që të kalojnë nëpër rehabilitimin psikik-social, punues e familjarë. Ky është aspekt i cili po dëgjohet shumë rrallë, e që është shumë i rëndësishëm edhe pse njerëzit krahas problemeve konkrete të jetës, e kanë edhe këtë lloji të problemit. Shteti kësaj duket ti kushtojë më shumë kujdes, gjykatat nuk po i kushtojnë, por ndoshta një organizatë si kjo tu ndihmojë njerëzve të cilët nuk e kanë fituar drejtësinë në gjyq, për ta iniciuar këtë çështje dhe në këtë mënyrë tu ndihmojë njerëzve. (Edin Jusović nga Tutini, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Novi Pazar, Serbi, 21 dhjetor 2009.)

Shteti e ka financuar policinë e cila i ka munduar njerëzit dhe e ka nxitur qëndrimin afirmativ ndaj viktimave. Këto janë pengesat kryesore të themelimit të KOMRA-s.

(...) njerëzit i ka rrëmbyer dhe munduar policia e shtetit, të cilën ata e kanë financuar me tatimin e vet, e gjithë kjo do të jetë shumë vështirë. Proble-

mi tjetër në të cilin dua ta fokusojë vëmendjen, ndonëse është vështirë numerikisht të hulumtohet, është problemi i mos-dënimat apo i qëndrimit afirmativ ndaj krimeve që kanë ndodhur. (Sedat Vrciq, Flores, Sjenicë, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Novi Pazar, Serbi, 21 dhjetor 2009.)

Do të jetë vështirë të fitohet besimi i viktimave që serish të flasin.

Kur them viktimat unë mendoj në njerëzit që janë viktimja direkte, që janë goditur, mbi të cilat është ushtruar torturë (...) mendoj se ata njerëz nuk po dëgjohen sa duhet dhe kjo do të jetë punë e vështirë që ta fitojmë besimin e atyre. (Omer Bronja, Urban In, Novi Pazar, Serbi Konsultimet me bashkësinë lokale, Novi Pazar, Serbi, 21 dhjetor 2009.)

Konsultimet me përfaqësuesit e bashkësive lokale mbi Iniciativën për formimin e KOMRA-s

Zaječar, Serbi
22 dhjetor 2009.

Konsultimet i ka organizuar organizata joqeveritare Iniciativa e Zaječarit. Pjesëmarrësit (30) kanë qenë aktivistë për të drejtat e njeriut, qytetarët, anëtarët e partive politike, përfaqësuesit e vetëqeverisjes lokale të Zaječarit, Knjazhevcit dhe Borit, përfaqësuesit e pakicave kombëtare, të gjyqësisë, arsimit e tjerë. Iniciativën KOMRA e kanë përfaqësuar Maja Stojanović (Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut, Serbi) dhe Millanka Shaponja-Haxhiq (Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi). Mbi tubimin kanë raportuar mediat lokale.

Propozimet, mendimet dhe Rekomandimet e pjesëmarrësve

Është më mirë që parlamenti të miratojë aktin mbi themelimin e Komisionit rajonal, sepse kjo do ta përfshinte diskutimin më të gjerë dhe më shumë mendime.

(...) mendoj se do të ishte më mirë sikur ta merrte mbështetjen zyrtare me anë të parlamentit, sepse do të përfshinte një diskutim më të gjerë, një debat më të gjerë dhe më shumë mendime, ngase kur presidenti ta konfirmonte me dekret ndoshta kjo në këto hapësira do të kuptohej si akt i nepotizmit.

(Sreqko Qeferjanoviq, Këshilli Komunal i Partisë Demokratike në Zajeçar, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Zajeçar, Serbi, 22 dhjetor 2009.)

KOMRA nuk duhet të kthehet në të kaluarën e thellë. Përfshirja e ngjarjeve para vitit 1989 do ti relativizojë krimet. Raporti duhet pasqyrojë krimet sipas komunave, ku kanë ndodhur.

E tash kur është fjala për periudhën kohore propozimi im është që kjo të jetë periudha 1991 – 2001. Pra të mos jetë viti përfundimtar viti 1999 por të jetë viti 2001, e kjo do të ndërliqej këtu me territorin e punës së Komisionit për shkak se ai duhet, natyrisht, të merret me ngjarjet edhe në Slloveni dhe në Maqedoni. Vitin 2001 pikërisht e përmenda për shkak të ndodhive në Maqedoni që për afërsisht kanë qenë atëherë, dhe natyrisht për hartimin e raportit final dhe për veprim nëpër komuna ku kanë ndodhur krimet e luftës. (Dragana Nikoliq, Këshilli për Iniciativën Qytetare, Nish, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Zajeçar, Serbi, 22 dhjetor 2009.)

Vërtetë mendoj se lypset të fokusohemi në atë periudhë prej vitit 1989 e këndeje. Ajo që ka qenë para kësaj (...) ajo do të ishte relativizim i gjithë kësaj. Supozoj se kjo është punë e historianëve, e jo punë e Komisionit. (Zoran Stankoviq, Këshilli Komunal i LDP në Zajeçar, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Zajeçar, Serbi, 22 dhjetor 2009.)

(...) sa i përket kohës konsideroj se duhet të përfshihet edhe periudha para vitit 1991, sepse gjithsesi nuk mundet asnjë ngjarje historike të kundrohet vetëm më 1991-2001. Domethënë edhe para vitit 1991, e sa i përket terminimit të fundit, mendoj edhe pas vitit 2000, sepse e kemi vitin 2001 në Luginën e Preshevës ... (Çedomir Vranjanac, qytetar nga Zajeçari, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Zajeçar, Serbi, 22 dhjetor 2009.)

Detyra e vetme e mundshme e Komisionit rajonal është që të mbledh faktet. Askush nuk mund të lëshohet në kualifikimin juridik të krimeve të luftës.

(...) jam i bindur se detyra parësore dhe e vetme e mundshme e këtij Komisioni është që ti vërtetojë vetëm faktet dhe asgjë tjetër. (...) Të vetmit që janë kompetentë ta kualifikojnë ndonjë vepër, janë organet e gjyqësisë sipas të gjitha ligjeve, sipas të gjitha kushtetutave, sipas të drejtës ndërkombëtare. Domethënë, Komisioni assesi nuk guxon të kuali-

fikojë diç si krim luftime. (Andreja Rajković, gazeta Timok, Zajeçar, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Zajeçar, Serbi, 22 dhjetor 2009.)

Komisioni duhet të merret edhe me faktet edhe me shkaqet e luftës.

(...) Komisioni duhet të merret me faktet dhe me shakat e luftës (...) këtu po shkruan edhe me pajtimin. Hajde ta quaj unë ashtu për shkak se duhet ta kuptojmë faktin se ata njerëz nuk ia kanë mësyre njëri tjetrit tek ashtu. Veç kanë qenë të frymëzuar me propagandën serioze nacionale dhe sikur ato shkaqe ti sqaronim, atëherë të gjithë ne do ta kishim më lehtë të shohim se çka i kemi bërë njëri tjetrit. (Sreqko Qeferjanoviq, Këshilli Komunal i Partisë Demokratike Zajeçar, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Zajeçar, Serbi, 22 dhjetor 2009.)

Mendoj se historia si shkencë duhet të flas mbi faktet dhe shkaqet e luftës, Komisioni të mos e marrë këtë të gatshme por nga aspekti i vet të flas mbi faktet dhe shkaqet e luftës. Mbi rrjedhën e ngjarjeve gjithsesi nëse do të bëhej në përgjithësi me rrjedhën e ngjarjeve të luftës, e patjetër regjistrimi i viktimave. Mendoj se ky do të ishte roli qenësor i Komisionit të atillë dhe konsideroj se duhet të jetë edhe në shkallë kombëtare dhe në atë rajonale. (Çedomir Vranjanac, qytetar nga Zajeçar, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Zajeçar, Serbi, 22 dhjetor 2009.)

Të hetohet pësimi i romëve në luftë.

Sa janë vlarë me përqindje romë në luftëra, sa për qind është pjesëmarrja e romëve në popullatën e tërësishme, të shihet një dallim i hatashëm. Apo, themi të konfirmohet sa djem të doktorëve apo të kryetarëve të komunave apo diç ngjashëm, janë vlarë në ato luftëra, dhe do të shihni se aty diçka nuk përputhet. Domethënë, këto janë fakte të cilat padyshim vënë në dukje se nuk kanë qenë të gjithë njësoj të trajtuar nga populli i vet. (Sava Smailoviq, Qendra e Romëve të Timokut në Zajeçar, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Zajeçar, Serbi, 22 dhjetor 2009.)

KOMRA është rast i mirë për viktimat që të mësojnë ku janë të zhdukurit e tyre, kush janë kryesit, përse e kanë bërë këtë – që të munden me këtë të vazhdojnë të jetojnë.

Gjithashtu do të shtoja se ky (KOMRA) është shumë i rëndësishëm për viktimat. Përse? Sepse

supozoj se shumica nga ato vec kanë mjaftë arsye të marrin pjesë në këso tribunash, të flasin në televizione të ndryshme, të bisedojnë me institucione të ndryshme, e që kjo të mos ketë ndonjë qëllim konkret, respektivisht që në fund të kësaj nuk kanë, ta quaj ashtu, kurrfarë fitimi. Ky ndoshta do të ishte rasti i mirë që me anë të diçka si kjo ata edhe të mësojnë se kush janë, ku janë të zhdukurit e tyre bie fjala, ose kush janë kryesit, përse e kanë bërë këtë, në mënyrë që të mund të jetojnë me tutje me këtë. ((Srećko Qeferjanović, Këshilli Komunal i Partisë Demokratike Zaječar, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Zaječar, Serbi, 22 dhjetor 2009.)

Në diskutimin mbi Komisionin rajonal duhet përfshirë partitë opozitare dhe organizatat e luftëtarëve.

(...) në këto konsultime nuk ka përfaqësues të të ashtuquajturës opozitë e cila, çfarëdo që mendojmë ne për atë e që është me përcaktim nacionalist tek ne, ka dy milion e gjysmë votues në zgjedhje. Kjo lidhur me një milion nënshkrime që dëshironi ti grumbulloni në rajon, domethënë opozita menjëherë ju mbulon për nga forca. Gjithashtu këtu nuk po i shoh as përfaqësuesit e organizatave të luftëtarëve. (Andreja Rajković, gazeta Timok, Zaječar, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Zaječar, Serbi, 22 dhjetor 2009.)

Përfshirja e veteranëve dhe të ish kampistëve në diskutim, individualisht dhe me anë të shoqatave, do të sjellë më shumë të vërtetë.

Konsideroj se është me vend propozimi që veteranët të përfshihen me numër sa më të madh. Supozoj se në shkallën më të ulët ka qenë indoktrinimi i regjimit i cili i ka dërguar atje ku i ka dërguar. Unë personalisht i njoh nja dhjetë njerëz nga Rrethi i Zajeçarit që kanë qenë si në kampe si në fushëbeteja dhe pjesëmarrja e tyre do të kontribuonte dukshëm në paraqitjen e të vërtetës dhe të detajeve nga krejt ajo që kanë përjetuar. (Dejan Zdravković, Këshilli Komunal i LDP Zaječar, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Zaječar, Serbi, 22 dhjetor 2009.)

Komisioni duhet të merret edhe me viktimat e "veta" për të cilat janë përgjegjës eprorët.

Cilët jenë kriteret çka është krimi i luftës dhe çka është viktimë e luftës, dhe a do të merret KOMRA edhe me ato viktimë që janë viktimë e popullit të vet, e jo vetëm e popullit tjetër, sepse është fakt se të tilla ka pasur edhe tërthorazi edhe direkt. Sa për

shembull, dikush e dërgon kamionin dhe e dinë që është i minuar (terreni) dhe pala tjetër e njofton se është i minuar, por kjo nuk përfillet. Prandaj shtrohet pyetja viktimë të kujt janë ata njerëz, a janë të anës kundërshtare apo të palës së atij që ka urdhëruar. (Sava Smailović, Qendra e Romëve të Timokut në Zaječar, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Zaječar, Serbi, 22 dhjetor 2009.)

Të rinjtë duhet informuar dhe përfshirë në fushatën për grumbullimin e nënshkrimeve.

(...) ka shumë njerëz të rinj të cilët jo vetëm që nuk kanë informacione, por fare nuk kanë qenë të vetëdijshëm për ndodhitë luftarake në periudhën e viteve të 90-ta, dhe prandaj është e domosdoshme që më parë ata të informohen mbi këtë, por edhe me anë të organizatave të shoqërisë civile dhe me anë të sistemeve të ndryshme të përfshihen edhe në formimin e Komisionit. (Maja Stojanović, Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Zaječar, Serbi, 22 dhjetor 2009.)

Unë po hasi në problem të madh që moshatarët e mi nuk kanë absolutisht kurrfarë qëndrimi ndaj asaj çfarë ka ndodhur në hapësirën e ish Jugosllavisë. Mendoj se lypset ta shfaqni kujdes ndaj tyre dhe ata të informohen më shumë. (Sinisha Kodicović, Gjumnazi në Negotin, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Zaječar, Serbi, 22 dhjetor 2009.)

Të ndriçohet roli dhe përgjegjësia e të gjitha shërbimeve të sigurimit të shtetit për krimet e kryera.

Gjithsesi duhet marrë parasysh strukturën e Sigurimit të Shtetit nga i mbarë ky rajoni. E di se ato janë fajtorë për krejt që ka ndodhur, domethënë ato krime nuk i kanë bërë popujt, ato krime i kanë kryer ideologjitë dhe individët të cilët kanë qenë të frymëzuar të bëjnë diç të tillë. (...) Unë mendoj se këto janë elemente kuqe për ta mësuar të vërtetën (...). sepse ato kanë qenë frymëzues para cilës do strukture shtetërore, dhe të shumtën përgjegjës për gjithë atë që është shkallëzuar më vonë. (Miodrag Miloshević, Atelieu për Riparimin e Qytetit të Borit, Asociacioni për Zhvillimin e Komunës së Borit, Bor, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Zaječar, Serbi, 22 dhjetor 2009.)

KOMRA duhet të merret me shkëlqen e të drejtave të njeriut në Sanxhak gjatë viteve të 90-ta.

(...) Nuk janë vetëm krimet e luftës që kanë ndodhur në hapësirën e ish Jugosllavisë në periudhën prej vitit 1991 deri më 1999. Për shembull, çfarë ka ndodhur në Sanxhak po ashtu në vitet e 90-ta. Këto nuk kanë qenë direkt krime të luftës, por ju e dini se atje njerëzit, kryesisht të nacionalitetit mysliman, kanë qenë të munduar nga ana e pjesëtarëve të policisë, jo të formacioneve paramilitare, kjo dihet saktë, pos tjerash edhe të paramilitarëve. Mirëpo policia i ka marrë në pyetje njerëzit, i ka shoqëruar në biseda informative e kështu me radhë. Kjo po ashtu është një vepër e cila duhet të jetë e dënueshme, nuk është krim direkt i luftës, por unë mendoj se Komisioni duhet të merret me këtë problem. (Dragana Nikoliq, Këshilli për Iniciativën Qytetare, Nish, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Zajeçar, Serbi, 22 dhjetor 2009.)

Secili shtet duhet ta formojë komisionin e vet, kursye ai rajonal duhet të jetë mbi-komision.

Konsideroj se secili shtet lypset ta formojë komisionin e vet dhe pastaj të ekzistojë si ndonjë mbi-komision në qoftë se mundet të punojë objektivisht dhe pa anim, (Marko Ristiç, Administrata Komunale e Komunës së Knjazhevcit, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Zajeçar, Serbi, 22 dhjetor 2009.)

Në komision duhet inkuadruar ekspertë të profileve të ndryshme.

(...) ky Komision duhet të përbëhet nga ekspertët e historisë, sociologjisë, psikologjisë dhe të kategorive tjera të qytetarëve (...), Domethënë duhet të inkuadrohen edhe të rinjtë, pastaj pjesëmarrësit e të

gjitha këtyre konflikteve dhe qytetarët tjerë të cilët janë të interesuar për një lloj të këtillë të aksionit (...) Mendoj se lypset të ndriçohen të gjitha krimet e luftës, dhe ne si Union i Rumunëve të Serbisë dëshirojmë të japim kontribut në këtë kuptim. (Bojko Stanković, Unioni i Rumunëve të Serbisë "Dunav", Zajeçar, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Zajeçar, Serbi, 22 dhjetor 2009.)

Pra, ajo që unë e konsideroj është se Komisioni para se gjithash duhet të ketë njerëz ekspertë, pastaj njerëzit nga strukturat e ndryshme dhe se nuk mund të punojë vetëm një Komision. Ai duhet të ketë ndonjë nën-komision, s'di si të them, dhe të gjithë ata duhet të bashkëpunojnë me qëllim që të shihen ato fakte dhe ajo e vërtetë. (Sava Smailović, Qendra e Romëve të Tomokut në Zajeçar, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Zajeçar, Serbi, 22 dhjetor 2009.)

KOMRA duhet të merret edhe me viktimat e bombardimeve të NATO-s dhe ti hetojë nëse janë shfrytëzuar mjetet e palejueshme të luftës.

(...) qëndrimi im personal, një vështrim ndaj bombardimeve dhe (...) pësimi të civilëve të pafajshëm. Kemi rastin e bombardimit të kolonës së refugjatëve, pastaj të atij treni të njohur dhe disa raste tjera, a do të shqyrtohen ato si krime të luftës. Sepse, praktikisht janë bërë në luftë ... pastaj a paraqet përdorimi i bombave kasetë, që nuk janë të lejueshme me të drejtën ndërkombëtare luftarake, krim të luftës. (Srećko Qeferjanović, Këshilli Komunal i Partisë Demokratike në Zajeçar, Serbi, Konsultimet me bashkësinë lokale, Zajeçar, Serbi, 22 dhjetor 2009.)

PËRMBAJTJA

Konsultimet me bashkësinë lokale mbi Iniciativën për formimin e KOMRA- s Pulë, Kroaci 1 korrik 2009.....	3
Konsultimet me bashkësinë lokale mbi Iniciativën për formimin e KOMRA- s Zvornik, BeH 18 korrik 2009.....	6
Konsultimet me bashkësinë lokale mbi Iniciativën për formimin e KOMRA- s Knin, Kroaci 4 gusht 2009.....	10
Konsultimet lokale me shoqatat e viktimave mbi Iniciativën për formimin e KOMRA- s Mitrovicë, Kosovë 5 shtator 2009.....	12
Konsultimet me bashkësinë lokale mbi Iniciativën për formimin e KOMRA- s Krushevc, Serbi 7 shtator 2009.....	15
Konsultimet kombëtare me të rinjtë mbi Iniciativën për formimin e KOMRA- s Sarajevë, BeH 19 shtator 2009.....	19
Konsultimet me bashkësinë lokale mbi Iniciativën për formimin e KOMRA- s Pakrac, Kroaci 22 korrik 2009.....	23
Konsultimet kombëtare me intelektualët mbi Iniciativën për formimin e KOMRA- s Novi Sad, Serbi 25 shtator 2009.....	27
Konsultimet rajonale me gazetarët mbi Iniciativën për formimin e KOMRA- s Novi Sad, Serbi 26 shtator 2009.....	32
Konsultimet kombëtare me të rinjtë mbi Iniciativën për formimin e KOMRA- s Prishtinë, Kosovë 30 shtator 2009.....	39
Konsultimet me bashkësinë lokale mbi Iniciativën për formimin e KOMRA- s Vukovar, Kroaci 30 shtator 2009.....	43
Konsultimet me bashkësinë lokale mbi Iniciativën për formimin e KOMRA- s Doboj, Bosnja e Hercegovina 3 tetor 2009.....	47
Konsultimet kombëtare me organizatat e grave, politikanet, artistet, gazetarët mbi Iniciativën për formimin e KOMRA- s Beograd, Serbi 9 tetor 2009.....	51
Konsultimet me bashkësinë lokale mbi Iniciativën për formimin e KOMRA- s Cazin, Bosnja e Hercegovina 10 tetor 2009.....	54
Konsultimet kombëtare me besimtarët dhe bashkësitë fetare mbi Iniciativën për formimin e KOMRA- s Zagreb, Kroaci 16 tetor 2009.....	58

Konsultimet me bashkësinë lokale mbi Iniciativën për formimin e KOMRA- s Osijek, Kroaci 17 tetor 2009.....	60
Konsultimet me bashkësinë lokale mbi Iniciativën për formimin e KOMRA- s Kikindë, Serbi 17 tetor 2009.....	63
Konsultimet kombëtare me të rinjtë mbi Iniciativën për formimin e KOMRA Banja Llukë, BeH 17 tetor 2009.....	66
Konsultimet kombëtare me grupin e grave mbi Iniciativën për formimin e KOMRA- s Podgoricë, Mali i Zi 23 tetor 2009.....	69
Konsultimet lokale me mbrojtësit mbi Iniciativën për formimin e KOMRA- s Donja Stubica, Kroaci 28 tetor 2009.....	71
Konsultimet lokale me shoqërinë civile mbi Iniciativën për formimin e KOMRA-s Mitrovicë, Kosovë 29 tetor 2009.....	77
Konsultimet kombëtare me intelektualët mbi Iniciativën për formimin e KOMRA- s Sarajevë, Bosnja e Hercegovina 7 nëntor 2009.....	80
Konsultimet kombëtare me grupet e grave mbi Iniciativën për formimin e KOMRA- s Tuzëll, BeH 11 nëntor 2009.....	83
Konsultimet me bashkësinë lokale mbi Iniciativën për formimin e KOMRA- s Shabac, Serbi 13 nëntor 2009.....	86
Konsultimet me bashkësinë lokale mbi Iniciativën për formimin e KOMRA Vllasenicë, Bosnjë e Hercegovinë, 14 nëntor 2009.....	89
Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare mbi Iniciativën për formimin e KOMRA- s Sarajevë, Bosnjë e Hercegovinë 21 nëntor 2009.....	92
Konsultimet me bashkësinë lokale mbi Iniciativën për formimin e KOMRA- s Zrenjanin, Serbi 28 nëntor 2009.....	96
Konsultimet me bashkësinë lokale mbi Iniciativën për formimin KOMRA-s Bërçko, BeH 5 dhjetor 2009.....	99
Konsultimet kombëtare me kampistët (llogorashët) mbi Iniciativën për formimin e KOMRA-s Sarajevë, BeH 10 dhjetor 2009.....	102
Konsultimet kombëtare me organizatat joqeveritare mbi Iniciativën për formimin e KOMRA-s Beograd, Serbi 17 dhjetor 2009.....	105
Konsultimet kombëtare me intelektualët mbi Iniciativën për formimin e KOMRA- s Podgoricë, Mali i Zi 17 dhjetor 2009.....	111

Konsultimet nacionale me organizatat joqeveritare mbi Iniciativën për formimin e KOMRA- s	
Prishtinë, Kosovë	
19 dhjetor 2009.....	115
Konsultimet me bashkësinë lokale mbi iniciativën për formimin e KOMRA-s	
Novi Pazar, Serbi	
21 dhjetor 2009.....	118
Konsultimet me përfaqësuesit e bashkësive lokale mbi Iniciativën për formimin e KOMRA- s	
Zajeçar, Serbi	
22 dhjetor 2009.....	121

Botuesi:

Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë

Për botuesin:

Bekim Blakaj

Tirazhi:

500

Shtypi:

Publikum

Beograd, mars 2009.

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare
e Kosovës

342.72/.73(497.1)(063)

Procesi konsultativ mbi iniciativën
për themelimin e KOMRA-s : pasqyrë e
mendimeve, propozimeve dhe rekomandi-
meve : korrik-dhjetor 2009 / Koalicioni për
KOMRA. - Prishtinë : Fondi për të Drejtën
Humanitare, 2010. - 127 f. ; 21X27 cm.

ISBN 978-9951-8769-1-9